REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

SENATI AKADEMIK

MIRATOHET

Kryetari i Senatit Akademik

Prof. Dr. Akli Fundo

RAPORTIM VJETOR PËR VEPRIMTARINË E KRYER PËR VITIN AKADEMIK 2024 –2025

Drejtor i Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve:	Prof. Dr. Elson Agastra
Drejtor i Drejtorisë së Kurrikulave:	Prof. Asoc. Mimoza Cukalla
Drejtor i Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë:	Prof. Asoc. Gjergji Islami
Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike:	Prof. Asoc. Stela Jorgji (Fortuzi)
Drejtor i Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit:	Z. Robert Kodra
Drejtor i Drejtorisë Ekonomike:	Znj. Elvana Ndreca

Tiranë 2026

E drejta e autorit © 2026,

Universiteti Politeknik i Tiranës

Ky dokument përmban informacion publik dhe të verifikueshëm.

Ndalohet riprodhimi ose shpërndarja e tij tek të tretët, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Përmbajtja

Përmbajtja 3

Lista e tabelave 8

Lista e figurave 11

Lista e përkufizimeve, akronimeve 12

1 Qëllimi i raportimit 13

1.1 Objektivat specifike të raportimit 13

1.2 Rubrikat kryesore të raportimit 13

1.2.1 Të dhëna të përgjithshme mbi personelin e njësive kryesore 14

1.2.2 Të dhëna të përgjithshme mbi personelin akademik 16

2 Mësimdhënie, kërkim shkencor, veprimtari krijuese dhe inovacion 20

2.1 Mësimdhënia 20

2.2 Kërkim shkencor dhe veprimtari krijuese dhe inovacion 23

2.2.1 Qëllimi i UPT-së në fushën e kërkimit Shkencor: 23

2.2.2 Realizimi i objektivave krahasuar me planin strategjik të UPT-së 24

2.2.3 Strukturat përgjegjëse 34

2.2.4 Qëllimi dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit 36

3 Bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte 65

3.1 Bashkëpunimi ndërinstitucional 65

3.2 Kërkim shkencor dhe projekte për njësitë kryesore 67

3.2.1 Politikat e kërkimit shkencor 67

3.2.2 Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës 68

3.2.3 Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave 69

3.2.4 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike 69

3.2.5 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike 71

3.2.6 Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike 72

3.2.7 Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit 76

3.2.8 Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit 76

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

3.2.9 Instituti i Gjeoshkencave 76

3.3 Projekte të kërkimit shkencor 80

3.4 Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien 82

3.4.1 Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës 82

3.4.2 Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave 83

3.4.3 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike 83

3.4.4 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike 84

3.4.5 Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike 84

3.4.6 Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit 88

3.4.7 Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit 88

3.4.8 Instituti i Gjeoshkencave 89

3.5 Produktet e kërkimit shkencor 89

3.5.1 Kërkimi shkencor në njësitë kryesore të UPT 89

3.5.2 Botime të aktivitetit shkencor të realizuara 100

3.5.3 Pjesëmarrje në aktivitete kombëtare 104

3.5.4 Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare 105

3.5.5 Pjesëmarrje si anëtarë të bordit editorial në revista shkencore/botime 107

3.5.6 Pjesëmarrje në Komitete organizative/Shkencore (Kombëtare/Ndërkombëtare) 108

3.5.7 Pjesëmarrje si Relator/Reçensues artikulli shkencor Revistë 110

3.5.8 Pjesëmarrje në workshope/seminare 111

4 Infrastruktura në shërbim të kërkimit shkencor 113

4.1 Biblioteka shkencore qendrore 113

4.1.1 Analizë e aktivitetit të bibliotekës shkencore 113

4.1.2 Pasurimi i Bibliotekës Shkencore nëpërmjet blerjes 116

4.1.3 Pasurimi i Bibliotekës Shkencore nëpërmjet shkëmbimeve ndërbibliotekare 117

4.1.4 Promovimi dhe shpërndarja e botime studimore universitare (UPT) 122

4.1.5 Sigurimi online i literaturës nëpërmjet platformës ELTAB 124

4.1.6 Pasurimi i Bibliotekës Shkencore me literaturë nëpërmjet dhurimeve. 125

4.1.7 Pasurimi i koleksioneve të arkivës shkencore. 126

4.1.8 Katalogimi standard i materialeve bibliotekare të reja që hyjnë në bibliotekë. 128

4.1.9 Shërbime ndaj përdoruesve të bibliotekës. 129

4.1.10 Anëtarësimi në BSH, i përdoruesve 131
4.1.11 Qarkullimi i koleksioneve bibliotekare 131
4.1.12 Aktivitetet e kryera nga biblioteka e fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave: 132
4.1.13 Aktivitetet e kryera nga biblioteka e fakultetit Inxhinieri Ndërtimi: 133
4.2 Infrastruktura e kërkimit shkencor 134
4.2.1 Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës 134
4.2.2 Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave 134
4.2.3 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike 135
4.2.4 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike 135
4.2.5 Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike 136
4.2.6 Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit 136
4.2.7 Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit 136
4.2.8 Instituti i Gjeoshkencave 160

5 Programet e studimit 162
5.1 Cikli i Parë i Studimeve 164
5.2 Cikli i Dytë i Studimeve 164
5.3 Cikli i tretë i studimeve 165
5.4 Programet e studimit të formimit të vazhduar 165
5.5 Përshtatshmëria e programeve të studimit me misionin e UPT. 165

6 Organizimi i programeve të studimit dhe përmirësimi i tyre. 169
6.1 Organizimi i mësimdhënies 169
6.1.1 Struktura mësimore 169
6.1.2 Kriteret e pranimit 169
6.1.3 Kuotat e pranimit 170
6.1.4 Hyrjet për vitin akademik 2024-2025 171
6.2 Veprimtaria e sigurimit të brendshëm të cilësisë 172
6.2.1 Ndryshimet në aktet e brendshme rregullatore 174
6.2.2 Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë në UPT dhe fakultete 175
6.2.3 Veprimtaria për sigurimin e brendshëm të cilësisë në fakultet 176
6.3 Angazhimi i personelit akademik 179
6.4 Gjurmimi i të diplomuarve në UPT 185

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

6.4.1 Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit 187
6.4.2 Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike 188
6.4.3 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike: 190
6.4.4 Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës: 191
6.4.5 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike 191
6.4.6 Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit 192
6.4.7 FGJM- Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave 193
6.5 Këshillat studentorë dhe përfaqësimi në upt 195
6.6 Të dhëna për studentët dhe programet e studimit 196
6.6.1 Studentët e çregjistruar dhe transferuar. 200
6.6.2 Hyrjet dhe daljet e studentëve sipas cikleve të studimit 205
6.7 Të përgjithshme lidhur me procesin mësimor 212
6.7.1 Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit 212
6.7.2 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike 212
6.7.3 Fakulteti i Arkitekturës e Urbanistikës 213
6.7.4 Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike 213
6.7.5 Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave 214
6.7.6 Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit 214
6.7.7 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike 214
6.8 Bursat dhe përjashtimet/reduktimet e tarifave të studimit 215

7 Analiza e veprimtarisë së kryer për vitin akademik 2024-2025 223
7.1 Pikat e forta dhe afirmime 223
7.2 Mundësi për zhvillime të mëtejshme 226

SHTOJCA

Shtojca e tabelës 3: Marrëveshje të reja ndërinstitucionale

Shtojca e tabelës 4: Projekte të kërkmit shkencor të aplikuara për financim

Shtojca e tabelës 5: Aktivitetet e kërkimit shkencor të ralizuara nga njësitë kryesore

Shtojca e tabelës 5.1: Aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara si botime.

Shtojca e tabelës 5.2: Aktivitetet e kërkimit shkencor në konferenca, simpoziume, kongrese kombëtare.

Shtojca e tabelës 5.3: Aktivitetet e kërkimit shkencor në konferenca, simpoziume, kongrese

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

ndërkombëtare.

Shtojca e tabelës 5.4: Pjesëmarrje si anëtarë bordi editorial..

Shtojca e tabelës 5.5: Pjesëmarrje në Komitete organizative/Shkencore (Kombëtare/Ndërkombëtare)

Shtojca e tabelës 5.6: Pjesëmarrje në Komitete organizative/Shkencore (Kombëtare/Ndërkombëtare)

Shtojca e tabelës 5.7: Pjesëmarrje në workshope/Seminare

Shtojca Për Realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies

Shtojca për të dhëna mbi programet e studimit, përshtatshmëria dhe realizimi i synimeve

Shtojca për angazhimin e personelit akademik

Shtojca për hyrjet dhe daljet e studentëve sipas programeve të studimit

Shtojca për përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen a atyre që diploohen

Shtojca për vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë së studentëve për cikël studimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS REKTORATI SEKRETARIA

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

LISTA E TABELAVE

Tab. 1:	Personeli akademik, ndihmës, laborant dhe teknik në UPT.	14
Tab. 1.1	Të dhënat e stafit akademik sipas titujve/gradave shkencore dhe gjinisë	16
Tab. 2.1.1:	FAU – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.	36
Tab. 2.1.2:	FGJM – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor	37
Tab. 2.1.3:	FIE – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.	37
Tab. 2.1.4:	FIM – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.	38
Tab. 2.1.5:	FIMIF – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.	39
Tab. 2.1.6:	FIN – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.	40
Tab. 2.1.7:	FTI – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.	40
Tab. 2.1.8:	IGJEO – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.	41
Tab. 2.2.1:	FAU – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.	41
Tab. 2.2.2:	FGJM – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.	42
Tab. 2.2.3:	FIE – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.	42
Tab. 2.2.4:	FIM – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.	43
Tab. 2.2.5:	FIMIF – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.	44
Tab. 2.2.6:	FIN – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.	45
Tab. 2.2.7:	FTI – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.	46
Tab. 2.2.8:	IGJEO – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.	47
Tab. 2.3.1:	FAU – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.	47
Tab. 2.3.2:	FGJM – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.	48
Tab. 2.3.3:	FIE – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.	48
Tab. 2.3.4:	FIM – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.	49
Tab. 2.3.5:	FIMIF – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.	50
Tab. 2.3.6:	FIN – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.	51
Tab. 2.3.7:	FTI – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.	52
Tab. 2.3.8:	IGJEO – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.	52
Tab. 2.4.1:	FGJM – Forcimi i rolit të IGJEO si njësi kryesore kërkimore e ekselencës.	53
Tab. 2.4.2:	FIMIF – Forcimi i rolit të IGJEO si njësi kryesore kërkimore e ekselencës.	53
Tab. 2.4.3:	IGJEO – Forcimi i rolit të IGJEO si njësi kryesore kërkimore e ekselencës.	54
Tab. 2.5.1:	FAU – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.	55
Tab. 2.5.2:	FGJM – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.	56
Tab. 2.5.3:	FIE – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.	56
Tab. 2.5.4:	FIM – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.	56
Tab. 2.5.5:	FIMIF – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.	58
Tab. 2.5.6:	FTI – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.	58
Tab. 2.5.7:	IGJEO – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.	59
Tab. 2.6.1:	FAU – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT	60
Tab. 2.6.2:	FGJM – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT.	60
Tab. 2.6.3:	FIE – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT.	61
Tab. 2.6.4:	FIM – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT.	61
Tab. 2.6.5:	FIMIF – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT.	62
Tab. 2.6.6:	FTI – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT	63
Tab. 2.6.7:	IGJEO – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT.	64
Tab. 3:	Marrëveshje ndërinstitucionale të reja, viti akademik 2024-2025	67

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tab. Sh.3.1:	Marrëveshje të reja ndërinstitucionale me IAL vendase, viti 2024 - 2025	Sh. Tab. 3. 1
Tab. Sh.3.2:	Marrëveshje të reja ndërinstitucionale me IAL të huaja, viti 2024 – 2025	Sh. Tab. 3. 1
Tab. Sh.3.3:	MoU të reja me IAL të huaja, viti 2024 – 2025	Sh. Tab. 3. 3
Tab. Sh.3.4:	Marrëveshje ndërinstitucionale me kompani e biznese, viti 2024 – 2025	Sh. Tab. 3. 4
Tab. Sh.3.5:	Marrëveshje ndërinstitucionale me institucione shtetërore, viti 2024 – 2025	Sh. Tab. 3. 3
Tab. 4:	Projekte të kërkimit shkencor të aplikuar për financim në vitin akademik 2024-2025	81
Tab. Sh.4	Projekte të kërkimit shkencor të aplikuar për financim.	Sh. Tab. 4. 1
Tab. Sh.5:	Aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara nga njësitë kryesore.	Sh. Tab. 5. 1
Tab. 5.1	Aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara si botime.	101
Tab. Sh. 5.1:	Aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara si botime.	Sh. Tab. 5.1. 1
Tab. Sh. 5.2	Aktivitetet e kërkimit shkencor në konferenca, simpoziume, kongrese kombëtare.	Sh. Tab. 5.2. 1
Tab. Sh. 5.3	Aktivitetet e kërkimit shkencor në konferenca, simpoziume, kongrese ndërkombëtare	Sh. Tab. 5.3. 1
Tab. Sh. 5.4:	Pjesëmarrje si anëtarë bordi editorial..	Sh. Tab. 5.4. 1
Tab. Sh. 5.5:	Pjesëmarrje në Komitete organizative/Shkencore (Kombëtare/Ndërkombëtare)	Sh. Tab. 5.5. 1
Tab. Sh. 5.6:	Pjesëmarrje si Relator/Reçensues artikulli shkencor (Revistë kombëtare/ Ndërkombëtare)	Sh. Tab. 5.6. 1
Tab. Sh. 5.7:	Pjesëmarrje në workshope/Seminare	Sh. Tab. 5.7. 1
Tab. 6.1:	Infrastruktura kërkimore e FIMIF.	137
Tab. 6.2:	Infrastruktura kërkimore e IGJEO.	138
Tab. 6.3:	Infrastruktura kërkimore e FIM.	142
Tab. 6.4:	Infrastruktura kërkimore e FIN.	148
Tab. 6.5:	Infrastruktura kërkimore e FIE.	149
Tab. 6.6:	Infrastruktura kërkimore e FGJM.	150
Tab. 6.7:	Infrastruktura kërkimore e FTI.	156
Tab. 6.8:	Infrastruktura kërkimore e FAU.	160
Tab. 7:	Numri i programeve të studimit të ofruara në tre cikle studimi në UPT.	162
Tab. 8.1:	Ndryshimet në aktet e brendshme rregullatore.	174
Tab. 8.2:	Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë në UPT dhe fakultete.	175
Tab. 8.3:	Akreditime të programeve të studimit.	176
Tab. 8.4:	Trajnime në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë të realizuara nga ASCAL dhe/ose DSBC	177
Tab. 8.5:	Trajnime të tjera në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë ku ka marrë pjesë Personelit Akademik / Ndihmës-akademik / Administrativ	178
Tab. 8.6:	Aktivitete dhe procese për sigurimin e brendshëm në fakultete	178
Tab. 9:	Ngarkesa mësimore vjetore në auditor.	180
Tab. 9.1.:	Ngarkesa mësimore mesatare vjetore në auditor për PAE	181
Tab. 9.2.:	Ngarkesa Mësimore Vjetore Totale në Auditor dhe Jashtë Auditorit (e pagueshme).	184
Tab. 10:	Përmbledhëse mbi statusin e punësimit të të diplomuarve të përfshirë në procesin e gjurmimit.	187
Tab. 10.1:	Gjurmimi i studentëve që kanë përfunduar studimet në FIN-UPT.	188
Tab. 10.2:	Gjurmimi i studentëve që kanë përfunduar studimet në FIMIF-UPT.	189
Tab. 10.3:	Gjurmimi i studentëve që kanë përfunduar studimet në FIM-UPT.	190
Tab. 10.4:	Gjurmimi i studentëve që kanë përfunduar studimet në FAU-UPT.	191
Tab. 10.5:	Gjurmimi i studentëve që kanë përfunduar studimet në FIE-UPT.	192
Tab. 10.6:	Gjurmimi i studentëve që kanë përfunduar studimet në FTI-UPT.	193
Tab. 10.7:	Gjurmimi i studentëve që kanë përfunduar studimet në FGJM-UPT.	193
Tab. 11:	Përbërja e këshillave studentorë.	196
Tab. 12:	Studentët anëtarë dhe përfaqësues në organet e UPT.	196

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS · REKTORATI · SEKRETARIA

Tab. 13:	Numri i përgjithshëm i studentëve në UPT	197
Tab. 14:	Studentët e çregjistruar dhe transferuar.	201
Tab. 15:	Studentët e ciklit të parë që përfitojnë bursë sipas VKM nr.903, datë 21.12.2016 (përditësuar)	215
Tab. 16:	Studentët eciklit të parë që paguajnë tarifë (50% ose 100%) sipas VKM nr. 288, datë 266 21.05.2018 (përditësuar).	217
Tab. 17:	Studentët e ciklit të parë që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit, sipas VKM nr. 269, datë 29.03.2017 (përditësuar).	218
Tab. 18:	Studentët e cikli të dytë që paguajnë tarifë (50 %) të ndarë sipas kritereve të VKM nr. 780, datë 26.12.2018	220

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Të dhënat e stafit akademik sipas gjinisë 16
Figura 2: Të dhënat e personelit akademik sipas gjinisë dhe kualifikimeve. 18
Figura 3: Të dhënat e personelit akademik sipas kualifikimeve: V.A.2023-2024, V.A. 2024-2025. 18
Figura 4: Fitimi i titujve akademikë në UPT për njësi kryesore 2024-2025. 25
Figura 5: Fitimi i titujve akademikë në UPT dhe aplikime nga IAL të tjera, 2024-2025. 25
Figura 6: Mobilitete në hyrje dhe dalje në UPT për vitin akademik 2024-2025. 26
Figura 7: Aplikime për projekte për njësi kryesore. 32
Figura 8: Numri i botimeve të indeksuara Scopus ose/edhe WoS. 32
Figura 9: Marrëveshje bashkëpunimi të reja të nënshkruara gjatë vitit 2024-2025. 67
Figura 10: Projekte të kërkimit shkencor në UPT për V.A. 2024-2025. 81
Figura 11: Aktivitete të kërkimit shkencore të organizuar/bashkëorganizuar në UPT. 100
Figura 12: Numri i botimeve të ndara në kategori si dhe për njësi kryesore të UPT 101
Figura 13: Numri i botimeve për staf në seicilën njësi kryesore të UPT. 102
Figura 14: Numri i botimeve në bashkëpunim me autorë të huaj. 103
Figura 15: Numri i aktiviteteve kombëtare në seicilën njësi kryesore të UPT. 104
Figura 16: Aktivitete ndërkombëtare për staf në seicilën njësi kryesore të UPT. 104
Figura 17: Aktivitete ndërkombëtare për seicilën njësi kryesore të UPT 105
Figura 18: Aktivitete ndërkombëtare për staf në secilën njësi kryesore të UPT. 106
Figura 19: Aktivitete kombëtare/ndërkombëtare për njësi kryesore të UPT. 106
Figura 20: Pjesëmarrje në borde editoriale dhe recensa periodikësh shkencor. 107
Figura 21: Pjesëmarrje në borde editoriale dhe recensa periodikësh shkencor për staf. 108
Figura 22: Pjesëmarrje në Komitete Organizative/Shkencore. 109
Figura 23: Pjesëmarrje në Komitete Organizative/Shkencore. 109
Figura 24: Pjesëmarrje si relator/reçensues . 110
Figura 25: Pjesëmarrje si relator/reçensues . 111
Figura 26: Pjesëmarrje në workshope/seminare . 111
Figura 27: Pjesëmarrje në workshope/seminare . 112
Figura 28: Tregues statistikorë për vitin akademik 2024-2025, 2022-2023 dhe 2023-2024. 173
Figura 29: Përqindje e ngarkesës akademike e realizuar nga PAE. 180
Figura 30:Ngarkesa mësimore e realizuar nga PAE. 182
Figura 31: Orët suplementare në auditor. 182
Figura 32: Diplomimi i studentëve 206
Figura 33: Grafiku i kalueshmërisë së studentëve në ciklin e parë të studimeve 208
Figura 34: Grafiku i kalueshmërisë së studentëve në ciklin e dytë të studimeve, Msc 209
Figura 35: Nota mesatare në hyrje dhe në dalje në programet e ciklit të parë. 211
Figura 35: Nota mesatare në hyrje dhe në dalje në programet e ciklit të dytë Msc. 211
Figura 35: Nota mesatare në hyrje dhe në dalje në programet e ciklit të dytë MP. 211

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS · REKTORATI · SEKRETARIA

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

LISTA E PËRKUFIZIMEVE, AKRONIMEVE

BAUPT	Bordi i Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës
BSH	Biblioteka shkencore e Universitetit Politeknik të Tiranës
DA	Departamenti i Automatikës (FIE)
DA	Departamenti i Arkitekturës (FAU)
DBE	Departamenti i Burimeve të Energjisë
DBI	Departamenti i Bazave të Informatikës (FTI)
DE	Departamenti i Energjitikës (FIM)
DE	Departamenti i Elektroteknikës (FIE)
DET	Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit (FTI)
DGJ	Departamenti i Gjeodezisë (FIN)
DGJ	Departamenti i Gjeologjisë (IGJEO)
DGJZGJ	Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar e Gjeoinformatikës (FGJM)
DIBM	Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare (FGJM)
DIF	Departamenti i Inxhinierisë Fizike (FIMIF)
DII	Departamenti i Inxhinierisë Informatike (FTI)
DIM	Departamenti i Inxhinierisë së Mjedisit (FIN)
DIM	Departamenti i Inxhinierisë Matematike (FIMIF)
DK	Departamenti i Kimisë (FIMIF)
DKNIT	Departamenti i Konstruksioneve të Ndërtimit dhe Infrastrukturës së Transportit (FIN)
DKSHP	Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve
DM	Departamenti i Mekanikës (FIM)
DM	Departamenti i Meteorologjisë (IGJEO)
DMS	Departamenti i Mekanikës së Strukturave (FIN)
DPM	Departamenti i Prodhim Menaxhimit (FIM)
DRTA	Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës (FAU)
DS	Departamenti i Sizmologjisë (IGJEO)
DSF	Departamenti i Sistemeve të Fuqisë (FIE)
DSHT	Departamenti i Shkencave të Tokës (FGJM)
DTM	Departamenti i Tekstilit dhe Modës (FIM)
DU	Departamenti i Urbanistikës (FAU)
DH	Departamenti i Hidrologjisë (IGJEO)
DHH	Departamenti i Hidraulikës dhe Hidroteknikës (FIN)
FAU	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
FGJM	Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave
FIE	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike
FIM	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
FIMIF	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike
FIN	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtim
FTI	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
IGJEO	Instituti Kërkimor shkencor i Gjeoshkencave
QGJH	Qendra e Gjuhëve të Huaja (FIMIF)
SAUPT	Senati Akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës
UPT	Universiteti Politeknik i Tiranës

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

1 QËLLIMI I RAPORTIMIT

Të sigurojë informacion sasior dhe cilësor mbi mësimdhënien dhe kërkimin shkencor pranë njësive kryesore dhe bazë të UPT-së me qëllim përgatitjen e Raportit Vjetor Institucional mbi veprimtarinë e kryer, i cili, në zbatim të Udhëzimit Nr. 5, Datë 19.02.2018, "Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë" i ndryshuar, do të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzuesin **"Për modelin e raportimit vjetor të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë, në zbatim të Udhëzimit Nr. 5, Datë 19.02.2018, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit", miratuar nga Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).**

1.1 OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË RAPORTIMIT

- ✓ Të sigurojë informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit pranë njësive bazë dhe atyre kryesore.
- ✓ Të nxjerrë informacion mbi aktivitete të ndryshme shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të realizuara nga departamentet dhe njësitë kryesore të UPT-së.
- ✓ Të sigurojë informacion të hollësishëm mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte kombëtare dhe ndërkombëtare ku departamentet dhe njësitë kryesore të UPT-së marrin pjesë.
- ✓ Të nxjerrë informacion mbi studime/botime të ndryshme shkencore të realizuara nga stafi akademik pranë njësive bazë dhe kryesore të UPT-së, etj.
- ✓ Të mbledhë informacion mbi angazhimin e personelit akademik, ngarkesën përkatëse, lëndën/t dhe/ modulin/et që ka zhvilluar secili prej tyre për secilin semestër të vitit akademik 2024-2025.
- ✓ Të dhëna për gjurmimin e studentëve, të cilët kanë përfunduar studimet për secilin program studimi që njësitë kryesore ofrojnë.
- ✓ Të dhëna mbi studentët si: numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit, numrin e studentëve që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar, numrin e studentëve të shkëlqyer, përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që diplomohen, etj.

1.2 RUBRIKAT KRYESORE TË RAPORTIMIT

a) Të dhëna mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit.

b) Të dhëna mbi bashkëpunime ndërinstitucionale dhe projekte ku merr pjesë njësia kryesore.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

c) Të dhëna mbi kërkimin shkencor dhe mbi projekte ku njësia kryesore merr pjesë si palë aktive.

d) Të dhëna mbi programet e studimit që ofron njësia kryesore.

e) Të dhëna mbi angazhimin e personelit akademik.

f) Të dhëna mbi gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për çdo program studimi.

g) Të dhëna të përgjithshme mbi studentët për çdo program studimi.

Ky raport shoqërohet me tabela në format elektronik Excel, për çdo aktivitet të raportuar, të cilat për lehtësi mbledhjeje dhe përpunimi duhet të plotësohen nga njësitë kryesore dhe të dërgohen në mënyrë elektronike bashkë me raportin e njësisë kryesore.

1.2.1 Të dhëna të përgjithshme mbi personelin e njësive kryesore

Tabela 1: Personeli akademik, ndihmës, laborant dhe teknik në UPT.

Njësia kryesore (Fakultet)	Njësia bazë (Departament)	Staf akademik (femra)	Staf akademik (meshkuj)	Staf ndihmës akademik me	Laborantë	Teknikë	Total
Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	Departamenti i Arkitekturës	9	12	0	1	0	**22**
	Departamenti i Urbanistikës	3	6	0	1	0	**10**
	Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Aktitekturës	6	2	0	1	0	**9**
	FAU TOTAL	**18**	**20**	**1**	**3**	**0**	**42**
Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave	Departamenti i Shkencave të Tokës	6	7	0	2	0	**15**
	Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare	2	9	0	2	0	**13**
	Departamenti i Burimeve të Energjisë	5	7	0	3	0	**15**
	Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës	6	10	0	3	0	**19**
	FGJM TOTAL	**19**	**33**	**0**	**10**	**0**	**62**
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	Departamenti i Automatikës	4	10	0	1	0	**15**
	Departamenti i Sistemeve të Fuqisë	2	8	0	1	0	**11**
	Departamenti i Elektroteknikës	4	5	0	2	0	**11**
	FIE TOTAL	**10**	**23**	**5**	**4**	**0**	**42**
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Departamenti Energjitikës	2	13	0	2	0	**17**
	Departamenti i Mekanikës	2	13	0	1	0	**16**
	Departamenti i Prodhim Menaxhimit	9	8	0	2	0	**19**
	Departamenti i Tekstilit dhe Modës	9	1	0	3	0	**13**
	FIM TOTAL	**22**	**35**	**0**	**8**	**0**	**65**

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Njësia kryesore (Fakultet)	Njësia bazë (Departament)	Staf akademik (femra)	Staf akademik (meshkuj)	Staf ndihmës akademik me	Laborantë	Teknikë	Total
Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Departamenti Inxhinierisë Matematike	18	10	0	1	0	**29**
	Departamenti i Inxhinierisë Fizike	8	9	0	3	0	**20**
	Departamenti i Inxhinierisë Kimike	8	1	0	2	0	**11**
	Qendra e Gjuhëve të Huaja	13	1	0	1	0	**15**
	FIMIF TOTAL	**47**	**21**	**5**	**7**	**0**	**80**
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	Departamenti Konstruksioneve të Ndërtimit dhe Infrastrukturës së Transportit	9	12	0	2	0	**23**
	Departamenti Mekanikës së Strukturave	3	7	0	2	0	**12**
	Departamenti Inxhinierisë së Mjedisit	6	5	0	2	0	**13**
	Departamenti i Hidraulikës dhe Hidroteknikës	0	7	0	1	0	**8**
	Departamenti i Gjeodezisë	2	10	0	2	0	**14**
	FIN TOTAL	**20**	**41**	**0**	**9**	**0**	**70**
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	Departamenti i Inxhinierisë Informatike	10	5	0	4	0	**19**
	Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit	8	13	0	5	0	**26**
	Departamenti i Bazave të Informatikës	3	2	0	1	0	**6**
	FTI TOTAL	**21**	**20**	**14**	**10**	**0**	**65**
Instituti i Gjeoshkencave	Departamenti i Sizmologjisë	2	4	0	5	0	**11**
	Departamenti i Meteorologjisë	2	3	0	3	0	**8**
	Departamenti i Hidrologjisë	5	2	3	0	0	**10**
	Departamenti i Gjeologjisë	4	4	0	2	0	**10**
	IGJEO TOTAL	**13**	**13**	**3**	**10**	**0**	**39**
Rektorati	**Rektorati TOTAL**			**30**			**30**
Totali	**Universiteti Politeknik i Tiranës**	**170**	**206**	**28**	**61**	**0**	**495**

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

1.2.2 Të dhëna të përgjithshme mbi personelin akademik

Personeli akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës, i organizuar në njësi bazë, kryesore dhe Rektorat, është i ndarë në gjini si në grafikun në vijim:




Figura 1: Të dhënat e stafit akademik sipas gjinisë

Nga sa më sipër vërehet se 45% e personelit akademik me kohë të plotë në Universitetin Politeknik të Tiranës, përbëhet nga femra dhe 55% e personelit akademik janë meshkuj.

Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, ka një raport të përmbysur Femra/Meshkuj, duke patur 69% të personelit të përbërë nga femra dhe 31% meshkuj.


Të dhëna të detajuara rreth shpërndarjes sipas gradave shkencore dhe titujve akademikë, dhe sipas gjinisë në njësitë bazë dhe kryesore në UPT, paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela 1.1: Të dhënat e stafit akademik sipas titujve/gradave shkencore dhe gjinisë.

Njësia kryesore (Fakultet)	Njësia bazë (Departament)	Doktor (F/M)	Docent (F/M)	Prof. Asoc. (F/M)	Prof. Dr. (F/M)	Akademik i Asoc. (F/M)	Akademik (F/M)	Doktorata në proces (F/M)	Total (F/M)
Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	Departamenti i Arkitekturës	3/4	0/1	1/1	0/2	0/0	0/0	2/1	**6/9**
	Departamenti i Urbanistikës	2/4	0/0	0/0	0/1	0/0	0/0	0/0	**2/5**
	Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës	6/1	0/0	0/0	0/0	0/0	0/0	0/0	**6/1**
	FAU TOTAL	**11/9**	**0/1**	**1/1**	**0/3**	**0/0**	**0/0**	**2/1**	**14/15**

Njësia kryesore (Fakultet)	Njësia bazë (Departament)	Doktor (F/M)	Docent (F/M)	Prof. Asoc. (F/M)	Prof. Dr. (F/M)	Akademik i Asoc. (F/M)	Akademik (F/M)	Doktorata në proces (F/M)	Total (F/M)
Fakulteti i Gjeologjisë dhe i minierave	Departamenti i Shkencave të Tokës	1/1	0/0	1/1	2/3	0/0	0/0	2/1	**6/6**
	Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare	1/4	0/0	1/1	0/3	0/0	0/0	0/1	**2/9**
	Departamenti i Burimeve të Energjisë	1/2	0/0	0/1	0/2	0/0	0/0	4/2	**5/7**
	Departamenti i Gjeologjisë së Zbatuar dhe Gjeoinformatikës	1/1	0/0	1/5	0/0	0/0	0/0	0/0	**2/6**
	FGJM TOTAL	**4/8**	**0/0**	**3/8**	**2/8**	**0/0**	**0/0**	**6/4**	**15/28**
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	Departamenti i Automatikës	2/2	0/0	1/3	1/1	0/0	0/0	0/4	**4/10**
	Departamenti i Sistemeve të Fuqisë	0/2	0/0	0/0	1/0	0/0	1/0	0/6	**2/8**
	Departamenti i Elektroteknikës	3/2	0/0	0/2	0/0	0/0	0/0	1/1	**4/5**
	FIE TOTAL	**5/6**	**0/0**	**1/5**	**2/1**	**0/0**	**1/0**	**1/11**	**10/23**
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Departamenti Energjetikës	0/6	0/0	2/4	0/2	0/0	0/0	0/1	**2/13**
	Departamenti i Mekanikës	0/4	0/0	2/4	0/1	0/0	0/0	0/2	**2/11**
	Departamenti i Prodhim Menaxhimit	2/1	0/0	5/4	0/1	0/0	0/0	2/0	**9/6**
	Departamenti i Tekstilit dhe Modës	2/0	0/0	6/0	1/1	0/0	0/0	0/0	**9/1**
	FIM TOTAL	**4/11**	**0/0**	**15/12**	**1/5**	**0/0**	**0/0**	**2/3**	**22/31**
Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Departamenti Inxhinierisë Matematike	3/2	0/0	12/5	1/2	0/0	0/0	2/1	**18/10**
	Departamenti i Inxhinierisë Fizike	3/2	0/0	6/4	0/1	0/0	0/0	0/1	**9/8**
	Departamenti i Inxhinierisë Kimike	0/0	0/0	8/1	0/0	0/0	0/0	0/0	**8/1**
	Qendra e Gjuhëve të Huaja	3/0	0/0	5/0	2/1	0/0	0/0	3/0	**13/1**
	FIMIF TOTAL	**9/4**	**0/0**	**31/10**	**3/4**	**0/0**	**0/0**	**5/2**	**48/20**
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	Departamenti Konstruksioneve të Ndërtimit dhe Infrastrukturës së Transportit	3/4	0/0	2/4	1/1	0/0	0/0	0/0	**6/9**
	Departamenti Mekanikës së Strukturave	3/3	0/0	0/3	0/0	0/0	0/0	0/0	**3/6**
	Departamenti Inxhinierisë së Mjedisit	1/2	0/0	3/2	0/1	0/0	0/0	1/1	**5/6**
	Departamenti i Hidraulikës dhe Hidroteknikës	0/2	0/0	0/0	0/0	0/0	0/0	0/5	**0/7**
	Departamenti i Gjeodezisë	1/3	0/0	0/2	0/0	0/0	0/0	0/5	**1/10**
	FIN TOTAL	**8/14**	**0/0**	**5/11**	**1/2**	**0/0**	**0/0**	**1/11**	**15/38**
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	Departamenti i Inxhinierisë Informatike	3/1	0/0	1/2	1/0	0/0	0/0	5/2	**10/5**
	Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit	2/2	0/0	2/3	2/5	0/0	0/0	2/3	**8/13**
	Departamenti i Bazave të Informatikës	1/1	0/0	0/1	0/0	0/0	0/0	2/0	**3/2**
	FTI TOTAL	**6/4**	**0/0**	**3/6**	**3/5**	**0/0**	**0/0**	**9/5**	**21/20**
Instituti i Gjeshkencave	Departamenti i Sizmologjisë	2/1	0/0	0/1	0/0	0/0	0/0	0/2	**2/4**
	Departamenti Meteorologjisë	1/1	0/0	2/1	0/1	0/0	0/0	0/1	**3/4**
	Departamenti i Hidrologjisë	3/1	0/0	1/0	0/0	0/0	1/0	0/1	**5/2**
	Departamenti i Gjeologjisë	3/0	0/0	0/0	0/2	0/0	0/0	2/1	**5/3**
	IGJEO TOTAL	**9/3**	**0/0**	**3/2**	**0/3**	**0/0**	**1/0**	**2/5**	**15/13**
	TOTAL	**56/59**	**0/1**	**62/55**	**12/31**	**0/0**	**2/0**	**28/42**	**160/188**


Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al



	Doktor	Docent	Prof. Asoc.	Prof. Dr.	Akademik i Asoc.	Akademik	Doktorantë në proces
FEMRA	56	0	62	12	0	2	28
MESHKUJ	59	1	55	31	0	0	42

Figura 2: Të dhënat e personelit akademik sipas gjinisë dhe kualifikimeve.

Rreth 80% e personelit akademik efektiv në Universitetin Politeknik të Tiranës kanë grada shkencore dhe tituj akademik dhe rreth 20% janë duke zhvilluar studimet e ciklit të tretë, doktoratë, me një predominancë të lehtë me 83% të gjinisë femërore, kundrejt 78% të gjinisë mashkullore.



	Doktor	Docent	Prof. Asoc.	Prof. Dr.	Akademik i Asoc.	Akademik	Doktorantë në proces
2023-2024	43%	0%	25%	14%	0%	0%	18%
2024-2025	33%	0%	34%	12%	0%	1%	20%

Figura 3: Të dhënat e personelit akademik sipas kualifikimeve: V.A.2023-2024, V.A. 2024-2025.

Kundrejt vitit akademik 2023-2024, në vitin akademik 2024-2025 vërehet një ulje e stafit akademik me vetëm gradën shkencore "Doktor", pasi gjatë këtij viti, janë kualifikuar duke fituar titullin akademik "Profesor i Asociuar", sikurse vihet re në figurën më sipër, ku kategoria me titullin akademik "Prof. Asoc", është rritur në 34% kundrejt 25% të vitit të kaluar akademik.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Ka një ulje të personelit akademik me titullin "Profesor", kjo për shkak të mbushjes së moshës së daljes në pension pleqërie. Edhe pse një pjesë e perosnelit akademik që mbante titullin akademik "Prof. Asoc." është promovuar dhe ka fituar titullin akademik "Prof. Dr.".

Për sa i përket personelit akademik të UPT-së, femrat kanë përfaqësim lehtësisht më të lartë në titullin akademik "Profesor i Asociuar", ndërsa meshkujt kanë përfaqësim më të lartë në titullin akademik "Profesor" dhe "Doktorantë në proces".

Krahas personelit akademik dhe ndihmësakademik, Universiteti Politeknik i Tiranës përfshin gjithashtu në strukturën e tij organizative edhe personelin administrativ dhe mbështetës. Në total, në UPT janë të punësuar 105 punonjës administrativë, si dhe 26 punonjës të Bibliotekës Shkencore, të cilët përbëjnë një pjesë integrale dhe të rëndësishme të funksionimit dhe zhvillimit të institucionit.

Gjatë vitit raportues janë realizuar procedurat e punësimit për 25 punonjës, konkretisht:

- ✓ 14 personel akademik,
- ✓ 10 personel ndihmësakademik,
- ✓ 2 punonjës administrativë.

Procesi i rekrutimit është zhvilluar në mënyrë të strukturuar dhe transparente, duke respektuar kriteret ligjore dhe procedurale në fuqi. Të gjithë kandidatët janë vlerësuar mbi bazën e kualifikimeve profesionale dhe nevojave reale të institucionit, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe eficiencës administrative.

Drejtoria ka garantuar administrimin korrekt të dokumentacionit të punësimit dhe ka bashkëpunuar ngushtë me strukturat në fakultete dhe IGJEO, duke kontribuar në zgjidhjen e problematikave të përditshme të Burimeve Njerëzore.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS · REKTORATI · SEKRETARIA

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë; Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

2 MËSIMDHËNIE, KËRKIM SHKENCOR, VEPRIMTARI KRIJUESE DHE INOVACION

Në këtë seksion të raportit paraqiten të dhëna mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit të realizuara në Universitetin Politeknik të Tiranës për vitin akademik 2024-2025. Në këtë seksion janë përfshirë raportet e vlerësimit të mësimdhënies, mësimnxënies si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të UPT-së.

2.1 MËSIMDHËNIA

Procesi mësimor në UPT është realizuar në përputhje me strukturën mësimore për vitin akademik 2024-2025, të shpallur nga Rektori i UPT. Realizimi i mësimdhënies për programet e studimeve Bachelor, Master i Shkencave dhe Master Profesional, për vitin akademik 2024-2025, është bërë në përputhje me planet mësimore të miratura nga Senati Akademik me Vendim Nr.05, datë 10.09.2024.

Procesi mësimor u zhvillua në auditorët e godinave të UPT sipas orarit mësimor, të shpallur nga dekanatet e fakulteteve. Auditorët janë të pajisura me teknikat audio-vizive dhe mjete të tjera didaktike, të përshtatshme për specifikat në mësimdhënie që ka natyra teknike e programeve të studimit. Numri i studentëve për çdo grup mësimor dhe numri i grupeve për leksionet janë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies së UPT. Gjatë vitit akademik 2024-2025, me Vendim të Senatit Akademik Nr.16, datë 22.10.2024 dhe Vendim të Bordit të Administrimit Nr.34, datë 13.11.2024, u miratua aktivizimi i programeve të studimit "Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analizë Sistemesh", "Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike" dhe "Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare" me numër studentësh më të vogël se 10. Miratimi i aktivizimit të këtyre programeve u mbështet në argumentimin se këto programe studimi i përkisnin fushave me prioritet kombëtar dhe krijimit të mundësisë studentëve për të plotësuar njohuritë e fituara në ciklin e parë. Infrastruktura didaktike është përmirësuar, si rezultat i rikonstruksioneve të bëra në disa fakultete.

Procesi i mësimdhënies realizohet konform me "Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies". Veprimtaritë formuese për arritjen e rezultateve të të nxënit për disiplinat/modulet e programeve të studimit japin formim teorik dhe formim praktik në një masë përgjithësisht 50% / 50% dhe konsistojnë në leksione, ushtrime/seminare, punë laboratorike, detyra/projekte kursi, praktika profesionale, projekt-diplomë. Format e kontrollit të dijeve konsistojnë në mbrojtje të punëve laboratorike, mbrojtje të detyrave/projekteve të kursit, mbrojtje të praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimi i lëndës dhe finalizohen me provim formimi, mbrojtje të temës të diplomës. Infrastruktura laboratorike është në përmirësim të vazhdueshëm. Komponentët e procesit mësimor, si mbrojtja e diplomave dhe ndjekja dhe mbrojtja e praktikave profesionale, janë realizuar në të gjitha njësitë kryesore në përputhje me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të UPT-së.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Në planin strategjik 2019-2024, u synua, që në UPT të përmirësohet kultura e cilësisë në procesin e edukimit nëpërmjet zbatimit të standardeve më të përparuara. Për këtë u krye riorganizimi dhe modernizimi i strukturës së sigurimit të cilësisë në UPT, duke shtrirë rrjetin e cilësisë deri në nivel njësie kryesore dhe programi studimi. Organizimi i sondazheve me studentët, realizimi me sukses i procesit të riakreditimit institucional dhe në vijim akreditimi i programeve të studimit të ciklit të parë, dhe disa programe studimi të ciklit të dytë, funksionimi i këshillave të programeve të studimit, përgjegjës për sigurimin e cilësisë të programit të studimit janë tregues të plotësimit të këtij objektivi strategjik. Gjatë vitit akademik 2024-2025 janë akreditуar për herë të parë 9 programe studimi të fakulteteve FIMIF, FGJM, FIE, FIM (7 të ciklit të parë dhe 2 të ciklit të dytë), dhe ka filluar procesi i akreditimit për 11 programe të tjera studimi të fakulteteve FIN, FAU, FTI, FIE, (5 të ciklit të parë, 5 të ciklit të dytë dhe 1 i ciklit të tretë të studimeve). Ky proces vijon me kërkesa të tjera për akreditim/riakreditim të programeve të studimit (8 kërkesa të reja) në të tre ciklet e studimit në fakultetet FIMIF, FIM, FTI.

Deri më sot në UPT janë akreditуar për herë të parë 20 programe të studimit të fakulteteve FIE, FIM, FTI, FIMIF, FGJM, nga të cilat 17 programe studimi janë të ciklit të parë dhe 3 program studimi është i ciklit të dytë. Ndërkohë janë në proces akreditimi/riakreditimi ose në pritje të fillimit të procesit edhe 19 programe të tjera studimi (7 programe të ciklit të parë dhe 11 programe studimi të ciklit të dytë dhe 1 program studimi i ciklit të tretë). UPT do të vazhdojë me procesin e akreditimit të të gjitha programeve të studimit, në të tre ciklet e studimit, si dhe do të synojë në përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë me synim rritjen e efektivitetit dhe efiçencës së programeve të studimit dhe zhvillimin e kapaciteteve për monitorimin e brendshëm të cilësisë në procesin e edukimit. Forcimi i rolit të biznesit dhe Alumnit në përmirësimin e programeve të studimit, matja e shkallës së plotësimit të pritshmërive të studentit në nivel program studimi, menaxhimi i të dhënave, përmirësimi i sistemit të informimit, komunikimit dhe promovimi i rezultateve më të mira janë disa nga detyrat që duhen adresuar në të ardhmen.

Një objektiv tjetër ka qenë reformimi i kurrikulave në bazë të rezultateve të të nxënurit. Kjo lidhet ngushtësisht me realizimin e studimit të kërkesave të tregut të punës në fushat e veprimtarisë së UPT. Theksohet se të gjitha programet e reja të studimit apo ato të riorganizuara në këtë periudhë janë mbështetur në kërkesat e tregut të punës për përcaktimin e kompetencave në dalje të studentit. Programet e studimit janë rishikuar gjatë këtij pesëvjeçari me synim harmonizimin e formimit teoriko-shkencor me aftësimin praktik dhe atë të sipërmarrjes të studentët. Forcimi i punës së pavarur të studentëve nëpërmjet realizimit të detyrave, projekt-kurseve, laboratorëve, praktikave profesionale, projekt-diplomave ka bërë që fokusi i mësimdhënies dhe mësim-nxënies të jetë i orientuar drejt studentit. Në këtë drejtim duhet të kemi një shtrirje më të madhe të orientimit nga mësim-nxënia edhe gjatë zhvillimit të orëve të ushtrimeve/seminare, duke futur më shumë kontrolle periodike gjatë gjithë semestrit. Metoda e mësimdhënies janë modernizuar duke futur jo vetëm teknikat audio-vizive të prezantimit, gërshetuar me shtjellime të nevojshme në tabelë, por gjithashtu përdorimi i software për simulime dhe llogaritje inxhinierike.

Rritja e cilësisë së praktikave profesionale ka qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes së njësive bazë dhe njësive kryesore të UPT. Për çdo program studimi është hartuar plani i zhvillimit të aftësive praktike të studentit, e cila dokumentohet në syllabusin e këtij aktiviteti formues. Fakultetet kanë rritur bashkëpunimin me biznesin për realizimin e praktikave profesionale. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan edhe Alumni. Rritja dhe forcimi i bashkëpunimit me bizneset krijon mundësi për

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

rekrutimin dhe punësimin e studentëve pranë këtyre bizneseve. Procedura për realizimin e praktikave është tashmë e konsoliduar në nivel institucional dhe realizohet me përgjegjshmëri nga të gjitha departamentet dhe fakultetet. Fakultetet deklarojne se gjatë viti akademik 2024–2025 është shënuar një rritje e ndjeshme e numrit të studentëve të angazhuar në praktika profesionale dhe projekte të integruara në kompani, falë bashkëpunimit të drejtpërdrejtë ndërmjet njësive bazë dhe aktorëve të industrisë. Ky bashkëpunim ka kontribuar ndjeshëm në rritjen e punësueshmërisë së të diplomuarve.

Një nga sfidat për këtë periudhë ka qenë edhe zhvillimi i infrastrukturës dixhitale për përmirësimin e arsimimit dhe krijimin e oportuniteteve për personelin akademik. Digjitalizimi i menaxhimit të proceseve ndihmës akademike, si ai i sekretarisë mësimore, krijimi i klasave virtuale me studentët dhe komunikimi nëpërmjet platformave TEAMS, Google Classroom, etj., bën të mundur që studenti të marrë në kohë reale të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me aktivitetet akademike. Këto platforma kanë lehtësuar komunikimin ndërmjet pedagogëve dhe studentëve, kanë rritur efikasitetin e dhënies dhe shpërndarjes së materialeve mësimore, si dhe kanë mundësuar ndjekjen e ecurisë akademike të studentëve në mënyrë të standardizuar. Përmirësimi i faqes zyrtare të UPT dhe të fakulteteve apo departamenteve informojnë publikun, stafin akademik dhe studentet për çdo aktivitetet që kryhet si dhe për dokumentacionin dhe procedurat që duhet të ndiqen. Në kuadër të objektivit të ndërkombëtarizimit, po synohet që informacioni dhe të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të jenë në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Përveç kësaj është punuar edhe për zhvillimin e infrastrukturës dixhitale në shërbim të mësimit, duke synuar rritjen e përdorimit të software për zhvillim profesional të personelit akademik dhe të studentëve.

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë është i lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm të cilësisë së pranimeve në të gjithë programet e studimit të UPT. Në këtë drejtim është punuar drejt promovimit të imazhit të UPT në procesin e rekrutimit të studentëve nëpërmjet formave të ndryshme, përfshirë organizimin e Ditës së Hapur për UPT, pjesëmarrjen në panairet e punës dhe edukimit, botimi dhe publikimi i udhëzuesve informuese për UPT dhe programet e studimit që ofrohen, të cilat gjenden edhe në faqen zyrtare të fakulteteve dhe UPT. Përmirësimi i procesit të orientimit të studentëve dhe këshillimit akademik të tyre ka qenë një nga drejtimet e punës së zyrës së karrierës në UPT dhe specialistëve të karrierës pranë fakulteteve. Përveç materialeve orientuese të publikuara, për çdo grup studentësh, janë vendosur këshilltarët akademik, të cilët bëjnë orientimin didaktik të studentëve dhe përcjellin nëpër departamentet përgjegjëse për programin e studimit, shqetësimet dhe nevojat e studentëve. Kriteret e pranimit janë tashmë të përcaktuara, miratohen çdo vit nga Senati Akademik dhe bëhen publike në portalin U-Albania. Kriteret specifike të vendosura janë të lidhura me natyrën teknike të programeve të studimit, dhe synojnë që të rekrutohen kandidatët me karakteristikat më të mira dhe në përshtatje me programin përkatës të studimit. UPT përdor edhe sistemin e bursave apo të reduktimit të tarifës së shkollimit për kandidatët cilësor, për kandidatët që vijnë nga shtresat në nevojë, apo grupe të margjinalizuara. Një nga sfidat për të ardhmen është edhe organizimi i shkollave verore përgatitore për kandidatët që synojnë të pranohen në vitin e parë të studimeve.

Një synim tjetër strategjik për përmirësimin e menaxhimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies ka qenë mbështetja e studentëve për t'i ndihmuar ata drejt suksesit të tyre profesional dhe futjes së tyre në tregun e punës. Në ndihmë të kësaj është forcimi i lidhjeve të UPT me botën e biznesit, qeverinë qëndrore dhe atë lokale si dhe me organizata të tjera jofitimprurëse me synim mbështetjen e punësimit të të diplomuarve. Nga ana tjetër krijimi i zyrës së karrierës me synimin e bërjes së saj hub informimi dhe këshillimi për studentët, organizimi nga kjo të seminareve/ workshopeve, panaireve të

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

punës, publikimi i kërkesave që vijnë nga kompani të ndryshme publike apo private, etj., janë arritje të rëndësishme në mbështetjen e studentëve. Përveç këtyre, kurrikulat tona përmbajnë module të veçanta që synojnë forcimin e aftësive dhe njohurive të studentëve për të hyrë në tregun e punës.

Gjatë vitit akademik 2024–2025, Universiteti Politeknik i Tiranës ka shënuar përparim të ndjeshëm në zbatimin e objektivit strategjik të ndërkombëtarizimit, përmes zgjerimit të bashkëpunimeve akademike, hapjes së programeve të përbashkëta të studimit dhe intensifikimit të mobilitetit ndërkombëtar të studentëve. Në këtë kuadër, gjatë këtij viti akademik u miratua hapja e dy programeve të përbashkëta të ciklit të parë të studimit të FTI me Universitetin e Teknologjisë së Compiègne (Francë), ndërsa është në fazë përfundimtare edhe një program diplome të dyfishtë të ciklit të dytë të studimeve të FIM me Universitetin Politeknik të Barit (Itali), duke forcuar ofertën akademike ndërkombëtare të UPT-së me gjithsej 11 programe në të tre ciklet e studimit, sipas deklarimeve të fakulteteve FTI, FIM, FAU, FIN, FGJM, që zhvillohen në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë. Paralelisht, janë promovuar formimet dhe diplomat e përbashkëta, veçanërisht në ciklin e dytë dhe të tretë, me synim rritjen e cilësisë së formimit universitar dhe vlerës së titujve akademikë. Universiteti ka intensifikuar gjithashtu lidhjet e qëndrueshme me institucione homologe evropiane dhe ndërkombëtare përmes projekteve të përbashkëta kërkimore, shkëmbimit të eksperiencave dhe përfshirjes aktive të studentëve në kërkimin shkencor, duke kontribuar në përgatitjen profesionale të tyre, orientimin drejt tregut të punës dhe formimin e brezit të ardhshëm të kërkuesve shkencorë.

Në tabelën nr.1 të shtojcës jepen në mënyrë të përmbledhur realizimi i këtyre objektivave nga të gjitha njësitë kryesore të UPT.

2.2 KËRKIM SHKENCOR DHE VEPRIMTARI KRIJUESE DHE INOVACION

Universiteti Politeknik i Tiranës synon zgjerimin dhe konsolidimin e veprimtarisë kërkimore shkencore përmes nxitjes së krijmtarisë shkencore, zhvillimit dhe promovimit të ideve inovative dhe rezultateve kërkimore me ndikim në përmirësimin e ofertës akademike në të tre fushat e studimit si dhe në fusha me rëndësi për zhvillimin kombëtar dhe më gjerë.

2.2.1 Qëllimi i UPT-së në fushën e kërkimit Shkencor:

Universiteti Politeknik i Tiranës promovon dhe mbështet kërkimin shkencor bazë dhe të aplikuar, duke inkurajuar bashkëpunimin ndër-institucional në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, pjesëmarrjen në programe e projekte kërkimore, si dhe përvetësimin dhe zhvillimin e njohurive bashkëkohore shkencore dhe teknologjike. UPT vlerëson dhe fuqizon ekspertizën kërkimore të personelit të tij akademik në fusha të ndryshme inxhinierike të dijes.

Veprimtaria kërkimore dhe inovative zhvillohet në përputhje me dokumentet strategjike institucionale dhe politikat kombëtare në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit, duke respektuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe arsimit të lartë.

Kërkimi shkencor në UPT realizohet në funksion të misionit të institucionit dhe objektivave strategjike afatmesme dhe afatgjata, duke kontribuar në rritjen e rolit të UPT-së si institucion prodhimi dhe

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

përhapjes së dijes, si dhe në forcimin e lidhjes midis arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe inovacionit.

Veprimtaritë kryesore kërkimore dhe zhvillimore në Universitetin Politeknik të Tiranës përfshijnë:

- ✓ Zhvillimin e punës krijuese dhe inovatite në njësitë bazë;
- ✓ Pjesëmarrjen në programe dhe projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare;
- ✓ Organizimin dhe pjesëmarrjen në konferenca, workshop-e dhe aktivitete shkencore;
- ✓ Publikimin e monografive dhe artikujve shkencorë në revista dhe botime akademike;
- ✓ Promovimin e gradave shkencore dhe titujve akademikë;
- ✓ Përfshirjen në struktura redaktuese dhe vlerësuese shkencore;
- ✓ Udhëheqjen e studimeve doktorale, etj.

2.2.2 Realizimi i objektivave krahasuar me planin strategjik të UPT-së

Objektivat e zhvillimit të kërkimit shkencor në UPT bazohen në vizionin dhe misionin e UPTsë, në Planin Strategjik të UPT-së 2019-2024, si dhe në planet strategjike të çdo njësie kryesore, në të cilët përcaktohen qartë objektivat strategjike të kërkimit shkencor dhe masat që ndërmerren për realizimin e tyre:

1. Zhvillimi i burimeve njerëzore, i kapaciteteve infrastrukturore dhe financiare në shërbim të kërkimit shkencor dhe shërbimeve në UPT.

   Ky objektiv synon rritjen e kapaciteteve institucionale të UPT-së për zhvillimin e kërkimit shkencor përmes zhvillimit të burimeve njerëzore, përmirësimit të infrastrukturës kërkimore dhe sigurimit të burimeve financiare.

   Në përmbushje të synimeve dhe plotësimit të këtij objektivi në mënyrë të përmbledhur, për vitin akademik 2024-2025 është realizuar:

   - ✓ Promovimi i personelit akademik në UPT.
     - ❖ 24 anëtarë të personelit akademik të UPT-së kanë fituar titullin akademik "Profesor i Asociuar", nga të cilët:
       - FGJM: 1 anëtarë të personelit akademik
       - FIE: 2 anëtarë të personelit akademik
       - FIM: 6 anëtarë të personelit akademik
       - FIMIF: 10 anëtarë të personelit akademik
       - FIN: 3 anëtarë të personelit akademik
       - IGJEO: 2 anëtarë të personelit akademik
     - ❖ 8 anëtarë të personelit akademik të UPT-së, janë në proces për fitimin e titullit akademik "Profesor i Asociuar", nga të cilët:
       - FIE: 1 anëtar i personelit akademik

- FIM: 1 anëtar i personelit akademik
- FIMIF: 3 anëtarë të personelit akademik
- FIN: 1 anëtar i personelit akademik
- FTI: 2 anëtar i personelit akademik

❖ 1 anëtar i personelit akademik të FIE, UPT ka fituar titullin akademik "Profesor".

❖ 1 anëtar i personelit akademik të FIMIF, është në proces për fitimin e titullit akademik "Profesor".

❖ Janë dhënë 5 tituj akademikë "Profesor i Asociuar" për personel akademik të jashtëm dhe 6 janë në proces.

E përmbledhur në formë grafike, të dhënat më sipër janë:




Figura 4: Fitimi i titujve akademikë në UPT për njësi kryesore 2024-2025.




Figura 5: Fitimi i titujve akademikë në UPT dhe aplikime nga IAL të tjera, 2024-2025.

✓ Shkolla Doktorale.

- ❖ UPT ofron në total 14 programe studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" të riorganizuara/hapura në UPT, 3 prej të cilave kanë marrë miratim për riorganizim/hapje gjatë vitit akademik 2024-2025.
- ❖ Projektet kërkimore shkencore mbi të cilat mbështeten të gjitha programet e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë", janë të mbështetura financiarisht nga UPT, reflektuara në Vendimet e Bordit të Administrimit të UPT-së.
- ❖ Numri total i studentëve të regjistruar në ciklin e tretë "Doktoratë" është 120, ndërsa numri i studentëve të regjistruar për vitin akademik 2024-2025 është 44.
- ❖ Gjatë vitit akademik 2024-2025 janë diplomuar 5 studentë doktorantë.

✓ Rritja dhe zgjerimi i bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor dhe të shkëmbimit të stafit akademik, administrativ dhe studentëve.

- ❖ 88 studentë të UPT-së kanë kryer mobilitete në IAL-të e huaja dhe 40 studentë kanë ardhur nga këto universitete.
- ❖ 65 personel akademik i UPT-së kanë kryer mobilitete në IAL-të e huaja dhe 43 personel akademik kanë ardhur nga universitete të huaja.
- ❖ 14 personel administrativ i UPT-së kanë kryer mobilitete në IAL-të e huaja dhe 47 personel administrativ kanë ardhur nga universitete të huaja.




Figura 6: Mobilitete në hyrje dhe dalje në UPT për vitin akademik 2024-2025.

✓ Fonde financiare të shpenzuara për projekte.

- ❖ Fonde nga financimi/bashkëfinancimi i projekteve BE: 40,266,650 ALL
- ❖ Fonde nga financimi/bashkëfinancimi i projekteve AKKSHI: 94,218,443 ALL.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ✓ **Përmirësimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor**: në këtë kuadër nga disa njësi kryesore është parashikuar që në periudhën 2022–2024 të rinovohet baza laboratorike dhe për këtë qëllim janë hartuar projekte nga departamente të ndryshëm për rinovimin dhe plotësimin të laboratorëve. Një pasqyrë e detajuar mbi numrin e laboratërëve, mbështetjen dhe llojin e shërbimit të ofruar nga seicili prej tyre jepet në vazhdim në Tabelën nr. 6: "Mbi infrastrukturën e kërkimit shkencor".
- ✓ **Biblioteka shkencore**: Pasurimi në nivele cilësore me literaturë i koleksioneve të bibliotekave të njësive kryesore, Qendrës Multimediale FIE dhe Bibliotekës Shkencore, BSH – UPT. E gjithë veprimtaria e bibliotekave në UPT, për vitin akademik 2024-2025 është fokusuar për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofrojnë, duke krijuar një qasje më të specializuar në shërbim të kërkimit shkencor dhe duke iu përgjigjur sa më gjerë kërkesave studimore të personelit akademik, në ndihmë të procesit mësimor dhe punës kërkimore shkencore në UPT. Një pasqyrë e detajuar mbi pasurimin e bibliotekave dhe veprimtarinë e tyre jepet në vazhdim në Tabelën nr. 6: "Mbi infrastrukturën e kërkimit shkencor".

2. Rritja në sasi dhe cilësi e veprimtarisë kërkimore dhe e shërbimeve në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

   Ky objektiv synon fuqizimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kapaciteteve krijuese të personelit akademik përmes nxitjes së lirisë kërkimore dhe zhvillimit të kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar në fushat inxhinierike që mbulon UPT. Ai synon forcimin e bashkëpunimit me IAL brenda dhe jashtë vendit, si dhe promovimin e pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për shkëmbimin e eksperiencave dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor. Ky objektiv mbështet gjithashtu ofrimin e ekspertizës shkencore dhe teknike për institucionet publike dhe sektorin privat në kuadër të bashkëpunimit institucional në përputhje me standardet e cilësisë.

   Në përmbushje të synimeve dhe plotësimit të këtij objektivi në mënyrë të përmbledhur, për vitin akademik 2024-2025 është realizuar:

   - ✓ **Ndërkombëtarizimi në UPT.** UPT ka marrë pjesë në mënyrë aktive në shumë aktivitete ndërkombëtare si dhe ka lidhur një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh ndër-institucionale bashkëpunimi me universitete vendase dhe të huaja, institucione shtetërore dhe kompani e biznese. Një pasqyrë e detajuar e këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit, të nënshkruara gjatë vitit akademik 2024-2025, jepet në vazhdim në Tabelën nr. 3: "Mbi bashkëpunimin ndërinstitucional".
     - ❖ 8 Marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore brenda vendit;
     - ❖ 6 Marrëveshje bashkëpunimi me universitete vendase;
     - ❖ 18 Marrëveshje bashkëpunimi me universitete të huaja;
     - ❖ 28 Marrëveshje bashkëpunimi me universitete të huaja, në kuadër të Erasmus+;
     - ❖ 18 Marrëveshje bashkëpunimi me kompani dhe biznese.
   - ✓ **Rritja e bashkëpunimit midis UPT-së dhe biznesit**, kryesisht me kompanitë të cilat operojnë në fushat inxhinierike. Një pasqyrë e detajuar e këtyre marrëveshjeve bashkëpunimi, të

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë; Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

nënshkruara gjatë vitit akademik 2024-2025, jepet në vazhdim në Tabelën nr. 3: "Mbi bashkëpunimin ndërinstitucional". Ky bashkëpunim ka konsistuar në:

- ❖ realizimin e praktikave të studentëve pranë kompanive të ndryshme;
- ❖ internshipeve të ndryshme;
- ❖ realizimin e studimeve dhe botimeve të përbashkëta;
- ❖ realizimin e temave të diplomave të studentëve me udhëheqje të përbashkët;
- ❖ realizimin e aktiviteteve shkencore si seminare, konferenca, workshope, etj.

✓ **Pjesëmarrje në aktivitete shkencore:** Personeli akademik i UPT-së ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme kërkimore shkencore si: konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat janë të konkretizuara me botime në revista brenda dhe jashtë vendit, referime në konferenca, workshope, forume e simpoziume brenda dhe jashtë vendit si dhe përgatitje materialesh për tekste mësimore dhe leksione të shkruara, si më poshtë:

- ❖ 80 pjesëmarrje në aktivitete kombëtare.
- ❖ 372 pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare.
- ❖ 294 botime.
- ❖ 40 pjesëmarrje në komitete organizative shkencore.
- ❖ 77 pjesëmarrje si anëtarë të Bordit Editorial në revista shkencore/botime.
- ❖ 104 pjesëmarrje si relator/reçencues artikulli shkencor (revista kombëtare, ndërkombëtare).
- ❖ 352 pjesëmarrje në workshope/seminare.
- ❖ 53 Konferenca, workshope seminareve, forumeve, trajnimeve, etj. të organizuara/bashkë organizuara nga njësitë kryesore të UPT-së për vitin akademik 2024-2025.

✓ Numri i lartë i personelit akademik të angazhuar në projekte kërkimore shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar: projekte shkencore dhe inovative në kuadrin e projekteve evropiane, projekte që synojnë zhvillimin e kapaciteteve të personelit akademik, mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve, etj. Një pasqyrë e detajuar mbi projektet në të cilat personeli akademik ka aplikuar dhe është përfshirë gjatë vitit akademik 2024-2025, jepet në vazhdim në Tabelën nr. 4: "Mbi projekte të kërkimit shkencor në të cilat njësia kryesore ka aplikuar për financim".

✓ Numri i lartë i personelit akademik të angazhuar në botime akademike si autor i parë/dytë në bashkëpunim me kërkues dhe autorë të njohur kombëtarë dhe ndërkombëtarë, etj. Një pasqyrë e detajuar mbi angazhimin e personelit akademik në botime akademike si autor i parë/dytë në bashkëpunim me kërkues dhe autorë të njohur kombëtarë dhe ndërkombëtarë, jepet në vazhdim në Tabelën nr. 5.1: "Botime".

✓ Numri i lartë i personelit akademik të UPT-së pjesëmarrës në konferenca dhe workshope shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, pjesëmarrje e realizuar me referime, si moderator, si anëtarë të Komiteteve Shencore ose si anëtarë të komiteteve organizative dhe nga të cilat rezultojnë si produkt shumë artikuj dhe materiale të botuar në revista/Proceeding Book, ISBN;

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

etj. Një pasqyrë e detajuar mbi pjesëmarrjen e personelit akademik në konferenca dhe workshope shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, jepet në vazhdim në Tabelën nr. 5.2: "Aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare".

- ✓ Numri i lartë i personelit akademik të UPT-së pjesëmarrës në si anëtarë të bordeve editoriale dhe revistave shkencore, i cili për vitin akademik 2024-2025, jepet në Tabelën nr. 5.3: "Pjesëmarrje si anëtarë Bordi Editorial".

3. Rritja e kontributit të kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike në të tre ciklet e studimit.

Ky objektiv synon forcimin e integrimit të kërkimit shkencor me mësimdhënien përmes angazhimit aktiv të studentëve në projekte kërkimore, duke kultivuar aftësi kërkimore dhe punë në grup. Gjithashtu, synohet sigurimi dhe promovimi i bashkëpunimeve të qëndrueshme me universitete homologe evropiane dhe më gjerë në funksion të kualifikimit shkencor, zhvillimit të doktoratave dhe shkëmbimit të eksperiencave. Përfshirja sistematike e studentëve në kërkimin shkencor do të kontribuojë në formimin e tyre profesional, rritjen e cilësisë në përvetësimin e programeve mësimore, orientimin më të mirë drejt tregut të punës dhe përgatitjen e tyre si kërkues të ardhshëm.

Në përmbushje të synimeve dhe plotësimit të këtij objektivi në mënyrë të përmbledhur, për vitin akademik 2024-2025 është realizuar:

- ✓ Organizimi i aktiviteteve ndërkombëtare në formën e seminareve ndërkombëtare të organizuara në kuadrin e lëndëve të ndryshme, mundësuar edhe në sajë të mobiliteteve Erasmus +. Këto mobilitete mundësuan prezencën e profesorëve dhe studentëve Ongoing, të cilët të ardhur nga universitete të huaja, sollën eksperiencën e tyre në fushat personale të kërkimit shkencor e të kurrikulave, duke hapur një komunikim profesional të frytshëm si për studentët ashtu edhe për personelin akademik të UPT-së.
- ✓ Mobilitete Erasmus+ për profesorë dhe studentët Outgoing të UPT-së, të cilët në Teaching mobility apo në Training mobility, transmetuan në institucionet pritëse eksperiencën e tyre në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, duke ndikuar në përhapjen informacionit mbi programet e studimit që UPT ofron, morën eksperiencën e gjerë në fushat e interesit të institucioneve pritëse, por edhe kontribuan në krijimin e network-eve me profesorë dhe studentë të universiteteve të huja.
- ✓ Organizimi i Workshopeve me tema studimore specifike, të mundësuara nga mobilitete Erasmus + për personelin akademik dhe për studentët, në të cilët u zhvilluan projekte konkrete të cilat vijnë si rezultat i studimeve të përbashkëta mes studentëve të UPT-së dhe studentëve të universiteteve partnere. Grupe studentësh të shoqëruar nga personeli akademik i UPT-së udhëtuan drejt institucioneve partnere jashtë vendit për të prezantuar studimet e përbashkëta atje, por edhe studentë nga ato universitete erdhën në UPT për të aplikuar një pjesë të studimit të tyre në Shqipëri.
- ✓ Zhvillimin e qëndrueshëm i Studimeve të Doktoratës në UPT.
- ✓ Organizimin e leksioneve të hapura në shumë njësi kryesore të UPT-së.
- ✓ Angazhimin e studentëve pranë ndërmarrjeve prodhuese në kuadër të kryerjes së praktikave

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

mësimore.

- ✓ Mbështetja e studentëve me infrastrukturë për ecurinë akademike si dhe mbështetja e tyre financiare, kryesisht për studentët e programeve të studimti të ciklit të tretë Doktoratë.

4. Rritja dhe forcimi i rolit të Institutit të Gjeoshkencave (IGJEO) në kërkimin shkencor, si njësi kryesore kërkimore e ekselencës në fushat përkatëse të ekspertizës.

   Puna e IGJEO për vitin akademik 2024-2025 në përmbushje të objektivave është fokusuar në: zhvillimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit, në përmirësimin e infrastrukturës kërkimore dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushat e kompetencës.

   Departamenti i Hidrologjisë, në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Meteorologjisë, është përfshirë në studimin e ciklit të ujit dhe proceseve që lidhen me shpërndarjen, rrjedhjen, ruajtjen dhe cilësinë e ujit në natyrë. Kërkimi shkencor dhe inovacioni në këto fusha është thelbësor për zhvillimin e metodave të qëndrueshme për menaxhimin e burimeve ujore, veçanërisht përballë ndryshimeve klimatike dhe rritjes së popullsisë. Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm dhe të sigurtë në lidhje me përdorimin e ujit, kërkimi dhe inovacioni në meteorologji dhe hidrologji mbulon aspekte të ndryshme që përfshijnë teorinë, teknologjinë dhe aplikacionet praktike. Kërkimi shkencor në këto fusha është i orientuar drejt përmirësimit të njohurive dhe zhvillimit të teknikave që mundësojnë një menaxhim më të mirë të burimeve ujore, parashikimin e ngjarjeve ekstreme dhe mbrojtjen e ekosistemeve ujore në kuadër të projekteve te ndryshme në të cilat është dhe pritet të jetë i përfshirë.

   - ✓ Modelimi dhe Simulimi i Sistemeve Hidrologjike: Një pjesë e rëndësishme e kërkimit shkencor në hidrologji është zhvillimi dhe përdorimi i modeleve matematikore dhe kompjuterike për të simuluar dhe parashikuar sjelljen e ujërave në nivele të ndryshme, nga ato lokale deri tek ato rajonale dhe globale. Këto modele mund të ndihmojnë në:
     - ❖ Parashikimin e përmbytjeve, thatësirave dhe ndryshimeve në nivelin e ujërave të lumenjve, liqeneve dhe ujërave nëntokësore.
     - ❖ Simulimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike në ciklin hidrologjik dhe disponueshmërinë e burimeve ujore.
     - ❖ Optimizimin e menaxhimit të burimeve ujore, psh: për përdorim në bujqësi, industrinë e ujit dhe energjinë hidroelektrike.
   - ✓ Studimi i Ndikimit të Ndryshimeve Klimatike në Hidrologji. Një tjetër fushë kërkimore kyçe, është ndikimi i ndryshimeve klimatike në ciklin hidrologjik. Kërkimet fokusohet në:
     - ❖ Ndryshimin e modeleve të reshjeve dhe ndikimin e këtyre ndryshimeve në disponueshmërinë e ujërave dhe rrezikun e përmbytjeve.
     - ❖ Analizën e temperaturave dhe ndikimin e tyre në fluksin e ujërave, reshjet dhe shkrirjen e akullnajave.
     - ❖ Studimin e mënyrave për adaptimin dhe mitigimin e këtyre ndikimeve përmes menaxhimit të ujërave dhe zbatimin e teknologjive të qëndrueshme.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ✓ Përmirësimi i infrastrukturës kërkimore dhe laboratorike. Janë planifikuar ndërtimi i arkivit dixhital të dhënave sizmike, ri-përpunimi i të dhënave për periudhën 2002–2020, ri-lokalizimi i ngjarjeve sizmike të periudhave të mëhershme, grumbullimi dhe analizimi i të dhënave nga rrjeti akselerometrik kombëtar dhe përmirësimi i mbulimit të rrjetit kombëtar sizmologjik. Gjithashtu, janë planifikuar centralizimi i arkivit dixhital të dhënave hidrometeorologjike, ri-përpunimi i të dhënave për periudhën 1991–2024, studimi i ngjarjeve të mëparshme hidrometeorologjike, grumbullimi dhe analizimi i të dhënave nga rrjeti kombëtar hidrometeorologjik dhe përmirësimi i mbulimit të këtij rrjeti.
- ✓ Zhvillimi i ekselencës shkencore në fushat e gjeoshkencave:
  - ❖ Fushat e sizmologjisë dhe inxhinierisë sizmike: Janë planifikuar kërkime mbi zgjidhjet e moment-tensorëve, analizimi i mekanizmave të thyerjeve dhe inversimi i stresit, si dhe përditësimi i hartave të rrezikut sizmik përmes analizave probabilistike dhe deterministike të rrezikut.
  - ❖ Fushat e meteorologjisë dhe hidrologjisë: Përmiresimi i hartave të rrezikut hidrometeorologjik, etj.
- ✓ Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe trajnimi profesional. Përfshihet trajnimi i stafit kërkimor në përdorimin e programeve sizmologjike (SeisComP5, NonLinLoc, StressInverse, PyGMT) dhe hidrometeorologjike (EFAS, SIMClim, FFG, ICON, ECMWF, etj.) dhe përfshirja në projekte kërkimore ndërkombëtare, si: IPA CARE, EMERGE, ALBAdapt, EU4Rivers, etj., me qëllim ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale.

5. Evidentimi dhe përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar që zhvillohet në UPT. Në kuadër të këtij objektivi synohet rritja e transparencës dhe shfrytëzimit të informacionit së kërkimit shkencor duke vënë theks të veçantë në promovimin e rezultateve përmes konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe përmes botimeve dhe artikujve shkencorë. Bërja publike e projekteve të financuara dhe nxitja e prezantimit të rezultateve të kërkimit shkencor në konferenca dhe revista shkencore, kontribuojnë në rritjen e vizibilitetit dhe në rritjen e ndikimit të rezultateve të arritura në kërkimin shkencor.
   - ✓ Administrimi dhe menaxhimi i kërkimit shkencor. Gjatë periudhës raportuese është punuar për përmirësimin e administrimit të kërkimit shkencor përmes krijimit të bazave të reja digjitale dhe përditësimit të atyre ekzistuese, me qëllim evidentimin, ruajtjen dhe aksesimin e informacionit mbi aktivitetin e kërkimit shkencor në UPT.
   - ✓ Transparenca dhe publikimi i projekteve. Gjatë vitit akademik 2024-2025 kanë vijuar përpjekjet për përhapjen e informacionit mbi aktivitetin e kërkimit shkencor përmes evidentimit dhe bërjes publike të projekteve për aplikim dhe projekteve të financuara në kuadër të programeve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.
   - ✓ Numri i lartë i personelit akademik të angazhuar në pjesëmarrje në 119 aplikime të projekteve kërkimore shkencore të financuara nga AKKSHI, në rang njësish kryesore. 73 prej tyre janë shpallur fitues, 28 prej tyre janë jo fitues dhe 19 projekte janë ende në prritje të përgjigjes pas aplikimit.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al




Figura 7: Aplikime për projekte për njësi kryesore.

- ✓ Konferenca shkencore të organizuara nga njësitë kryesore të UPT-së. Njësitë kryesore të UPT-së kanë organizuar konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat kanë shërbyer si hapësira për prezantimin dhe diskutimin e rezultateve të kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar. Këto aktivitete kanë kontribuar në rritjen e vizibilitetit së produkteve kërkimore, në shkëmbimin e përvojave dhe eksperiencës akademike kërkimore ndërmjet kërkuesve të UPT-së dhe atyre të huaj si dhe në forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional. Gjatë vitit akademik 2024-2025 nga njësitë bazë/kryesore të UPT-së kanë organizuar ose bashkëorganizuar 53 aktivitete të kërkimit shkencor të prezantuara në formën e konferencave, work-shop, seminare, forume, trajnime, etj.
- ✓ Publikime shkencore në revista kombëtare dhe ndërkombëtare. Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor në UPT ka ndikuar edhe në publikimet në revistat me SCOPUS ku vihet re një numër i lartë i publikimeve nga personeli akademik. Numri i punimeve të realizuara nga personeli akademik të indeksuara në Scopus dhe/ose WoS për vitin akademik 2024-2025 është 126 atrikuj, ndarë sipas njësive kryesore në grafikun e mëposhtëm:




Figura 8: Numri i botimeve të indeksuara Scopus ose/edhe WoS.

- ✓ Numri i lartë i personelit akademik të UPT-së pjesëmarrës në konferenca dhe workshope shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, pjesëmarrje e realizuar me referime, si moderator, si anëtar të Komiteteve Shencore ose si anëtarë të komiteteve organizative dhe nga të cilat rezultojnë si produkt shumë artikuj dhe materiale të botuar në revista/Proceeding Book, ISBN, etj. Një pasqyrë e detajuar mbi pjesëmarrjen e personelit akademik në konferenca dhe workshope shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe produktet e gjithësecilit, jepet në vazhdim në tabelat nr. 5.1, 5.2 dhe 5.3.
- ✓ Publikimi dhe aksesueshmëria e doktoratave. Me synimin krijimin e një arkive institucionale të aksesueshme për komunitetin akademik dhe publikun e gjerë, publikimi i doktoratave ka kontribuar gjithashtu si një mjet në forcimin e standardeve të cilësisë shkencore, parandalimin e mbivendosjes tematike në projektet doktorale dhe nxitjen e kërkimeve e projekteve të reja si dhe për mbështetjen e studentëve dhe kërkuesve të rinj në procesin e studimit dhe hulumtimit shkencor.
- ✓ Buletini i Shkencave Teknike. Ky buletini është organ i Universitetit Politeknik të Tiranës dhe vlerësohet si revistë shkencore me Bord Editorial, ku ka si qëllim publikimin e rezultateve të arritura në kërkimin shkencor, bazë e të aplikuar, në fushat e shkencave teknike, të kontribuojë në këmbimin e përvojës dhe kualifikimin e specialistëve në Republikën e Shqipërisë, publikimin e arritjeve të shqiptarëve në këto fusha jashtë vendit tonë, si punime të tyre ose si bashkëpunime në fusha të ndryshme inxhinierike. Buletini botohet periodikisht në gjuhën shqipe dhe në raste të veçanta mund të botojë artikuj edhe në gjuhë të tjera me vendim të Redaksisë së tij. Gjatë vitit akademik 2024-2025 në këtë buletin janë botuar 14 artikuj.

6. Rritja e kontributit të kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe ekspertizës në fushat përkatëse inxhinierike në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT. Në kuadër të këtij objektivi synohet rritja e kontributit të kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe ekspertizës inxhinierike, me qëllim sigurimin e të ardhurave suplementare përmes pjesëmarrjes aktive në projekte kërkimore dhe infrastrukturore, gjenerimit të të ardhurave nga veprimtaritë kërkimore shkencore si dhe zgjerimit të angazhimit në ekspertiza të ndryshme.
   - ✓ Pjesëmarrja në projekte të financuara nga AKKSHI. Në këtë kuadër, numri i projekteve kërkimore dhe infrastrukturore të fituara nga AKKSHI është 73.
   - ✓ Shërbime, studime dhe ekspertiza për të tretët.
     - ❖ Gjatë vitit akademik 2024-2025, personeli akademik dhe studentët e UPT-së janë përfshirë në punë aktive për të realizuar shërbime për të tretët. UPT ofroi 316 shërbime, studime dhe ekspertiza për institucione publike dhe subjekte private. Prej këtyre shërbimeve rezultojnë:
     - ❖ Të ardhura të arkëtuara 502,003,677.
     - ❖ Numri i personelit akademik i angazhuar 120.
     - ❖ Numri i studentëve të angazhuar 30.

   Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat financiare të detajuara të kërkimit shkencor.:

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela: Të ardhura të planifikuara/shpenzuara dhe krijuara nga kërkimi shkencor në UPT.

Fonde	Përshkrimi	Vlera (lek)
Fonde financiare të planifikuara për kërkimin shkencor	Fonde të planifikuara nga vetë institucioni për kërkimin shkencor	162,110,953
	Fonde të projekteve të huaja	60,281,000
	Fonde të buxhetit të shtetit (grant)	7,358,000
	Fonde të buxhetit të shtetit (AKKSHI)	175,091,134
Fonde financiare të shpenzuara për kërkimin shkencor	Fonde nga UPT	75,598,550
	Fonde të buxhetit të shtetit për kërkimin shkencor	6,265,403
	Fonde nga financimi/bashkëfinancimi i projekteve BE	40,266,650
	Fonde nga financimi/bashkëfinancimi i projekteve AKKSHI	94,218,443
Shpenzime për transferim të njohurive dhe produktet të kërkimit shkencor	Konferenca të organizuara nga UPT	1,369,160
	Botime të financuara: tekste, monografi, artikuj, etj.	3,308,476
	Pjesëmarrje në konferenca	4,425,615
Shpenzime për të tretët	Numri i shërbimeve të realizuara	316
	Të ardhura të arkëtuara	502,003,677
	Numri i personelit akademik i angazhuar	120
	Numri i studentëve të angazhuar	30

Një pasqyrë e detajuar mbi realizimin e objektivave të kërkimit shkencor nga njësitë kryesore të UPT-së jepet më poshtë në Tabelën nr. 2 "Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit".

2.2.3 Strukturat përgjegjëse

Veprimtaria kërkimore-shkencore në UPT zhvillohet në:

- ✓ njësitë bazë të Fakulteteve;
- ✓ njësitë bazë të Institutit të Kërkim-Zhvillimit (IGJEO).

Departamentet në UPT, kanë të drejtë të organizohen në grupe kërkimore-shkencore, të përhershme ose të përkohshme.

Në strukturën akademike të UPT, Instituti (IGJEO) funksionon si njësi kryesore dhe departamentet e tij si njësi bazë. Instituti (IGJEO) në UPT kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi, si edhe merr pjesë në realizimin e programeve të studimit në të gjitha ciklet e studimit, që ofrohen nga UPT.

Njësitë bazë në UPT kryejnë veprimtari kërkimore-shkencore bazë ose të zbatuar nëpërmjet projekteve kërkimore-shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe veprimtarive të tjera krijuese të përcaktuara në këtë statut, sipas natyrës dhe objektivave specifikë të tij dhe në kornizën ligjore në fuqi.

Çdo një njësi bazë/kryesore planifikon, zbaton, monitoron dhe raporton në mënyrë periodike aktivitetin e kryer kërkimor shkencor dhe krijues në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, me Planin Strategjik të UPT-së, me Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës si dhe me rregullore e vendime të ndryshme.

Veprimtaria kërkimore-shkencore në UPT realizohet mbi bazën e programeve dhe projekteve të miratuara dhe të realizuara në njësitë bazë, njësitë kryesore dhe struktura ndërdisiplinore.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Fushat kërkimore dhe drejtimet kryesore të veprimtarisë kërkimore, përcaktohen mbi bazën e propozimeve të njësive bazë dhe kryesore të tij si dhe miratohen nga SAUPT.

Njësitë bazë të UPT, në fund të çdo viti akademik, hartojnë raportin vjetor të veprimtarisë kërkimore-shkencore të kryer.

Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, mbështet kërkimin shkencor në UPT, në përputhje të plotë me prioritetet strategjike dhe interesat e vendit, e cila gërshetohet me mësimdhënien me pikësynim rritjen e cilësisë së ofertës akademike. Drejtoria e kërkimit shkencor dhe projekteve e realizon misionin e saj me anë të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në administrimin e sistemit të burimeve të kërkimit shkencor në nivel institucional dhe mbështetjes funksionale të tij. Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në UPT, siguron menaxhimin eficient të aktiviteteve kërkimore shkencore nëpërmjet nxitjes, bashkëpunimit, koordinimit dhe promovimit të formave të ndryshme të kërkimit shkencor e inovacionit, në bashkëpunim të plotë me të gjitha njësitë kryesore dhe strukturat në UPT.

UPT ofron nëpërmjet veprimtarive kërkimore-shkencore, të zhvillimit dhe krijuese, shërbime për të tretët. Të ardhurat e krijuara nga këto veprimtari administrohen nga Drejtoria e Shërbimeve ndaj të Tretëve, që kryen veprimtarinë, sipas rregullores së miratuar nga Bordi i Administrimit të UPT-së.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS · REKTORATI · SEKRETARIA

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

2.2.4 Qëllimi dhe objektivave në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit

Njësitë bazë dhe ato kryesore, planifikojnë aktivitete dhe detyra konkrete për realizimin e objektivave të planit strategjik të vetë njësive bazë dhe kryesore dhe në tërësi të atij të Universitetit Politeknik të Tiranës.

2.2.4.1 Zhvillimi i burimeve njerëzore, i kapaciteteve infrastrukturore dhe financiare në shërbim të kërkimit shkencor dhe shërbimeve në UPT

Tabela 2.1.1: FAU – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
-Rritja e fondeve për KSH dhe botime në revista ndërkombëtare. -Pasurimi i laboratoreve me paisje për KSH. -Përmirësimi i aftësisë arkivuese të platformës Elearning FAU. -Mbështetja e mobiliteteve ndërkombëtare të anëtarëve të stafit të FAU. -Politikë rekrutimi në përputhje me nevojat e njësive bazë. -Kualifikim i vazhduar i anëtareve të stafit akademik dhe ndihmës akademik. -Aplikime në projekte bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë.	-Rritja e buxhetit për KSH. -Mbështetja me të ardhura nga FAU i pjesëmarrjes së stafit në konferenca ndërkombëtare dhe i botimeve në revista ndërkombëtare. -Aplikim në projekte që mundësojnë pasurim të laboratorëve. -Aplikim për projekte të përbashkëta studimore me kolegët ndërkombëtarë.	-Është rritur buxheti në mbështetje të kërkimit shkencor. -Kërkesat e ardhura nga Stafi për mbështetje financiare janë realizuar. -Përfundoi me sukses një projekt mbi krijimin e laboratorit për Virtual Reality, pranë departamentit të Arkitekturës, mbështetur nga AKKSHI. - U zhvillua viti i dytë dhe përfundoi me sukses një projekt bilateral Shqipëri Itali i financuar nga AKKSHI. Projekti studion ndërtimet prej qerpiçi në Shqipëri.	2024-2025	FAU ka vështirësi të vënies në eficencë të plotë të laboratorëve të tij, për shkak të mungesës së ambjenteve të dedikuar për laboratorë (shkak prishja e godinës).

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
		-Është rritur buxheti në mbështetjë të kërkimit shkencor. -Kërkesat e ardhura nga Stafi për mbështetje financiare janë realizuar.		

Tabela 2.1.2: FGJM – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Kualifikime individuale të stafit akademik.	Shkëmbime me universitete të ndryshme.	Shkëmbim studentësh dhe stafi.	2024-2025	

Tabela 2.1.3: FIE – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1. Zhvillimi i një sistemi kuadër të menaxhimit dhe lidershipit në të gjitha nivelet. 2. Zhvillimi i qëndrueshëm i numrit të studentëve, që ndjekin programet e studimit të FIE në të gjitha ciklet e studimit. 3. Ndërtimi i dy laboratoreve të ri që ndihmojnë në fushën e kërkimit shkencor.	1. Përmirësimi i politikave të rekrutimit të stafit. 2. Krijimin e një mjedisi tërheqës dhe krijues për stafin e ri. 3. Garantimi i mundësive të barabarta. 4. Rritja e të ardhurave nga ekspertiza. 5. Specifikimi dhe ndërtimi i laboratoreve sipas standarteve dhe zhvillimeve teknologjike të cilat mbështesin Kërkimin	1. Kualifikimi i stafit akademik. 2. Intensifikim marrëdhënieve me partnerët ndërkombtarë.	Çdo vit akademik	Kualifikimi i stafit akademik dhe krijimi i marrëdhënieve me institucione homologe ndërkombëtare është një prioritet i përvitshëm.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
	Shkencor.			

Tabela 2.1.4: FIM – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
-Fillimi i vitit të parë akademik të shkollës së doktoratës në FIM, e cila po ndiqet nga 6 studentë doktorantë, nga ku 4 staf efektiv në FIM. Aplikimi për fitimin e gradës shkencore "Doktor" nga një anëtar i DM. -Aplikimi për fitimin e titullit akademik "Profesor i Asociuar" nga tre anëtarë të DPM, një i DE dhe dy të DTM. -Përgatitja për plotësimin e kritereve për marrjen e këtyre titujve. -Planifikimi në buxhetet e departamenteve të FIM për kërkimin shkencor (botim artikujsh dhe pjesmarrje në konferenca dhe aktivitete të tjera) si dhe planifikimin në buxhetet përkatëse të departamentve të FIM për v.a. 2024-2025 për blerje pajisjesh laboratorike, softe kompiuterike, etj. -Fillimi i implementimit të një Projektit të AKKSH-it (2024-2026).	-Planifikimi në Departamentet e FIM për nevojat më imediate për pajisje laboratorike dhe softe kompjuterike, planifikimi në Departamente për mbështetje financiare për botim artikujsh, pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare, për pedagoget që syojnë kualifikim të mëtejshem. -Përgatitja e projekt buxhetit të Departamenteve për vitin akademik 2024-2025 dhe projekt-buxheti afatmesëm 2026-2028 nga drejtuesi i departamentit dhe drejtuesit e grupeve mësimore, në bashkepunim me administratorin e FIM. Realizimi i aktiviteteve të parashikuar në vitin e parë të zhvillimit të projektit të financuar nga AKKSHI dhe projekteve EU.	Përgatitja dhe miratimi i buxhetit të Departamenteve per v.a. 2024-2025 në Dekanatin e FIM dhe më tej. Instalimi i pajisjeve të reja laboratorike financuar nga buxhetit i FIM. Realizimi i të gjitha aktiviteteve në kuadër të projekteve kombëtare dhe EU.	2024-2025	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 2.1.5: FIMIF – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1. Ruajtja dhe zhvillimi i burimeve njerëzore për të garantuar vazhdueshmërinë e kërkimit shkencor në FIMIF; 2. Përmirësimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor nëpërmjet modernizimit të laboratorëve ekzistues; 3. Modernizimi i bibliotekës shkencore të fakultetit si një burim i vlefshëm dhe i domosdoshëm informacioni në shërbim të kërkimit shkencor dhe zgjerimit të njohurive për studentët; 4. Zhvillimi i kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar në fushat që fakulteti mbulon; 5. Orientimi i kërkimit të mirëfilltë dhe të avancuar shkencor në fushat kërkimore shkencore prioritare të përcaktuara në departamentet përkatëse të FIMIF: DIM, DIF, DIK, QGJH; 6. Inkurajimi dhe nxitja e stafit akademik për studime të zbatuara dhe projekte bashkëpunimi me fakultetet e tjera të UPT, dhe në veçanti me Institutin e Gjeoshkencave. Bashkëpunimi me institucione të tjera publike dhe private brenda dhe jashtë vendit për probleme inxhinierike dhe ekonomike, zgjidhja e të cilave mundësohet ose lehtësohet nga përdorimi i teknikave matematike, metodave fizike dhe teknologjive kimike; 7. Hapja e Shkollës së Doktoratës në Inxhinieri Matematike për herë të parë në vitin akademik 2024-2025.	1. Përmirësimi i politikave të rekrutimit të stafit. 2. Krijimi i një mjedisi tërheqës dhe krijues për stafin e ri. 3. Rritja e të ardhurave nga ekspertiza. 4. Blerja e pajisjeve të reja laboratorike për DIF dhe DIK. 5. Kompletimi me teknologji bashkëkohore i laboratorëve. 6. Marrja pjesë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. 7. Bashkëpunime me departamente të tjera në FIMIF, dhe me fakultete të tjera në UPT. 8. Regjistrimi i 9 studentëve të rinj në programet e doktoratës (4 në DIF, 5 në DIM). 9. Organizimi i programeve mësimore për shkollën e doktoratës. 10. Sigurimi i aksesit në databazat ndërkombëtare të kërkimit shkencor.	Mbështetja dhe kualifikimi i stafit akademik. Konceptimi dhe realizimi i projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në ndihmë të rritjes së veprimtarisë kërkimore shkencore. Regjistrimi me sukses i 9 doktorantëve të rinj. Hapja e Shkollës së Doktoratës në Inxhinieri Matematike realizuar me sukses. Studentët e vitit të parë kanë përfunduar vitin akademik dhe kanë bërë prezantimet në departamente. Janë blerë pajisje të reja dhe moderne për laboratorët e DIF dhe DIK, duke përmirësuar kapacitetet kërkimore.	Çdo vit akademik	Hapja e Shkollës së Doktoratës në Inxhinieri Matematike përfaqëson një arritje të rëndësishme në diversifikimin e ofertës akademike të FIMIF. Investimi në infrastrukturë laboratorike ka krijuar kushte më të mira për kryerjen e kërkimeve eksperimentale të avancuara.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 2.1.6:. FIN – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Është parashikuar që të kemi një rritje të cilësisë së kërkimit shkencor dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore.	Gjatë kësaj periudhe nga ana e stafit të departamenteve është bërë e mundur pjesëmarja në mjaft aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe publikimi i një numuri të kënaqshëm artikujsh shkencorë në revista të indeksuara me Scopus ose Clarivate Analytics (Thomson Reuters).	22 artikuj dhe periodikë në revista shkencorë jashtë vendit. Është realizuar pjesëmarrja me 63 referime në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)	Tetor 2024 – Shtator 2025	N/A

Tabela 2.1.7: FTI – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Kualifikimi i stafit të ri nëpërmjet shkollës së doktoratës si dhe përfitimi i titujve për stafin akademik të FTI-së. Pasurimi i laboratorëve si dhe financimi i aktiviteteve të ndryshme kualifikuese shkencore.	Shkolla e Doktoratës; Projektet kërkimore-shkencore; Pasurimi i laboratorëve; Pjesëmarrja në konferenca dhe botimet në revista kombëtare dhe ndërkombëtare.	Vazhdimësia e shkollës së doktoratës. Përfitimi i titujve nga personeli akademik. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i infrastrukturës së laboratoreve. Monitorimi i vazhdueshëm dhe plotësimi i raporteve.	Vjetor	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 2.1.8: IGJEO – Kapacitetet njerëzore, infrastrukturore dhe financiare për kërkimin shkencor.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Finalizimi i investimeve në rrjetin e monitorimit sizmik, meteorologjik dhe hidrologjik dhe përditësimi i teknologjive të përdorura. -Trajnime për staf akademik dhe studentë. -Finalizimi i investimeve në rrjetin e GPS.	Aktivitete dhe detyrat konkrete - Azhornimi i rrjeteve të monitorimit me teknologji të gjeneratës së fundit. - Finalizimi i marrëveshjeve ndërkombëtare për shkëmbim të dhënash. -Trajnime të vazhdueshme për kërkimin shkencor dhe teknologjinë.	Përputhje e plotë me planin strategjik të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin Europian (SASPAC 2022) -Përshtatje e burimeve njerëzore për kërkime shkencore dhe shërbime.	Viti akademik 2024-2025 dhe në vijim.	Arritjet përfshijnë përmirësimin e hartave probabilitare të rrezikut sizmik sipas Eurokodit 8. -Nevojiten burime të reja financiare për të mbështetur këto aktivitete. -Trajnimi i stafit për përdorimin e pajisjeve të reja.

2.2.4.2 Rritja në sasi dhe cilësi e veprimtarisë kërkimore dhe shërbimeve në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit

Tabela 2.2.1: FAU – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
-Bashkëpunimi me institucionet publike dhe organizmat qeveritare me qëllim rritjen e kontributit për trajtimin e problematikave që lidhen me zhvillimin perspektiv të vendit për përballimin e sfidave në drejtim të një zhvillimi të qëndrueshëm; -Identifikimi i fushave me interes	Hartimi i projekteve kërkimore, pjesëmarrja në projekte kërkimorë në proces, zhvillimi dhe mbështetja e studimeve doktorale dhe orientimi i tezave të diplomave drejt këtyre fushave.	Bashkëpunim me ChWb dhe IKTK për praktika mësimore. Temat e trajtuara në diplomat e MpRMK janë zhvilluar mbi tema dhe	2024-2025	Bashkëpunimi me institucionet publike dhe organizmat qeveritare me qëllim rritjen e kontributit për trajtimin e problematikave që lidhen

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

		monumente konkrete që kanë nevojë për restaurim.		me zhvillimin perspektiv të vendit për përballimin e sfidave në drejtim të një zhvillimi të qëndrueshëm; -Identifikimi i fushave me interes.

Tabela 2.2.2: FGJM – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Pjesëmarrje në Grupet e Punës të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.	Takime konsultuese për Strategjinë e Zhvillimit të Sektorit Minerar.		2024-2025	

Tabela 2.2.3: FIE – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1.Bashkëpunimi me institucionet publike dhe organizmat qeveritare; 2. Zhvillimi i një klime bashkëpunimi me institucione të tjera publike dhe private; 3. Rritja në cilësi e veprimtarisë kërkimore duke shtuar artikujt e botuar në revista të indeksuara në Scopus.	1. Ofrimin e ekspertizës në fushat me interes për zhvillimin e vendit; 2. Krijimi i laboratorëve të rinj; 3. Marrja pjesë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare; 4. Përmisimi i laboratorëve ekzistues; 5. Bashkëpunime ndërmjet departamenteve në FIE dhe me fakultete të tjera në UPT.	1. Marrja pjesë në realizimin e ekspertizave; 2. Studime mbi tendencat e zhvillimit industrial; 3. Pjesëmarrje në konceptim projektesh.	2019 -2024	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 2.2.4: FIM – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Mbyllja me sukses e dy prej projekteve të PKKZH dhe PTI dhe ndërkohë një projekt PKKZH është në vazhdim. Gjithashtu mbyllja me sukses e 3 projekte të fituara Capacity Building Project dhe 1 projekt nga READ program. Aplikimi tek AKKSH-i nga: Prof. Asoc. Irma Shyle e një projekti PKKZH, Prof. Asoc. Eralda Xhafa e një projekti AADF, Prof. Asoc. Jonida Teta e një projekti PIKSH dhe PKKZH, Prof. Odhise Koca e një projekti PKKZH, Prof. Asoc. Shpresa Caslli e një projekti PKKZH dhe Ilda Kazanit si anëtare e grupit e një Projekti PIKSH. Për programin Interreg IPA III është aplikuar një projekt, nga MSc. Dorian Osmanaj. Për projektet EU, janë bërë disa aplikime për projekte të ndryshme nga: 3 projekte Prof. Ermira Shehi, 1 projekt Prof. Asoc.Tatjana Spahiu. 1 projekt Prof. Asoc. Ilda Kazani. Për projektet ndërkombëtare të AKKSH-it, Prof. Asoc. Ilda Kazani me një projekt në EUREKA. Përgatitjet për zhvillimin e konferencës ndërkombëtare në FIM "Engineering and Enterprice" (parashikuar për tu mbajtur në 23-24 Tetor 2025); Kritja e bashkëpunimit me biznesin privat që operon në fushat që mbulon FIM.	Dorëzimi i raporteve të projekteve të mbyllura të PKKZH-s dhe PIKSH-it si dhe përgatitja e raporteve nga ana e anetarëve të grupeve të punës për projektet e fituara të PKKZH-ës, PIKSH-it, PTI-së, Bilateral-it Capacity Building Project dhe projektit READ. Bërja gati e laboratorit të ri dhe ndjekja e realizimit të blerjes dhe ardhjes së pajisjeve të reja laboratorike në kuadrin e projektit PIKSH-it. Përgatitjet për reailizimin eworshopeve/seminareve/forumeve në kuadër të projekteve të fituara në ambjentet e FIM.	-Fitimi i titullit akademik Dr. dhe Prof. Asoc nga: Anis Sulejmani, Artan Hoxha, Ilo Bodi, Idlir Dervishi, Silva Spahiu, Erald Piperi, Elmira Dumishllari; -Hapja e programit të studimit të formimit të vazhduar: Kursi "Siguria dhe shëndeti në Punë"; -Fillimi në vitin e parë akademik të gjashtë doktoratave në FIM që lidhen me trajtimin e problematikave të rëndësishme me të cilat përballen sektorë të caktuar të ekonomisë së vendit tonë; -Fitues i 5 projekteve Kombëtare (1 AADF, 2 PKKZH, 2 PIKSH, ku tek një është anëtar); -Organizimi në kuadër të projekteve të kombëtare dhe EU të shumë workshopeve, seminarëve dhe një Forumi Shkencor nga stafi akademik i FIM;	2024-2025	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

		-Publikimi i 49 artikujve në revista kombëtare dhe ndërkombëtare; -Pjesëmarrja me 12 referime në konferenca kombëtare dhe 57 referime në konferenca ndërkombëtare nga stafi akademik i FIM; -Përfshirja e stafit akademik të FIM në 25 Borde Editoriale të revistave kombëtare dhe në 20 Borde Editoriale të revistave ndërkombëtare; -Gjithashtu përfshirja edhe në pjesëmarrje si reçensues të artikujve shkencorë: 4 në revista kombëtare, 68 në revista ndërkombëtare dhe 4 në projekte kombëtare.		

Tabela 2.2.5: FIMIF – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Harmonizimi dhe integrimi më i mirë i shkencave bazë të edukimit në FIMIF me pjesën tjetër të edukimit inxhinierik; Përfshirja në programet mësimore të metodave të orientuara drejt kompjuterit dhe e disa softeve të rëndësishme për këtë qëllim;	Zhvillimi i qëndrueshëm i Studimeve të Doktoratës në FIMIF, në DIF dhe DIM. Organizimi i leksioneve të hapura. Nxitja e mobilitetit të studentëve pranë universiteteve Evropiane. Angazhimi i studentëve pranë ndërmarrjeve prodhuese. Mbështetja e tyre financiare, me	Mbështetje financiare e studentëve të FIMIF në të tre ciklet e studimit, në pjesëmarrjet e tyre në veprimtari shkencore të ndryshme. Realizimi i praktikave të studentëve të	Viti akademik 2024-2025	Projektet e fituara adresojnë direkt prioritete strategjike të vendit në energji të rinovueshme, mjedis dhe integrimin e AI në arsim. DIM ka kontribuar me 67 botime

Thellimi i integrimit të kërkimit shkencor në mësimdhënie dhe rritja e përgjegjshmërisë së studentit; Angazhimi i studentëve të nivelit Master dhe Doktoratë në projekte studimore e kërkimore me qëllim kultivimin e shprehive të kërkuesit të integruar në grup; Publikimi i rezultateve të kërkimit shkencor në revista të njohura si brenda ashtu edhe jashtë vendit; Aplikimi në thirrjen AKKSHI 2025 për projekte kërkimore-shkencore dhe infrastrukturore.	infrastrukturë për ecurinë akademike. Botime në revista shkencore me faktor impakti. Pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Publikime me akses të hapur dhe arkivim në bibliotekën e FIMIF. Hartimi dhe dorëzimi i 6 propozimeve projekti në AKKSHI (2 PIKSH, 4 PKKZH). Ekzekutimi i projekteve kërkimore të DIK me fokus në problematika mjedisore kombëtare.	nivelit Master pranë kompanive private apo shtetërore me të cilat UPT ka marrëveshje. FIMIF ka realizuar 98 botime në revista shkencorë ndërkombëtare. Realizuar 84 pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Fituar 3 nga 6 projekte AKKSHI (normë suksesi 50%). DIK ka siguruar financim prej 2,143,000 lekë për dy projekte kërkimore: "Investigating the Impact of Open Burn Pits on Air Pollution in Albania" (READ Programme - AADF) dhe "Vlerësimi i shkallës së eutrofikimit në Liqenin artificial të Tiranës" (Akademia e Shkencave).		ndërkombëtare dhe 39 pjesëmarrje në konferenca. DIF ka realizuar 19 botime dhe 37 pjesëmarrje në konferenca. DIK ka kontribuar me 3 botime dhe 13 pjesëmarrje. QGJH ka realizuar 9 botime dhe 25 pjesëmarrje në konferenca.

Tabela 2.2.6: FIN – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Është paraqitur që të kemi një rritje në cilësi dhe sasi të veprimtarisë së kërkimit në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.	Nga ana e stafit të FIN, gjatë kësaj periudhe kohore është punuar në rritjen si në cilësi ashtu edhe në sasi të kërkimit shkencor, kjo për t'u përfshirë dhe marrë në konsideratë	Konferenca e dytë Kombëtare "Aplikimi i Teknologjive të Pastra për një Mjedis të Qëndrueshëm"(ATPMQ 2)	Tetor 2024 – Shtator 2025	N/A

	nga institucione të ndryshme të cilat punojnë në kuadër të zhvillimit strategjik të vendit.	Workshop në lidhje me Ekonominë Qarkulluese i zhvilluar pranë HUB, përfshirë dhe biznese Pjesëmarrja në projekte: 1 Future project Scills2Sustaine Project ERASMUS+, të financuara nga CE, si dhe nga UPT.		

Tabela 2.2.7: FTI – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Bashkëpunimi me institucionet publike dhe organizmat qeveritare me qëllim kontributin për trajtimin e problematikës që lidhen me zhvillimin perspektiv të vendit për përballimin e sfidave në drejtim të një zhvillimi të qëndrueshëm. Fuqizimi i kapaciteteve krijuese të personelit akademik e kërkimor të FTI nëpërmjet inkurajimit të lirisë kërkimore për të adresuar çështje me rëndësi shkencore në shërbim të zhvillimit të vendit. Zhvillimi i kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar në fushën e informatikës. Zhvillimi i një klime bashkëpunimi me institucione të tjera publike dhe private brenda vendit që operojnë në fushat përkatëse inxhinierike.	Pjesëmarrja në tryeza të rrumbullakëta organizuar nga AKKSHI, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Arsimit, etj. Forume të sektorit privat që operojnë në Republikën e Shqipërisë. Lidhje e ngushtë me Akademinë e Shkencave.	Pjesëmarrje në tryeza të ndryshme të rrumbullakëta të organizuara me institucione partnere. Vendosja e marrëdhënieve të reja bashkëpunuese me institucione publike dhe private të fushë dhe forcimi i bashkëpunimeve ekzistuese nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme, si: ditë informative, konferenca, tryeza të rrumbullakëta, projekt-propozime etj. Monitorimi i vazhdueshëm dhe plotësimi i raporteve.	Vjetor	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Bashkëpunimi me sektorin privat për të mundësuar dhënien e ekspertizës dhe zgjidhjen e problemeve teknike e teknologjike që hasen. Zhvillimi i kërkimit shkencor në FTI në përputhje me standardet e cilësisë.				

Tabela 2.2.8: IGJEO – Veprimtari në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
-Përditësimi dhe avancimi i modelit të rrezikut sizmik dhe atij hidrometeorologjik për Shqipërinë. -Angazhimi në projekte kërkimore ndërkombëtare dhe kombëtare. -Përpunim dhe analiza statistikore mbi të dhënat në fushat përkatëse të studimeve në IGJEO. -Studime për të tretë.	-Përfundimi i projektit "Reducing the impact of earthquakes in Albania" në bashkëpunim me GEM Foundation. -Përgatitja e hartave të reja të rrezikut sizmik për kushtet e Eurokodit 8. -Publikimi i rezultateve për të informuar komunitetin inxhinierik. -Pjesëmarrje në konkurse të financuara nga BE dhe qeveria.	Plotësisht në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (2023-2030).	Viti akademik 2024-2025 dhe në vijim.	-Kjo arritje mbështet implementimin e kodeve moderne ndërtimore në Shqipëri. -Identifikimi dhe aplikimi për fonde kërkimore është kyç për suksesin e këtyre objektivave.

2.2.4.3 Rritja e kontributit të kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike në të tre ciklet e studimit

Tabela 2.3.1: FAU – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente

-Mbështetje e studentëve për të kryer mobilitete në Erasmus +. -Organizimi i leksioneve të hapura nga arkitektë të vendit e të huaj. -Organizimi workshopeve dhe seminareve internacionale.	Përditësimi i kurrikulave dhe programeve mësimore në përputhje me rezultatet e proceseve kërkimore.	-Workshop me Saxson University, Hollandë. -Workshop me ESTP, Paris. -Tema studimore të përbashkëta me Saxon University, Holandë. -Leksione të hapura nga kërkues dhe arkitektë të huaj.	2024-2025	

Tabela 2.3.2: FGJM – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Publikime, Seminare, Workshope Finalizimi i marrëveshjeve me partnerët për hapjen e programeve të përbashkëta.	Përfshirje e studentëve të Masterit dhe Doktoratës në FGJM në studime, botime dhe projekt konkrete.	Studentë të programeve të studimit në FGJM kanë marrë pjesë në publikime, seminare dhe workshope të ndryshme.	2024-2025	

Tabela 2.3.3: FIE – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1. Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor; 2. Integrimit të kërkimit shkencor me mësimdhënien nëpërmjet angazhimit të studentëve të nivelit Master dhe Doktoratë në projekte studimore e kërkimore;	1. Zhvillimin e qëndrueshëm i Studimeve të Doktoratës në FIE; 2. Organizimin e leksioneve të hapura; 3. Nxitjen e mobilitetit të studentëve pranë universiteteve Evropiane;	1. Mbështetje nga buxheti i fakultetit për studimet në doktoraturë;	2019 -2024	Kontributi shkencor është një prioritet i përvitshëm i FIE

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

3. Sigurimi dhe promovimi i lidhjeve të vazhdueshme me institucionet dhe universitetet homologe Evropiane.	4. Angazhimin e studentëve pranë ndërmarrjeve prodhuese; 5. Mbështetja e tyre financiare, me infrastrukturë për ecurinë akademike.	2. Pjesëmarrje e studentëve pranë universiteteve Evropiane; 3. Zhvillimi i praktikave mësimore pranë ndërmarrjeve prodhuese.		

Tabela 2.3.4: FIM – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Rritja e interesit dhe tërheqja e studentëve të nivelit bachelor në FIM dhe programe të tjera studimi në UPT e më gjerë për të aplikuar dhe ndjekur programet e studimit master që mbulojnë Departamentet e FIM, nëpërmjet njohjes së tyre me aktivitetin kërkimor-shkencor që zhvillohet nga stafi akademik i FIM. Vazhdimi me sukses i zhvillimit të KFV, nga DPM, "Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve" dhe nga DE, "Auditim energjie" në dy drejtime: 1) në Ndërtesa dhe 2) në Procese, hapur në FIM që në vitin 2013. Hapja e një programit të ri, po nga DE, e një kursi të ri të KFV, "Siguria dhe shëndeti në punë". Fillimi i shkollës së doktoratës në FIM dhe realizimi viti të parë akademik të saj.	Njohja dhe përfshirja e studentëve në aktivitetet e ndryshme kërkimore shkencore që zhvillojnë departamentet e FIM; Prezantimi dhe njohja e studentëve të nivelit bachelor në FIM dhe më gjerë, edhe nëpërmjet rrjeteve të ndryshme sociale, me aktivitetin kërkimor-shkencor që zhvillojnë pedagoget e FIM si dhe me programet e studmit që mbulon fakulteti; Realizimi i një projekt diplomë master në bashkëpunim me Universitetin e Siegenit, Gjermani dhe e zhvillimi i një programi studimi master të tipit diplomë e dyfishtë në bashkëpunim me UNITUS, Itali; Prezantimi dhe njohja e studentëve në FIM, edhe nëpërmjet web-it të FIM dhe rrjeteve të ndryshme sociale, me aktivitetin	Rritja e numrit të studentëve që kanë aplikuar për të ndjekur programet e studimit master që mbulon FIM; Një numer i konsiderueshëm pjesëmarrësish që u regjishtruan dhe ndoqën KFV "Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve", "Auditm Energjie" dhe "Siguria dhe shëndeti në punë".	2024-2025	

	kërkimor-shkencor që zhvillojnë pedagogët e FIM; Hapja e shkollës së doktoratës dhe fillimi i 6 doktoratave në FIM; Kontakti me subjekte të ndryshme për të promovuar punën kërkimore – shkencore që zhvillohet në departamentet e FIM dhe për të promovuar edhe programet e ndryshme të studimit që janë aktivë apo synohen të hapen.			

Tabela 2.3.5: FIMIF – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Pjesëmarrje aktive në projektet e financuara nga AKKSHI; Pjesëmarrje aktive në projektet e financuara nga READ-AADF; Krijimi i të ardhurave nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga shërbimet, nga pjesëmarrja në ekspertiza e konsulencë; Integrimi i rezultateve kërkimore në programet mësimore; Përfshirja e studentëve të doktoratës në projekte kërkimore-shkencore konkrete; Mbështetja e projekteve për integrimin e AI në programet STEM.	1. Zhvillimi i 5 projekteve kërkimore në kuadër të Shkollës së Doktoratës në DIM: "Studim krahasimor i metodave interpoluese hapësinore për modelimin hidrologjik (Pellgu ujëmbledhës i Prespës)"; "Ndërtimi i modelit matematik për vlerësimin e përputhshmërisë në tekstet shqip"; "Metoda të avancuara numerike për simulimin e materialeve sintetike". 2. Zhvillimi i 2 projekteve kërkimore në DIF: "Përdorimi i imazheve HD të PET/CT në radioterapi dhe korrelimi me MRI dhe CT"; "Energjia diellore prej sistemeve fotovoltaike në shkallë të lartë në Shqipëri	1. Shkolla e Doktoratës funksionon me sukses dhe studentët janë të angazhuar në projekte konkrete kërkimore. 2. Projekti i integrimit të AI në STEM është fitues në AKKSHI dhe do të modernizojë kurrikulat dhe metodat e mësimdhënies. 3. Rezultatet kërkimore po integrohen gradualisht në kurrikulat e programeve të studimit.	Viti akademik 2024-2025 dhe në vazhdim	Projekti i AI në STEM do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së ofertës akademike në të gjitha nivelet e studimit. Projektet e doktoratës adresojnë problematika të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

	me metoda të optimizimit të energjisë diellore me anë të inteligjencës artificiale". 3. Realizimi i prezantimeve nga 9 studentë të vitit të parë të doktoratës. 4. Realizimi i prezantimeve nga 10 studentë të vitit të dytë në DIF. 5. Ekzekutimi i projektit fitues "Integrimi i aplikimeve të AI në programet universitare të studimit STEM".	4. Studentët e doktoratës kanë raportuar për aktivitetin e tyre shkencor në prezantimet në departamente. 5. Bashkëpunim i ngushtë midis doktorantëve dhe udhëheqësve shkencorë për botime dhe pjesëmarrje në konferenca.		

Tabela 2.3.6: FIN – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Është parashikuar që të kemi një rritje të cilësisë akademike për të tre ciklet e studimit që ofrohen nga departamentet e FIN.	Gjatë kësaj periudhe kohore është bërë e mundur rritja e kontributit të kërkimit shkencor, kjo e evidentuar kryesisht tek programet e ciklit të tretë Doktoratë.	Gjatë kësaj periudhe janë aktive dy shkolla doktorate: 1. Inxhinieri Ndërtimi, nënfusha Inxhinieri Mjedisi 2. Shkolla e doktoraturës Gjeodezi Gjatë kësaj periudhe janë rregjistruar 4 kandidatë në Inxhinieri Mjedisi dhe 3 kandidatë në Gjeodezi.	Tetor 2024 – Shtator 2025	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 2.3.7: FTI – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Thellimin e integrimit të kërkimit shkencor me mësimdhënien nëpërmjet angazhimit të studentëve në projekte studimore e kërkimore me qëllim kultivimin tek këta të fundit të shprehive të kërkuesit e studiuesit të integruar në grup si dhe të ofrimit të kapaciteteve cilësore laboratorike dhe të vëzhgimit e eksperimentimit në terren. Sigurimin dhe promovimin e lidhjeve të vazhdueshme me institucionet dhe universitetet homologe Evropiane dhe më gjerë përmes bashkëpunimit dhe projekteve të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët në shërbim të kualifikimit shkencor dhe shkëmbimi i eksperiencave në këto fusha. Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, për të kontribuar në formimin e tyre profesional, rritjen e shkallës së përvetësimit të programeve mësimore, orientimin e tyre në tregun e punës, inicimin e tyre si kërkues të ardhshëm si dhe për të realizuar objektivat e kërkimit.	Përmirësimin e elementeve zbatues në kurikulat e lëndëve të të tre cikleve të studimit. Përdorimin e rezultateve laboratorike si shembuj praktikë në këto cikle studimi. Përfshirja e studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë në veprimtaritë shkencore të FTI-së.	Përfshirja e studentëve të Shkollës së Doktoratës dhe dy cikleve të tjera të studimeve, Bachelor dhe Master në projektet kërkimore-shkencore. Zhvillimi i temave të diplomave në fushën kërkimore në të cilën janë të përfshirë udhëheqësit e tyre. Përmirësimi i kurrikulës të lëndëve. Monitorimi i vazhdueshëm dhe plotësimi i raporteve.	Vjetor	

Tabela 2.3.8: IGJEO – Kontribut i kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
-Organizimi i trajnimeve ndërkombëtare dhe pjesëmarrja në workshop-e ndërkombëtare,	-Dërgimi i stafit akademik në institutet lider ndërkombëtare për trajnime në	-Përputhje me planin strategjik dhe objektivat e	Viti akademik	-Rezultatet e trajnimeve kontribuan në avancimin

-Rishikimi i kurrikulave mësimore për t'i përshtatur me kërkimet e fundit.	sizmologji dhe gjeodinamikë, hidrologji, meteorologji dhe gjeologji, - Pjesëmarrja në konferenca dhe simpoziume ndërkombëtare për të shkëmbyer njohuri dhe teknologji, -Integrimi i rezultateve të kërkimit në programet e studimit.	IGJEO për përmirësimin e kapaciteteve kërkimore, -Integrimi i kërkimit shkencor në mësimdhënie.	2024-2025 dhe në vijim.	e fushave prioritare të kërkimit, -Përshtatja e kurrikulave me kërkimin shkencor është e rëndësishme për modernizimin e ofertës akademike.

2.2.4.4 Forcimi i rolit të IGJEO si njësi kryesore kërkimore e ekselencës në fushat përkatëse të ekspertizës

Tabela 2.4.1: FGJM – Forcimi i rolit të IGJEO si njësi kryesore kërkimore e ekselencës.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
		Është hartuar Plani i Aktiviteteve. Janë përfshirë 4 studentë të Masterit.	2024-2025	

Tabela 2.4.2: FIMIF – Forcimi i rolit të IGJEO si njësi kryesore kërkimore e ekselencës.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1. Projekte ndërdisiplinore: Ekspertiza e IGJEO, përfshirë hulumtime në fushat e gjeoshkencës, energjisë dhe mjedisit krijon një ambient të përshtatshëm për të ndërmarrë projekte që ndërlidhin fizikën me modele matematikore dhe fizike. Projektet bashkojnë inxhinierët matematikë dhe	1. Përmirësimi i politikave të praktikave për studentët e Masterit Shkencor. 2. Krijimi i një mjedisi tërheqës dhe krijues për Doktorantët. 3. Rritja e të ardhurave nga ekspertiza.	Mbështetja dhe kualifikimi i stafit akademik. Bashkëpunimi ekziston dhe vazhdon të zhvillohet, veçanërisht në projekte mjedisore të DIK (ndotja e ajrit, eutrofikimi) dhe projekte të energjisë diellore	Çdo vit akademik.	FIMIF mbështet IGJEO përmes ekspertizës në modelim matematik, simulime numerike dhe teknologji kimike. Bashkëpunimi strategjik është i inkurajuar në politikat e fakultetit dhe

fizikë me gjeologët dhe specialistët e IGJEO për të krijuar zgjidhje të reja dhe inovative. 2. Programet e bashkëpunimit me studentët dhe doktorantët: Krijimi i mundësive për studentët dhe doktorantët për të punuar në projekte kërkimore të përbashkëta, të cilat përfshijnë përdorimin e teorive dhe aplikimeve matematike dhe fizike për të studiuar procese gjeoshkencore dhe mjedisore. 3. Pajisje dhe teknologji për kërkime të avancuara: Modernizimi i pajisjeve për matjen dhe analizën e të dhënave gjeoshkencore, duke përdorur teknologji si GIS, simulime numerike dhe modelim matematikor. 4. Software dhe platforma të avancuara: Zhvillimi dhe përdorimi i algoritmeve të sofistikuara për analizën e të dhënave dhe për prognozimin e ngjarjeve gjeologjike dhe mjedisore.	4. Bashkëpunim në projekte të ardhshme. 5. Zhvillimi i projekteve interdisiplinore në fushën e modelimit hidrologjik, mjedisit dhe energjisë së rinovueshme.	të DIF. Projekti kërkimor "Studim krahasimor i metodave të ndryshme interpoluese hapësinore të të dhënave të rreshjeve për modelimin hidrologjik në shkallë pellgu ujëmbledhës" (Pellgu Ujëmbledhës i Prespës) përfaqëson bashkëpunim konkret midis DIM dhe IGJEO.		materializohet në projekte konkrete kërkimore.

Tabela 2.4.3: IGJEO – Forcimi i rolit të IGJEO si njësi kryesore kërkimore e ekselencës.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Krijimi i një qendre të ekselencës kërkimore në IGJEO.	Formimi i ekipeve kërkimore multidisiplinare.	Përdorimi i platformave ndërkombëtare për shpërndarjen e kërkimeve.	Viti akademik 2024-2025 dhe në vijim.	Publikimi i kërkimeve në revista të nivelit të lartë është një aspekt i rëndësishëm i përhapjes së rezultateve.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

2.2.4.5 Evidentimi dhe përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar që zhvillohet në UPT

Tabela 2.5.1: FAU – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
-Publikimi i rezultateve të kërkimit shkencor në revista të njohura si brenda ashtu edhe jashtë vendit; -Pjesëmarrjen në kongrese e konferenca të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare me punime cilësore; -Organizimi i konferencave shkencore nga departamente dhe njësia bazë, apo edhe në partneritet me IAL të tjera. -Organizimi konkurseve, ekspozitave, Workshopeve.	-Botime në revista shkencore ndërkombëtare dhe me faktor impakti sa më të lartë. -Pjesëmarrja në konferenca shkencore e stafit me rezultate të fushave të tyre të kërkimit. -Organizimi i konferencave ndërkombëtare në partneritet më universitete të huaja.	-Botime në resvista shkencore i artikujve të shkruar nga anëtarë të stafit akademik FAU; -Organizimi i Konferencës së Fakultetit -IFAU2025; -Konkurs: Riciklo Creativ, për studentët e FAU dhe fakulteteve të arkitekturës në Kosovë e Maqedoninë e Veriut; -Workshop internacional WAVE2025, në IUAV, Venezia Itali; -Workshop nderkombëtar: Monumental Architecture; -Seminar ndërkombëtar: "Architettura di Terra in Albania", Sardegna, Itali; -Organizimi i Konferencës: Monumental Architecture	Qershor Nëntor 2025 Qershor-Tetor 2025. 23 Qershor - 5 korrik 2025. 28 shkurt - 4 mars 2025. 14 Maj 2025 Mars 2025.	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 2.5.2: FGJM – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Publikime, workshope dhe seminare në lidhje me rezultatet e kërkimit shkencor në FGJM.	Janë publikuar rezultate të kërkimit shkencor dhe projekteve në formë artikujsh, posterash apo workoshope.	Është realizuar në përputhje me planin strategjik evidentimi dhe përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor në FGJM.	2024-2025	

Tabela 2.5.3: FIE – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1. Përmirësimin e cilësisë së publikimeve; 2. Pjesëmarrjen në kongrese e konferenca të njohura kombëtare dhe ndërkombëtare me punime cilësore; 3. Rezultatet e kërkimit shkencor janë publike dhe të aksesueshme, pjesa e pa aksesueshme arkivohet në bibliotekën e FIE.	1. Botime në revista shkencore me faktor impakti; 2. Pjesëmarrës në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare; 3. Publikimet në akses të hapur si dhe arkivohen në bibliotekë.	Buxhet për pjesëmarrje në konferenca dhe botime në revista të njohura të stafit akademik.	2019 -2024	Kontributi shkencor është një prioritet i përvitshëm i FIE.

Tabela 2.5.4: FIM – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Profilizimi në web-in e FIM, në aktivitete të ndryshme (konferenca, revista shkencore,	Angazhimi i stafit akademik të FIM për të prezantuar, promovuar dhe përhapur	Organizimi me sukses i shumë seminareve,	2024-2025	

pjesëmarrje në grupe ndër-institucionale), rrjetet sociale të FIM (FB, LinkedIn, etj). Organizimi i seminareve, workshopeve dhe forumeve shkencore, në kuadër të projekteve kombëtare dhe EU-s.	përvojën dhe rezultatet e kërkimit shkencor bazë dhe të aplikuar në aktivitete të ndryshme: revista, konferenca shkencore, seminare, workshope, etj.	workshopeve dhe forumit shkencor që u zhvilluan në kuadrin e projekteve kombëtare dhe EU; Interesi në rritje i treguar nga studentët për të ndjekur programet e studimit master që mbulon FIM-ja.; Vazhdimi me sukses i realizimit të programeve të KFV që ofron FIM.; Rritje e numrit të ndjekësve në rrjetet sociale ku promovohet veprimtaria kërkimore-shkencore e FIM-s; Rritja e kontaktit me universitete të huaja për bashkepunime, sidomos nëpërmjet Projekteve Erasmus+ për shkëmbim stafi.		

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 2.5.5: FIMIF – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1. Zhvillimi i kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar në fushat që fakulteti mbulon; 2. Orientimi i kërkimit të mirëfilltë dhe të avancuar shkencor në fushat kërkimore shkencore prioritare të përcaktuara në departamentet përkatëse të FIMIF: DIM, DIF, DIK, QGJH; 3. Inkurajimi dhe nxitja e stafit akademik për studime të zbatuara dhe projekte bashkëpunimi me fakultetet e tjera të UPT, dhe në veçanti me Institutin e Gjeoshkencave. 4. Bashkëpunimi me institucione të tjera publike dhe private brenda dhe jashtë vendit për probleme inxhinierike dhe ekonomike, duke përdorur teknikat matematike, metodave fizike dhe teknologjive kimike; 5. Publikimi sistematik i rezultateve në revista ndërkombëtare dhe prezantimi në konferenca shkencore.	1. Marrja pjesë në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. 2. Përmirësimi i laboratorëve ekzistues. 3. Bashkëpunime me departamente të tjera në FIMIF, dhe me fakultete të tjera në UPT. 4. Publikimi i 98 artikujve në revista ndërkombëtare me impact factor. 5. Prezantimi i rezultateve në 84 konferenca shkencore. 6. Mbrojtja e 2 disertacioneve doktorate në DIF. 7. Organizimi i prezantimeve të studentëve të doktoratës në departamente. 8. Arkivimi i publikimeve në bibliotekën e FIMIF dhe sigurimi i aksesit të hapur.	Konceptimi dhe realizimi i projekteve të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në ndihmë të rritjes së veprimtarisë kërkimore shkencore. FIMIF ka realizuar 95 artikuj ndërkombëtarë dhe 84 referime në konferenca. DIM ka realizuar 64 botime dhe 39 pjesëmarrje. DIF ka realizuar 19 botime dhe 37 pjesëmarrje, duke përfshirë mbrojtjen e 2 disertacioneve doktorate. DIK ka kontribuar me 3 botime dhe 13 pjesëmarrje. QGJH ka realizuar 9 botime dhe 25 pjesëmarrje. Aksesi në databazat ndërkombëtare përmes bibliotekës ka lehtësuar përhapjen e rezultateve.	Viti akademik 2024-2025.	Rezultatet e kërkimit janë të dukshme dhe të njohura në nivel ndërkombëtar. Revista me impact factor të lartë dhe konferenca prestigjioze dëshmojnë cilësinë e punës kërkimore të FIMIF.

Tabela 2.5.6: FTI – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Një administrim më i mirë i kërkimit shkencor nëpërmjet krijimit të bazave të të dhënave digjitale, lehtësisht të përdorshme dhe inventarizim më të mirë të pasurive shkencore të FTI-së; Bërja publike të të gjithë projekteve të financuara, në kuadrin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim zhvillimit për një shfrytëzim sa më të gjerë të informacionit shkencor. Publikimi i rezultateve të kërkimit shkencor në revista të njohura si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Organizimi i konferencave ndërkombëtare.	Nxitja dhe financimi i publikimeve në revista, buletine shkencore si dhe pjesëmarrja në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Pjesëmarrja në mobilitete për mësimdhënie dhe për studime. Organizimi i një konference ndërkombëtare nga fakulteti në bashkëpunim me partnerë të huaj.	Pjesëmarrja me punime shkencore në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Publikimi i artikujve shkencorë në revista kombëtare dhe ndërkombëtare me faktor impakti. Pjesëmarrja e stafit akademik në mobilitete për mësimdhënie dhe studime. Monitorimi i vazhdueshëm dhe plotësimi i raporteve.	Vjetor.	

Tabela 2.5.7: IGJEO – Përhapja e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Transferim njohurish dhe teknologjie.	Organizim konferencash/workshopesh, publikime dhe mësimdhënie.	Janë zhvilluar dy konferenca nga Departamenti i Meteorologjisë, në Mars dhe Shtator 2024 dhe një simpozium shkencor në Korrik 2024.	Viti akademik 2024-2025 dhe në vijim.	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

2.2.4.6 Zhvillimi i burimeve njerëzore, i kapaciteteve infrastrukturore dhe financiare në shërbim të kërkimit shkencor dhe shërbimeve në UPT

Tabela 2.6.1: FAU – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Zgjerimi i bashkëpunimit me institucionet homologe në sektorin shtetëror dhe në sektorin privat, duke u konkretizuar në projekte e studime të përbashkëta.	Pjesëmarrje në projekte dhe ekspertiza të specializuara në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës.	Anëtarët e stafit FAU kanë marrë pjesë në grupe pune për përgatitje projektesh dhe ekspertiza të specializuara në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës.	2024-2025	

Tabela 2.6.2: FGJM – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Kryerja e ekspertizave të ndryshme në fushat e gjeologjisë dhe minierave.	Janë kryer një numër i konsiderueshëm i ekspertizave në fushat e gjeologjisë dhe minierave nga stafi i FGJM.	Objektivi është realizuar sipas parashikimit në Planin Strategjik të UPT-së. Janë realizuar të gjitha ekspertizat e kërkuara nga UPT.	2025-2026	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 2.6.3: FIE – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1. Zgjerimi i bashkëpunimit me institucionet homologe dhe me sektorin privat në trojet shqipfolëse; 2. Kualifikime shkencore dhe shkëmbime të eksperiencave të stafit akademik dhe kërkimor shkencor në institucionet dhe universitetet partnere.	1. Përpjekje e vazhdueshme për bashkëpunim me sektorin privat; 2. Ofrimi i ekspertizës nga anëtarët e departamentit.	Bashkëpunime të financuara nga biznesi.	2019 -2024	Kontributi shkencor është një prioritet i përvitshëm i FIE.

Tabela 2.6.4: FIM – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Realizimi me sukses i projekteve PKKZH PIKSH, dhe EU si dhe i projekteve në vazhdim kombëtare dhe EU-s. Aplikimi i projekteve të reja PKKZH, PIKSH dhe AADF. Pjesëmarrja e pedagogëve të FIM në oponencat për projekte të ndryshme si për të tretë, ofruar nga UPT. Realizimi i programeve të studimit të KFV, që ofron FIM, si kurse me vetëfinancim dhe me të ardhura suplementare për UPT.	Përgatitja dhe dorëzimi i raporteve për realizimin e objektiva të këtyre projekteve; Përgatitja dhe aplikimi për projektet e reja.	Paraqitja e raporteve nga anëtarët e grupit të punës për projektet kombëtare dhe të EU-s; Ndjekja në vazhdimësi e realizimit të projekteve të fituara nga AKKSH-i dhe EU; Një aplikim në thirrjet Interreg Ipa II dhe 6 aplikime në thirrjet e programeve të EU dhe 7 aplikime në thirrjet kombëtare.	2024-2025	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 2.6.5: FIMIF – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1. Harmonizimi dhe integrimi më i mirë i shkencave bazë të edukimit në FIMIF me pjesën tjetër të edukimit inxhinierik. Rritja e peshës së kurseve interdisiplinore në raport me kurset klasike teorike dhe autonome të shkencave bazë; 2. Përfshirja në programet mësimore të metodave të orientuara drejt kompjuterit dhe e softeve të rëndësishme për këtë qëllim; 3. Thellimi i integrimit të kërkimit shkencor me mësimdhënien dhe rritja e përgjegjshmërisë së studentit; 4. Angazhimi i studentëve të nivelit Master dhe Doktoratë në projekte studimore e kërkimore; 5. Aplikimi sistematik në konkurse për projekte me financim kombëtar dhe ndërkombëtar; 6. Zhvillimi i ekspertizës dhe konsulencës për sektorin publik dhe privat.	1. Zhvillimi i qëndrueshëm i Studimeve të Doktoratës në FIMIF, në DIF dhe DIM. 2. Organizimi i leksioneve të hapura. 3. Nxitja e mobilitetit të studentëve pranë universiteteve Evropiane. 4. Angazhimi i studentëve pranë ndërmarrjeve prodhuese. 5. Mbështetja e studentëve me financim dhe me infrastrukturë për ecurinë akademike. 6. Aplikimi dhe fitimi i projekteve konkurruese AKKSHI. 7. Ekzekutimi i projekteve të financuara nga READ Programme dhe Akademia e Shkencave. 8. Kërkimi aktiv i financimeve nga organizata të tjera ndërkombëtare dhe kombëtare.	1. Mbështetje financiare e studentëve të FIMIF në të tre ciklet e studimit, në pjesëmarrjet e tyre në veprimtari shkencore të ndryshme. 2. Realizimi i praktikave të studentëve të nivelit Master pranë kompanive private apo shtetërore me të cilat UPT ka marrëveshje. 3. Fituar 3 projekte AKKSHI me financim të konsiderueshëm: "Ngritja e një laboratori kombëtar CMS RPC ALBANIA LAB për detektor me gaz" (Dr. Enkelejd Çaça), "Energjia Diellore prej sistemeve fotovoltaike në shkallë të lartë në Shqipëri me optimizim AI" (Prof. Asoc. Driada Mitrushi), "Integrimi i aplikimeve të AI në programet universitare të studimit STEM" (Prof. Asoc. Dafina Xhako).	Viti akademik 2024-2025 dhe në vazhdim për ekzekutimin e projekteve.	Kapaciteti për të tërhequr fonde konkurruese është rritur ndjeshëm. Projektet e fituara jo vetëm sigurojnë të ardhura suplementare por edhe modernizojnë infrastrukturën dhe forcojnë kapacitetet kërkimore të fakultetit.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

		4. DIK ka siguruar 2,143,000 lekë financim për dy projekte kërkimore mjedisore. 5. Norma 50% e suksesit në AKKSHI dëshmon cilësinë e lartë të propozimeve. 6. Totali i financimeve të reja konkurruese tejkalon ndjeshëm objektivat.		

Tabela 2.6.6: FTI – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Pjesëmarrje aktive në projektet e financuara nga AKKSHI. Krijimi i të ardhurave nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Një pjesëmarrje më e gjerë në ekspertiza e konsulencë, duke i konsideruar si elementë jo vetëm të afirmimit profesional e shkencor. Pjësëmarrja në projekte ndërkombëtare të financuara nga Bashkimi Evropian apo institucione të tjera.	Aplikime me projekte në thirrje për projekt-propozime të institucioneve ndërkombëtare dhe kombëtare. Pjesëmarrje si ekspertë në projektet e UPT-se ndaj palëve të treta.	Aplikimi me projekt-propozime në thirrje e hapura nga AKKSHI në kuadër të Programeve Kombëtare për Kërkim dhe Zhvillim, dhe Programit të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor. Aplikimi me projekt-propozime në thirrjet në kuadër të Horizon Europe. Pjesëmarrje në Aksione COST. Monitorimi i vazhdueshëm dhe plotësimi i raporteve.	Vjetor	

Tabela 2.6.7: IGJEO – Rritja e kontributit në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT.

Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
Zhvillimi i partneriteteve me industrinë për aplikimin e kërkimeve shkencore.	Krijimi i mundësive për shpërndarje licencash dhe teknologjish.	Krijimi i mundësive për shpërndarje licencash dhe teknologjish.	Viti akademik 2024-2025 dhe në vijim.	Ky objektiv kërkon një qasje të fortë për të lidhur kërkimin shkencor me sektorin e industrisë.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

3 BASHKËPUNIME NDËRINSTITUCIONALE DHE PROJEKTE

Bashkëpuinimi ndërinstitucional është një pikë e fortë e Universitetit Politeknik të Tiranës.

UPT ka bashkëpunim të ngushtë me institucione brenda dhe jashtë vendit, me universitete brenda vendit, me kompani dhe biznese brenda dhe jashtë vendit, me universitetete dhe institucione jashtë vendit, si dhe me universitete të huaja në kuadër të projekteve të ndryshme bashkëpuniumi të financuara nga Bashkimi Euroipan.

3.1 BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT), në kuadër të Planit të tij Strategjik, ka përcaktuar një sërë objektivash që synojnë forcimin e procesit të ndërkombëtarizimit të institucionit. Këto objektiva përfshijnë:

1. Rritjen e njohjes ndërkombëtare të titujve universitarë të lëshuar nga UPT në të gjitha ciklet e studimit.
2. Rritjen e aktivitetit ndërkombëtar në fushën e kërkimit shkencor, përmes pjesëmarrjes në programe dhe projekte kërkimore kombëtare, evropiane, rajonale dhe ndërkombëtare.
3. Zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkëmbimit të stafit akademik në të gjitha ciklet e studimit.
4. Intensifikimin e shkëmbimeve ndërkombëtare të studentëve në kuadër të programeve ndërkombëtare dhe marrëveshjeve dypalëshe.
5. Promovimin e programeve të përbashkëta të studimit dhe diplomave të përbashkëta me institucione partnere ndërkombëtare, kryesisht në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, duke i dhënë kështu vlerë të shtuar formimit akademik dhe titujve universitarë të ciklit të parë të lëshuar nga UPT.

Në funksion të realizimit të këtyre objektivave, gjatë viteve akademike 2024–2025, Universiteti Politeknik i Tiranës ka ndërmarrë një sërë iniciativash konkrete, ndër të cilat.

1. Nënshkrimi i marrëveshjeve të përgjithshme (MoU) me universitete të huaja, me qëllim zhvillimin e bashkëpunimit në fusha të përbashkëta të studimit dhe kërkimit shkencor. **(Gjithsej 14 Memorandum of Understanding)**.
2. Nënshkrimi i marrëveshjeve institucionale në kuadër të programit Erasmus+ (IIA), me synimin e shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve. **(Gjithsej 22 Inter Institutional Agreements)**.
3. Nënshkrimi i marrëveshjeve për diploma të dyfishta në cikle të ndryshme të studimit.
4. Anëtarësim në rrjete universitare.

Bashkëpunimi me universitete të huaja ka pasur një ndikim pozitiv të ndjeshëm për UPT-në, duke

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

kontribuar në rritjen e vizibilitetit të tij në arenën evropiane dhe ndërkombëtare. Për komunitetin akademik, ky bashkëpunim reflektohet në ekspozimin ndaj praktikave bashkëkohore të mësimdhënies, aksesin në laboratorë modernë për kërkimin shkencor, si dhe në krijimin e rrjeteve profesionale për zhvillimin e iniciativave dhe projekteve të përbashkëta kërkimore.

Stafi administrativ përfiton nga mundësitë për ndjekjen e trajnimeve në universitete homologe jashtë vendit, me qëllim përmirësimin e praktikave të punës dhe rritjen e efikasitetit institucional. Ndërkohë, studentëve u ofrohet mundësia të përfitojnë nga metodologji të reja mësimdhënieje dhe të angazhohen në projekte praktike në laboratorë plotësisht të pajisur.

Në një perspektivë më të gjerë, bashkëpunimi ndërkombëtar u mundëson stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve të ndihen pjesë e komunitetit evropian të arsimit të lartë, të përvetësojnë një kulturë pranimi dhe përfshirjeje, të zhvillojnë aftësi digjitale dhe të përmirësojnë kompetencat gjuhësore.

Në kuadër të programeve të **dyfishta të studimit**, është nënshkruar gjithashtu një marrëveshje për hapjen e **International Campus UTC–UPT** në fushat e Inxhinierisë Informatike dhe Inxhinierisë Elektronike, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të mëtejshëm të ndërkombëtarizimit të UPT-së.

Punësimi i studentëve përbën një nga çështjet prioritare të Planit Strategjik të Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT). Në këtë kuadër, universiteti synon të krijojë dhe forcojë ura të qëndrueshme bashkëpunimi me aktorë të rëndësishëm të tregut të punës, me qëllim ofrimin e mundësive konkrete për praktika profesionale, internship-e dhe punësim për studentët e tij.

Përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione brenda vendit, UPT synon shkëmbimin e ekspertizës, krijimin e mundësive për kryerjen e praktikave të punës dhe përfshirjen e studentëve në programe të strukturuara internship-i. Paralelisht, bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë (IAL) në vend ka për objektiv shkëmbimin e stafit akademik, ndarjen e përvojave më të mira, realizimin e punimeve të përbashkëta kërkimore-shkencore si dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta.

Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe bashkëpunimi me kompanitë private që operojnë në tregun vendas, me fokus krijimin e mundësive për praktika profesionale, internship-e dhe punësim të drejtpërdrejtë të studentëve dhe të diplomuarve. Aktualisht, Universiteti Politeknik i Tiranës ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me mbi **130 kompani,** ndër të cilat **18 janë** nënshkruar për vitin akademik **2024–2025.**

Sipas fushave të studimit, njësitë kryesore akademike monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme tregun e punës, me synim evidentimin e nevojave aktuale dhe perspektive të tij. Kompanitë që operojnë në fushat përkatëse përfshihen në aktivitete të përbashkëta, duke kontribuar në lehtësimin e procesit të punësimit të studentëve, si dhe në përmirësimin dhe përshtatjen e kurrikulave mësimore për formimin e individëve të aftë për t'u përthithur nga tregu i punës.

Partnerët e universitetit, si nga institucionet publike ashtu edhe nga sektori i biznesit, janë të pranishëm në prezantime, panele diskutimi, leksione të hapura dhe panaire punësimi, ku prezantojnë ofertat e tyre dhe krijojnë mundësi të drejtpërdrejta komunikimi me studentët e UPT-së.

E përmbledhur, marrëveshjet e reja të bashkëpunimit, të hartuara dhe nënshkruara gjatë vitit akademik

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

2024-2025 paraqiten në tabelën në vijim. Të detajuara paraqiten në shtojcën e tabelës 3 në fund të këtij materiali, faqen Sh. Tab. 3. 1.

Tabela 3: Marrëveshje ndërinstitucionale të reja, viti akademik 2024-2025[1].

Bashkëpunime me:	Marrëveshje të reja 2024-2025
IAL vendase	6
IAL të huaja	22
MoU me IAL të huaja	14
Biznese	18
Institucione shtetërore	9




Figura 9: Marrëveshje bashkëpunimi të reja të nënshkruara gjatë vitit 2024-2025.

3.2 KËRKIM SHKENCOR DHE PROJEKTE PËR NJËSITË KRYESORE

3.2.1 Politikat e kërkimit shkencor

a) Prioritetet në lidhje me kërkimin shkencor.

b) Objektivat dhe synimet bazuar në strategjinë kombëtare dhe ndërkombëtare për kërkimin shkencor.

Kërkimi shkencor në UPT mbështetet në prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit, në

[1] Të detajuara paraqiten në Shtojcën e tabelës 3, faqe Sh. Tab. 3. 1.

përputhje me "Strategjinë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj", të miratuar me VKM Nr. 542, datë 20.9.2023. Prioritetet në lidhje me kërkimin shkencor si dhe objektivat dhe synimet bazuar në Strategjinë Kombëtare dhe Ndërkombëtare për Kërkimin Shkencor, për çdo njësi kryesore të UPT-së, jepen në mënyrë të përmbledhur më poshtë:

3.2.2 Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

FAU dhe njësitë bazë të tij kanë objektiva të qartë të lidhura me kërkimin shkencor, duke synuar që t'i aplikojnë ato në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për kërkimin shkencor.

Në këtë kuadër edhe në vitin akademik 2024-2025, u punua fort për të përmbushur qëllime të lidhura me:

- ✓ Ndërkombëtarizimin e Fakultetit duke synuar zgjerimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetet me të cilat ka marrëveshje, por edhe bisedime për vendosje bashkëpunimi me universitete të tjera të ngjashme. Në këtë kuadër, janë vendosur ura bashkëpunimi apo janë nënshkruar marrëveshje me universitete të ngjashme.
- ✓ Hartimin dhe pjesëmarrjen në projekte dhe studime të përbashkëta me institucione partnere në shkallë vendi, rajoni dhe me gjerë si në fushen e kërkimit shkencor, të edukimit ashtu edhe në hartimin e studimeve apo dhënien e asistencës teknike për implementimin e projekteve me rëndësi prioritare në projektimin arkitektonik dhe urban. Në këtë kuadër edhe në 2024-2025 vazhdoi puna për projektin e përbashkët kërkimor dy vjeçar, me CNR Firenze, mbi ndërtimet prej çerpiçi në Shqipëri. (Në këtë projekt bëjnë pjesë 4 Profesorë nga Stafi FAU). Njëkohësisht vazhdoi implementimi i projektit infrastrukturor mbi ngritjen e Laboratorit AI, virtual Reality, si një financim i AKKSHI-t. (Në këtë projekt bëjnë pjesë 2 Profesorë nga Stafi FAU).
- ✓ Pjesëmarrja në workshope të përbashkët me universitetet me të cilat FAU ka marrëveshje bashkëpunimi. Në këtë kuadër gjatë vitit 2024-2025:
  - ❖ U organizua workshop me Universitetin Saxon (Hollandë). Studentët punuan në grupe të përbashkët për një temë studimore të përbashkët, duke komunikuar online por edhe duke udhëtuar në vendet respektive në sajë të bursave Erasmus Blended Mobility (8 studentë dhe 2 staf akademik).
  - ❖ Pjesëmarrje në Workshopin "WAVE2025" të organizuar nga Universiteti IUAV Venezia, Itali (10 studentë dhe staf akademik), me financim të Erasmus por edhe të buxhetit FAU.
- ✓ Zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkëmbimit të personelit akademik në të gjitha ciklet e formimit, si dhe shkëmbimeve ndërkombëtare të studentëve në kuadrin e programeve ndërkombëtare dhe marrëveshjeve dypalëshe.
  - ❖ Në këtë kuadër u fitua një projekt Erasmus me IUAV Venezia, sipas së cilit do të punohet në fusha të përbashkëta të kërkimit shkencor por edhe do të ketë shkëmbim studentësh nga të dy fakultetet. Studentët, duke ndjekur studimet e vitit të fundit, do të fitojnë diplomë të dyfishtë.
  - ❖ Njëkohësisht marrëveshjet Erasmus+ mundësuan shkëmbimin e stafit me universitetet e Bari, Torino, Venezia, Pescara (Itali), Nysa (Poloni), Saxon (Hollandë).

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ✓ Fuqizimin e infrastrukturës laboratorike në shërbim të Kërkimit Shkencor dhe Didaktikës. Kërkimet mbi metodat e avancuara të digjitalizimit dhe të paraqitjes në mjedisin e ndërtuar, si fushë kërkimore e Departamentit të Arkitekturës, kërkojnë ngritjen e laboratorëve bashkëkohore lidhur me këto tema, duke shtyrë stafin akademik të aplikojë në thirrje të ndryshme lidhur me projektet infrastrukturore. Projekti i fundit që vazhdoi për 2 vjet 2023-2025, i aplikuar dhe fituar nga stafi akademik i Departamentit të Arkitekturës dhe grupi kërkimor i grafikës kompiuterike, lidhet me simulimet virtuale dhe AI.

3.2.3 Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave

Politikat e kërkimit shkencor në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave gjatë vitit akademik 2024–2025, janë orientuar drejt forcimit të rolit të fakultetit si njësi akademike me ekspertizë të konsoliduar në fushat e gjeoshkencave, burimeve natyrore, energjisë dhe mjedisit, në përputhje me strategjinë institucionale të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe prioritetet kombëtare dhe Evropiane të kërkimit shkencor dhe inovacionit. Në këtë kuadër, FGJM ka ndjekur prioritetet kryesore që lidhen me menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, lëndët e para kritike dhe adresimin e sfidave të ndryshimeve klimatike, duke i reflektuar këto drejtime në temat e kërkimit shkencor. Fokus i veçantë ka qenë pjesëmarrja e stafit akademik në thirrje për financim, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me synimin e sigurimit të burimeve financiare dhe forcimit të integrimit të fakultetit në rrjetet kërkimore Evropiane. Paralelisht, politikat e ndjekura kanë synuar forcimin gradual të kapaciteteve kërkimore, përmes zhvillimit të burimeve njerëzore dhe përmirësimit të infrastrukturës në shërbim të kërkimit shkencor. Gjatë vitit akademik 2024–2025 FGJM ka marrë pjesë aktive në thirrje për projekte kërkimore-shkencore, duke aplikuar për financim në programe kombëtare dhe ndërkombëtare. Projektet e aplikuara mbulojnë fusha prioritare të kërkimit shkencor dhe reflektojnë ekspertizën e stafit akademik dhe nevojat afatgjata të sektorëve strategjikë që mbulon fakulteti. Megjithëse jo të gjitha aplikimet kanë rezultuar fituese, procesi i aplikimit dëshmon një angazhim të qëndrueshëm institucional dhe një nivel të përshtatshëm përgatitjeje profesionale të stafit akademik në hartimin dhe menaxhimin e projekteve kërkimore.

3.2.4 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, me njësitë bazë përbërëse, ka realizuar kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar në fushat e tij të ekspertizës. I ndarë sipas njësive bazë, aktivietet e realizuara paraqiten në vijim.

3.2.4.1 Departamenti i Automatikës

Departamenti i Automatikës si pjesë e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike ndër prioritete kryesore në veprimtarinë e tij ka kërkimin shkencor. Kërkimi bazohet në strategjinë e FIE dhe UPT si dhe duke pasur në vëmendje strategjinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Fokusi i kërkimit shkencor për vitin 2024 – 2025 ka qenë:

Rritja e kontributit të kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe ekspertizës në fushat përkatëse inxhinierike si një mjet për rritjen e të ardhurave.

- ✓ Pjesëmarrje aktive në projektet e financuara nga institucione dhe organizata shteterore dhe

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

joshteterore si AKKSHI, MAS dhe institucione ndërkombëtare si Komisioni Europian. Për vitin akademik 2024 – 2025, DA ka fituar një projekt të rëndësishëm kërkimor shkencor SOLAR-MOVE dhe vazhdon me sukses pjesëmarrjen në Projektin AHEAD. Të dy projektet janë të financuar nga programi Horizon Europe.

- ✓ Bashkëpunimi me institucionet qeveritare dhe jo qeveritare, publike dhe private, për të ofruar ekspertizë shkencore dhe profesionale me synim ndihmesën për një zhvillim të qëndrueshëm perspektiv të vendit dhe rajonit dhe për përballimin e sfidave të rritjes profesionale, ekonomike, kulturore dhe sociale.
- ✓ Zhvillimi i një klime bashkëpunimi me institucione dhe organizata publike dhe private brenda vendit dhe rajonit në fusha të njëjta inxhinierike, për të mundësuar dhënien e ekspertizës dhe zgjidhjen e problemeve teknike e teknologjike. Në këtë aspekt janë nënshkruar disa marrëveshje bashkpunimi me kompani të ndryshme që operojnë në sistemin elektroenergjitik si dhe në atë industrial.

Nxitja e pjesëmarrjes së stafit akademik në projekte të orientuara ndaj ndërkombëtarizimit si Erasmus+ dhe COST:

- ✓ CA22137 - Randomised Optimisation Algorithms Research Network (ROAR-NET)– Prof. Asoc. Miranda Harizaj.
- ✓ CA23138 - Port City Territories in Action: A collaborative Laboratory for Inclusive Energy Transition (PACT) – Prof. Dr. Aida Spahiu.

Nxitja e pjesëmarrjes së stafit akademik në borde editoriale të revistave shkencore ndërkombëtare dhe komitete të konferencave ndërkombëtare:

- ✓ Alfred Pjetri, Gentian Dume, Journal of Transactions in Systems Engineering (JTSE), Tallinn, Estoni,ISSN Online: 2806-2973.
- ✓ Aida Spahiu, Journal of Policy and Society, Green Development, Singapor, Open Access.
- ✓ Alfred Pjetri, Journal of Transactions in Systems Engineering (JTSE), Buletini i Shkencave Teknike, BSHT.
- ✓ Aida Spahiu, CoDiT 2025, IEEE CANDO-EPE 2024.

Projekti "Modernizimi i Laboratorit të Automatikës" është financuar tashmë nga fondet e fakultetit dhe gjatë vitit akademik raportues janë instaluar pajisjet e parashikuara. Laboratori është në përdorim për aktivitetin mësimor dhe kërkimor-shkencor.

Projekti AHEAD ka vazhduar fazën e realizimit në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

Gjatë vitit akademik 2024-2025 është aplikuar dhe është fituar projekti SOLAR-MOVE, përsëri me financim nga HORIZON EUROPE. Projekti ka një financim total prej 7 milion € nga Bashkimi Europian dhe është një mundësi shumë e mirë për avancimin e kërkimin shkencor në DA dhe axhendës së ndërkombëtarizimit të parashikuar në strategjinë e UPT dhe FIE.

3.2.4.2 Departamenti i Sistemeve të Fuqisë

DSEF ka kryer mbyllur me sukses projektin e financuar nga AKSHI me temë: "Analiza e sigurisë së sistemit elektroenergjitik të Shqipërisë në kushtet e rritjes së kapaciteteve instaluese të burimeve të

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

rinovueshme" dhe me drejtues projekti Prof. Dr. Marialis Çelo. Objektivat dhe qëllimet e këtij projekti janë realizuar të gjitha. Normalisht DSEF ka vazhdimisht në fokusin e saj aplikimin dhe pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare si një mundësi për rritje profesionale, akademike dhe financiare.

Ndërkohë DSEF, nëpërmjet Prof. Dr. Marialis Çelo në cilësinë e anëtares së grupit të punës së Universitetit Politeknik, Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike, është partner fitues i një projekti të ri, Projektit SOLAR MOVE, Horizon 2020.

Projekte të strukturave qeveritare (Këshillit të Ministrave):

- ✓ Enciklopedia Shqiptare (redaksia e fushës Energjitë dhe Energjitika), 2023 në vazhdim.
- ✓ Projekte në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademive të Shkencave dhe të Arteve të vendeve fqinje (Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi).
- ✓ Platformë për zhvillim të qëndrueshëm të Sektorit Energjitik Kosovë - Shqipëri, 2025.

Projekte të tjera në programet e institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare:

- ✓ Ndërveprimi i teknologjive informatike dhe energjetike për një sistem elektroenergjetik të mençur (smart grid). Në kuadër të projekteve në mbeshtetje te Shkollës së Doktoratës FIE. Vendim i Bordit të Administrimit të UPT-së Nr. 28, datë 20.11.2020 (Anëtare). Në vazhdim.
- ✓ Analiza e ndryshueshmërisë së gjenerimit nga BRE-ve dhe të ngarkesës elektrike, ndikimi në sigurinë e sistemit elektroenergjitik, kohëzgjatja 3 vjet, 2024.

3.2.5 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Stafi i FIM ndjek politikat e kërkimit shkencor kombëtar, ku janë përcaktuar disa prioritetete kyçe për zhvillimin e kërkimit shkencor. Këto përfshijnë forcimin e kapaciteteve kërkimore, nxitjen e inovacionit, dhe përmirësimin e bashkëpunimit midis institucioneve akademike dhe sektorit privat. Prioritetet gjithashtu nënvizojnë rëndësinë e mbështetjes për kërkimin në fushat e teknologjisë, shëndetësisë, bujqësisë dhe mjedisit, duke e fokusuar kërkimin në zgjidhjen e problemeve në fushat që FIM mbulon por mbi të gjitha edhe në zhvillimin e qëndrueshëm.

FIM merr pjesë si palë aktive në të gjitha thirrjet kombëtare duke patur parasysh edhe objektivat e strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor si:

- ✓ Rritjen e investimeve në kërkimin shkencor, duke synuar gjithashtu të ngrejë laboratore dhe qendra kërkimore me pajisje dhe teknologji moderne, nëpërmjet mbështetjes me anë të thirrjeve për projekteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor (PIKSH).
- ✓ Zhvillimin e projekteve shkencore në bashkëpunim me universitetet partnere kombëtare dhe industrinë duke kontribuar në inovacion dhe zhvillim teknologjik, nëpërmjet thirrjeve për projekte kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit (PKKZH) dhe projekteve të teknologjisë dhe inovacionit (PTI).
- ✓ Forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në kërkimin shkencor përmes angazhimeve në iniciativa dhe projekte të përbashkëta me organizata ndërkombëtare dhe universitete të huaja, kjo nëpërmjet

thirrjeve të projekteve bilaterale që ofron Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, apo projekteve të tjera të BE-s, apo organizatave të ndryshme që operojnë në vend si GIZ, UNIDO, etj.

- ✓ Promovimin e edukimit dhe trajnimeve për kërkuesit e rinj dhe gjithashtu për profesionistë të tjerë të fushës, për të ndihmuar në rritjen e standardeve të kërkimit, nëpërmjet aplikimit për projekte Erasmus+ për shkëmbim stafi dhe studentësh.
- ✓ Siç shihet edhe nga Tabela nr. 4, për vitin akademik 2024-2025, stafi i FIM ka aplikuar për financim në 12 projekte Europiane, nga të cilat në 7 ka rezultuar jo fitues dhe në 5 pret të marri rezultatet, ndërkohë katër janë në vazhdim dhe një është mbyllur.
- ✓ Përsa i përket aplikimit për projekte Kombëtare tek AKKSHI janë bërë 7 (3 PIKSH, 3 PKKZH dhe 1 AADF), nga të cilët 5 kanë rezultuar fitues (dy PIKSH, dy PKKZH dhe një AADF) dhe dy jo fitues (një PIKSH dhe një PKKZH). Ndërkohë që gjatë këtij viti akademik janë mbyllur dy projekte PKKZH dhe një PTI, ndërsa një projekt PKKZH është në vazhdim.

3.2.6 Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike

Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike ka vendosur si prioritet strategjik zhvillimin e kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar në fushat që fakulteti mbulon, me fokus të veçantë në fushat kërkimore shkencore prioritare të përcaktuara në departamentet përkatëse: Departamenti i Inxhinierisë Matematike (DIM), Departamenti i Inxhinierisë Fizike (DIF), Departamenti i Inxhinierisë Kimike (DIK), dhe Qendra e Gjuhëve të Huaja (QGJH).

Prioritetet kryesore të kërkimit shkencor në FIMIF për vitin akademik 2024-2025 përfshijnë:

- ✓ Ruajtja dhe zhvillimi i burimeve njerëzore për të garantuar vazhdueshmërinë e kërkimit shkencor në fakultet përmes investimit në formimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Për këtë qëllim, një vend të rëndësishëm ka zënë hapja për herë të parë e Shkollës së Doktoratës në Inxhinieri Matematike në vitin akademik 2024-2025, e cila bashkë me Shkollën ekzistuese të Doktoratës në Inxhinieri Fizike ka regjistruar gjithsej 9 (nëntë) studentë të rinj, duke krijuar një bazë të fortë për zhvillimin e brezit të ardhshëm të kërkuesve shkencorë.
- ✓ Përmirësimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor nëpërmjet modernizimit të laboratorëve ekzistues dhe blerjes së pajisjeve të reja shkencore, me fokus të veçantë në laboratorët e Departamentit të Inxhinierisë Fizike dhe Departamentit të Inxhinierisë Kimike. Gjatë vitit akademik 2024-2025, janë blerë pajisje të reja dhe moderne që kanë përmirësuar ndjeshëm kapacitetet kërkimore dhe mundësitë për realizimin e eksperimenteve të avancuara që janë thelbësore për kërkimin bashkëkohor.
- ✓ Modernizimi i bibliotekës shkencore të fakultetit si një burim i vlefshëm dhe i domosdoshëm informacioni në shërbim të kërkimit shkencor dhe zgjerimit të njohurive për studentët dhe stafin akademik. Aksesi në databazat ndërkombëtare të kërkimit shkencor përmes bibliotekës së FIMIF, ka qenë një burim i paçmuar që ka lehtësuar qasjen në literaturën më të fundit shkencore dhe ka mbështetur në mënyrë të drejtpërdrejtë punën kërkimore të fakultetit.
- ✓ Orientimi i kërkimit të mirëfilltë dhe të avancuar shkencor në fushat kërkimore shkencore prioritare kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë energjitë e rinovueshme, inteligjencën artificiale,

mbrojtjen e mjedisit, modelimin matematikor dhe fizik të proceseve komplekse, teknologjitë e reja kimike dhe materiale të avancuara, si dhe zhvillimin e teknologjive gjuhësore. Këto fusha korrespondojnë drejtpërdrejt me prioritetet strategjike të Shqipërisë për zhvillim të qëndrueshëm dhe me sfidat globale të shekullit XXI.

- ✓ Inkurajimi dhe nxitja e stafit akademik për studime të zbatuara dhe projekte bashkëpunimi me fakultetet e tjera të Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe në veçanti me Institutin e Gjeoshkencave (IGJEO), duke krijuar sinergji të domosdoshme për adresimin e problemeve komplekse ndër-disiplinore. Bashkëpunimi me institucione të tjera publike dhe private brenda dhe jashtë vendit për probleme inxhinierike dhe ekonomike, zgjidhja e të cilave mundësohet ose lehtësohet nga përdorimi i teknikave matematike, metodave fizike dhe teknologjive kimike, mbetet një prioritet strategjik që udhëzon zhvillimin e ardhshëm të fakultetit.
- ✓ Rritja e cilësisë dhe sasisë së publikimeve shkencore në revista ndërkombëtare me impact factor të lartë, si dhe pjesëmarrja aktive në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare për të siguruar evidentimin dhe përhapjen e rezultateve të kërkimit shkencor që zhvillohet në fakultet. Gjatë vitit akademik 2024-2025, FIMIF ka realizuar 97 botime në revista shkencorë ndërkombëtare dhe 84 pjesëmarrje në konferenca.

3.2.6.1 FIMIF - Objektivat bazuar në strategjinë kombëtare dhe ndërkombëtare për kërkimin shkencor

Objektivat dhe synimet e kërkimit shkencor në FIMIF janë të harmonizuara plotësisht me strategjinë kombëtare dhe ndërkombëtare për kërkimin shkencor, duke u fokusuar në kontributin konkret për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe integrimin në hapësirën evropiane të kërkimit shkencor.

Në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018-2030 dhe Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK), FIMIF ka zhvilluar dhe fituar projektin AKKSHI "Energjia Diellore prej sistemeve fotovoltaike në shkallë të lartë në Shqipëri. Metoda të optimizimit të energjisë diellore me anë të Inteligjencës Artificiale, aplikime dhe drejtimet e kërkimit të ardhshëm" i drejtuar nga Prof. Asoc. Driada Mitrushi. Ky projekt kontribuon drejtpërdrejt në arritjen e objektivave të integrimit të lëndëve djegëse të rinovueshme në masën 34.6% në vitin 2030 dhe dekarbonizimin e thellë të sektorit energjetik deri në vitin 2050.

Në linjë me Axhendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe me prioritetet e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e mjedisit dhe luftën kundër ndryshimeve klimatike, Departamenti i Inxhinierisë Kimike ka siguruar dy projekte të rëndësishme me financim total prej 2,143,000 lekë:

- ✓ Projekti "Investigating the Impact of Open Burn Pits on Air Pollution in Albania" i financuar nga READ Programme - AADF në bashkëpunim me UMass Lowell (SHBA),
- ✓ Projekti "Vlerësimi i shkallës së eutrofikimit në Liqenin artificial të Tiranës" i financuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Këto projekte adresojnë çështje kritike mjedisore për vendin tonë dhe kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ujit.

Në harmoni me strategjinë evropiane për transformimin dixhital dhe zhvillimin e inteligjencës artificiale, FIMIF ka fituar projektin AKKSHI "Integrimi i aplikimeve të AI në programet universitare

të studimit STEM" i drejtuar nga Prof. Asoc. Dafina Xhako. Ky projekt synon modernizimin e kurrikulave dhe metodave të mësimdhënies në fushat STEM duke integruar aplikime të inteligjencës artificiale në procesin mësimor, duke përgatirur kështu studentët për sfidat e teknologjisë moderne dhe ekonomisë së bazuar në njohuri.

Në përputhje me politikat evropiane për shkëmbimin e kërkimit shkencor dhe për rritjen e pjesëmarrjes në infrastrukturën kërkimore evropiane, FIMIF ka fituar projektin AKKSHI për "Ngritja e një laboratori kombëtar CMS RPC ALBANIA LAB për detektor me gaz" i drejtuar nga Dr. Enkelejd Çaça. Ky projekt do të krijojë infrastrukturën e parë të këtij lloji në vend për kërkime në fizikën e energjive të larta dhe do të forcojë bashkëpunimin me projektin evropian të Solenoidit Kompakt të Muonit (CMS) në CERN, duke integruar kërkimin shkencor shqiptar në projekte prestigjioze ndërkombëtare.

FIMIF ka aplikuar me sukses dhe fituar projektin Jean Monnet "Application of European geospatial standards in the monitoring of radio frequency electromagnetic fields" në kuadër të programit Erasmus Plus, duke kontribuar në harmonizimin e praktikave shqiptare me standardet evropiane gjeohapësinore dhe duke forcuar kapacitetet për monitorimin mjedisor në përputhje me direktivat evropiane.

Harmonizimi dhe integrimi më i mirë i shkencave bazë të edukimit në FIMIF me pjesën tjetër të edukimit inxhinierik, duke rritur peshën e kurseve interdisiplinore në raport me kurset klasike teorike dhe autonome të shkencave bazë, përfaqëson një objektiv strategjik që lidhet drejtpërdrejt me rekomandimet e Procesit të Bolonjës dhe me standardet evropiane për arsimin e lartë. Thellimi i integrimit të kërkimit shkencor në mësimdhënie dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe pavarësisë së studentit nëpërmjet trekëndëshit Laborator-Detyra Kursi-Projekte Kursi është një qasje që reflekton praktikat më të mira ndërkombëtare në edukimin inxhinierik.

Angazhimi i studentëve të nivelit Master dhe Doktoratë në projekte studimore e kërkimore me qëllim kultivimin tek këta të fundit të shprehive të kërkuesit të integruar në grup përfaqëson një objektiv kyç që harmonizohet plotësisht me politikat evropiane për zhvillimin e brezit të ri të kërkuesve dhe për rritjen e atraktivitetit të karrierës kërkimore. Studentët e shkollës së doktoratës janë të angazhuar në projekte konkrete kërkimore-shkencore që adresojnë problematika të rëndësishme si modelimi hidrologjik, zhvillimi i teknologjive të gjuhës shqipe, simulimi i materialeve sintetike, imazhet HD në radioterapi, dhe optimizimi i energjisë diellore me inteligjencë artificiale.

Krijimi i të ardhurave nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga shërbimet, nga pjesëmarrja në ekspertiza e konsulencë, përfaqëson një objektiv strategjik që lidhet me politikat evropiane dhe kombëtare për rritjen e kontributit të universiteteve në ekonominë e bazuar në njohuri dhe për forcimin e lidhjes shkencë-industri. Fitimi i tre projekteve nga gjashtë të aplikuara në AKKSHI 2025, me një normë suksesi prej 50% që është jashtëzakonisht e lartë për standarde kombëtare, dëshmon kapacitetin e FIMIF për të tërhequr financime konkurruese dhe për të kontribuar në rritjen e të ardhurave suplementare për Universitetin Politeknik të Tiranës.

3.2.6.2 FIMIF - të dhëna mbi projektet e kërkimit shkencor

Gjatë vitit akademik 2024-2025, FIMIF ka demonstruar një aktivitet të intensifikuar në aplikimin për projekte kërkimore-shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Fakulteti ka aplikuar në thirrjen e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKKSHI) për vitin 2025, me gjithsej gjashtë projekt-propozime ambicioze, të ndara në dy kategori: dy projekte për Infrastrukturë Kërkimore-Shkencore (PIKSH) dhe katër projekte për Kërkimi dhe Zhvillimi

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Hulumtues (PKKZH).

Nga gjashtë projektet e aplikuara, tre janë shpallur fituese, duke arritur një normë suksesi prej 50%, që është jashtëzakonisht e lartë dhe dëshmon cilësinë e lartë të propozimeve të FIMIF si dhe kapacitetin shkencor të stafit akademik për të konceptuar dhe zhvilluar projekte konkurruese në nivel kombëtar. Projektet fituese përfshijnë një projekt infrastrukture PIKSH "Ngritja e një laboratori kombëtar CMS RPC ALBANIA LAB për detektor me gaz", i drejtuar nga Dr. Enkelejd Çaça nga Departamenti i Inxhinierisë Fizike, dhe dy projekte kërkimore PKKZH: "Energjia Diellore prej sistemeve fotovoltaike në shkallë të lartë në Shqipëri. Metoda të optimizimit të energjisë diellore me anë të Inteligjencës Artificiale, aplikime dhe drejtimet e kërkimit të ardhshëm" i drejtuar nga Prof. Asoc. Driada Mitrushi nga Departamenti i Inxhinierisë Fizike, dhe "Integrimi i aplikimeve të AI në programet universitare të studimit STEM", i drejtuar nga Prof. Asoc. Dafina Xhako nga Departamenti i Inxhinierisë Matematike.

Projektet që nuk fituan financim në këtë raund, por që përfaqësojnë iniciativa të vlefshme dhe dëshmojnë ambicien e fakultetit, përfshijnë projektin PIKSH "Krijimi i një laboratori inovativ për Data Science, Big Data dhe Inteligjencë Artificiale, në mbështetje të Programit të ri Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Data Science", i drejtuar nga Prof. Asoc. Endri Raço nga Departamenti i Inxhinierisë Matematike, projektin PKKZH "Fjalori Anglisht-Shqip i Terminologjisë së Inxhinierisë Mekanike e Mekatronike", i drejtuar nga Prof. Asoc. Miranda Enesi nga Qendra e Gjuhëve të Huaja, dhe projektin PKKZH "Metoda të Avancuara Numerike për simulimin e materialeve sintetike (Qelizat)", i drejtuar nga Prof. Asoc. Saimir Tola nga Departamenti i Inxhinierisë Matematike.

Përveç projekteve AKKSHI, Departamenti i Inxhinierisë Kimike ka vazhduar ekzekutimin e dy projekteve të rëndësishme të fituara më parë: projekti "Investigating the Impact of Open Burn Pits on Air Pollution in Albania" me financim prej 1,071,500 lekë nga READ Programme - AADF në bashkëpunim me Prof. Dr. Dhimitër Bello nga UMass Lowell (SHBA), dhe projekti "Vlerësimi i shkallës së eutrofikimit në Liqenin artificial të Tiranës" me financim prej 1,071,500 lekë nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, të dy koordinuar nga stafi i Departamentit të Inxhinierisë Kimike.

FIMIF ka aplikuar me sukses dhe fituar projektin Jean Monnet "Application of European geospatial standards in the monitoring of radio frequency electromagnetic fields" në kuadër të programit Erasmus Plus, në bashkëpunim me Departamentin e Inxhinierisë Matematike. Ky projekt evropian do të kontribuojë në aplikimin e standardeve gjeohapësinore në monitorimin e fushave elektromagnetike dhe do të forcojë kapacitetet institucionale për kërkime në këtë fushë.

FIMIF ka aplikuar gjithashtu në projektin evropian Erasmus+ KA220-HED "Cooperation partnerships in higher education" me titull "Joining Forces in Medical Physics to Defeat Cancer" në bashkëpunim me Universitetin e Craiova (Rumani), Universitetin e Tetovës (Maqedonia e Veriut), Universitetin Plovdiv (Bullgari), dhe Universitetin e Prishtinës (Kosovë). Edhe pse ky projekt nuk u shpall fitues në këtë raund, përpjekja për të krijuar partneritete rajonale në fushën e fizikës mjekësore dëshmon angazhimin e fakultetit për bashkëpunime ndërkombëtare të qëndrueshme.

Fakulteti vazhdon të jetë i angazhuar në projekte të vazhdueshme të financuara nga AKKSHI dhe institucione të tjera, duke përfshirë projektin "Nanomaterialet inovative me bazë hidroksiluor..apatiti për aplikime në stomatologji" ku dy anëtarë të stafit të DIK, Prof. Asoc. Bujar Dida dhe Prof. Asoc. Dafina Karaj, marrin pjesë si bashkëpunëtorë me lider Akademia Ivodent, projektin për përdorimin e laboratorit virtual të imazherisë mjekësore diagnostikuese në bashkëpunim me DIF (i financuar nga

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

NASRI), projektin për shfrytëzimin e Qendrës Llogaritëse në mbështetje të bashkëpunimit me projektin evropian CMS në CERN (i financuar nga AKKSHI), si dhe projekte të tjera në fushën e nanoteknologjisë, materialeve polimerike dhe energjisë së rinovueshme.

Administrimi më i mirë i kërkimit shkencor është realizuar nëpërmjet krijimit të bazave të të dhënave dixhitale për inventarizimin e publikimeve, projekteve dhe pasurive shkencore të FIMIF. Publikimi i rezultateve të kërkimit shkencor në revista të njohura ndërkombëtare me impact factor të lartë dhe prezantimi i tyre në konferenca prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare mbetet një prioritet i vazhdueshëm. Gjatë vitit akademik 2024-2025, FIMIF ka realizuar 98 artikuj të botuar në revista shkencorë ndërkombëtare dhe 84 prezantime në konferenca.

Koordinimi dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e veprimtarisë kërkimore nga Dekani i fakultetit dhe Këshilli Shkencor i FIMIF, në bashkëpunim të ngushtë me drejtuesit e departamenteve, siguron që objektivat e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovative të realizohen me sukses, duke u përputhur me planet dhe afatet strategjike të përcaktuara dhe duke kontribuar në mënyrë konkrete në misionin e Universitetit Politeknik të Tiranës për të qenë një institucion lider rajonal në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

3.2.7 Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

FIN ka në objektivat e tij prioritare startegjike kërkimin shkencor.

Përsa i takon realizimit të objektivave dhe synimeve bazuar në strategjinë kombëtare dhe ndërkombëtare për kërkimin shkencor, mund të thuhet se nga ana e departamenteve, janë bërë përpjekje të konsiderueshme në mënyrë që ato të jenë pjesë e projekteve të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës kërkimore, por edhe rritjen e kapaciteteve të stafit akademik.

3.2.8 Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

Stafi i FTI-së gjatë këtij viti akademik është angazhuar në hartim/aplikim projektesh, angazhim në projekte aktuale kërkimore apo rritje kapacitetesh, vizita shkëmbimi për rritjen e kërkimit shkencor në institucione të ndryshme ndërkombëtare me të cilat FTI-ja ka marrëveshje bashkëpunimi në vende si: Francë, Portugali, Turqi, Itali, etj. Një aspekt pozitiv është fakti që disa projekte kërkimore, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, janë tashmë në fazë zbatimi. Këto projekte jo vetëm që kontribuojnë në rritjen e kapaciteteve kërkimore, por gjithashtu forcojnë reputacionin tonë në komunitetin shkencor.

3.2.9 Instituti i Gjeoshkencave

Departamenti i Sizmologjisë është partner në projektin IPA CARE (Capacity for Risk Management of Earthquakes and Health Emergencies 2024–2025), në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe partnerët e Bashkimit Evropian. Në kuadër të këtij projekti, Shqipëria ka miratuar zhvillimin e një platforme për vlerësimin e rrezikut sizmik, e cila do të mirëmbahet nga Instituti i Gjeoshkencave dhe do të përdoret nga institucionet e mbrojtjes civile. Projekti përfshin zhvillimin e mjetit të rrezikut sizmik në formë web, organizimin e trajnimeve për përdorimin e tij dhe

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

garantimin e qasjes për institucionet përkatëse. Këto veprime realizohen në kuadër të paketave të punës WP 1.1.b dhe WP 2.3.b, që lidhen me bashkëpunimin institucional për menaxhimin e rrezikut sizmik dhe përmirësimin e shpërndarjes së informacionit para dhe pas ngjarjeve tërmetesh.

Po ashtu, Departamenti është pjesëmarrës në projektin EMERGE, që përfshin komponentin "Rapid Multi-Risk Needs Evaluation and Planning Platform". Ky projekt ndërkombëtar synon vlerësimin shumë-shtetëror dhe ndërkufitar të rreziqeve natyrore, përfshirë tërmetet dhe rrëshqitjet e dheut, si dhe zhvillimin e një platforme të integruar për identifikimin e shpejtë të nevojave për reagim të hershëm bazuar në vlerësimin në kohë reale të rrezikut. Pjesëmarrja e Institutit të Gjeoshkencave përmes Departamentit të Sizmologjisë në këtë projekt, konsiston në analizimin e rrezikut sizmik dhe kontributin në ndërtimin e moduleve të platformës për planifikimin e emergjencave në nivel rajonal.

Këto angazhime përbëjnë pjesën përbërëse të planit strategjik të Departamentit të Sizmologjisë dhe janë në përputhje të plotë me objektivat kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës kërkimore, zhvillimin e ekselencës shkencore në fushat prioritare dhe pjesëmarrjen aktive në programe kërkimore rajonale dhe evropiane.

Ndërkohë, IGJEO, konkretisht përmes Departamenteve të Meteorologjisë dhe të Hidrologjisë është i përfshirë si partner/përfitues në dy projekte me rendësi dhe shtrirje kombëtare, si më poshtë vijon:

❖ ALBAdapt

Programi për zhvillimin urban rezistent ndaj klimës në Shqipëri, një program me rëndësi kombëtare i nisur më 25 nëntor 2024, i financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), Fondi i Gjelbër për Klimën (GCF), Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim (SDC) SECO dhe Qeveria Shqiptare (QSH). Partnerë zbatues: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) si institucioni që harton politikën për ndryshimet klimatike dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC). IGJEO është partner në këtë projekt. Kohezgjatja: 2024-2030.

Programi ALBAdapt synon të rrisë rezistencën kimatike të popullsisë shqiptare përmes krijimit, koordinimit dhe përdorimit efektiv të informacionit klimatik – mbështetur nga një Shërbim Kombëtar Hidrometeorologjik funksional dhe nga Kuadri Kombëtar për Shërbimet Klimatike – si dhe një system i paralajmërimit të hershëm. Bazuar në problematikat e lartpërmendura, projekti synon të:

- ✓ Komponenti 1. Shërbimet hidrometeorologjike dhe klimatike në suport të politikave, planeve dhe aktiviteteve në sektorët prioritare.
  - Modernizimi i infrastrukturës software dhe hardware të monitorimit hidro-meteorologjik në vend në përputhje me standartet e Organizatës Botërore të meteorologjisë.
  - Reformimimin institucional në fushën e hidrometerologjisë, përfshirë edhe bazën ligjore të munguar.
  - Krijimi e platformës kombëtare (e para e këtij lloji në Ballkanin Perëndimor) për të dhënat dhe shërbimet klimatike, të aksesueshme nga të gjithë aktorët institucional dhe jo vetëm.
- ✓ Komponenti 2. Sistemet e paralajmerimit të hershëm të rreziqeve natyrore (EWS) dhe masat paraprake. Shqipëria ndërton një EWS të gjerë duke ndihmuar të adresohen masat paraprake për të shpëtuar jetë, për të mbrojtur mjedisin, pronën private dhe atë shtetërore, etj., për të zvogëluar risqet lidhur me klimën, përmes:

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- Krijimi dhe operacionalizimi 24/7 i një sistemi modern të paralajmërimit të hershëm i cili adreson 3 nga 6 rrisqet e identifikuara në Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Rrezikut ndaj Fatkeqësive.
- Vendosja e proçedurave standarde të operimit të cilat mundësojnë qartësimin e roleve dhe përgjegjësive në situatë rrisqesh klimatike.
- Vendosja e kanaleve të shumfishta të komunikimit të drejtpërdrejtë nga niveli qendror në komunitet përmes sistemeve të komunikimit digjital, telekomunikacion dhe mediatik me qëllim njoftimin e popullsisë, minimizimin e dëmeve materiale, minimizimin e rriskut etj.

✓ Komponenti 3. Vendime për investime lidhur me klimën (Climate –informed investment decisions) për të ndërmarrë dhe adresuar masat adaptuese, nëpërmjet:

- Stimulimi i inovacionit dhe përfshirjes së biznesit privat në komercilizimin e shërbimeve klimatike.
- Krijimi i një mekanizmi financiar studion, promovon dhe zbaton masa përshtatëse të bazuara nënatyrë dhe EcoDRR.
- Zbatimi i masave përshtatëse të bazuara në natyrë dhe EcoDRR për të siguruar një zhvillim urban rezistent ndaj ndryshimeve klimatike.

Në një kohë kur ndryshimet klimatike po ndikojnë ndjeshëm mbi bujqësinë, burimet ujore, energjinë, shëndetin publik dhe sigurinë e komuniteteve tona, nevoja për shërbime klimatike të besueshme, të aksesueshme dhe të orientuara drejt përdoruesit është bërë më e madhe se kurrë më parë. Instituti i Gjeoshkencave, si institucioni përgjegjës për monitorimin, analizën dhe ofrimin e informacionit klimatologjik në nivel kombëtar, e sheh këtë proces si një hap thelbësor drejt forcimit të reziliencës klimatike dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit tonë. Në këtë kuadër, IGEO është i gatshëm të bashkëpunojë në aspektet teknike dhe shkencore në procesin e ngritjes së Kuadrit Kombëtar për Shërbimet Klimatike, duke vënë në dispozicion ekspertizën, të dhënat dhe përvojën e tij shumëvjeçare në fushën e meteorologjisë, klimatologjisë dhe hidrologjisë.

Eshte domosdoshmeri ndërtimi i një sistemi kombëtar të qëndrueshëm për menaxhimin e informacionit klimatik, që do të ndihmojë Shqipërinë të parashikojë më mirë rreziqet klimatike, të planifikojë me mençuri zhvillimin dhe të mbrojë më mirë komunitetet e saj.

IGJEO, gjithashtu bashkëpunon me donatorë të ndryshëm përmes projekteve aktuale si më poshtë vijon:

Projekti EU4Rivers me mbështetje teknike nga Universiteti BOCU në Austri, dhe përfitues janë institucione shumë të rëndësishme shqiptare si IGJEO, AMBU, Shërbimi Kombëtar Gjeologjik, Instituti i Shëndetit Publik në Shqipëri, etj.

BE për Ujin - Komponenti 1: "EU4Rivers" (për të nxitur zbatimin e Menaxhimit të Integruar të Ujit në përputhje me acquis të BE-së), bashkëfinancohet nga BE dhe ADC (Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim), dhe zbatohet nga ADA (Agjencia Austriake për Zhvillim).

✓ Periudha e zbatimit: Shtator 2023 - Shtator 2028.

✓ Buxheti total: 8.8 milionë BE (7.5 milionë kontribut i BE-së nga BE dhe 1.3 milionë kontribut

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

i BE-së nga ADC).

- ✓ Përfituesit: Institucione monitoruese te ujerave si AMBU, IGJEO, SHGJSH, ISHP dhe AKM.

Qëllimi kryesor i projektit është të mbështesë zbatimin e Reformës Kombëtare të Ujit dhe të përparojë përafrimin e Shqipërisë me legjislacionin e BE-së për ujin, duke rritur kështu kapacitetin e vendit për të menaxhuar sektorin e ujit në përputhje me politikat e BE-së.

Projekti EU4Rivers përqendrohet në trajtimin e problemeve urgjente që lumenjtë në Shqipëri po përjetojnë aktualisht. Ai njeh rolin jetësor që lumenjtë luajnë në ekosisteme, ekonomi dhe mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve, dhe duke siguruar që ato të mbeten të qëndrueshme për brezat e ardhshëm. Rezultati 1: Kuadri ligjor dhe institucional gjithëpërfshirës i Menaxhimit të Integruar të Ujit (MIU) është përmirësuar ndjeshëm në përputhje me kërkesat e acquis të BE-së (DKU dhe direktiva të tjera që lidhen me ujin).

Rezultati 1:

- Zhvillimi i Udhërrëfyesve për zbatimin e qartë të Acquis të BE-së për ujin.
- Zhvillimi i instrumenteve të nevojshme ligjore për të mbështetur Acquis të BE-së për ujin.
- Zhvillimi i një qasje sistematike për ndërtimin e skenarëve dhe rishikimi i Strategjisë MWM-së.

Produkti 2:

- Zbatimi i MBR-së është rritur në të gjitha pellgjet e lumenjve në përputhje me kërkesat e DKU-së.
- Zhvillimi i planeve të menaxhimit të pellgjeve të lumenjve për Vjosën dhe Shkumbinin; Përmirësimi i planeve ekzistuese të menaxhimit dhe zbatimi i tyre për pellgjet e tjera të lumenjve të mbetur.
- Stimulimi i dialogut ndërkufitar dhe zhvillimi i nismave të përbashkëta për monitorimin e ujit.

Produkti 3:

- Monitorimi, raportimi dhe zbatimi i ujit janë përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme në përputhje me kërkesat e acquis të BE-së që lidhen me ujin për direktivat e ujit.
- Zhvillimi dhe zbatimi i një programi operativ të monitorimit të ujit që synon të sigurojë pajtueshmërinë me direktivat e BE-së për ujin.
- Rritja e aftësive të laboratorëve kombëtarë të referuar në përputhje me programin kombëtar të monitorimit të ujit, përmes përmirësimeve të pajisjeve, trajnimeve dhe akreditimit.
- Forcimi i rrjetit të monitorimit, duke lehtësuar mbledhjen, vlerësimin, ndarjen, raportimin dhe zbatimin e përmirësuar të të dhënave, duke adresuar edhe mangësitë aktuale në politikat e ujit.

Projekti: National Adaptation Plan/NAP, i mbështetur nga GEF dhe i zbatuar UNDP. IGJEO, veçanërisht Departamentet e Meteorologjisë dhe Hidrologjisë, përfitojnë nga ky projekt:

- Zhvillimi i raportit të analizes për digjitalizimin e të dhënave historike hidrometeorologjike ekzistuese të përgatitur nga IGEO dhe të mbeshtetur nga UNDP.
- Financim i procesit të dixhitalizimit për 5 vjet (1991-1996) të të dhënave meteorologjike.
- Trajnime të vazhdueshme të specializuara dhe ndërtim kapacitetesh për stafin teknik dhe akademik

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

në IGJEO.

- Raport Analize i të dhënave dhe informacionit ekzistues hidrometeorologjik i cili duhet të transformohet në mënyrë dixhitale.

Projekti: Integrated Climate-Resilient Transboundary Flood Risk Management in the Drin River Basin in the Western Balkans (Drin FRM) Project, i zbatuar nga UNDP. IGJEO, veçanërisht Departamentet e Meteorologjisë dhe Hidrologjisë, përfitojnë nga ky projekt:

- Trajnime të vazhdueshme të specializuara dhe ndërtim kapacitetesh për stafin teknik dhe akademik në IGJEO.
- High Performance Computer i vendosur në dhomën e serverave, IGJEO, etj.
- Server ku janë instaluar të gjitha shërbimet e reja të monitorimit sizmik.
- Hapësirë e Dedikuar Ruajtjeje 96 TB (Shtator 2022 / Investuar nga UNDP).
- Modelet e parashikimit të permbytjeve për basenin e Drinit, të krijuara në kuadër të këtij projekti tashmë janë asete të IGJEO.
- Modelet hidrologjike dhe hidraulike të lart përmendura, mund të run-ohen me ndihmën e High Performance Computer/HPC, gjithashtu të ofruar nga UNPD në kuadër të projektit në fjalë.

Projekti: "Për Ngritjen e Kapaciteteve për Sistemin Kombëtar të Informacionit të Zjarreve në Pyje (NFFIS) dhe Zgjidhjet e Bazuar në Natyrë për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive (NbS-DRR)", financuar nga JICA. Disa nga objektivat e këtij projekti janë:

- Shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira në menaxhimin e pyjeve,
- Zbatimin e metodave më inovative për zvogëlimin e rrisqeve,
- Trajnime intensive me ekspertët japonezë,
- Strategjitë më të përparuara për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje,
- Aplikime të teknologjive të reja për mbrojtjen e burimeve natyrore,
- Vizita në institucionet homologe japoneze,
- Analizim i projekteve më të fundit për mbrojtjen e pyjeve dhe metodat për kontrollin e erozionit.

3.3 PROJEKTE TË KËRKIMIT SHKENCOR

Universiteti Politeknik i Tiranës, me njësitë kryesore përbërëse është shumë aktiv në aplikme, fitime dhe zbatime me sukses të projekteve të kërkimit shkencor.

Në tabelën në vijim paraqiten të përmbledhur në formë statistikore numri i aplikimeve për projekte gjatë vitit akademik 2024-2025, duke vënë në dukje numrin e projekteve të fituara, atyre jo të fituara dhe atyre për të cilët nuk është marrë përgjigje përfundimtare, si pjesë e proceseve vendimmarrëse të thirrjeve të ndryshme ku janë aplikuar.

Të detajuara të dhënat e këtyre projekteve, ku përfshihen të dhënat e koordinatorit në Universitetin Politeknik, titullin e projektit dhe institucionin financues të projekteve, paraqitet në shtojcën e tabelës 4 në faqen Sh. Tab. 4.1 1

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 4: Projekte të kërkimit shkencor të aplikuar për financim në vitin akademik 2024-2025.[2]

Fakulteti / Njësia	Projekte Fitues	Projekte Jo Fitues	Në pritje të përgjigjes	Totali i Projekteve
DKSHP	4	6	0	10
FAU	5	2	0	7
FGJM	9	0	3	12
FIE	4	0	0	4
FIM	14	9	5	28
FIMIF	8	4	0	12
FIN	4	2	0	6
FTI	10	4	10	24
IGJEO	19	7	0	26
Total	**77**	**34**	**18**	**129**




Figura 10: Projekte të kërkimit shkencor në UPT për V.A. 2024-2025.

[2] Të detajuara projektet e aplikuara për financim paraqiten në Shtojcën e tabelës 4 në fund të këtij materiali.

3.4 LIDHJA E KËRKIMIT SHKENCOR ME MËSIMDHËNIEN

- ✓ Përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve në aktivitetin e kërkimit shkencor
- ✓ Ndikimi i kërkimit shkencor në përditësimin dhe modernizimin e programeve të studimit e kurrikulave mësimore.

Gjatë vitit akademik 2024-2025 njësitë bazë dhe kryesore të UPT-së kanë zhvilluar një sërë aktivitetesh për të integruar kërkimin shkencor dhe mësimdhënien. Janë organizuar workshope dhe aktivitete kërkimore, të financuar nga partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, me përfshirjen aktive të personelit akademik të UPT-së dhe studentëve. Studentët kanë realizuar punime shkencore për konferenca dhe revista shkencore, duke kultivuar tek ta shprehitë e kërkuesit dhe të studiuesit të integruar në grup dhe duke krijuar një lidhje të ngushtë mes kërkimit shkencor dhe formimit të tyre akademik.

Përpjekje të vazhdueshme janë bërë për zgjerimin e bashkëpunimit me institucione evropiane dhe universitete homologe, përfshirë shkëmbimin e personelit akademik dhe të studentëve, një qasje në literaturë shkencore bashkëkohore, mobilitetin e studentëve dhe personelit akademik të UPT-së, realizimin e projekteve të përbashkëta dhe hapjen e programeve të studimit të cilat ofrojnë diploma të dyfishta. Kjo qasje ka mundësuar një përvojë ndërkombëtare në kërkimin shkencor si dhe një rritje të cilësisë akademike si për studentët ashtu edhe për personelin akademik të UPT-së.

Gjatë studimeve të ciklit të tretë "Doktoratë", studentët inkurajohen të marrin pjesë në projekte kërkimore individuale, duke u fokusuar në zgjidhjen e problemeve konkrete në sektorë të ndryshëm të operimit. Gjithashtu, studentët e doktoratës janë angazhuar në procesin mësimor të cikleve të para dhe të dyta të studimit. Këto aktivitete demonstrojnë qartë se integrimi i kërkimit shkencor në mësimdhënie përmirëson procesin e mësimdhënies dhe përgatit studentët për sfidat profesionale.

Në këtë kuadër, rendisim në mënyrë të përmbledhur disa nga veprimtaritë e kryera nga njësitë kryesore të UPT-së, me qëllim përfshirjen e personelit akademik dhe studentëve në aktivitetin e kërkimit shkencor dhe përditësimin dhe modernizimin e programeve të studimit nëpërmjet aktivitetit të kërkimit shkencor:

3.4.1 Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

Në FAU mbetet një objektiv i vazhdueshëm integrimi i proceseve kërkimore shkencore me ato didaktike, si dhe lidhjen organike mes proceseve kërkimore të zhvilluara në ciklet e treta me atë të ciklit të parë e të dytë.

- ✓ Seicili nga departamentet e FAU ka shpallur fushat e veta kërkimore, të cilat orientojnë anëtarët e stafit akademik në proceset e tyre kerkimore por shërbejnë edhe për ndërtimin e programeve të ciklit të tretë apo për përcaktimin e temave të diplomave të Masterit Shkencor e të nivelit Bachelor.
- ✓ FAU dhe departamentet e tij kanë ndjekur një politikë dhe strategji mbështetëse e promovuese për pjesëmarrjet në konferenca dhe publikime, duke financuar çdo anëtar të stafit efektiv që ka kërkuar mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca apo botime. Si rrjedhojë, vërehet përditësimi i vazhduar i literaturës së detyruar dhe asaj të rekomanduar në sylabuset e lëndëve, lëndët projektuese kanë përditësuar në mënyrë të ndjeshme metodologjinë mësimdhënëse dhe njëkohësisht është forcuar komponenti i formimit teorik dhe mendimi kritik i studentëve.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ✓ Personeli akademik udhëheq procese kërkimore në përputhje me fushat e interesit dhe kualifikimin e vazhduar të tij. Puna e përbashkët kërkimore e personelit dhe studentëve shprehet në tezat e diplomave, por edhe në publikime të mëtejshme të cilat përvijojnë punën e filluar në tezat e masterit.
- ✓ Një nga outputet kryesore të procesit të kërkimit shkencor në nivel individual i personelit, është përmirësimi i vazhduar i silabuseve të lendëve dhe kurrikulës në përgjithësi.
- ✓ Në fakultet janë zhvilluar workshope me karakter kërkimor të financuar nga partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilët kanë patur në fokus përfshirjen e studentëve në këto aktivitete si dhe ngritjen e temave studimore të përbashkëta. (përmendim këtu bashkëpunimet me Saxon University, me Estp Paris, me Universitetin IUAV Venezia).

3.4.2 Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave

Puna kërkimore shkencore në FGJM është e lidhur ngushtësisht me procesin e mësimdhënies. Veprimtaria kërkimore-shkencore në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave është e lidhur në mënyrë të qëndrueshme me procesin e mësimdhënies, duke kontribuar në përditësimin e përmbajtjes akademike dhe në rritjen e cilësisë së formimit profesional të studentëve.

- ✓ Një pjesë e stafit akademik të FGJM është përfshirë si drejtues, koordinatorë ose bashkëpunëtorë në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, të financuara nga institucione si AKKSHI, Bashkimi Evropian, DFG dhe COST. Kjo përfshirje ka mundësuar integrimin e rezultateve të kërkimit shkencor në procesin mësimor, përmes pasurimit të leksioneve, punimeve praktike dhe temave të diplomave në të gjitha ciklet e studimit.
- ✓ Paralelisht, studentët janë përfshirë në mënyrë të kufizuar por të qëndrueshme në aktivitete kërkimore, përfshirë projekte shkencore, workshope, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, vizita studimore dhe, në raste të veçanta, në botime shkencore.
- ✓ Gjatë këtij viti akademik, një pjesë e stafit akademik të departamentit përkatës ka qenë e angazhuar në projekte kërkimore që përfshijnë edhe komponentë për përmirësimin e infrastrukturës laboratorike. Dy prej këtyre projekteve kanë pasur si objektiv të drejtpërdrejtë modernizimin e laboratorëve, me një vlerë totale financimi prej rreth 475,000 euro, duke rritur kapacitetet eksperimentale dhe praktike të përdorura në mësimdhënie.
- ✓ Një element i rëndësishëm i këtij viti akademik është gjithashtu përfshirja aktive e studentëve të shkollave të doktoratës pranë FGJM, të cilët kanë hartuar dhe dorëzuar projekte kërkimore individuale në kuadër të thirrjeve të AKKSHI-t për financimin e studimeve të tyre doktorale. Këto iniciativa kontribuojnë në forcimin e lidhjes ndërmjet kërkimit shkencor dhe formimit akademik, si dhe në ndërtimin e një kulture kërkimore të qëndrueshme brenda fakultetit.

3.4.3 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike

Në kuadër të kërkimit shkencor në Departamentin e Automatikës ka një bashkëpunim me fushat ndërdisiplinore që ndërlidhin bashkëpunimin me departamentet e tjera të FIE dhe UPT si nevojë e projekteve të bashkepunimit, duke ndjekur zhvillimet teknologjike dhe bashkëpunimin në mësimdhënie.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

3.4.4 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Përfshirja e stafit akademik dhe studentëve në aktivitetet kërkimore shkencore reflektohet në mënyrë të dukshme në cilësinë e punimeve të diplomave, veçanërisht në ato të nivelit master. Kjo përfshirje pasqyrohet gjithashtu në publikimin e artikujve në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në pjesëmarrjen aktive në konferenca, kongrese dhe workshope, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Gjithashtu, stafi dhe studentët janë angazhuar në projekte kërkimore-shkencore të mbështetura nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, duke zgjeruar kështu fushëveprimin dhe ndikimin e tyre akademik.

Një aspekt thelbësor i kërkimit shkencor është ndikimi i tij në përditësimin dhe modernizimin e programeve të studimit dhe kurrikulave mësimore. Përmes integrimit të arritjeve dhe metodologjive të avancuara, stafi akademik i FIM ka sjellë përmirësime të ndjeshme në procesin mësimor. Një ndër elementët kryesorë është përdorimi i softeve inxhinierike të specializuara në lëndë të ndryshme, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e aftësive për ndërtimin, simulimin dhe zgjidhjen e problemeve komplekse inxhinierike. Këto mjete janë një komponent i rëndësishëm i detyrave, projekteve dhe punimeve të diplomave të studentëve, duke garantuar përgatitjen e tyre për sfidat profesionale dhe kërkesat e tregut të punës.

3.4.5 Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike

Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike ka vendosur si prioritet strategjik integrimin e ngushtë të kërkimit shkencor me mësimdhënien, duke krijuar një mjedis akademik ku stafi dhe studentët janë të angazhuar aktivisht në veprimtari kërkimore-shkencore që pasurohen vazhdimisht dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në cilësinë e procesit mësimor.

- ✓ Stafi akademik i FIMIF gjatë vitit akademik 2024-2025 ka demonstruar një nivel të lartë angazhimi në kërkimin shkencor, duke arritur rezultate të jashtëzakonshme me 96 botime në revista shkencorë ndërkombëtare dhe 104 pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Departamenti i Inxhinierisë Matematike ka kontribuar në mënyrë të veçantë me 64 botime ndërkombëtare në revista me impact factor të lartë, një artikull të veçantë dhe dy disertacione doktorate, duke arritur totalin e 64 botimeve. Pedagogët e këtij departamenti kanë qenë veçanërisht aktivë në skenën ndërkombëtare, duke marrë pjesë në 28 konferenca shkencore ndërkombëtare, 3 konferenca kombëtare, si dhe duke organizuar dy evente shkencore, duke arritur në total 31 pjesëmarrje që dëshmojnë praninë e fortë të departamentit në komunitetin shkencor global.
- ✓ Departamenti i Inxhinierisë Fizike ka realizuar 19 botime ndërkombëtare dhe tre disertacione doktorate, duke arritur totalin prej 22 botimeve që reflektojnë punën intensive kërkimore të stafit të tij. Veçanërisht duhet të theksohet që gjatë këtij viti akademik në këtë departament janë mbrojtur me sukses dy disertacione doktorate me tematika të avancuara në fushën e kimisë fizike dhe termodinamikës. Stafi i departamentit ka marrë pjesë në konferenca shkencore me 29 referime ndërkombëtare, gjashtë konferenca kombëtare, dy kapituj librash dhe prezantime të tjera, duke arritur në total 37 pjesëmarrje. Departamenti i Inxhinierisë Kimike ka kontribuar me tre botime ndërkombëtare dhe ka pasur një prezencë të konsiderueshme në konferenca me nëntë referime ndërkombëtare, dy kapituj librash dhe aktivitete të tjera shkencore, duke arritur në total 13

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

pjesëmarrje. Qendra e Gjuhëve të Huaja ka realizuar nëntë botime ndërkombëtare dhe një disertacion doktorate, si dhe ka pasur një aktivitet të dukshëm në konferenca me 18 referime ndërkombëtare, dy konferenca kombëtare, një kapitull, dy prezantime dhe aktivitete të tjera, duke arritur në total 24 pjesëmarrje.

- ✓ Një arritje e veçantë e vitit akademik 2024-2025 është hapja për herë të parë e Shkollës së Doktoratës në Inxhinieri Matematike, e cila bashkë me Shkollën ekzistuese të Doktoratës në Inxhinieri Fizike ka regjistruar gjithsej nëntë studentë të rinj. Konkretisht, janë regjistruar katër studentë në Shkollën e Doktoratës në Inxhinieri Fizike dhe pesë studentë në Shkollën e Doktoratës në Inxhinieri Matematike. Studentët e shkollës së doktoratës janë të angazhuar aktivisht në projekte kërkimore-shkencore konkrete që zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me stafin akademik dhe që kontribuojnë drejtpërdrejt në veprimtarinë kërkimore të departamenteve.
- ✓ Pranë Departamentit të Inxhinierisë Matematike po zhvillohen projekte kërkimore-shkencore inovative që adresojnë problematika të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare: Studimi krahasimor i metodave të ndryshme interpoluese hapësinore të të dhënave të rreshjeve për modelimin hidrologjik në shkallë pellgu ujëmbledhës, me fokus në Pellgun ujëmbledhës të Prespës, i cili përfaqëson një bashkëpunim konkret midis DIM dhe Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit; Ndërtimi i modelit matematik për vlerësimin e përputhshmërisë në tekstet shqip, projekt që do të kontribuojë në zhvillimin e teknologjive të gjuhës shqipe dhe që ka aplikime të rëndësishme në përpunimin automatik të gjuhës; si dhe Metoda të avancuara numerike për simulimin e materialeve sintetike, projekt që lidhet me aplikime në biomjekësi dhe inxhinieri të materialeve. Pranë Departamentit të Inxhinierisë Fizike po zhvillohen projekte ambicioze si Përdorimi i imazheve HD të PET/CT në radioterapi dhe korrelimi i tyre me MRI dhe CT, projekt që kontribuon në përmirësimin e trajtimeve mjekësore të kancerit, si dhe Energjia diellore prej sistemeve fotovoltaike në shkallë të lartë në Shqipëri me metoda të optimizimit të energjisë diellore me anë të inteligjencës artificiale, projekt që lidhet drejtpërdrejt me projektin fitues të AKKSHI të drejtuar nga Prof. Asoc. Driada Mitrushi.
- ✓ Studentët e vitit të parë të doktoratës kanë përfunduar me sukses vitin akademik dhe kanë bërë prezantimet në departamentet përkatëse duke raportuar për aktivitetin e tyre shkencor, ku kanë shfaqur rezultatet e para të kërkimeve të tyre dhe kanë marrë feedback të vlefshëm nga stafi akademik. Në Departamentin e Inxhinierisë Fizike, dhjetë studentët e vitit të dytë kanë bërë prezantimin e paraprak të punës së tyre kërkimore-shkencore dhe kanë raportuar për pjesëmarrjet në evente shkencore ndërkombëtare dhe botime në revista në bashkëpunim me udhëheqësit e tyre shkencor, duke dëshmuar integrimin e tyre të suksesshëm në veprimtarinë kërkimore të departamentit.
- ✓ Përfshirja e studentëve të nivelit Bachelor dhe Master në aktivitete kërkimore realizohet nëpërmjet një qasjeje të integruar që përfshin laboratorë, detyra kursi, projekte kursi dhe teza diplome që janë të lidhura ngushtë me projektet kërkimore të stafit akademik. Thellimi i integrimit të kërkimit shkencor në mësimdhënie dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe pavarësisë së studentit realizohet nëpërmjet trekëndëshit Laborator-Detyra Kursi-Projekte Kursi, një qasje pedagogjike që krijon mundësi për studentët të eksperimentojnë, të zbulojnë dhe të kontribuojnë aktivisht në procesin e të mësuarit përmes angazhimit në problemet kërkimore reale.
- ✓ Fakulteti ka krijuar një kulturë kërkimore ku studentët motivohen dhe mbështeten financiarisht për

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

të marrë pjesë në konferenca shkencore, për të publikuar rezultatet e punëve të tyre në revista dhe akte konferencash, dhe për të zhvilluar aftësi kërkimore që janë thelbësore për karrierën e tyre të ardhshme akademike ose profesionale. Gjatë vitit akademik 2024-2025, një numër i konsiderueshëm studentësh të FIMIF janë mbështetur financiarisht nga fakulteti dhe universiteti për pjesëmarrje në veprimtari shkencore të ndryshme, duke përfshirë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, workshope, dhe shkollime verore në institucione partnere.

- ✓ Realizimi i praktikave të studentëve të nivelit Master pranë kompanive private apo shtetërore me të cilat UPT ka marrëveshje bashkëpunimi krijon mundësi për studentët të aplikojnë njohuritë teorike dhe metodat kërkimore që kanë mësuar në fakultet në zgjidhjen e problemeve praktike industriale dhe shkencore. Këto praktika profesionale shërbejnë si një urë e rëndësishme midis botës akademike dhe botës së punës, duke kontribuar në përgatitjen e specialistëve të kualifikuar që janë të aftë të integrojnë kërkimin shkencor me praktikën inxhinierike.
- ✓ Stafi akademik i FIMIF angazhohet aktivisht në mbikëqyrjen shkencore të studentëve të të tre ciklet e studimit, duke u siguruar që temat e tezave të diplomës, projekteve të kursit dhe detyrave kërkimore janë të lidhura me fushat prioritare të kërkimit shkencor të fakultetit dhe me nevojat e shoqërisë dhe ekonomisë shqiptare. Kjo qasje garanton që studentët jo vetëm fitojnë njohuri teorike por edhe zhvillojnë aftësi praktike kërkimore që janë të vlefshme për tregun e punës dhe për vazhdimin e karrierës akademike.

Kërkimi shkencor që zhvillohet në FIMIF ka një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në përditësimin dhe modernizimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe kurrikulave mësimore. Fakulteti ka vendosur si prioritet strategjik që të sigurojë që programet akademike reflektojnë zhvillimet më të fundit shkencore dhe teknologjike në fushat përkatëse dhe që studentët të jenë të ekspozuar ndaj metodave, teknikave dhe teknologjive më të avancuara që përdoren në kërkimin bashkëkohor.

- ✓ Projekti fitues i AKKSHI "Integrimi i aplikimeve të AI në programet universitare të studimit STEM" i drejtuar nga Prof. Asoc. Dafina Xhako përfaqëson një iniciativë strategjike që do të transformojë kurrikulat e programeve të studimit në FIMIF duke integruar aplikime të inteligjencës artificiale në kurset bazë dhe të specializuara. Ky projekt do të rezultojë në zhvillimin e moduleve të reja mësimore, materialeve didaktike bashkëkohore, dhe metodave pedagogjike inovative që do të përmirësojnë ndjeshëm cilësinë e ofertës akademike dhe do të përgatisë studentët për sfidat e ekonomisë digjitale dhe të teknologjisë moderne. Integrimi i AI në programet STEM nuk është thjesht një shtesë e përmbajtjes së re por përfaqëson një ripërcaktim fundamental të qasjes pedagogjike që vendos teknologjitë inteligjente në qendër të procesit të të mësuarit.
- ✓ Projekti fitues "Energjia Diellore prej sistemeve fotovoltaike në shkallë të lartë në Shqipëri. Metoda të optimizimit të energjisë diellore me anë të Inteligjencës Artificiale, aplikime dhe drejtimet e kërkimit të ardhshëm" i drejtuar nga Prof. Asoc. Driada Mitrushi ka ndikim të drejtpërdrejtë në programet mësimore të Departamentit të Inxhinierisë Fizike, duke krijuar mundësi për zhvillimin e kurseve të reja dhe përditësimin e kurseve ekzistuese në fushat e energjisë së rinovueshme, modelimit të sistemeve energjetike, dhe aplikimeve të inteligjencës artificiale në inxhinierinë energjetike. Rezultatet e këtij projekti do të integrohen në leksionet, punët laboratorike, projektet e kursit dhe temat e tezave të diplomës, duke krijuar një lidhje të fortë midis kërkimit shkencor dhe procesit mësimor.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ✓ Projektet e doktoratës që zhvillohen në Departamentin e Inxhinierisë Matematike, siç janë studimi krahasimor i metodave interpoluese hapësinore për modelimin hidrologjik, ndërtimi i modelit matematik për vlerësimin e përputhshmërisë në tekstet shqip, dhe metodat e avancuara numerike për simulimin e materialeve sintetike, kontribuojnë drejtpërdrejt në pasurimin e përmbajtjes së kurseve të nivelit Master dhe Bachelor në fushat e analizës numerike, modelimit matematikor, përpunimit të të dhënave, dhe aplikimeve të matematikës në shkencat e tjera. Pedagogët që mbikëqyrin këto projekte doktorate integrojnë rezultatet e kërkimeve në leksionet e tyre, duke ofruar studentëve akses në njohuritë më të fundit shkencore dhe në metodat më të avancuara të kërkimit.
- ✓ Projektet e Departamentit të Inxhinierisë Kimike, siç janë "Investigating the Impact of Open Burn Pits on Air Pollution in Albania" dhe "Vlerësimi i shkallës së eutrofikimit në Liqenin artificial të Tiranës", kanë rezultuar në përditësimin e kurrikulave të kurseve që lidhen me kiminë mjedisore, analizën kimike, metodat instrumentale dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit dhe ujit. Studentët e përfshirë në këto projekte kanë mundësinë të punojnë me pajisje bashkëkohore analitike, të aplikojnë protokolle të avancuara të matjes dhe analizës, dhe të zhvillojnë aftësi praktike që janë shumë të kërkuara në tregun e punës. Rezultatet e këtyre projekteve janë integruar në materialet mësimore dhe janë përdorur si raste studimore në leksionet dhe punët laboratorike.
- ✓ Hapja e Shkollës së Doktoratës në Inxhinieri Matematike në vitin akademik 2024-2025 përfaqëson një hap të rëndësishëm në diversifikimin e ofertës akademike të fakultetit dhe krijon mundësi të reja për integrimin e kërkimit shkencor me mësimdhënien në nivelin më të lartë të studimit. Programi i doktoratës është strukturuar në mënyrë që të sigurojë që doktorantët jo vetëm kryejnë kërkime origjinale por edhe kontribuojnë në procesin mësimor nëpërmjet asistencës në kurse, udhëheqjes së seancave laboratorike, dhe mbikëqyrjes së punëve të studentëve të nivelit Bachelor dhe Master. Kjo qasje krijon një mjedis akademik dinamik ku transferimi i njohurive ndodh në të gjitha drejtimet dhe ku vijueshmëria e ekspertizës shkencore garantohet nëpërmjet formimit të brezit të ri të kërkuesve.
- ✓ Harmonizimi dhe integrimi më i mirë i shkencave bazë të edukimit në FIMIF me pjesën tjetër të edukimit inxhinierik, si dhe rritja graduale e peshës së kurseve interdisiplinore në raport me kurset klasike teorike dhe autonome të shkencave bazë, janë të udhëhequra nga kërkimi shkencor që demonstron rëndësinë e qasjeve integruese dhe ndërdisiplinore në zgjidhjen e problemeve komplekse bashkëkohore. Projektet kërkimore që përfshijnë bashkëpunime midis departamenteve të ndryshme të FIMIF dhe midis FIMIF dhe fakulteteve të tjera të UPT, veçanërisht me Institutin e Gjeoshkencave, informojnë drejtpërdrejt zhvillimin e kurseve interdisiplinore që përgatiten studentët për të punuar në ekipe multidisiplinare dhe për të adresuar problemet që kërkojnë ekspertizë nga fusha të ndryshme.
- ✓ Përfshirja në programet mësimore të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike të metodave të orientuara drejt kompjuterit dhe e softeve të rëndësishme për këtë qëllim reflekton trendet e kërkimit shkencor bashkëkohor ku metodat kompjuterike dhe simulimet numerike luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm. Pedagogët që janë aktivë në kërkimin shkencor që përdor metoda të avancuara numerike, modelim kompjuterik, dhe analiza të të dhënave të mëdha integrojnë këto përvoja drejtpërdrejt në kurset që japin, duke siguruar që studentët të jenë të pajisur me aftësitë kompjuterike dhe analitike që janë thelbësore për karrierën e tyre profesionale.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ✓ Krijimi i një baze të dhënash me modele, shembuj dhe praktika të punës më të mirë për leksione, seminare, projekte kursi, detyra kursi, punë laboratori, dhe teza diplome që vijnë nga projektet kërkimore që zhvillohen në fakultet krijon një burim të çmuar që mund të përdoret efektivisht në procesin e mësimit, duke ndihmuar studentët dhe stafin e ri akademik për t'u integruar në spektrin e gjërë të aktiviteteve mësimore dhe kërkimore. Kjo bazë të dhënash përditësohet vazhdimisht me rezultate të reja kërkimore dhe me raste studimore që reflektojnë zhvillimet më të fundit në fushat përkatëse.
- ✓ Publikimi i të gjithë projekteve të financuara në kuadrin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim-zhvillimit për një shfrytëzim sa më të gjerë të informacionit shkencor, si dhe publikimi i rezultateve të kërkimit shkencor në revista të njohura si brenda ashtu edhe jashtë vendit me akses të hapur dhe arkivimi i tyre në bibliotekën e FIMIF, siguron që studentët dhe stafi akademik kanë akses të lehtë në prodhimin shkencor të fakultetit dhe mund ta përdorin atë si material mësimor dhe si burim frymëzimi për punët e tyre akademike.
- ✓ Mbështetja financiare e studentëve të FIMIF në të tre ciklet e studimit për pjesëmarrjet e tyre në veprimtari shkencore të ndryshme, si konferenca, workshope, shkollime verore, dhe vizita kërkimore, krijon mundësi për ekspozim ndaj metodave dhe praktikave më të mira ndërkombëtare që më pas rikthehen në procesin mësimor nëpërmjet prezantimeve që studentët bëjnë për kolegët e tyre, materialeve që hartojnë, dhe entuziazmit që transmetojnë për fushat e tyre të studimit.

3.4.6 Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

Nga ana e Departamentit të Inxhinierisë së Mjedisit, është përfshirë një pjesë e stafit akademik në projekte të ndryshme ERASMUS +, ku eksperienca e fituar nga trajnimet dhe bashkëpunimet me Universitetet Homologe Europiane, është përdorur në përmirësimin e kurrikulave. Gjithashtu nga realizimi i këtyre projekteve është bërë i mundur dhe shkëmbimi si i stafit akademik ashtu edhe ai i studentëve.

Disa anëtarë të stafit akademik të Departamentit të Gjeodezisë janë angazhuar në projektet ERASMUS+, SmartWB (12.2022-12.2025). Anëtarë të stafit akademik të DGJ janë trajnuar për teknologjitë gjeohapësinore (Geospatial World Forum 2025) dhe për teknologjitë satelitore GNSS (SMALLSAT Europe) përkatësisht në Madrid, Spanjë më 22-25 Prill 2025, Partner Geospatial World dhe në Amsterdam, Hollandë më 27-28 Maj 2025, Partner SatNews Events, European Space Agency, si dhe janë angazhuar në projektet e kërkimit shkencor të Departamentit të Gjeodezisë.

3.4.7 Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

Kërkimi shkencor konsiderohet pjesë e pandarë e aktivitetit të përditshëm të personelit akademik të FTI-së duke qenë se arritjet kërkimore dhe shkencore të tij janë të lidhura drejtpërdrejt me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, me përditësimin e informacionit shkencor që u përcillet studentëve në auditor dhe me rritjen akademike të stafit në kërkimit shkencor. Arritjet kërkimore ndihmojnë në përditësimin e përmbajtjes akademike, duke siguruar që studentët të përfitojnë informacion të përditësuar dhe të bazuar në zhvillimet më të fundit shkencore.

Personeli akademik ka angazhuar disa nga studentët më të mirë në realizimin e punimeve shkencore

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

në konferenca ose revista, duke pasur si qëllim kultivimin tek këta të fundit të shprehive të kërkuesit e studiuesit të integruar në grup. Kjo qasje ka krijuar një lidhje të ngushtë mes kërkimit shkencor dhe formimit akademik të studentëve.

Studentët e vitit të dytë të shkollës së doktoratës janë thelluar më tej në punën e tyre kërkimore-shkencore sipas fushave të tyre të interesit. Ndërkohë, studentët e vitit të parë të shkollës doktorale zgjeruan njohuritë e tyre në fushat specifike të temave të tyre doktoratës. Të gjithë studentët e doktoratës janë angazhuar në procesin mësimor në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në FTI.

3.4.8 Instituti i Gjeoshkencave

Instituti i Gjeoshkencave ka si mision:

- ✓ Të kryejë kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar në fushën e Gjeologjisë, Hidrologjisë, Meteorologjisë dhe Sizmologjisë;
- ✓ Të kontribuojë nëpërmjet monitorimit, parashikimit dhe kërkimit shkencor mbi rreziqet natyrore gjeologjike dhe hidro-meteorologjike, në mbeshtetje të strukturave të mbrotjes civile, sigurisë kombëtare dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit;
- ✓ Të kontribuojë në formimin universitar të thelluar dhe në kualifikimin e kërkuesve të rinj nëpërmjet transferimit të njohurive dhe teknologjiësë, në fushat e kërkimit që mbulon.

Në këtë kuadër, ka patur një përfshirje të gjerë të stafit akademik, atij ndihmës akademik dhe studentëve në aktivitetin e kërkimit shkencor. Kërkimi i thelluar shkencor ndikon drejtpërdrejt dhe vazhdimisht në përditësimin dhe modernizimin e programeve të studimit e kurrikulave mësimore.

3.5 PRODUKTET E KËRKIMIT SHKENCOR

UPT synon rritjen e veprimtarisë kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare nëpërmjet: pjesëmarrjes në konferenca e workshope, botimeve shkencore, artikujve, hartimit, implementimit e pjesëmarrjes në projekte kombëtare, evropiane, rajonale dhe më gjerë, në përmbushje të politikave dhe strategjisë së institucionit mbi kërkimin shkencor.

Proceset kërkimore në UPT zhvillohen në dy nivele, në nivel personeli akademik si dhe në nivel të grupeve kërkimore shkencore, në kuadër të njësisë bazë/kryesore.

Personeli akademik i UPT-së ka marrë pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe ka realizuar botime në revista shkencore ndërkombëtare. Një pjesë e mirë e botimeve janë të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare me Faktor Impakti dhe me Bord Editorial.

3.5.1 Kërkimi shkencor në njësitë kryesore të UPT

Njësitë kryesore të UPT-së, promovojnë vazhdimisht aktivitete të ndryshme kërkimore shkencore dhe në disa prej të cilave ato janë organizues ose bashkë organizues të këtyre aktiviteteve. Më poshtë rendisim vetëm disa prej tyre:

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

3.5.1.1 Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

- ✓ FAU zhvillon procese kërkimore në dy nivele, në nivel profesorati dhe në forma të organizuara në trajtën e grupeve kërkimore, në kuadër të njësisë bazë.
- ✓ Në trajtën e grupeve kërkimore, në fakultet disa grupe kërkimore janë duke kryer kërkime mbi aspekte historike dhe të tranzicionit në lidhje me qytetet dhe kontekstin shqiptar.
- ✓ Në nivel individual, kërkimi kryesisht brendashkruhet në fushat e specializimit të personelit. Në proceset e shkëmbimeve apo të konferencës, partneret janë kryesisht ndërkombëtarë, ndërkohë që ende nuk ka procese kërkimore të cilat kane partnere nga biznesi apo kompanitë private.
- ✓ Kualifikimi i vazhduar i stafit akademik mbetet një nga prioritetet kryesore. Për nga natyra e disiplinës, por edhe lidhur me kushtet specifike te shkollës se arkitekturës, ndërkombëtarizimi mbetet një objektiv me shume rendesi. Mobiliteti i stafit akademik është një proces thelbësor lidhur me këtë të fundit si dhe ne fuqizimin e rrjeteve rajonale e globale të kërkimit. Gjatë vitit akademik 2024-2025 nje pjesë e anëtarëve kanë zhvilluar mobilitete për trajnime apo leksione të hapura në universitete të huaja. Në planet e veprimit si dhe projekt buxhetet vjetore, per çdo vit janë konsideruar si prioritete pjesëmarrjet në konferenca dhe aktivititete ndërkombëtare shkencore, me synimin që seicilit anëtar t'i ofrohet mundësia e përfaqësimit. Nga ana tjetër, mbetet sfide e Fakultetit ngritja e një strukture që angazhohet në përgatitje dokumentacioni dhe aplikimesh për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare si Erasmus, Horizon, Interreg, etj.
- ✓ Janë realizuar pjesëmarrje në konferenca shkencore me impakt, organizuar nga universitete prestigjoze apo shoqata të njohura ndërkombëtarisht që veprojnë në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës. Këto pjesëmarrje në koferenca janë mbështetur financiarisht nga buxheti i FAU, sa herë që profesorët kanë shprehur interes për subvencionim të shpnzimeve dhe fee-se së konferencës.

3.5.1.2 Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave

Gjatë vitit akademik 2024–2025, Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave, ka zhvilluar një numër të konsiderueshëm aktivitetesh kërkimore-shkencore, botimesh, konferencash, projektesh të fituara dhe prej tyre të realizuara, si dhe veprimtarish të tjera akademike brenda dhe jashtë vendit. Këto produkte pasqyrojnë rritjen e kapaciteteve kërkimore të tij, forcimin e bashkëpunimeve ndërinstitucionale në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe rritjen e impaktit të FGJM në skenën shkencore dhe akademike. Aktivitetet e zhvilluara janë të larmishme dhe përfshijnë:

- ✓ projekte kërkimore të financuara nga AKKSHI;
- ✓ programe të BE-së (Horizon Europe, COST), si dhe nga fondacione dhe agjenci ndërkombëtare;
- ✓ botime shkencore në revista ndërkombëtare me faktor impakti, si dhe në revista kombëtare si Journal of Natural and Technical Sciences dhe revista të tjera shkencore të indeksuara;
- ✓ prezantime në konferenca dhe takime shkencore ndërkombëtare në shtete të ndryshme të Evropës si dhe pjesëmarrje në trajnime e workshop-e profesionale;
- ✓ organizimin nga DSHT të aktiviteteve shkencore në kuadër të COST Action-ave (SaltAges, Recovery of Mining Districts), duke sjellë në Tiranë ekspertë dhe pjesëmarrës nga shumë vende europiane;

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ✓ angazhimin e stafit në role editoriale, komitete shkencore, recensime dhe oponenca shkencore;
- ✓ Gjatë periudhës 2024-2025, FGJM ka marrë pjesë në: 12 Projekte, 16 aktivitete të kerkimit shkencor, 47 Botime, 38 Konferenca, Forume, Workshope kombëtare ashtu dhe ndërkombëtare, 4 pjesëmarrje si anëtarë të bordit editorial në revista shkencore/botimet, 1 pjesëmarrje në Komitete Organizative Ndërkombëtare, 1 Monografi brenda vendit dhe 5 Recensues/Relator.

3.5.1.3 Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike

Departamenti i Automatikës. Raporti i veprimtarisë shkencore pasqyron aktivitetet shkencore të realizuara nga anëtarët e DA të cilat janë të konkretizuara me botime në revista jashtë dhe brenda vendit, referime në konferenca, ëorkshope, forume e simpoziume jashtë dhe brenda vendit si dhe përgatitje materialesh për tekste mësimore dhe leksione të shkruara. Një vend të rëndësishem ka zënë puna për shkollën e doktoratës në të cilën janë regjitruar tre studentë të rinj. Përmirësimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor nëpërmjet ngritjes së laboratorëve të rinj.

Gjatë vitit akademik 2024 – 2025 pothuajse i gjithë stafi akademik i DA ka realizuar publikime cilësore si në revista shkencore ashtu edhe në ëorkshope apo konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përpjekje të vazhdueshme për zgjerimin e bashkëpunimit me institucione evropiane të arsimit të lartë, duke synuar rritjen e shkëmbimeve në nivelin e personelit akademik, shkëmbimin e literaturës shkencore në funksion të studentëve. Janë bërë përpjekje për bashkëpunime me departamente të tjera brenda UPT-së si dhe aplikimi në projekte të KE si thirrjet COST dhe Erasmus+. Vëmendja është përqëndruar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, për t'i bërë ato të krahasueshëm me programet më të mira të fushave përkatëse, në vend e më gjerë. Këto arritje vlerësohen si pjesë e një përpjekjeje të vazhdueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara në planin afatmesëm dhe afatgjatë, që konsistojnë në realizimin e ekselencës akademike, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe ambientit të mësimit.

Departamenti i Automatikës është angazhuar ne orientimin e kërkimit shkencor në përputhje me perspektivën evropiane dhe objektivat e mijëvjeçarit. Përpjekje të vazhdueshme për zgjerimin e bashkëpunimit me institucione evropiane të arsimit të lartë, duke synuar rritjen e shkëmbimeve në nivelin e personelit akademik, shkëmbimin e literaturës shkencore në funksion të studentëve, realizimin e mobilitetit të studentëve, pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta të kërkimit shkencor, etj. Janë bërë përpjekje për bashkpunime me universitete homologe për krijimin e diplomave të dyfishta. Departamenti i Automatikës synon kualifikimin e stafit akademik dhe kërkimor, nëpërmjet hartimit të projekteve kërkimore mbështetëse. Aktualisht cikli i tretë i studimeve është hapur dhe katër anëtarë të departamentit janë rregjistruar.

Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë. Në kuadër të lëndëve "Burimet e Rinovueshme të Energjisë" dhe "Gjenerimi i Shpërndarë dhe Mikrogride", në ambientet e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike në datë 30 prill 2025 u zhvillua prezantimi i projekteve nga studentët e vitit të tretë të ciklit Bachelor, profili Energjetikë, si dhe nga studentët e ciklit Master Profesional në Elektroenergjetikë. Aktiviteti u udhëhoq nga pedagogu i lëndës, z. Andi Hida.

Studentët prezantuan modele dhe makete të ndryshme që ilustronin tema inovative:

- ✓ Përdorimi i burimeve të rinovueshme për furnizimin e ngarkesave elektrike në një aeroport;
- ✓ Instalimi i moduleve fotovoltaike në zonat rurale;

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ✓ Kompleksi banimi "Green";
- ✓ Përdorimi i burimeve të rinovueshme për ndriçimin rrugor;
- ✓ Ndikimi i burimeve të rinovueshme në rrjetin elektrik të shpërndarjes në qytetin e Tiranës;
- ✓ Furnizimi i ndriçimit publik nëpërmjet moduleve fotovoltaike.

Në këtë prezantim morën pjesë studentë të të dy cikleve të studimit, si edhe personel akademik dhe ndihmës akademik të fakultetit. Gjatë aktivitetit u theksua rëndësia e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë në vendin tonë, si dhe roli që kanë këto iniciativa në nxitjen e kuptimit praktik të lëndëve, zhvillimin e aftësive kërkimore dhe rritjen e interesit shkencor tek studentët e Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë (DSEF). Në përfundim të workshopit studentët janë vlerësuar me certifikatë vlerësimi.

Departamenti i Elektroteknikës. Personeli PAE i DE synon të përfshihet dhe të japë kontribut në projektet e kërkimit shkencor ku merr pjesë FIE dhe UPT në bashkëpunimet ndërinstitucionale me IAL-të brenda dhe jashtë vendit dhe t'a ndërlidhë atë me mësimdhënien. Kjo për arsye se shihet si një premisë e rëndësishme në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, sidomos në aspektin e përditësimit të njohurive teorike e praktike që pasqyrohen në syllabuset e lëndëve të DE në përputhje me karakterin e veçantë që kanë 16 programet e studimit në 6 fakultete të UPT ku stafi PAE i DE zhvillon aktivitet mësimdhënës.

3.5.1.4 Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Stafi akademik i FIM ka zhvilluar një aktivitet të gjerë shkencor me publikim të artikujve shkencore, referimeve në konferenca, kongrese, etj, si dhe pjesëmarrje në pesë projekte ndërkombëtare si dhe projekte të financuara nga AKSHI: tre për kërkim zhvillim (PKKZH), dhe një PTI, që janë bërë të njohura për FIM me realizimin e workshopeve në FIM, UPT.

3.5.1.5 Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike

Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike gjatë vitit akademik 2024-2025 ka arritur rezultate të jashtëzakonshme në prodhimin shkencor, duke e vendosur fakultetin si lider në rang Universiteti Politeknik të Tiranës për nga numri dhe cilësia e produkteve kërkimore-shkencore. Produktet shkencore të fakultetit përfshijnë botime në revista ndërkombëtare me impact factor të lartë, prezantime në konferenca prestigjioze kombëtare dhe ndërkombëtare, projekte kërkimore të fituara me financim konkurruese, disertacione doktorate të mbrojtura me sukses, si dhe bashkëpunime të shumta me institucione kërkimore vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare.

- ✓ Botime shkencore dhe artikuj në revista ndërkombëtare

Gjatë vitit akademik 2024-2025, stafi akademik i FIMIF ka botuar gjithsej 95 artikuj në revista shkencorë ndërkombëtare. Këto botime përfaqësojnë kontribute origjinale në fushat e matematikës së aplikuar, fizikës bashkëkohore, kimisë mjedisore dhe analitike, si dhe në gjuhësi të aplikuar dhe pedagogji.

Departamenti i Inxhinierisë Matematike ka kontribuar me 64 artikuj të botuar në revista ndërkombëtare me impact factor, duke mbuluar fusha të tilla si inekualitetet e tipit Newton dhe Hermite-Hadamard për integrale të thyera, algebër fuzzy dhe aplikime në shkenca të ndryshme, analiza statistikore e të

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

dhënave të aksidenteve rrugore, si dhe aplikime të sistemeve informative gjeografike (GIS) në monitorimin mjedisor. Veçanërisht të spikatura janë kontributet në fushën e integrimit të thyer dhe teoritë e inekualiteteve, ku pedagogët e DIM kanë publikuar në revista prestigjioze si "Mathematical Methods in the Applied Sciences", "Filomat", "Mathematica Slovaca", dhe "Sahand Communications in Mathematical Analysis". Këto publikime përfaqësojnë bashkëpunime të gjerë ndërkombëtare me autorë nga Turqia, India, Pakistani, Meksika, Kina dhe vende të tjera, duke dëshmuar integrimin e plotë të DIM në komunitetin shkencor global të matematikës së aplikuar.

Një kontribut i veçantë është dhënë në fushën e aplikimeve të GIS dhe analizës së të dhënave hapësinore mjedisore, ku janë publikuar artikuj në bashkëautor që adresojnë problematika të rëndësishme kombëtare si ndikimi i ndotjes mjedisore në shëndetin e njeriut, vlerësimi i ndikimit mjedisor në sektorin e transportit për të përmbushur objektivat klimatike, dhe metodat e studimit të të dhënave hapësinore ambientale. Këto publikime kontribuojnë drejtpërdrejt në mbështetjen shkencore të politikave mjedisore dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri.

Departamenti i Inxhinierisë Fizike ka realizuar 19 botime ndërkombëtare që mbulojnë fusha të tilla si vetitë termofizike të përzierëve të lëngjeve, sistemet fotovoltaike dhe energjia e rinovueshme, imazhet mjekësore dhe aplikime në radioterapi, si dhe fizika e materialeve dhe karakterizimi i nanomaterialeve. Këto publikime janë botuar në revista të specializuara në fizikë dhe inxhinieri fizike, dhe përfaqësojnë kontribute të rëndësishme në fushat përkatëse të kërkimit. Veçanërisht të rëndësishme janë publikimet që lidhen me projektet e doktoratës dhe që kontribuojnë në avancimin e njohurive në fushat e termodinamikës, kinetikës kimike, dhe vetive fizike të sistemeve komplekse të lëngjeve.

Departamenti i Inxhinierisë Kimike ka kontribuar me tre botime ndërkombëtare që fokusohen në çështje mjedisore të rëndësishme për vendin tonë, duke përfshirë studime mbi ndotjen e ajrit, cilësinë e ujit, dhe aplikime të metodave analitike të avancuara për monitorimin mjedisor. Këto publikime janë rezultat i drejtpërdrejtë i projekteve kërkimore të financuara nga READ Programme - AADF dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, dhe përfaqësojnë bashkëpunime me institucione prestigjioze ndërkombëtare si University of Massachusetts Lowell në SHBA.

Qendra e Gjuhëve të Huaja ka realizuar dhjetë botime ndërkombëtare në fushat e pedagogjisë gjuhësore, metodave të mësimdhënies së gjuhëve të huaja, terminologjisë teknike, dhe integrimit të teknologjisë në mësimdhënien e gjuhëve. Këto publikime kontribuojnë në avancimin e praktikave më të mira në mësimdhënien e gjuhëve në kontekstin shqiptar dhe rajonal, dhe përfaqësojnë pjesëmarrje aktive në diskursin ndërkombëtar për edukimin gjuhësor.

Përveç artikujve në revista, stafi akademik i FIMIF ka kontribuar gjithashtu me një artikull të veçantë dhe shtatë disertacione doktorate që përfaqësojnë kontribute substanciale në fushat përkatëse të kërkimit dhe që janë të dokumentuara plotësisht në tabelat përkatëse të këtij raporti.

- ✓ Pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare

Gjatë vitit akademik 2024-2025, stafi akademik dhe studentët e FIMIF kanë marrë pjesë në 107 aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë konferenca, simpoziume, workshope, dhe seminare shkencore. Kjo pjesëmarrje aktive në evente shkencore dëshmon angazhimin e fakultetit për shkëmbimin e njohurive, për bashkëpunime ndërkombëtare, dhe për prezantimin e rezultateve të kërkimeve të zhvilluara në fakultet në forume prestigjioze shkencore.

Departamenti i Inxhinierisë Matematike ka marrë pjesë në 31 aktivitete shkencore, duke përfshirë 28

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

referime në konferenca ndërkombëtare, shtatë konferenca kombëtare, një aktivitet organizues, një prezantim disertacioni, dhe dy organizime të eventeve shkencore. Pedagogët e DIM kanë prezantuar rezultatet e kërkimeve të tyre në konferenca prestigjioze ndërkombëtare të organizuara në Turqi, Portugali, Azerbajxhan, Kanada, dhe vende të tjera, duke mbuluar tema si teoria e inekualiteteve, analiza numerike, aplikime të inteligjencës artificiale në matematikë, dhe modelimi matematikor i proceseve reale. Pjesëmarrja në konferencën kombëtare "Shkenca dhe Teknologjia në Shërbim të Zhvillimit" organizuar në Tiranë ka qenë veçanërisht e suksesshme, me shumë prezantime që adresojnë problematika kombëtare dhe aplikime të matematikës në kontekstin shqiptar.

Departamenti i Inxhinierisë Fizike ka marrë pjesë në 37 aktivitete shkencore, duke përfshirë 29 referime në konferenca ndërkombëtare, katër konferenca kombëtare, një prezantim, një disertacion, dhe dy kapitulli. Prezantimet në konferenca ndërkombëtare kanë mbuluar fusha të tilla si fizika e materialeve, sistemet fotovoltaike dhe optimizimi me inteligjencë artificiale, imazhet mjekësore në radioterapi, detektorët me gaz për fizikën e energjive të larte, dhe aplikime të metodave fizike në mjekësi dhe industri. Pjesëmarrja në konferencën kombëtare "Shkenca dhe Teknologjia në Shërbim të Zhvillimit" ka përfshirë prezantime mbi energjinë e rinovueshme, metodat e avancuara në fizikë eksperimentale, dhe aplikime të fizikës në zgjidhjen e problemeve praktike.

Departamenti i Inxhinierisë Kimike ka marrë pjesë në 14 aktivitete shkencore, duke përfshirë nëntë referime në konferenca ndërkombëtare, një aktivitet organizues, dy kapitulli, dhe një disertacion. Prezantimet kanë fokusuar në çështje mjedisore si ndotja e ajrit nga djegiet e hapura, eutrofikimi i ujërave, aplikime të nanoteknologjisë në stomatologji, dhe zhvillimi i membranave polimerike për aplikime farmaceutike. Pjesëmarrja në konferencën kombëtare ka përfshirë prezantime që adresojnë problematika aktuale të cilësisë së mjedisit në Shqipëri dhe metodat e avancuara të analizës kimike.

Qendra e Gjuhëve të Huaja ka marrë pjesë në 25 aktivitete shkencore, duke përfshirë 18 referime në konferenca ndërkombëtare, një aktivitet organizues, një kapitull, një disertacion, dy konferenca kombëtare, dhe dy prezantime. Prezantimet kanë fokusuar në metodat inovative të mësimdhënies së gjuhëve të huaja, integrimin e teknologjisë në mësimdhënien gjuhësore, zhvillimin e terminologjisë teknike në gjuhën shqipe, dhe përdorimin e softuerëve të specializuar si GeoGebra në mësimdhënien e gjuhëve për fusha teknike.

- ✓ Projekte kërkimore të fituara dhe të realizuara

Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike ka demonstruar sukses në konkurimet kombëtare për financim kërkimor gjatë vitit akademik 2024-2025. Nga gjashtë projekt-propozime të aplikuara në thirrjen e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKKSHI) për vitin 2025, tre janë shpallur fituese, duke arritur një normë suksesi prej 50% që është e lartë për standarde kombëtare.

Projektet fituese në AKKSHI 2025 përfshijnë:

- ✓ Projekt PIKSH (Infrastrukturë Kërkimore-Shkencore): "Ngritja e një laboratori kombëtar CMS RPC ALBANIA LAB për detektor me gaz", i drejtuar nga Dr. Enkelejd Çaça nga Departamenti i Inxhinierisë Fizike. Ky projekt do të krijojë infrastrukturën e parë të këtij lloji në vend për kërkime në fizikën e energjive të larta dhe do të forcojë bashkëpunimin me projektin evropian të Solenoidit Kompakt të Muonit (CMS) në CERN, duke integruar kërkimin shkencor shqiptar në projekte ndërkombëtare prestigjioze.

- ✓ Projekt PKKZH (Kërkimi dhe Zhvillimi Hulumtues): "Energjia Diellore prej sistemeve fotovoltaike në shkallë të lartë në Shqipëri. Metoda të optimizimit të energjisë diellore me anë të Inteligjencës Artificiale, aplikime dhe drejtimet e kërkimit të ardhshëm", i drejtuar nga Prof. Asoc. Driada Mitrushi nga Departamenti i Inxhinierisë Fizike. Ky projekt kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin e burimeve të energjisë së rinovueshme në vendin tonë duke përdorur metoda të avancuara të inteligjencës artificiale për optimizimin e sistemeve fotovoltaike, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018-2030 dhe Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës.
- ✓ Projekt PKKZH (Kërkimi dhe Zhvillimi Hulumtues): "Integrimi i aplikimeve të AI në programet universitare të studimit STEM", i drejtuar nga Prof. Asoc. Dafina Xhako nga Departamenti i Inxhinierisë Matematike. Ky projekt synon modernizimin e kurrikulave dhe metodave të mësimdhënies në fushat STEM duke integruar aplikime të inteligjencës artificiale në procesin mësimor, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin cilësor të ofertës akademike.

Projektet në vazhdim nga vitet e mëparshme përfshijnë:

- ✓ Projekt READ Programme - AADF: "Investigating the Impact of Open Burn Pits on Air Pollution in Albania", me financim prej 1,071,500 lekë, i koordinuar nga Prof. Asoc. Dr. Edlira Baraj nga Departamenti i Inxhinierisë Kimike, në bashkëpunim me Prof. Dr. Dhimitër Bello nga University of Massachusetts Lowell (SHBA). Projekti parashikon matje në terren të lëndës së grimcuar në pezulli dhe të ndotësve të tjerë në ajër, duke përdorur pajisje multimetrike të avancuara dhe metodologji të sofistikuara analitike.
- ✓ Projekt Akademia e Shkencave: "Vlerësimi i shkallës së eutrofikimit në Liqenin artificial të Tiranës", me financim prej 1,071,500 lekë, i koordinuar nga Dr. Edlira Tako nga Departamenti i Inxhinierisë Kimike. Projekti adreson çështje të rëndësishme mjedisore lidhur me cilësinë e ujit dhe ekosistemit të liqenit artificial të Tiranës.
- ✓ Projekt Jean Monnet Erasmus+: "Application of European geospatial standards in the monitoring of radio frequency electromagnetic fields", projekt fitues evropian që fokusohet në aplikimin e standardeve gjeohapësinore evropiane në monitorimin e fushave elektromagnetike, në bashkëpunim me Departamentin e Inxhinierisë Matematike.
- ✓ Projekt AKKSHI: "Nanomaterialet inovative me bazë hidroksifluoroapatiti për aplikime në stomatologji", me lider Akademia Ivodent dhe pjesëmarrës aktivë Prof. Asoc. Bujar Dida dhe Prof. Asoc. Dafina Karaj nga DIK.

Totali i financimeve të siguruara vetëm për dy projektet e DIK arrin në 2,143,000 lekë, ndërsa financimet e projekteve AKKSHI të fituara në 2025 do të shtohen në këtë total duke e çuar kontributin e FIMIF në sigurimin e të ardhurave suplementare për UPT në një nivel të lartë.

- ✓ Disertacione doktorate të mbrojtura

Gjatë vitit akademik 2024-2025, në FIMIF janë mbrojtur me sukses dy disertacione doktorate në Departamentin e Inxhinierisë Fizike:

- ✓ "Studimi i vetive fizike të sistemit katërsh methyl tert-butyl ether + n-heksan + cikloheksan + benzen dhe nënsistemeve të tij dyshe dhe treshe në temperaturë T = (293.15, 298.15, dhe

303.15) K dhe shtypje lokale atmosferike", mbrojtur nga kandidati Artan Llozana. Kjo disertacion përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në fushën e vetive termofizike të përzierëve të lëngjeve dhe ka aplikime të rëndësishme në industrinë kimike dhe petrokimike.

- ✓ "Studimi i vetive termofizike të përzierjeve treshe alkanol (C1-C4) + cikloheksan + benzen (dhe disa derivateve të tij) në rajonin e temperaturave nga 20 deri në 60°C dhe shtypje lokale atmosferike", mbrojtur nga kandidati Arbër Zeqiraj. Kjo disertacion kontribuon në zgjerimin e njohurive mbi sjelljen termofizike të sistemeve komplekse të lëngjeve dhe ka vlerë të madhe për aplikime praktike në dizajnin e proceseve kimike.

Të dy disertacionet përfaqësojnë punë kërkimore origjinale që janë kryer në laboratorët e Departamentit të Inxhinierisë Fizike dhe që janë shoqëruar me botime në revista ndërkombëtare dhe prezantime në konferenca shkencore.

- ✓ Përcaktimi për secilin produkt nëse veprimtaria është organizuar brenda vendit apo jashtë tij

Produktet shkencore të FIMIF përfaqësojnë një kombinim të ekuilibruar të veprimtarive të organizuara brenda vendit dhe jashtë tij, duke reflektuar integrimin e plotë të fakultetit në komunitetin shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar.

- ✓ Botime në revista ndërkombëtare: Të gjitha 95 botimet në revista shkencore janë në revista ndërkombëtare të botuara jashtë vendit, kryesisht nga shtëpi botuese prestigjioze evropiane, amerikane dhe aziatike. Revista përfshijnë botime nga Elsevier, Springer, Wiley, MDPI, Taylor & Francis, dhe shtëpi të tjera botuese të njohura ndërkombëtarisht. Revista specifikisht përfshijnë: "Mathematical Methods in the Applied Sciences" (Wiley, Britani e Madhe), "Filomat" (Serbia), "Mathematica Slovaca" (Sllovaki), "Sahand Communications in Mathematical Analysis" (Iran), "Rendiconti del Circolo Matematico di Palermo" (Itali), "Journal of Inequalities and Applications" (Springer, gjermani), "Fractal and Fractional" (MDPI, Zvicër), "Palestine Journal of Mathematics" (Palestinë), dhe shumë të tjera. Ky diversitet gjeografik i revistave dëshmon shtrirjen globale të bashkëpunimeve shkencore të FIMIF.
- ✓ Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare: Nga 84 pjesëmarrjet totale në aktivitete shkencore, 84 prej tyre (përfshirë referime ndërkombëtare, konferenca kombëtare, prezantime, dhe organizime) përfshijnë aktivitete të organizuara si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Konferencat ndërkombëtare në të cilat stafi i FIMIF ka marrë pjesë janë organizuar në vende të tilla si:
  - ❖ Turqi: International Conference on Mathematical Advances and Applications (Stamboll, Korrik 2025), The 13th International Summit on Mathematics and its Applications (Sanliurfa, Shkurt 2025), The 5th International Ethics Congress (Adana, Dhjetor 2024), The 5th International Baku Science Congress (Baku-Azerbajxhan, Dhjetor 2024), 2nd International Conference on Pure and Applied Mathematics (Konya, Shtator 2025).
  - ❖ Portugali: The 11th International European Conference on Social Sciences (Lisbonë, Janar 2025).
  - ❖ Kanada: 2nd International Canadian Science Congress (Toronto, Tetor 2024).
  - ❖ Azerbajxhan: Konferenca të organizuara në Baku.
- ✓ Konferencat kombëtare të organizuara brenda vendit përfshijnë kryesisht "Konferenca e Dytë

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Kombëtare: Shkenca dhe Teknologjia në Shërbim të Zhvillimit" organizuar në Tiranë në Prill 2025, ku pedagogë dhe studentë të FIMIF kanë prezantuar një numër të konsiderueshëm punimesh që adresojnë problematika kombëtare në fushat e matematikës së aplikuar, fizikës, kimisë mjedisore dhe teknologjive të informacionit.

- ✓ Projekte kërkimore: Projektet e fituara dhe të realizuara përfshijnë një kombinim të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare:
  - ❖ Projekte kombëtare: Të gjitha projektet AKKSHI janë projekte kombëtare të financuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit e Shqipërisë. Projekti i financuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë është gjithashtu një projekt kombëtar.
  - ❖ Projekte ndërkombëtare: Projekti READ Programme është një projekt ndërkombëtar në bashkëpunim me University of Massachusetts Lowell (SHBA). Projekti Jean Monnet është një projekt evropian në kuadër të programit Erasmus+. Projektet e aplikuara në Erasmus+ KA220 përfaqësojnë gjithashtu iniciativa ndërkombëtare në bashkëpunim me universitete të rajonit.
- ✓ Përcaktimi për secilin produkt të nivelit të institucionit bashkëpunues nëse është në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar

Bashkëpunimet shkencore të FIMIF përfshijnë të tre nivelet: vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar, duke dëshmuar integrimin e plotë të fakultetit në rrjetet kërkimore në të gjitha nivelet.

Nivel vendor (institucione të tjera të UPT):

- ✓ Bashkëpunim i vazhdueshëm me Institutin e Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEO) në projekte ndërdisiplinore që kombinojnë ekspertizën e FIMIF në modelim matematikor dhe fizik me ekspertizën e IGJEO në gjeoshkenca dhe mjedis. Projekti i doktoratës "Studim krahasimor i metodave të ndryshme interpoluese hapësinore të të dhënave të rreshjeve për modelimin hidrologjik në shkallë pellgu ujëmbledhës" përfaqëson një bashkëpunim konkret midis DIM dhe IGJEO.
- ✓ Bashkëpunim me fakultete të tjera të UPT në projekte kërkimore dhe në organizimin e aktiviteteve shkencore të përbashkëta, duke përfshirë seminare, workshope, dhe leksione të hapura.

Nivel kombëtar (institucione shqiptare jashtë UPT):

- ✓ Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Bashkëpunim në projektin "Vlerësimi i shkallës së eutrofikimit në Liqenin artificial të Tiranës" me financim prej 1,071,500 lekë.
- ✓ Akademia Ivodent: Bashkëpunim në projektin AKKSHI "Nanomaterialet inovative me bazë hidroksifluoroapatiti për aplikime në stomatologji" ku anëtarë të stafit të DIK marrin pjesë si bashkëpunëtorë.
- ✓ Universiteti Mjekësor i Tiranës: Bashkëpunim në projektin "Përdorimi i një sistemi polimerik në optimizimin e biodisponibilitetit të barnave" që lidh kërkimin shkencor me industrinë farmaceutike në Shqipëri.
- ✓ Kompania farmaceutike Profarma - Tiranë: Bashkëpunim në projektet që lidhin kërkimin

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

akademik me aplikime industriale.

- ✓ Institucione të tjera publike dhe private shqiptare me të cilat FIMIF ka marrëveshje bashkëpunimi për praktika studentore, ekspertiza, dhe konsulencë teknike.

Nivel ndërkombëtar:

Bashkëpunimet ndërkombëtare të FIMIF janë të gjera dhe të shumëllojshme, duke përfshirë institucione prestigjioze nga e gjithë bota:

- ✓ SHBA: University of Massachusetts Lowell (UMass Lowell) - bashkëpunim në projektin READ Programme "Investigating the Impact of Open Burn Pits on Air Pollution in Albania" me Prof. Dr. Dhimitër Bello si akademik nga diaspora.
- ✓ CERN (Organizata Evropiane për Kërkime Bërthamore, Zvicër): Bashkëpunim në projektin e Solenoidit Kompakt të Muonit (CMS) përmes projektit të financuar nga AKKSHI për Qendrën Llogaritëse dhe laboratorin CMS RPC ALBANIA LAB.
- ✓ Turqi: Bashkëpunime të shumta me universitete turke që reflektohen në bashkëautorë të shumtë në publikime dhe në pjesëmarrje në konferenca të organizuara në Turqi. Universitete partnere përfshijnë universitete nga Stamboll, Sanliurfa, Adana, dhe Konya.

Rajoni i Ballkanit:

- ✓ Universiteti i Prishtinës (Kosovë): Bashkëpunime të vazhdueshme në aktivitete kërkimore dhe organizim i konferencave të përbashkëta.
- ✓ Universiteti i Tetovës (Maqedonia e Veriut): Partner në aplikimin për projektin Erasmus+ KA220.
- ✓ Universiteti i Craiova (Rumani): Partner në aplikimin për projektin Erasmus+ KA220.
- ✓ Universiteti Plovdiv (Bullgari): Partner në aplikimin për projektin Erasmus+ KA220.
- ✓ India, Pakistani, Kina, Meksika, Spanjë, Itali, Iran: Bashkëautorë të shumtë në publikime shkencore nga këto vende, duke dëshmuar rrjetin e gjerë global të bashkëpunimeve të FIMIF.
- ✓ Programi Jean Monnet (Bashkimi Evropian): Bashkëpunim në nivelin e BE-së përmes projektit fitues "Application of European geospatial standards in the monitoring of radio frequency electromagnetic fields".

Të dhënat e detajuara mbi datën, vendin, dhe pjesëmarrësit për secilin produkt shkencor janë paraqitur në tabelat e mëposhtme të këtij raporti:

- ✓ Tabela 5.1 - Botime: Përfshin të dhëna të detajuara për të gjitha 98 botimet, duke specifikuar autorin e parë, bashkëautorët, titullin e botimit, emrin e revistës ose shtëpisë botuese, volumin, vitin e botimit, ISSN/ISBN, dhe DOI për çdo publikim. Tabela është e organizuar sipas departamenteve (DIM: 70 botime, DIF: 22 botime, DIK: 3 botime, QGJH: 10 botime) dhe llojit të botimit (E - artikull në revistë, A - artikull i veçantë, D - disertacion doktorate).
- ✓ Tabela 5.2 - Konferenca: Përfshin të dhëna të detajuara për të gjitha 84 pjesëmarrjet në aktivitete shkencore, duke specifikuar llojin e aktivitetit (A - referim ndërkombëtar, B - aktivitet organizues, C - kapitull, D - disertacion, E - konferencë kombëtare, F - prezantim, G - organizim eventi), emrin e pjesëmarrësit, pjesëmarrësit e tjerë, emërtimin e aktivitetit, vendin

e organizimit, datën e organizimit, titullin e botimit (nëse ka), dhe ISBN/ISSN të proceedings. Tabela është e organizuar sipas departamenteve dhe përfshin informacion të plotë për secilin event.

- ✓ Tabela 4 - Projekte të aplikuara dhe të fituara: Përfshin të dhëna për të gjitha projektet e aplikuara dhe të fituara gjatë vitit akademik 2024-2025, duke specifikuar titullin e projektit, drejtuesi i projektit, departamentin, institucionin financues, llojin e projektit, statusin (fitues/jo fitues), vlerën e financimit, dhe periudhën e ekzekutimit.
- ✓ Tabela mbi bashkëpunimet ndërinstitucionale: Përfshin të dhëna të detajuara për të gjitha bashkëpunimet me institucione vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare, duke specifikuar institucionin partner, llojin e bashkëpunimit, projektet e përbashkëta, personelin e angazhuar, dhe rezultatet e arritura.

3.5.1.6 Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

- ✓ Janë publikuar 22 artikuj dhe periodikë në revista shkencorë jashtë vendit.
- ✓ Eshtë realizuar pjesëmarrja me 63 referime në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca).
- ✓ 5 staf akademik përfaqësues në borde editoriale në revista shkencore
- ✓ 23 staf akademik pjesëmarrës në komitete organizative/shkencore (kombëtare/ndërkombëtare).
- ✓ 9 pjesëmarrje si Relator/Reçensues artikulli shkencor (Revistë kombëtare/Ndërkombëtare).

3.5.1.7 Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

Produktet e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara janë një pjesë e punës së përditshme të personelit akademik të FTI-së. Ato vijnë si rezultat i kërkimit shkencor, punës me studentët e ciklit të dytë dhe të tretë si dhe nga bashkëpunimi me universitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

Një punë që është për t'u vlerësuar në kuadrin e kërkimit shkencor është që stafi akademik dhe studentët e doktoratës, masterit shkencor dhe bachelorit kanë marrë pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe kanë realizuar botime në revista shkencore ndërkombëtare. Një pjesë e mirë e botimeve janë të një niveli dhe cilësie shumë të lartë, të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare me Faktor Impakti dhe me bord editorial.

- ✓ "KONFERENCA SOSE". Në datat 18-11 qershor 2025 FTI bashkë organizoi 20th Annual System of Systems Engineering Conference, SOSE në bashkëpunim me Universitetin e Genovas.
- ✓ Në datat 8–11 qershor 2025, FTI bashkë organizoi Konferencën Ndërkombëtare të 20-të Vjetore IEEE "System of Systems Engineering Conference" (SoSE 2025), e cila u mbajt për herë të parë në Shqipëri. Konferenca u mbajt në institucionin tonë dhe u bashkë organizua nga Universiteti i Genovës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Universitetin Politeknik të Tiranës, University of Texas at San Antonio (UTSA) dhe Université de Technologie de Compiègne.
- ✓ Këtë vit, konferenca u zhvillua në bashkërendim me programin Erasmus Mundus EMSSE – European Master in Systems Engineering, duke forcuar më tej lidhjet ndërmjet arsimit të lartë,

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Informacion më i hollësishëm mbi produktet në fushën e kërkimit shkencor, gjendet i pasqyruar në Tabelën nr. 5, Tabelën nr. 5.1, Tabelën nr. 5.2, Tabelën 5.3 dhe Tabelën 5.4 të paraqitura si shtojca të këtij raporti, si dhe në raportimet e aktiviteteve të njësive kryesore të UPT-së.




Figura 11: Aktivitete të kërkimit shkencore të organizuar/bashkëorganizuar në UPT.

Referuar aktiviteteve të kërkimit shkencore të organizuar/bashkëorganizuara nga njësitë kryesore të UPT-së, vërehet se numrin më të lartë të aktiviteteve e kryeson Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike me 36 aktivitete, pasuar nga IGJEO me 5 aktivitete, FAU dhe FTI me nga 4 aktivitete seicila, FIN me 3 dhe FGJM me 1 aktivitet.

E detajuar sipas tabelave 5.1-5.6 dhe të përshkruara në këtë raport.

3.5.2 Botime të aktivitetit shkencor të realizuara


Arritjet e aktiviteteve të kërkimit shkencor janë publikuar nga stafi i Universitetit Politeknik të Tiranës si tekste shkollore/universitare, monografi shkencore brenda dhe jashtë vendit, artikuj në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, për një total prej 249 botime të këtij lloji. Të paraqitura sipas përkatësisë në njësi kryesore të personelit akademik, të përmbledhura paraqiten në tabelën në vijim. Të detajuara si emërtime të punimeve dhe të autorëve, paraqiten në shtojcën e tabelës 5.1 në vijim të këtij raporti

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 5.1: Aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara si botime [3].

Botime	FAU	FGJM	FIE	FIM	FIMIF	FIN	FTI	IGJEO	Tot.
A: Tekste shkollore/universitare	0	0	0	1	0	0	0	0	**1**
B: Monografi shkencore brenda vendit	0	1	0	0	0	0	0	0	**1**
C: Monografi shkencore jashtë vendit	0	0	3	0	0	0	0	0	**3**
D: Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit	1	13	1	4	6	4	2	9	**40**
E: Artikuj dhe periodike në revista shkencorë jashtë vendit	16	33	11	44	87	18	18	22	**249**

Në grafikun vijues paraqiten në formë krahasuese kjo kategori botimesh, ku dukshëm dominojnë ato në periodikë shkencorë jashtë vendit.



	FAU	FGJM	FIE	FIM	FIMIF	FIN	FTI	IGJEO
A	0	0	0	1	0	0	0	0
B	0	1	0	0	0	0	0	0
C	0	0	3	0	0	0	0	0
D	1	13	1	4	6	4	2	9
E	16	33	11	44	87	18	18	22

Figura 12: Numri i botimeve të ndara në kategori si dhe për njësi kryesore të UPT

A: Tekste shkollore/universitare
B: Monografi shkencore brenda vendit
C: Monografi shkencore jashtë vendit
D: Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj)
E: Artikuj dhe periodike në revista shkencorë jashtë vendit

[3] Të detajuara, realizmi i botimeve paraqitet në Shtojcën e tabelës 5.1

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Nga sa më sipër, mund të themi se është botuar 1 tekst shkollor, nga stafi akademik i FIM.


Janë botuar 4 monografi shkencore, të ndara respektivisht në 1 monografi shkencore brenda vendit nga stafi akademik i FGJM dhe 3 monografi shkencore jashtë vendit e botuar nga staf akademik i FIE.

Artikuj në revista shkencore brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj) janë 40. Numrin më të madh të artikujve të botuar e zë FGJM me 13 artikuj, dhe vijohet me 9 artikuj nga IGJEO, 6 artikuj nga FIMIF, FIM dhe FIN me nga 4 artikuj seicila, 2 artikuj nga FTI, FAU dhe FIE me nga 1 artikull seicila.

Artikuj dhe periodikë në revista shkencore jashtë vendit janë realizuar 249. Numrin më të madh e kanë realizuar stafi akademik i FIMIF me 87 artikuj, ndiqet nga FIM me 44 artikuj, FGJM me 33 artikuj, IGJEO me 22 artikuj, FIN dhe FTI me nga 18 artikuj seicila, FAU me 16 artikuj.

Numrin më të madh të botimeve të realizuara në total për njësi kryesore e kanë FIMIF me 93 botime, FIM me 49 botime, FGJM me 47 botime, IGJEO me 31 botime, FIN me 22 botime, FTI me 20 botime, FAU me 17 botime dhe FIE me 15 botime.

Nëse grafikun e më sipërm do ta paraqesim si botime për staf, rezultati paraqitet në grafikun vijues.



	FAU	FGJM	FIE	FIM	FIMIF	FIN	FTI	IGJEO
A	0.00	0.00	0.00	0.02	0.00	0.00	0.00	0.00
B	0.00	0.02	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
C	0.00	0.00	0.09	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
D	0.03	0.25	0.03	0.07	0.09	0.07	0.05	0.35
E	0.42	0.63	0.33	0.77	1.28	0.30	0.44	0.85

Figura 13: Numri i botimeve për staf në seicilën njësi kryesore të UPT.

A: Tekste shkollore/universitare
B: Monografi shkencore brenda vendit
C: Monografi shkencore jashtë vendit
D: Artikuj në revista dhe periodike shkencorë brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj)
E: Artikuj dhe periodike në revista shkencorë jashtë vendit

Nga ku vërehet se Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, ka numrin më të lartë të botimeve për personel të kategorisë artikuj dhe periodike në revista shkencorë jashtë vendit, me një mesatare prej 1.28 botime në vit për seicilin personel akademik, i ndjekur nga IGJEO me 0.85 botime për personel akademik.

Botimet me autorësi/bashkëautorësi të huaj, në tërësinë e botimeve të realizuara në këtë kategori, zënë

95 botime kundrejt totalit pre 294, ose rreth 32%.

Në tabelën në vijim paraqitet ndarja sipas njësive kryesore të autorësisë/bashkëautorësis me kërkues të huaj.

Tabela: Botime të realizuara në bashkëpunim me kërkues të huaj..

Autorësia	FAU	FGJM	FIE	FIM	FIMIF	FIN	FTI	IGJEO
Autor I UPT/Bashkëautor huaj	0	0	3	8	8	1	2	2
Autor I huaj/Bashkëautor UPT	1	9	1	15	32	1	3	9
Autorësi UPT/kombëtar	16	39	11	25	53	20	15	20
% bashkautorësi e huaj	**6%**	**19%**	**27%**	**48%**	**43%**	**9%**	**25%**	**35%**

Këto të dhëna paraqiten edhe në figurën vijuese, ku dukshëm shohim se në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, 48% e botimeve kanë së paku një autor/bashkëautor të huaj. Trend i ndjekur me 43% nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.

Në këtë kuadër, fakultetet me numrin më të ulët të botimeve me autorësi/bashkëautorësi të huaj, janë Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës si dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.





Figura 14: Numri i botimeve në bashkëpunim me autorë të huaj.

Në këndvështrimin e ndërkombëtarizimit dhe për sa i përket kontributit në botime sipas llojit të autorësisë, në të gjitha njësitë kryesore të UPT-së dominon numri i botimeve në të cilat autor i parë është i huaj, ndërsa botimet në të cilat autori i parë është personel akademik nga njësitë kryesore të UPT-së dhe bashkëautori i huaj, paraqiten në numër më të kufizuar. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një nivel të lartë drejt bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht në FIMIF, pasuar nga FIM, IGJEO, etj.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

3.5.3 Pjesëmarrje në aktivitete kombëtare

Në vijim, paraqiten në formë grafike, aktivitetet e kërkimit shkencor në konferenca, simpoziume, kongrese kombëtare. Të detajuara këto aktivitete, paraqiten në Shtojcën e tabelës 5.2 në vijm.




	FAU	FGJM	FIE	FIM	FIMIF	FIN	FTI	IGJEO
E	2	1	4	12	10	34	2	2
F	0	0	0	0	3	0	0	0
G	0	0	0	1	1	2	0	3
GJ	0	0	0	2	0	0	0	1

Figura 15: Numri i aktiviteteve kombëtare në seicilën njësi kryesore të UPT.

E: Referime në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
F: Moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
G: Anëtare të Komitetit shkencor në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
Gj: Anëtare të Komitetit organizativ në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)

Nga pjesëmarrja në aktivitete me karakter kombëtar, mbizotëron angazhimi i stafit të FIN, si në vlerë absolute, ashtu edhe në përpjestim me numrin e stafit akademik të kësaj njësie kryesore.




	FAU	FGJM	FIE	FIM	FIMIF	FIN	FTI	IGJEO
E	0.05	0.02	0.12	0.21	0.15	0.56	0.05	0.08
F	0.00	0.00	0.00	0.00	0.04	0.00	0.00	0.00
G	0.00	0.00	0.00	0.02	0.01	0.03	0.00	0.12
GJ	0.00	0.00	0.00	0.04	0.00	0.00	0.00	0.04

Figura 16: Aktivitete ndërkombëtare për staf në seicilën njësi kryesore të UPT.

E: Referime në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
F: Moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
G: Anëtare të Komitetit shkencor në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
Gj: Anëtare të Komitetit organizativ në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)

3.5.4 Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare

Në vijim, paraqiten në formë grafike, aktivitetet e kërkimit shkencor në konferenca, simpoziume, kongrese ndërkombëtare. Të detajuara këto aktivitete, paraqiten në Shtojcën e tabelës 5.3 në vijm.



	FAU	FGJM	FIE	FIM	FIMIF	FIN	FTI	IGJEO
A	19	18	27	45	78	9	33	24
B	2	0	0	5	2	3	4	6
C	2	1	0	61	5	2	4	0
D	7	2	0	13	4	0	0	0

Figura 17: Aktivitete ndërkombëtare për seicilën njësi kryesore të UPT[4]

A: Referime në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
B: Moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
C: Anëtare të Komitetit shkencor në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
D: Anëtare të Komitetit organizativ në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)


- ✓ Për referime në aktivitete shkencore ndërkombëtare, kryeson Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike me 78 pjesëmarrje, i ndjekur nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike me 45 pjesëmarrje.
- ✓ Për moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare, kryeson IGJEO me 6 pjesëmarje, i ndjekur nga FIM me 5 pjesëmarrje.
- ✓ Si Anëtarë të Komitetit shkencor në aktivitete shkencore ndërkombëtare, kryeson FIM me 61 pjesëmarrje.
- ✓ Si Anëtare të Komitetit organizativ në aktivitete shkencore ndërkombëtare, kryeson FIM me 13 pjesëmarrje, i ndjekur nga FAU me 7 pjesëmarrje.

Referuar numrit të personelit akademik, për të njëjta aktivitete ndërkombëtare, rezultatet paraqiten në grafikun vijues, ku në këtë rast, kryeson Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike

[4] Të detajuara paraqiten në shtojcë e tabelës 5.3 në vijim të këtij raporti.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al


me një mesatare prej 1.15 referime ndërkombëtare për staf akademik, e ndjekur nga Instituti i Gjeoshkencave me 0.92 referime, pasuar nga FIE me 0.82 referime për staf akademik, etj.



	FAU	FGJM	FIE	FIM	FIMIF	FIN	FTI	IGJEO
A	0.50	0.35	0.82	0.79	1.15	0.15	0.80	0.92
B	0.05	0.00	0.00	0.09	0.03	0.05	0.10	0.23
C	0.05	0.02	0.00	1.07	0.07	0.03	0.10	0.00
D	0.18	0.04	0.00	0.23	0.06	0.00	0.00	0.00

Figura 18: Aktivitete ndërkombëtare për staf në secilën njësi kryesore të UPT.

A: Referime në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
B: Moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
C: Anëtare të Komitetit shkencor në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
D: Anëtare të Komitetit organizativ në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)



	FAU	FGJM	FIE	FIM	FIMIF	FIN	FTI	IGJEO
A	19	18	27	45	78	9	33	24
B	2	0	0	5	2	3	4	6
C	7	1	0	61	5	2	4	0
D	0	2	0	13	4	0	0	0
E	2	1	4	12	10	34	2	0
F	0	0	0	0	3	0	0	0
G	0	0	0	1	1	2	0	3
GJ	0	0	0	2	0	0	0	1

Figura 19: Aktivitete kombëtare/ndërkombëtare për njësi kryesore të UPT.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

A: Referime në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
B: Moderator në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
C: Anëtare të Komitetit shkencor në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
D: Anëtare të Komitetit organizativ në aktivitete shkencore ndërkombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
E: Referime në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
F: Moderator në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
G: Anëtare të Komitetit shkencor në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)
GJ: Anëtare të Komitetit organizativ në aktivitete shkencore kombëtare (seminare, kongrese, konferenca)

Gjatë vitit akademik 2024-2025, personeli akademik i UPT-së ka marrë pjesë në 452 aktivitete shkencore kombëtare/ndërkombëtare. Me numrin më të lartë të pjesëmarrjes së personelit akademik në aktivitetet e mësipërme rezulton FIM me 139 pjesëmarrje, pasuar nga FIMIF me 103 pjesëmarrje, FIN me 50 pjesëmarrje, FTI me 43 pjesëmarrje, IGJEO me 34 pjesëmarrje, FIE me 31 pjesëmarrje, FAU me 30 pjesëmarrje dhe FGJM me 22 pjesëmarrje.

Për sa i përket numrit të pjesëmarrjeve për aktivitet shkencor, vihet re se numri më i lartë i pjesëmarrjes së personelit akademik është në "Referime në aktivitete shkencore ndërkombëtare" me 253 pjesëmarrje, ndërsa numri më i ulët i pjesëmarrjes së personelit akademik është në "Moderator në aktivitete shkencore kombëtare" dhe "Anëtare të Komitetet organizativ në aktivitete shkencore kombëtare", me 3 pjesëmarrje në seicilën.

3.5.5 Pjesëmarrje si anëtarë të bordit editorial në revista shkencore/botime

Të dhënat e pjesëmarrjes së personelit akademik nga njësitë kryesore si anëtar të bordeve editoriale, paraqiten në shtojcën e tabelës 5.4 në vijim të këtij raporti.





Figura 20: Pjesëmarrje në borde editoriale dhe recensa periodikësh shkencor.

A: Revista kombëtare
B: Revista ndërkombëtare
C: Libra/monografi botuar brenda vendit
D: Libra/monografi botuar jashtë vendit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS · REKTORATI · SEKRETARIA

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al



	FGJM	FIE	FIM	FIMIF	FIN	FTI	IGJEO
A	0.06	0.03	0.44	0.01	0.07	0.00	0.08
B	0.02	0.12	0.35	0.04	0.07	0.15	0.08
D	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.02	0.00

Figura 21: Pjesëmarrje në borde editoriale dhe recensa periodikësh shkencor për staf.

A: Revista kombëtare
B: Revista ndërkombëtare
C: Libra/monografi botuar brenda vendit
D: Libra/monografi botuar jashtë vendit


Numri më i lartë i pjesëmarrjes së personelit akademik si anëtarë të Bordit Editorial vihet re në "Revista kombëtare" me 36 pjesëmarrje në total për UPT, 25 nga të cilat nga personeli akademik i FIM dhe numrin më i ulët i pjesëmarrjes së personelit akademik si anëtarë të Bordit Editorial vihet re në "Libra/monografi botuar jashtë vendit" me 1 pjesëmarrje në total për UPT, nga FTI.

Personeli akademik i FIM rezulton të ketë pjesëmarrje më të lartë si anëtarë të bordit editorial në revista shkencore/botime me 45, pasuar nga FIN me 8 pjesëmarrje, FTI me 7, FIE me 5 dhe FGJM, FIMIF dhe IGJEO me nga 4 pjesëmarrje seicila.

3.5.6 Pjesëmarrje në Komitete organizative/Shkencore (Kombëtare/Ndërkombëtare)

Të dhënat e pjesëmarrjes së personelit akademik nga njësitë kryesore si anëtar të bordeve editoriale, paraqiten në shtojcën e tabelës 5.5 në vijim të këtij raporti.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al




	FGJM	FIE	FIMIF	FIN	FTI	IGJEO
A	0	0	1	16	1	0
B	1	1	2	1	8	4
D	0	5	0	0	0	0

Figura 22: Pjesëmarrje në Komitete Organizative/Shkencore.

A: Komitete organizative kombëtare
B: Komitete organizative ndërkombëtare

Numrin më të lartë të pjesëmarrjeve në komitete organizative/shkencore e ka personeli akademik i FIN me 17, pasuar nga FTI me 9 pjesëmarrje, FIE me 6, IGJEO me 4, FIMIF me 3 dhe FGJM me 1 pjesëmarrje.



	FGJM	FIE	FIMIF	FIN	FTI	IGJEO
A	0.00	0.00	0.01	0.26	0.02	0.00
B	0.02	0.03	0.03	0.02	0.20	0.15
D	0.00	0.15	0.00	0.00	0.00	0.00

Figura 23: Pjesëmarrje në Komitete Organizative/Shkencore.


A: Komitete organizative kombëtare
B: Komitete organizative ndërkombëtare

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI POLITEKNIK TIRANËS REKTORATI SEKRETARIA

Referuar numrit të personelit akademik, për të njëjtat pjesëmarrje në komitete organizative/shkencore kombëtare/ndërkombëtare, rezultatet paraqiten në grafikun vijues, ku në këtë rast, kryeson Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me 0.28 pjesëmarrje, e ndjekur nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit me 0.22 pjesëmarrje për staf akademik.

3.5.7 Pjesëmarrje si Relator/Reçensues artikulli shkencor Revistë

Të dhënat e pjesëmarrjes së personelit akademik nga njësitë kryesore si anëtar të bordeve editoriale, paraqiten në shtojcën e tabelës 5.6 në vijim të këtij raporti.




	FGJM	FIE	FIM	FIN	FTI	IGJEO
A	3	0	0	0	0	1
B	0	0	0	0	1	0
C	2	1	4	3	2	1
D	0	3	69	6	4	0
E	0	0	4	0	0	0

Figura 24: Pjesëmarrje si relator/reçensues .

A: Relator artikulli shkencor në revistë kombëtare
B: Relator artikulli shkencor në revistë ndërkombëtare
C: Reçensues artikulli shkencor në revistë kombëtare
D: Reçensues artikulli shkencor në revistë ndërkombëtare
E: Reçensues Projektesh kombëtare

Numrin më të lartë të pjesëmarrjes si relator/reçensues artikulli shkencor e ka personeli akademik i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike me 77, pasuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me 9 pjesëmarrje.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al



	FGJM	FIE	FIM	FIN	FTI	IGJEO
A	0.06	0.00	0.00	0.00	0.00	0.04
B	0.00	0.00	0.00	0.00	0.02	0.00
C	0.04	0.03	0.07	0.05	0.05	0.04
D	0.00	0.09	1.21	0.10	0.10	0.00
E	0.00	0.00	0.07	0.00	0.00	0.00


Figura 25: Pjesëmarrje si relator/reçensues .

A: Relator artikulli shkencor në revistë kombëtare
B: Relator artikulli shkencor në revistë ndërkombëtare
C: Reçensues artikulli shkencor në revistë kombëtare
D: Reçensues artikulli shkencor në revistë ndërkombëtare
E: Reçensues Projektesh kombëtare

Duke ju referuar pjesëmarrjes si relator/reçensues për staf, numrin më të lartë vihet re tek Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike me 1.35, pasuar nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit me 0.17 pjesëmarrje për staf.

3.5.8 Pjesëmarrje në workshope/seminare


Të dhënat e pjesëmarrjes së personelit akademik nga njësitë kryesore si anëtar të bordeve editoriale, paraqiten në shtojcën e tabelës 5.7 në vijim të këtij raporti.



	FAU	FGJM	FIE	FIM	FIN	FTI	IGJEO
A	6	0	2	66	6	0	2
B	13	3	1	57	0	13	29
C	1	0	0	40	0	1	3
D	7	1	0	93	1	0	4

Figura 26: Pjesëmarrje në workshope/seminare .

A: Workshope kombëtare
B: Workshope ndërkombëtare
C: Seminare kombëtare
D: Seminare ndërkombëtare



	FAU	FGJM	FIE	FIM	FIN	FTI	IGJEO
A	0.16	0.00	0.06	1.16	0.10	0.00	0.08
B	0.34	0.06	0.03	1.00	0.00	0.32	1.12
C	0.03	0.00	0.00	0.70	0.00	0.02	0.12
D	0.18	0.02	0.00	1.63	0.02	0.00	0.35

Figura 27: Pjesëmarrje në workshope/seminare .

A: Workshope kombëtare
B: Workshope ndërkombëtare
C: Seminare kombëtare
D: Seminare ndërkombëtare

Referuar pjesëmarrjes në workshope/seminare, "Seminare ndërkombëtare", numri më i lartë verehet në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike me 93 pjesëmarrje, pasuar nga Instituti i Gjeoshkencave me 9 pjesëmarrje.

Në workshope/seminare, kombëtare/ndërkombëtare, kryeson Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike me 256 pjesëmarrës, pasuar nga Instituti i Gjeoshkencave me 43, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës me 27, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit me 14, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me 7, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave me 4 dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike me 3 pjesëmarrës.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

4 INFRASTRUKTURA NË SHËRBIM TË KËRKIMIT SHKENCOR

Infrastruktura në shërbim të kërkimit shkencor në UPT, vit pas viti është përmirësuar dukshëm, si me fuqizimin e laboratorëve ekzistues me pajisje të reja, ashtu edhe me krijimin e laboratorëve të rinj. Gjithashtu, si pjesë integrale e kërkimit shkencor është edhe fondi i bibliotekës i cili pasurohet në mënyrë të vazhduar vite pas viti.

4.1 BIBLIOTEKA SHKENCORE QENDRORE

MISIONI: Biblioteka Shkencore e Universitetit Politeknik është institucion kulturor dhe informues dhe e ushtron veprimtarinë e vet në mbështetje dhe shërbim të Procesit Mësimor, Edukativ, të Formimit Profesional dhe të Veprimtarisë Kërkimore Shkencore të Universitetit Politeknik të Tiranës. Biblioteka mbështet studentët dhe stafin akademik në punën shkencore përmes sigurimit të informacionit në fushat e interesit të tyre. B.Sh. është një nga bibliotekat më të rëndësishme universitare në vend dhe qendër kërkimore shkencore e mirëfilltë, jo vetem përsa i përket krijimit dhe pasurimit te koleksioneve të B. Sh, me literaturë bashkëkohore me profil tekniko – shkencore kryesisht/dhe jo vetëm, (në gjuhën shqipe por dhe në gjuhë të huaj) në mbështetje realizimit të procesit mësimor/programeve studimore ne nivel institucional dhe punës kërkimore shkencore në UPT, por edhe për, informimin, promovimin dhe zhvillimin e kërkimit shkencor në UPT.

B.SH. konsiderohet institucion me karakter shkencor, sepse grumbullon dhe ruan të gjithë trashëgiminë kërkimore shkencore të shkruar të personelit akademik e kërkimor të UPT-së, si edhe personelit kërkimor të instituteve të tjera të kërkim zhvillimit, të botuara brenda dhe jashtë vendit. Funksionet e saj janë:

- ✓ Depoziton dhe ruan botimet me karakter tekniko-shkencor, në gjuhen shqipe/të huaj.
- ✓ Krijon bibliografi tematiko – shkencore, vjetore, etj.
- ✓ Depoziton dhe ruan dizertacionet dhe tekstet mësimore (dispenca), periodikë shkencore dhe të gjitha botimeve me karakter tekniko shkencor të të gjithë personelit akademik e më gjerë, që kur është themeluar UPT në Arkivën Shkencore.
- ✓ Shpërndan dhe promovon Organet Botuese të UPT-së (Buletini i Shkencave Teknike, UPT).
- ✓ Shpërndan materialet që përfaqësojnë zhvillimet studimore, kërkimore shkencore etj., të Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe më gjerë, në të gjitha bibliotekat brenda dhe jashtë vendit me të cilat ka marrëdhënie shkëmbimi mbi bazën e reciprocitetit.

4.1.1 Analizë e aktivitetit të bibliotekës shkencore

Objektivat kryesore ku mbështetet veprimtaria e Bibliotekës Shkencore:

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë; Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ✓ Përpunimi standard i materialeve bibliotekare që hyjnë në bibliotekë.
- ✓ Përgatitja dhe shpërndarja e informacionit bibliotekar – bibliografik.
- ✓ Krijimit dhe mirëmbajtja e katalogut përmbledhës të pasurisë bibliotekare kombëtare dhe asaj të huaj.
- ✓ Sigurimi nëpërmjet marrëdhënieve të shkëmbimit ndërbibliotekar, projekteve dhe dhurimeve, i botimeve me vlera profesionale në fushat e shkencave teknike që nuk mund të mundësohen nëpërmjet blerjes me fonde buxhetore të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit.

Biblioteka Shkencore - Qendër, e pozicionuar pranë UPT-së, (Sheshi: "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë), ka pjesë përbërëse të strukturës së saj: Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Bibliotekën e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, si dhe Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, pasurimi i të cilave me literaturë të re nëpërmjet blerjes, shkëmbimit ndërbibliotekar, dhurimeve etj., kryhet nga Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve, pranë B.SH. Aktiviteti i Bibliotekës Shkencore mbështetet mbi shërbime të cilat i kryejnë të gjitha bibliotekat, pavarësisht nga lloji i tyre: Shërbimet Teknike dhe Shërbimet për Përdoruesit e saj: studentë, staf akademik, studiues, etj.

Analiza e veprimtarisë së Bibliotekës Shkencore në vijim, mbështetet mbi raportet e bëra nga çdo sektor/bibliotekë dhe është analizuar në vijim në këtë raport.

4.1.1.1 Zhvillimi i koleksioneve të Bibliotekës Shkencore

Pasurimi i koleksioneve të Bibliotekës Shkencore - Qendër, dhe atyre të degëve në varësi të saj: Bibliotekës së Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Bibliotekës së Fakultetit të Gjeologjisë dhe i Minierave, si dhe Bibliotekës së Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike me literaturë me karakter tekniko-shkencore, (gjuhën shqipe & huaj; libra dhe periodikë), në përgjigje të plotësimit të kërkesave/nevojave të përdoruesve të Bibliotekës Shkencore (studentë, staf akademik, etj.) me literaturë, në ndihmë të zhvillimit të procesit mësimor & plotësimit të nevojave studimore të UPT-së si institucion.

Biblioteka Shkencore bashkëpunon me të gjitha fakultetet e UPT-së, kur harton programin e blerjes së literaturës, për të garantuar cilësi të koleksioneve të saj, në kontekst të përmbajtjes shkencore së një libri/materiali: risive që ato sjellin, zbatueshmërisë, etj., duke iu kërkuar atyre si rekomandime për pasurimin e koleksioneve të B.Sh., listat e titujve të literaturës (të miratuara këto në bazë të kurrikulave pranë dekanateve të fakulteteve), të cilat nevojiten për t'i ardhur në ndihmë zhvillimit të procesit mësimor, plotësimit të nevojave studimore të studentëve apo në mbështetje të punës kërkimore – shkencore të stafit akademik e më gjerë.

Gjithashtu, biblioteka ka kriteret e veta të përzgjedhjes së literaturës, të cilat garantojnë cilësi të koleksioneve në tërësi (përsa i përket vitit të botimit, shtëpisë botuese prestigjioze, kredibilitetit dhe kontributit të një autori të caktuar në një fushë të caktuar, ISBN etj.).

Pra, pasurimi dhe zhvillimi i koleksioneve të bibliotekës me literature të re apo retrospektive, realizohet në bazë të kërkesave dhe nevojave që përdoruesit e saj (studentë, staf akademik, kërkues shkencore, përdorues të jashtëm) dëshirojnë të kenë, në përshtatje me kërkesat arsimore, shkencore dhe kulturore të tyre.

Objektiva të realizuara:

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ✓ Pasurimi i koleksioneve të Bibliotekës Shkencore-Qendër, dhe atyre të degëve në varësi të saj: bibliotekës FIN, FGJM, si dhe bibliotekës FIM &FIF me literaturë me karakter tekniko-shkencore, (gjuhën shqipe & huaj; libra dhe periodikë), nëpërmjet blerjes, dhurimeve, si dhe shkëmbimeve bibliotekare brenda dhe jashtë vendit.
- ✓ Pasurimi i Bibliotekës Shkencore me tituj të rinj.
- ✓ Rritja e cilësisë së koleksioneve të bibliotekës në mbështetje të realizimit të programeve mësimore akademike dhe atyre për kërkime shkencore në UPT.
- ✓ Pasurimi korent dhe retrospektiv i arkivës shkencore të bibliotekës me botimet e reja/bashkëkohore/retrospektive bazuar në legjislacionin përkatës dhe në kriteret e pasurimit të këtij koleksioni, disertacione dhe tituj të rinj shkencorë.
- ✓ Zgjerimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërbibliotekar brenda dhe jashtë vendit me bibliotekat universitare private dhe shtetërore, për sigurimin e botimeve me vlera profesionale në fushat e shkencave teknike.
- ✓ Shpërndarja dhe promovimi i revistave shkencore që përfaqësojnë zhvillimet studimore, kërkimore shkencore etj, të Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe më gjerë, në të gjitha bibliotekat brenda dhe jashtë vendit me të cilat ka marrëdhënie shkëmbimi mbi bazën e reciprocitetit. ("Buletini i shkencave" 'JNTS-Journal of Natural and Technical Sciences', "Journal of the Albanian Young Academy") etj.

Numri total i Zhvillimit të Koleksioneve për vitin 2025 nëpërmjet blerjes, dhurimeve, si dhe shkëmbimeve bibliotekare brenda dhe jashtë vendit është si më poshtë vijon:

Tabela: Zhvillimi i koleksioneve në B.Sh.

Nr.	EMËRTIMI	GJITHSEJ				NGA KËTO:												Vlera
		NJËSI	TITUJ	NGA KËTO		BIBLIOTEKA SHKENCORE QENDËR			DEGË TË BIBLIOTEKËS SHKENCORE									Lekë
									BIBLIOTEKA FIN			BIBLIOTEKA FGJM			BIBLIOTEKA FIM& FIF			
				Shkencor	Shoqëror	Sasi	Tituj	Vlera	Sasi	Tituj	Vlera	Sasi	Tituj	Vlera	Sasi	Tituj	Vlera	
	LITERATURA GJITHSEJ (I + II)	**196**	**118**	**118**		**111**	**81**		**66**	**37**		**19**	**9**		**-**	**-**	**-**	
I	**LIBRA GJITHSEJ A+ B** *Gjuhë Shqipe & Gjuhë të Huaj Blerje & Shkëmbim, Dhurim & Projekte*	**143**	**100**	**100**		**72**	**69**		**61**	**34**		**10**	**5**		**-**	**-**	**-**	
A	**LIBRA NË GJUHËN SHQIPE**	**49**	13	13		12	11		33	7		4	1		-	-	-	
B	**LIBRA NË GJUHË TË HUAJ**	**94**	87	87		60	58		28	27		6	4		-	-	-	
II	**PERIODIK GJITHSEJ A+ B** *Gjuhë Shqipe & Gjuhë të Huaj Blerje & Shkëmbim, Dhurim & Projekte*	**53**	**18**	**18**		**39**	**12**		**5**	**3**		**9**	**4**		**-**	**-**	**-**	
A	**PERIODIK NË GJUHËN SHQIPE**	**6**	3	3		1	1		3	2		2	1		-	-	-	
B	**PERIODIK NË GJUHË TË HUAJ**	**47**	15	15		38	11		2	1		7	3		-	-	-	

Literature gjithsej: 196 Njësi /Copë 118 Tituj

Libra gjithsej 143 Njësi /Copë 100 Tituj

Periodike gjithsej: 53 Njësi /Copë 18 Tituj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS REKTORATI SEKRETARIA

4.1.2 Pasurimi i Bibliotekës Shkencore nëpërmjet blerjes

Përzgjedhja e materialeve bibliotekare për hartimin e programit të blerjes së tyre, është bërë në bashkëpunim me të gjitha dekanatet/departamentet e fakulteteve, në mënyrë që Biblioteka Shkencore t'i përgjigjet sa më gjerë kërkesave studimore të institucionit të cilit i shërben, duke plotësuar në këtë mënyrë edhe objektivat e veta si institucion që lidhen me shërbimin ndaj përdoruesve të tyre.

Ajo ka marrë parasysh të gjitha kërkesat e fakulteteve në fjalë për përzgjedhjen e literaturës, duke iu kërkuar atyre në formë shkresore dhe e-mail listat e titujve/literaturës (të miratuara këto në bazë të kurrikulave pranë dekanateve të fakulteteteve), si rekomandime për pasurimin e koleksioneve të B.Sh, të cilat nevojiten për t'i ardhur në ndihmë zhvillimit të procesit mësimor, plotësimit të nevojave studimore të studentëve dhe në mbështetje të punës kërkimore – shkencore të stafit akademik e më gjerë.

Bazuar tek kërkesat e ardhura nga Fakultetet e UPT-së, programi 2025 është orientuar në politikën e pasurimit të koleksioneve të Bibliotekës Shkencore kryesisht me tituj të rinj profesionalë në gjuhë të huaj, (duke qenë se edhe kërkesat e ardhura prej gjithë fakulteteve të UPT-se kanë qenë për këtë literaturë),- edhe por edhe me tituj të rinj dhe retrospektive në gjuhën shqipe gjithashtu.

Programi për pasurimin e BSH për vitin 2025, u hartua duke u bazuar në:

- ✓ Rekomandimet për pasurim/Kërkesat e ardhura për literaturë nga Fakultetet/Departamentet/ Bibliotekat pranë Fakulteteve të cilat plotësojnë kriteret për nevoja studimore: në ndihmë të zhvillimit të procesit mësimor & plotësimit të nevojave studimore të studentëve të UPT-së.
- ✓ Rekomandimet nga fakultetet për pasurimin e bibliotekës, kanë ardhur kryesisht nga: FGJM, FIM, FTI, FIN dhe FAU.
- ✓ Kërkesat e ardhura për literaturë nga studentët/përdoruesit e bibliotekës, të cilat relatohen me shkrim nga përgjegjësit e Sektorëve të Shërbimit të të gjithë degëve/bibliotekave të B.SH. për plotësimin e nevojave të tyre.
- ✓ Janë marrë në konsideratë publikimet e reja profesionale të stafit akademik të UPT-së, të profilit tekniko- shkencor, të cilat plotësojnë kriteret për nevoja studimore në të gjitha nivelet e studimeve në UPT, për t'u bërë pjesë e koleksioneve tona. (Pjesë e Arkivës Shkencore të botimeve profesionale të stafit akademik & Pjesë e Fondeve të Shërbimit).
- ✓ Kërkesat për literaturë që bibliotekat homologe të vendeve të ndryshme të botës me të cilat kemi marrëdhënie shkëmbimi ndërbibliotekare, bëjnë për botimet tona: libra / periodikë.
- ✓ Për të siguruar cilësi të koleksioneve të bibliotekës janë mbajtur parasysh kriteret e përzgjedhjes së literaturës:
  - ❖ Vitit të botimit të tyre, shtëpisë botuese prestigjioze, kredibilitetit dhe kontributit të një autori të caktuar në një fushë të caktuar, ISBN etj.), të cilat përbëjnë specifikimet teknike të literaturës.
  - ❖ Subjektit/lëndorit të gjerë të një libri që mund t'i shërbejë disa fushave të dijes/shkencës, fushave ndërdisiplinare: i njëjti libër kërkohet nga dy profile studimi/fakultete.
  - ❖ I është dhënë përparësi pasurimit të koleksioneve bibliotekare nëpërmjet marrëdhënieve të shkëmbimit ndërbibliotekar; në bazë të kërkesave për literaturë që bibliotekat homologe të

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

vendeve të ndryshme bëjnë për botimet tona, kryesisht libra për këtë vit. (Nga kjo politikë bashkëpunimi Biblioteka Shkencore siguron pasurim të koleksioneve të saj me literaturë bashkëkohore në gjuhë të huaj, në fushën e shkencës/teknikës, që nuk mund të mundësohen nëpërmjet blerjes p.sh "Library of Congress", Amerikë, etj.).

Realizimi i programit me blerje për pasurimin e bilbliotekës me literaturë, është si më poshtë vijon: (Tabela 2).

Tabela: Pasurimi i bibliotekës shkencore me literaturë për vitin 2025, me blerje.

Tabela 2

PASURIMI I BIBLIOTEKËS SHKENCORE ME LITERATURË PËR VITIN 2025 , ME BLERJE																				
Nr.	EMËRTIMI	GJITHSEJ				NGA KËTO:													Vlera	
		NJËSI	TITUJ	NGA KËTO		BIBLIOTEKA SHKENCORE QENDËR			DEGË TË BIBLIOTEKËS SHKENCORE											Lekë
									BIBLIOTEKA FIN			BIBLIOTEKA FGJM			BIBLIOTEKA FIM& FI					
				Shkenco	Sh	Sasi	Tituj	Vlera	Sasi	Tituj	Vlera	Sasi	Tituj	Vlera	Sasi	Tituj	Vlera			
Σ	LITERATURA GJITHSEJ (I + II)	74	46	46		23	23		50	25		1	1							
I	LIBRA GJITHSEJ A+ B *Gjuhë Shqipe & Gjuhë të Huaj*	74	46	46		23	23		50	25		1	1							
A	LIBRA NË GJUHËN SHQIPE	33	5	5		3	3		30	5										
B	LIBRA NË GJUHË TË HUAJ	41	41	41		20	20		20	20		1	1							
II	PERIODIK GJITHSEJ A+ B *Gjuhë Shqipe & Gjuhë të Huaj*																			
A	PERIODIK NË GJUHËN SHQIPE																			
B	PERIODIK NË GJUHË TË HUAJ																			

Literature gjithsej: 74 Njësi /Copë 46 Tituj Vlerë: ALL

Libra në gjuhën shqipe/të huaj: 74 Njësi /Copë 46 Tituj Vlerë: ALL

Libra në gjuhën shqipe: 33 Njësi /Copë 5 Tituj Vlerë: ALL

Libra në gjuhë të huaj: 41 Njësi /Copë 41 Tituj Vlerë: ALL

Është e rëndësishme të përmendim se programi i blerjes së literaturës u realizua sipas parashikimeve dhe kërkesave të ardhura për to. Biblioteka Shkencore arriti të plotësojë të gjitha objektivat dhe kërkesat studimore të UPT-së si institucion.

4.1.3 Pasurimi i Bibliotekës Shkencore nëpërmjet shkëmbimeve ndërbibliotekare

Numri total i zhvillimit të koleksioneve për vitin 2025, nëpërmjet Shkëmbimeve Ndërbibliotekare të literaturës, brenda dhe jashtë vendit, është si më poshtë vijon: (Tabela 3).

Tabela: Pasurimi i bibliotekës shkencore me literaturë për vitin 2025, nëpërmjet shkëmbimeve.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 3

PASURIMI I BIBLIOTEKËS SHKENCORE ME LITERATURË PËR VITIN 2025
NËPËRMJET SHKËMBIMEVE NDËRBIBLIOTEKARE

Nr.	EMËRTIMI	GJITHSEJ			NGA KËTO:														Vlera
		NJËSI	TITUJ	NGA KËTO:		B.SH. Qendër			FIN			GJ-M			Arkivi				
				Shkenco	Shc	Sasi	Tituj	Vlerë	Sasi	Tituj	Vlerë	Sasi	Titu	Vlerë	Sasi	Tituj	Vlerë		Lekë
Σ	LITERATURA GJITHSEJ (I-IV)	89	55	55	-	73	46	165600	5	4	8200	10	5	25464	1	1	732		199996
I	LIBRA ME SHKËMBIM GJITHSEJ (A+ B)	39	39	39	-	35	35	118500	3	3	6800	1	1	2000	-	-	-		127300
A	LIBRA NË GJUHËN SHQIPE	-	-	-		-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
B	LIBRA NË GJUHË TË HUAJ	39	39	39	-	35	35	118500	3	3	6800	1	1	2000	-	-	-		127300
II	PERIODIK ME SHKËMBIM GJITHSEJ (A+ B)	50	16	16		38	11	47100	2	1	1400	9	4	23464	1	1	732		72696
A	PERIODIK NË GJUHËN SHQIPE	3	1	1	-	-	-	-	-	-	-	2	1	1464	1	1	732		2196
B	PERIODIK NË GJUHË TË HUAJ	47	15	15	-	38	11	47100	2	1	1400	7	3	22000	-	-	-		70500

Literature gjithsej: 89 Njësi /Copë 55 Tituj Vlerë: 199,996 ALL

Libra në gjuhën shqipe/të huaj: 39 Njësi /Copë 39 Tituj Vlerë: 127,300 ALL

Libra në gjuhën shqipe: - Njësi /Copë - Titull Vlerë: - ALL

Libra në gjuhë të huaj: 39 Njësi /Copë 39 Tituj Vlerë: 127, 300 ALL

Revista / Peridike gjithsej: 50 Njësi /Copë 16 Tituj Vlerë: 72,696 ALL

Revista në gjuhën shqipe: 3 Njësi /Copë 1 Titull Vlerë: 2,196 ALL

Revista në gjuhë të huaj: 47 Njësi /Copë 15 Tituj Vlerë: 70,500 ALL

Të gjithë titujt e librave dhe revistave janë tituj me karakter tekniko-shkencor.

Theksojmë se në kuadër të pasurimit të Bibliotekës Shkencore me literaturë të re, me profil tekniko-shkencor Biblioteka zhvillon marrëdhënie shkëmbimi brenda dhe jashtë vendit, me vendet si me poshtë vijon:

- ✓ Jashtë vendit:

  Me 9 shtete: SHBA; Gjermani, Itali, Bullgari, Rumani, Çeki, Zvicër, Japoni dhe Serbi.

  Me 18 biblioteka të huaja, si: Ville de Geneve: Museum D'Histoire Naturelle, Geneve, Switzerland; Bibliotheque Academie Serbe des Sciences et des Arts, Beograd, Serbia; Biblioteca Academia Romana, Bukuresht, Rumania; Universitätsbibliothek Stuttgart, Germany; Universitätsbibliothek und TIB, Hannover, Germany; The Library of Congress, Washington, USA; The Central Library of the Bulgarian Academy of Sciences, Bulgaria University of Toyama, Japan etj.

- ✓ Brenda vendit:

  Biblioteka e Universitetit F. Noli Korçë, Biblioteka Univerisitare Ismail Qemali, Vlorë, Biblioteka Kombëtare Tiranë, me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, Tiranë, Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, Akademinë e Shkencave, etj.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Sektori i Zhvillimit të Koleksioneve po punon për të zhvilluar akoma më gjerë marrëdhëniet e shkëmbimit brenda dhe jashtë vendit me bibliotekat universitare private dhe shtetërore, për bashkëpunim të mëtejshëm për sigurimin e literaturës me profil tekniko-shkencor. Krahas pasurimit të B.SH. me koleksione fizike, ajo ka arritur të sigurojë edhe burime online free access (pa pagesë), libra dhe revista.

4.1.3.1 Pasurimi i bibliotekës me nëpërmjet shkëmbimit jashtë vendit:

Të gjithë titujt e librave dhe revistave me të cilat është pasuruar Biblioteka Shkencore si dhe degët e saj (Biblioteka e Fakultetit Inxhinierisë së Ndertimit, Biblioteka e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave, etj.), nëpërmjet shkëmbimit ndërbibliotekar jashtë vendit, për vitin 2025, janë siguruar si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me 16 biblioteka të huaja gjithsej, prej të cilave dallojmë (tabela 3):

- ✓ "Central Library of Bulgarian Academy of Science", Bullgari: gjithsej 23 copë/ 5 tituj,
- ✓ Library of Congress në Amerike: gjithsej: 16 copë/16 tituj,
- ✓ Biblioteka Universitare Stuttgart në Gjermani: 12 copë/ 12 tituj,
- ✓ Universitaetsbibliothek"Georgius Agricola" der Technischen Universitat bergakademie, Freiberg : Bibliotekën Teknike Universitare Freiberg, Gjermani: gjithsej: 8 copë/ 8 tituj,
- ✓ Senckenberg Research Institute and Natural History Museum Frankfurt: 4 copë/ 1titull,
- ✓ Central Research and Technical Library, Bullgari: 8 copë/ 1 titull,
- ✓ University of Toyama, Japoni: 2 copë/ 1titull,
- ✓ Etj.

Librat dhe revistat në fjalë, të përzgjedhura me kujdes nga biblioteka jonë janë botime të viteve të fundit, 2016, 2017, 2020, 2021 dhe 2022, 2023, 2024, 2025, në fushat e shkencave teknike dhe inxhinierike që zhvillohen në UPT. Si të tilla, këto libra i shërbejnë në radhë të parë studentëve, por edhe pedagogëve e studiuesve të tjerë për procesin e mësimdhënies, kërkimin shkencor, për zhvillimin profesional, etj.

Për pjesën më të madhe të librave të ardhura në kuadër të shkëmbimit ndërbibliotekar, vendin kryesor e kanë zënë shkëmbimet me bibliotekat e gjashtë vendeve të mëposhtme:

- ✓ **Amerike:** 16 njësi/tituj ku mbizoteron shkembimi me:
- ✓ Bibliotekën "The Library of Congress", Washington, SHBA. Librat që kemi marrë i shërbejnë kryesisht fushave inxhinierike sidomos asaj Mekanike, të Inxhinierisë së Ndërtimit, Gjeologji dhe Miniera, Arkitekturës, etj. Në këtë bibliotekë kemi dërguar revistën tonë Buletini i Shkencave Teknike, JNTS-Jounal of Natural and Technical Sciences, & Buletini i Shkencave Gjeologjike, librin "Rritja e naftënxjerrjes me aplikimin e metodave të veprimit në shtresë", botim i vitit 2025, me autorë Sotir Tego dhe Lusjen Ismaili në kuadër të shkëmbimit ndërbibliotekar, si dhe libra me karakter shoqëror.
- ✓ Biblioteka Universitare "Georgius Agricola", Freiberg, Gjermani: 8 njësi/ tituj. Këto libra i shërbejnë kryesisht fushave inxhinierike sidomos asaj Mekanike, të Inxhinierisë së Ndërtimit, Gjeologji dhe Miniera. Në këtë bibliotekë kemi dërguar revistën tonë Buletini i Shkencave

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Teknike, librin "Rritja e naftënxjerrjes me aplikimin e metodave të veprimit në shtresë", botim i vitit 2025, me autorë Sotir Tego dhe Lusjen Ismaili si dhe librin "Oil and Gas in Eastern Albania", botim i vitit 2024, me autorë Vangjel Kici në kuadër të shkëmbimit ndërbibliotekar.

- ✓ Biblioteka Universitare Stuttgart, Gjermani: 10 njësi/10 tituj. Këto libra i shërbejnë kryesisht kryesisht fushave inxhinierike sidomos asaj mekanike, teknologjisë së informacionit dhe matematikë-fzikës. Në këtë bibliotekë kemi dërguar librin " Modernisation and Globalization New paradigms in architecture, city, territory", botim i vitit 2021, me autorë Florian Nepravishta, Andrea Maliqari në kuadër të shkëmbimit ndërbibliotekar.

Në kuadër të shkëmbimit ndërbibliotekar, vendin kryesor e kanë zënë shkëmbimet me bibliotekat e shtatë vendeve të mëposhtme:

- ✓ ***Bullgari:*** 31 njësi, 6 tituj, ku mbizotëron shkëmbimi me:
  - ❖ Bibliotekën "The Central Library of the Bulgarian Academy of Sciences" (23 njësi me 5 tituj), Sofia, në Bullgari, ku kemi dërguar revistën tonë Studia Albanica dhe Studime Historike në kuadër të shkëmbimit ndërbibliotekar.
  - ❖ Bibliotekën "Central Research and Technical Library, Bullgari: 8 copë/1 titull", Sofia, ne Bullgari, ku kemi dërguar revistën tonë JNTS-Journal of Natural and Technical Sciences në kuadër të shkëmbimit ndërbibliotekar.
- ✓ ***Rumani:*** 4 njësi, 2 titull, ku mbizotëron shkëmbimi me
  - ❖ Biblioteca Universitatea "Central Library Politehnica University of Timisoara", Rumani (2 njësi me 1 titull).
  - ❖ Library of Universitatea "Dunarea de Jos" din Galati", Romania (2 njësi me 1 titull).
  - ❖ Në të dyja këto biblioteka kemi dërguar revistën tonë JNTS-Journal of Natural and Technical Sciences, si dhe Buletinin e Shkencave Teknike në Central Library Politehnica University of Timisoara, Romania në kuadër të shkëmbimit ndërbibliotekar.
- ✓ ***Gjermani***: 5 njësi, 2 tituj, ku nënvizojmë shkëmbimin me:
  - ❖ Bibliotekën e Senckenberg Research Institute and Natural History Museum Frankfurt, Germany (4 njësi, 1 titull).
  - ❖ Universitaetsbibliothek der TU Claussthal, Germany (2 njësi, 1 titull).

Në të dyja keto biblioteka kemi dërguar revistën: JNTS- Journal of Natural and Technical Sciences (2 copë) & Buletini i Shkencave Gjeologjike.

- ✓ ***Itali:*** 1 njësi, 1 titull, ku mbizotëron shkëmbimi me:
  - ❖ Ufficio Publicazioni e Scambi, Universita Degli Studi, Trieste, Italia.

Në këtë bibliotekë kemi dërguar, në kuadër të shkëmbimit ndërbibliotekar, revistën: JNTS- Journal of Natural and Technical Sciences (2 copë) & Buletinin e Shkencave Teknike.

- ✓ ***Serbi***: 1 njësi, 1 titull, ku mbizotëron shkëmbimi me:

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ❖ Bibliotheque Academie Serbe des Sciences et des Arts, Beograd, Serbia

Në këtë bibliotekë kemi dërguar, në kuadër të shkëmbimit ndërbibliotekar, revistën: JNTS- Journal of Natural and Technical Sciences (2 copë).

- ✓ ***Zvicër:*** 1 njësi, 1 titull, ku mbizotëron shkëmbimi me:
  - ❖ Ville de Geneve: Museum D'Histoire Naturelle, Geneve,Zvicër.

Në këtë bibliotekë kemi dërguar, në kuadër të shkëmbimit ndërbibliotekar, revistën: JNTS- Journal of Natural and Technical Sciences (2 copë) & Buletini i Shkencave Gjeologjike.

- ✓ ***Japoni:*** 2 njësi, 1 titull, ku mbizotëron shkëmbimi me:
  - ❖ University of Toyama, Japoni: 2 cope/ 1titull.

Në këtë bibliotekë kemi dërguar, në kuadër të shkëmbimit ndërbibliotekar, revistën: JNTS- Journal of Natural and Technical Sciences (2 copë).

Është për t´u nënvizuar se, të gjitha revistat e siguruara nga ky bashkëpunim janë me profil tekniko-shkencor.

Po në kuadër të shkëmbimit bibliotekar, biblioteka jonë jo vetëm ka promovuar, duke u dërguar bibliotekave të huaja partnere, revistat shkencore të institucioneve tona, si "Buletini i Shkencave Teknike", "Buletini i Shkencave Gjeologjike", "JNTS-Journal of Natural and Technical Sciences" etj., si edhe punime shkencore të stafit akademik UPT, por edhe dhe ka marrë prej tyre, revista të ndryshme në fushat e shkencave teknike, si:

Titujt e revistave

- ✓ CIT -Cybernetics and Information technologies
- ✓ Journal of theoretical and applied mechanics
- ✓ Serdica: Mathematical Journal
- ✓ Serdica: Journal of Computing
- ✓ International Journal on Information Technologies and Security
- ✓ Palaeobiodiversity and Paleoenvironments: A journal of the Senckenberg Research Institute
- ✓ Welding Equipment and Technology
- ✓ Revue de paleobiologie
- ✓ Bulletin: classe des sciences mathematiques at naturelles ....
- ✓ Trasactions on Hydrotechnics
- ✓ Folia: Geologica et Paleobiologica
- ✓ Toyama Mathematical Journal etj.

4.1.3.2 Pasurim i bibliotekës nëpërmjet shkëmbimit brenda vendit:

Të gjithe titujt e librave dhe revistave me te cilat është pasuruar Biblioteka Shkencore si dhe degët e saj (Biblioteka e Fakultetit Inxhinierisë së Ndertimit, Biblioteka e Fakultetit të Gjeologjisë dhe të

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Minierave, etj.), nëpërmjet shkëmbimit ndërbibliotekar brenda vendit, për vitin 2025, janë siguruar si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me:

- ✓ Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, Tiranë - kemi shkëmbyer *Buletinin e Shkencave Teknike* me *Buletinin e Shkencave Gjeologjike.* Revista që sigurojmë nga ky shkëmbim është përdorur jo vetëm për pasurimin e Bibliotekës së *Fakultetit të Gjeologjisë* dhe të *Minierave dhe Arkiven e Bibliotekës Shkencore*, por edhe për t'i dërguar ato në Institutin e Kërkimit Senckenberg dhe Muzeun e Historisë Natyrore Frankfurt, Gjermani, në Bibliotekën e Muzeumit Plzen Çeki, në Bibliotekën e Kongresit, Amerikë, Zvicër, etj., në kuadër të Shkëmbimit Ndërbibliotekar jashtë vendit *(Tabela: Shkëmbimi brenda dhe jashtë vendit, 2025).*
- ✓ Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, - kemi shkëmbyer Buletinin e Shkencave Teknike Nr.1,2020-2021, Nr.1/2022 dhe Nr.1/2023., - me "Buletinin shkencor" të këtij universiteti.
- ✓ Akademinë e Shkencave, Tiranë , - me të cilën gjate vitit 2025 kemi shkëmbyer 24 Albume me 12 tituj librash me karakter shoqëror të cilat do të dërgohen në vitin 2026 në Bibliotekën e Kongresit, USA. dhe 26 copë me 5 tituj revistash të cilat i kemi dërguar në "The Central Library of the Bulgarian Academy of Sciences"si dhe të tjerat do të dërgohen në vitin 2026 në Bibliotekën e Kongresit, USA.

Kjo praktikë (shkëmbim ndërbibliotekar brenda vendit, për të siguruar shkëmbim ndërbibliotekar jashtë vendit) është shumë domethënëse për Bibliotekën tonë, pasi jo vetëm që shërben për pasurimin e saj me tituj të rinj, por edhe sepse marrim nga jashtë vendit literaturë të përzgjedhur, të viteve të fundit, të fjalës së fundit të dijes dhe shkencës, shumë të kushtueshme. Ruajtja dhe zhvillimi i këtij lloj bashkëpunimi është i një rëndësie të veçantë për B.SH., sepse kostoja (vlera në lekë) e literaturës që marrim/sigurojmë për pasurimin e bibliotekës, është më e madhe në raport me vlerën në lekë që biblioteka shpenzon për t'i siguruar ato.

Gjithashtu, literatura e siguruar me shkëmbim bibliotekar brenda vendit, përdoret shpeshherë si praktikë për të siguruar shkëmbim ndërbibliotekar jashtë vendit.

4.1.4 Promovimi dhe shpërndarja e botime studimore universitare (UPT)

Biblioteka Shkencore shpërndan dhe promovon të gjitha materialet shkencore që përfaqësojnë zhvillimet studimore, kërkimore shkencore etj., të UPT-së brenda dhe jashtë vendit në të gjitha bibliotekat me të cilat BSH ka marrëdhënie shkëmbimi ndërbibliotekare mbi bazën e reciprocitetit

- ✓ Organeve Botuese të UPT-së : *Buletini i Shkencave Teknike*, UPT.
- ✓ "JNTS" Journal of Natural and Technical Sciences".
- ✓ Materialeve shkencore të stafit akademik në gjuhë të huaj dhe në gjuhën shqipe.

4.1.4.1 Buletini i Shkencave Teknike, UPT:

Shpërndarja dhe Promovimi i "Buletinit të Shkencave Teknike" Jashte Vendit, në kuadër të Shkëmbimit Ndërbibliotekar në të gjitha Bibliotekat Universitare me të cilat kemi marrëdhenie bashkëpunimi. Për vitin 2025 është dërguar si më poshtë vijon:

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ✓ Library of University of Aarchitecture, Civil Engineering and Geodesy, (UACEG) Bullgari.
- ✓ Library of Technical University of Gabrovo, Bullgar .
- ✓ KIT Bibliothek Sued, Karlsruhe, Gjermani.
- ✓ Massachutts Institute of Technology, CAMBRIDGE, USA.
- ✓ Kresge Engineering Library University of California, USA.
- ✓ Georgia Institute of Technology, Atlanta, USA.
- ✓ University of Southhampton, Angli.
- ✓ UTC-Université de Technologie de Compiegne, Francë.
- ✓ Université PSL, Paris, Francë.
- ✓ Plaça Cívica, Campus de la UAB, Barcelona, Spanjë.
- ✓ Universitat Politècnica de València, Spanjë.
- ✓ Universiteit van Amsterdam, Hollandë.
- ✓ Izmir Institute of Technology Library iYTE Library, Turqi.

Shpërndarja dhe promovimi i "Buletinit të Shkencave Teknike" brenda vendit:

- ✓ Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, Tiranë.
- ✓ Biblioteka Kombëtare, Tiranë.
- ✓ Biblioteka e Universitetit " Fan Stilian Noli", Korçë.
- ✓ Universiteti " Ismail Qemali", Vlorë.

4.1.4.2 "Buletini i Shkencave Gjeologjike" Vol. 1/2024 është dërguar në:

- ✓ Universitaetsbibliothek"Georgius Agricola" der Technischen Universitat bergakademie, Freiberg : Bibliotekën Teknike Universitare Freiberg, Gjermani.
- ✓ Senckenberg Research Institute and Natural History Museum Frankfurt, Gjermani.
- ✓ The library of congress, Washington, Amerike/ Bibliotekën e Kongresit Amerikë.
- ✓ VILLE DE GENEVE: MUSEUM D'HISTOIRE NATURELLE – ZVICËR/ Biblioteka Muzeumit Gjenevë.
- ✓ Biblioteka Muzeumit Plzen Ceki.
- ✓ Ufficio Publicazioni e scambi Iniversita degli Studi, Trieste, Itali/ Bibliotekën Universitare Trieste, Itali.

4.1.4.3 "Buletini i Shkencave Gjeologjike" Vol. S/2022 është dërguar në:

- ✓ Senckenberg Research Institute and Natural History Museum Frankfurt, Gjermani.
- ✓ Library of Congress, Washington, Sh.B.A.
- ✓ Ville de Geneve: Museum d'Histoire Naturelle, Zvicër.
- ✓ Library of Zapadoceske Muzeum V Plzni, Ceki.

4.1.4.4 Revista JNTS Journal of Natural and Technical Sciences:

Shpërndarja dhe Promovimi i revistës shkencore JNTS- Nr. 3/2022 & Nr.1/2023 në të gjitha bibliotekat universitare jashtë vendit me të cilat kemi marrëdhënie shkëmbimi ndërbibliotekar: ***14 biblioteka jashte vendit.***

- ✓ Universitatsbibliothek und TIB, Hannover, Gjermani;

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ✓ Universitaetsbibliothek "Georgius Agricola" der Technischen Universitaet Bergakademie, Freiberg, Gjermani;
- ✓ Biblioteca Universitatea " Transilvania" din Brasov, Rumani;
- ✓ Senckenberg Research Institute and Natural History Museum Frankfurt, Gjermani;
- ✓ The library of congress, Washington, Amerike/ Bibliotekën e Kongresit Amerikë;
- ✓ Library of Universitatea "Dunarea de Jos" din Galati, Rumani;
- ✓ Central Library Politehnica University of Timisoara, Rumani;
- ✓ Ville de Geneve: Museum d'Histoire Naturelle, Zvicër;
- ✓ Bibliotheque Academie Serbe des Sciences et des Arts, Beograd, Serbi;
- ✓ Central Research and Technical Library, Bullgari;
- ✓ Library of Technical University of Gabrovo, Bullgari;
- ✓ Ufficio Publicazioni e Scambi, Universita Degli Studi, Trieste, Itali;
- ✓ Universitatsbibliothek der TU Claussthal, Gjermani;
- ✓ University of Toyama, Japoni.

4.1.4.5 Revista Studia Albanica

Revista Studia Albanica është dërguar në:

- ✓ The Central Library of the Bulgarian Academy of Sciences, Sofia, Bullgari;

4.1.5 Sigurimi online i literaturës nëpërmjet platformës ELTAB

ELTAB është një platformë shkëmbimi online që është e hapur për bibliotekat në mbarë botën (e hapur për publikun/pronësinë publike). Përdoruesit mund të kërkojnë, shfletojnë dhe porosisin lehtësisht tituj të përshtatshëm nga arkivi online. Shkëmbimi është falas dhe pa detyrime.

Sektori i Zhvillimit te Koleksioneve nëpërmjet platformes ELTAB ka siguruar literaturen online tekniko shkencore, si më poshtë vijon:

Disertacione në fushën e informatikës:

1. Existence of solutions for strain-limiting viscoelasticity of strain-rate and stress-rate type https://opus.bibliothek.uni-wuerzburg.de/opus4 wuerzburg/frontdoor/deliver/index/docId/39949/file/Bachmann_Luisa_Dissertation.pdf

Wurzburg, Deutschland 2024.

2. Design space exploration in engineering automation

https://eldorado.tu-dortmund.de/items/38613ced-3045-43e1-bc31-b8edad4c9f2a

Dortmund, Deutschland 2025.

Disertacionet në fushën elektrike/informatikë:

1. A contribution to beam scanning with array antennas

file:///C:/Users/HP/Downloads/RohrdantzBenjamin_AContributionToBeamScanningWithArrayAntennas_2024_PhDThesis%20(1).pdf

Hamburg, Deutschland 2024.

2. Fully integrated ultra-wideband receiver and transmitter front-ends for frequency modulated

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

continuous wave multiple input multiple autput imaging radars

https://tud.qucosa.de/api/qucosa%3A95234/attachment/ATT-0/?L=1

Dresden, Deutschland 2024.

3. Towards functional device applications of gas phase electrodeposition

   https://www.dbthueringen.de/servlets/MCRFileNodeServlet/dbt_derivate_00066865/ilm1-202400058.pdf

   Ilmenau, Deutschland 2024.

4. Development, modelling and characterization of a three-dimensional thermoelectric micro-generator based on LTCC technology

   https://www.dbthueringen.de/servlets/MCRFileNodeServlet/dbt_derivate_00064682/ilm12023000463.pdf

   Ilmenau, Deutschland 2023.

5. Facile synthesis of 2D nanomaterials with tailored properties for information storage and energy conversion devices

   https://www.dbthueringen.de/servlets/MCRFileNodeServlet/dbt_derivate_00066230/ilm12024000424.pf

   Ilmenau, Deutschland 2024.

4.1.6 Pasurimi i Bibliotekës Shkencore me literaturë nëpërmjet dhurimeve.

Gjatë vitit 2025 Biblioteka Shkencore është pasuruar me literaturë nëpërmjet dhurimeve, si më poshtë vijon:

Tabela: Pasurimi i bibliotekës shkencore me literaturë për vitin 2025, me dhurime.

Tabela 4

PASURIMI ME LITERATURË I BIBLIOTEKËS SHKENCORE NËPËRMJET DHURIMEVE, 2025																			
Nr.	EMËRTIMI	GJITHSEJ			NGA KËTO														Vlera
		NJËSI	TITUJ	NGA KËTO		BIBLIOTEKA SHKENCORE QENDËR			BIBLIOTEKA FIN			BIBLIOTEKA GJ - M			Arkivi			Vlera Lekë
				Shkenco	Sh	Sasi	Tituj	Vlera	Sasi	Tituj	Vlera	Sasi	Titu	Vlera	Sasi	Tituj	Vlera	
Σ	LITERATURA GJITHSEJ (I + II	33	17	17	-	-	-	-	11	8	15594	8	3	24000	14	11	####	62026
I	LIBRA GJITHSEJ (A+ B) *Gjuhë Shqipe & Gjuhë të Huaj*	30	15	15		-	-	-	8	6	12432	8	3	24000	14	11	21432	58864
A	LIBRA NË GJUHËN SHQIPE	16	8	8	-	-	-	-	3	2	2432	4	1	20000	9	8	17432	39864
B	LIBRA NË GJUHË TË HUAJ	14	7	7	-	-	-	-	5	4	10000	4	2	4000	5	3	5000	19000
II	PERIODIK GJITHSEJ (A+ B) *Gjuhë Shqipe & Gjuhë të Huaj*	3	2	2	-	-	-	-	3	2	3162	-	-	-	-	-	-	3162
14	Laboratori i dinamikës së vibrimeve	Mësimdhënie / Kërkim shkencor	JO	2024	Një electrodynamic shaker (shkundës elektrodinamik) është një sistem testimi i avancuar që përdor forcën elektromagnetike për të gjeneruar dridhje lineare të kontrolluara, të cilat shërbejnë për të vlerësuar qëndrueshmërinë, besueshmërinë dhe performancën dinamike të komponentëve mekanikë dhe elektronikë. Duke siguruar kontroll të saktë mbi frekuencën, amplitudën, përshpejtimin dhe profilin e sinjalit (sine, random, shock), ky sistem mund të simulojë me saktësi mjediset reale të ngarkesave vibruese si ato të transportit, funksionimit në automjete, pajisjeve industriale, avionëve apo satelitëve. Shaker-at elektrodinamik përdoren gjerësisht për testim të lodhjes mekanike, verifikim të integritetit të saldimeve dhe lidhjeve elektrike, analizë modal për përcaktimin e frekuencave të rezonancës, si dhe për kryerjen e testeve të goditjeve të shpejta. Falë kontrollit të lartë dhe përsëritshmërisë së profilit të dridhjeve, ata janë të domosdoshëm në industri si automotivë, aerohapësirë, elektronikë dhe prodhim të pajisjeve industriale, duke u përdorur për certifikim sipas standardeve ndërkombëtare (IEC, ISO, MIL-STD) dhe për zhvillim të produkteve të sigurta, të qëndrueshme dhe të optimizuara për kushtet reale të përdorimit. Përfituar nga një projekt me AKKSHI-n.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
15	Laboratori i Fërkimit dhe Konsumimit	Mësimdhënie / Kërkim shkencor	JO	2025	Tribometër i blerë nga një projekt me READ, mbështetur nga AADF. Emërtimi i tij është: EMMW-1W, shërben për të matur fërkimin dhe konsumimin e pjesëve që fërkohen në të thatë por edhe në prani të lubrifikantëve. Ka disa aksesorë të çifteve në fërkim: Kunj mbi disk, sferë mbi disk, unazë mbi disk. Shërben për të kryer laboratoret mësimore të lëndës Tribologjia Inxhinierike dhe për kërkim shkencor të çifteve tribologjike reale duke përshtatur parametrat e ngarkeses, shpejtesise, sipërfaqes së kontaktit, në funksion të materialeve të tyre. Rezultatet gjenerohen në formë grafike (5 njëkohësisht) dhe analitike (të dhënat e matura në vlera), të cilat reflektohen në fletë analize laboratorike.
16	Laboratori i Metrologjisë Mekanike	Mësimdhënie / Kërkim shkencor	JO	2019	Pajisje matëse për precizionin përmasor, gabimet makro dhe miro gheometrike. Kaliber, mikrometër, rugozimeter etj.
17	Laboratori i Teknologjisë Mekanike	Mësimdhënie / Kërkim shkencor	JO	2019	Makina metal-punuese tradicionale: torno, bareno koordinative, freze kreator.
18	Laboratori i CAD-CAM	Mësimdhënie / Kërkim shkencor	JO	2020	Makina metal-punuese me kontroll nukemtik: torno, freze.
19	Laboratori i Materialeve	Mësimdhënie / Kërkim shkencor	JO	2019	Makina poliruese për përgatitje kamionësh për prova mikrostrukturore, makineri për matjen e fortësisë Vicker dhe Rockwell, Analizë imazhi e imazhit: mikroskopi optik dhe kompjutër me software profesional për analizën e imazhit, Furrë e përpunimit termik, Mikroskop biologjik dhe optik.
20	Laboratori i AutoCAD	Mësimdhënie / Kërkim shkencor	JO	2019	PC të pajisur me software projektues: AutoCad, Invertor, Solidworks.
21	Laboratori i Reverse Engineering dhe Rapid Prototyping	Mësimdhënie / Kërkim shkencor	JO	2025	Printera 3D, Skaner 3D pa kontakt, Sensor 3D Pajisje VR-AR.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
22	Laboratori i Saldimit	JO funksional	JO	2016	Pajisje saldimi të ndryshme MIG, MAG.
23	Laboratori i Grafikës Inxhinierike	Mësimdhënie / Kërkim shkencor	JO	2019	Instrumenta dhe pajisje demostrative për lendën e vizatimit teknik: vizore, shabllona, instrumenta matës, etalona të ndryshëm.
24	Biblioteka e FIM	Ka 31 vende/poste pune-kërkimi.	JO	2025	NA

Tabela 6.4: Infrastruktura kërkimore e FIN.

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
1	Qendra për Klimën dhe Qendrueshmërinë (HUB)	Mësimdhënie	Jo		Paisje laboratorike portable.
2	Laboratori i Gjeodezisë	Mësimdhënie: Bachelor Inxhinieri Gjeodezi, Master shkencor/Master Profesional Inxhinieri në Gjeodezi.	PO Rilevime topografike, Rilevime kadastrale, Monitorime vertikaliteti objektesh, Monitorime qëndrueshmërie.	2010 - 2025	Pajisjet e Laboratorit të Gjeodezisë përdoren për qëllime mësimi, laboratore, praktika profesionale dhe kërkim shkencor (Rilevime topografike, Rilevime kadastrale, Monitorime vertikaliteti objektesh, Monitorime qëndrueshmërie).
3	Laboratori i Geomatikës	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	JO	2010 - 2025	Pajisjet e Laboratorit të Gjeodezisë përdoren për qëllime mësimi, praktika profesionale dhe kërkim shkencor.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
4	Laboratori i Fotogrametrisë dhe Remote Sensing	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	PO Rilevime fotogrametrike	2016 - 2025	Pajisjet e Laboratorit të Gjeodezisë përdoren për qëllime mësimi, praktika profesionale dhe kërkim shkencor.
5	Laboratori i Hidraulikës dhe Hidroteknikës	mësimdhënien në fushën e Hidraulikës			Laborator Mësimor për kryerjen e punëve të lëndëve të Hidraulikës sipas programit mësimor.
6	Laboratorët e DKNIT	Mund të themi se janë përdorur për studentët në mënyrë të rregullt.	N/A		
7	Laboratorët e DMS	Në lidhje me laboratorët e DMS mund të themi se pas datës 26 Nëntor 2019 deri në 2022, laboratoret nuk u përdoren, për arsye se godina në të cilën ato ndodheshin ishte e papërdorshme nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019. Ndërsa në vitin 2023 kjo godinë u boshatis, pasi filloi puna për prishjen dhe ndërtimin e godinës së re. Një pjesë e pajisjeve laboratorike janë të magazinuara dhe nuk përdoren. Pjesa tjetër funksionon.	N/A		

Tabela 6.5: Infrastruktura kërkimore e FIE.

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrimi
1	Laboratori i Matjeve Elektrike DA/FIE	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Në matjet e parametrave të energjisë elektrike.		
2	Laboratori i Makinave dhe Transmisioneve Elektrike (DA/FIE)	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Në shfrytëzimin e makinave elektrike.		

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrimi
3	Laboratori i Automatikës (DA/FIE)	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Në automatizimin e proceseve industriale.		
4	Laboratori Elektroteknika 1 (DE /FIE)	Mësimdhënie			
5	Laboratori Elektroteknika 2 (DE /FIE)	Mësimdhënie			
6	Laboratori i Tensioneve të Larta (DSEF/FIE)	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Në problematikat e linjave të tensionit të lartë.		
7	Laboratori i mbrotjes ne Sistemin Elektroenergjetik (DSEF/FIE)	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Në problematikat e sistemit elektroenergjitik.		
8	Laboratori i Analizës së Sistemit Elektroenergjetik (DSEF/FIE)	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Në problematikat e sistemit elektroenergjitik.		
9	Laboratori i Tensioneve te Mesme (DSEF/FIE)	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Në problematikat e sistemit elektroenergjitik.		
10	Qendra multimediale – Biblioteka (FIE)	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor			
11	Laboratori i kompjuterave (FIE)	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor			

Tabela 6.6: Infrastruktura kërkimore e FGJM.

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
1	Laboratori i Shlifeve dhe Anshlifeve	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	N/A	2024	Laboratori i Shlifeve dhe Anshlifeve është një njësi laboratorike e DSHT, për përgatitjen e shlifeve dhe anshlifeve nga shkëmbinjtë/mineralet për analiza mikroskopike dhe karakterizim mineralogjik, petrografik dhe gjeokimik.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
2	Laboratori i Paleontologjise dhe Termokronologjisë	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	N/A	2023	Laboratori i Paleontologjisë dhe Termokronologjisë është një hapësirë e specializuar për studimin e fosileve, analiza biostratigrafike dhe proceset e datimit termokronologjik, me metodën fission track.
3	Laboratori Mineragrafisë	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	N/A		Laboratori i Mineragrafisë është i pajisur me mikroskopë me dritë të reflektuar dhe tepershkruar për analizën mikroskopike të mineraleve opake dhe jo opake. Ai mundëson studimin e teksturave, strukturave dhe përbërjes minerale të xeheroreve për qëllime kërkimore dhe didaktike.
4	Laboratori Petrografisë dhe Mikroskopise Optike	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	N/A	2021	Laboratori i Petrografisë dhe Mikroskopisë Optike është i pajisur me mikroskopë polarizues binokularë dhe trinokularë për studimin e mineraleve në shlife. Ai ofron kushte të përshtatshme për analizën petrografike të shkëmbinjve dhe për zhvillimin e ushtrimeve laboratorike të studentëve në identifikimin optik të mineraleve.
5	Laboratori i Gjeokimisë dhe Gjeomjedisit	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	N/A	2024	Laboratori i Gjeokimisë dhe Gjeomjedisit është i pajisur me aparatura për përgatitjen, tretjen dhe analizimin e mostrave shkëmbore, ujore dhe tokësore, si peshore analitike, pH-metër, konduktometër dhe spektrofotometër UV-VIS, absorber atomik. Ai mundëson kryerjen e analizave bazë gjeokimike dhe mjedisore për vlerësimin e përbërjes kimike dhe ndotjes në ekosistemet tokësore dhe ujore.
6	Laboratori i Gjeofizikes	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	N/A	2023	Laboratori i Gjeofizikës është i pajisur me aparatura për matje dhe interpretim të fushave fizike të Tokës. Ai shërben për realizimin e praktikave mësimore dhe studimeve kërkimore në fushat kërkimit gjeofizik, si sizmologjisë, elektrometrise dhe monitorimit të mjedisit.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
7	Laboratori i Mekanikës së Shkëmbinjve	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	JO	2010 dhe shtesa në vijim.	Mundëson: - përgatitjen e kampionaturës dhe kryerjen e provës në shtypje njëaksiale dhe tërheqjes indirekte për kampionë shkëmborë. - kryerjen e provës së ngarkesës në pikë; - matjen e shpejtësisë së kalimit të valëve në shkëmbinj; - kryerjen e llogaritjeve numerike në fushën e mekanikës së shkëmbinjve.
8	Laboratori i Ajrimit dhe Mbrojtjes në Punë "Hajredin Shtino"	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	JO	Mungesë pajisjesh.	Lëndët që zhvillohen në këtë laborator: Inxhinieri Miniere (LZ); Hyrje në burimet natyrore; Teknologji shpimi, shfrytëzim pasurimi; Punime në miniera; Cikli i dytë: Ndërtimi i galereive dhe tuneleve; Shfrytëzim në sipërfaqe dhe rehabilitim mjedisi; Shfrytëzimi nëntokësor i vendburimeve; Ajrimi në miniera; Legjislacioni dhe siguria në punë; Cikli i tretë: Ndërtim Shfrytëzim miniera;
9	Laboratori GIS dhe Modelim	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	JO	2020 e ne vazhdim, shtesa nga Projekti AKKSHI.	Laboratori Modelim dhe GIS është krijuar në vitin 2016. Ky Laborator eshtë bërë i mundur nëpërmjet mbështetjes së Projektit ERASMUS "Modernising geodesy education in ëestern Balkan ëith foucs on comptences and learning outcomes" (GEOëEB). Eshte fuqizuar ne vitin 2025 me : Laptop për punimet fushore; • Drone Lidar dhe Softet përkatëse; Lëndët që zhvillohen ne kete Laborator janë: • Modelim Vendburimesh; • Sistemet të Informacionit Gjeografik GIS; • Fotogrametri; • Autocad • Matje në Miniera; • Gjeodezi Satelitore; • Telerilevim; • Menaxhim Projekti.
10	Laboratori i Matjeve Gjeomatike	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	N/A	2010 dhe shtesa në vazhdim.	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
11	Laboratori i përpunimit mekanik të mineraleve	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	JO	1985 e në vazhdim, Pjesërisht Mungesë e pajisjeve/mir ëmbajtje pajisjesh.	Eshtë laborator i krijuar që në fillimet e viteve 80-të ne FGJM, në kuadër të Katedrës së Pasurimit të Mineraleve. Lëndët që zhvillohen në këtë Laborator janë: Cikli i parë: Përpunim mineralesh, Impiante dhe procese, Minerale Industriale, Kimi Mjedisi, Përpunim mineralesh, shpim dhe miniera, Përpunim i xeherorëve, Cikli i dytë: Teknologji shpimi, shfrytëzim pasurimi; Proceset e përpunimit të lëndëve minerare; Impiantet e përpunimit të lëndëve të para minerare; Impiantet e trajtimit të lëndëve të ngurta dhe të lëngëta; Teknologji e pasurimit të mineraleve; Bazat teorike të pasurimit; Proceset e përgatitore dhe të parapasurimit të xeherorëve; Metodat gravitative, Flotimi i mineraleve dhe cujëzimit; Impiantet e pasurimit; Riciklimi i mbetjeve; Cikli i tretë: Konceptet Themelore të pasurimit të xeherorëve; Proceset dhe Impiantet e pasurimit të xeherorëve me metodat gravitative e të kombinuara; Proceset dhe impiantet e pasurimit të xeherorëve me flotim dhe proceset ndihmëse të pasurimit.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
12	Laboratori i Flotimit dhe C'ujëzimit	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	JO	1986 e në vazhdim. Pjesërisht Mungesë e pajisjeve/mir embajtje pajisjesh.	Eshtë laborator i krijuar që në fillimet e viteve 80-të ne FGJM, në kuadër të Katedrës së Pasurimit të Mineraleve. Lëndët që zhvillohen në këtë Laborator janë: Cikli i parë: Përpunim mineralesh, Impiante dhe procese, Minerale Industriale, Kimi Mjedisi, Përpunim mineralesh, shpim dhe miniera, Përpunim i xeherorëve, Cikli i dytë: Teknologji shpimi, shfrytëzim pasurimi; Proceset e përpunimit të lëndëve minerare; Impiantet e përpunimit të lëndëve të para minerare; Impiantet e trajtimit të lëndëve të ngurta dhe të lëngëta; Teknologji e pasurimit të mineraleve; Bazat teorike të pasurimit; Proceset e përgatitore dhe të parapasurimit të xeherorëve; Metodat gravitative, Flotimi i mineraleve dhe cujëzimit; Impiantet e pasurimit; Riciklimi i mbetjeve; Cikli i tretë: Konceptet Themelore të pasurimit të xeherorëve; Proceset dhe Impiantet e pasurimit të xeherorëve me metodat gravitative e të kombinuara; Proceset dhe impiantet e pasurimit të xeherorëve me flotim dhe proceset ndihmëse të pasurimit.
13	Laboratori i Presion, Vëllim, Temperaturë (PVT)	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	N/A		
14	Laboratori i Modelimit të Burimeve të Energjisë	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	N/A		
15	Laboratori i Metodave të Veprimit në Shtresë	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	N/A		
16	Laboratori i Mekanikës së Fluideve	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	N/A		

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
17	Laboratori i Lëngjeve Larës dhe Fluideve Teknologjike	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	N/A		
18	Laboratori i gjeologjisë inxhinierike dhe hidrogjeologjisë	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	N/A	2008	Laboratori është plotësisht në funksion të procesit mësimor. Ai ka pajisje të cilat janë në funksion të plotë dhe disa kanë nevojë për riparime, zevendësime ose/dhe mirëmbajtje. Ky laborator mundëson përcakitim e granulometrisë së dherave dhe shkëmbinjve, vetive fiziko-mekanike të tyre. Në infrastrukturën e vet disponon edhe një kompjuter desktop me paramtra të vjetër ku janë të instaluar disa programe në funksion të kryerjes dhe përpunimit të analizave për dherat dhe shkëmbinjtë.
19	Laboratori i Gjeokimise Organike	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	JO	NA	Laboratori është plotësisht në funksion të procesit mësimor per lëndët që lidhen me Hidrokarbure. Ka në infrastrukturën e vet kampionaturë të bollshme të shkëmbinjve që lidhen me hidrokarburet të vendosura në rafte të vjetër dërrase. Ka edhe kampione të hidrokarbureve të lëngët por të vendosur në enë të pa përshtatshme për ruajtjen dhe përdorimin e tyre. Pajisjet e këtij laboratori prej vitesh kanë qenë jashtë funksionit dhe me rikonstrusionin e godinës së vjetër ku kanë qenë të vendosura jashtë përodrimit.
20	Laboratori i Gjeoinformatikes	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	JO	NA	Ky laborator përbëhet nga 16 komjutera desktop të pajisur me programet përkatëse për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Këto pragrame janë versione të vjetra dhe të pa përditësuar si edhe vetë komjuterat të cilët duhet të zëvendësohen me kopjutera me parametra të teknologjisë së fundit bashkëkohore. Laboratori është plotësisht në funksion të procesit mësimor.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 6.7: Infrastruktura kërkimore e FTI.

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
1	Laboratori i Telekomunikacionit, Sistemeve të sigurisë dhe Sistemeve të Informacionit	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Jo		Laboratori është projektuar për të mbështetur mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fushat e telekomunikacionit, rrjetat wireless, rrjetat mobile, rrjetat me fibër optike, antenat dhe sistemet mikrovalore etj. Laboratori është i pajisur me infrastrukturën e përbërë nga një numër modulesh transmetues, marrës, antena dhe kompjutera të lidhur në rrjet lokal me përdorimin e teknologjive të ndryshme. Infrastruktura e laboratorit mbësht edhe laboratorët e tjerë për zhvillimin e aplikimeve në protokollet e transmetimit të të dhënave, si në rrjetat P2P, Ad-Hoc, WSNs, WMNs, DTN, LPWAN etj. Në këtë laborator trajtohen problematikat e komunikimeve wireless duke u përqendruar në studimin e teknologjive të avancuara, simulimin e rrjetave komplekse dhe protokolleve të standardizuara për këtë komunikim, implementimin e skemave të sigurisë, analizën e trafikut dhe optimizimin e antenave inteligjente. Laboratori përdoret për qëllime didaktike dhe kërkimin shkencor në fusha specifike si: pajisjet Wireless inteligjente, rrjetat wireless (ad-hoc, mesh etj.), planifikimi dhe optimizimi i rrjetave wireless, sistemet e transmetimit wireless, protokollet wireless, simulimi, analizimi dhe përmirësimi i tyre dhe jo vetëm.
2	Laboratori Multimedial dhe Sistemet e Rindertimit 3D	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Jo		Infrastruktura e laboratorit përfshin kompjutera, software, kamera, laptop dhe gjithë pajisjet ndihmëse të lidhur në rrjet. Laboratori përdoret për të mbështetur mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fushat e përpunimit të informacionit, si komunikimet multimediale, përpunimi 3D, rindërtimi 3D etj. Me infrastrukturën e laboratorit trajtohen temat si projektimi i filtrave numerikë, analizimi statistikor i sinjaleve numerikë, përpunimin e imazheve të kompresuara, studimin e transmetimit audio dhe video, si dhe simulimi i sistemeve komplekse. Gjithashtu dhe analiza e teknikave te rindërtimit 3D kundrejt saktësisë së parametrave të përftuar nga imazhet e kamerave dhe performancës së sistemit. Laboratori përdoret për qëllime kërkimore në fusha specifike si, kodimet e imazheve dhe transmetimeve video, dhe të dhënave video, kodimi në burime dhe kanale, qëndrueshmëria ndaj gabimeve dhe korrigjimi i tyre, modelimi i zhurmave, filtrim, metoda statistikore, ndarja e zhurmave, rindërtimi i sinjaleve, rindërtimi 3D etj.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
3	Laboratori i Radiofrekuencës dhe Komunikimeve Optike - LRFO	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Jo		Laboratori i LRFO është një hapësirë moderne kërkimore dhe didaktike që mbështet zhvillimin, testimin dhe aplikimin e teknologjive bashkëkohore në fushën e telekomunikacioneve. Ai ofron infrastrukturë të avancuar për eksperimentimin me sisteme RF, antena, komunikime optike dhe transmetime wireless, duke lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë teorinë me praktikën. Laboratori shërben si qendër bashkëpunimi për studentë, pedagogë dhe studiues, duke kontribuar në formimin profesional dhe kërkimin shkencor. Ky laborator është fuqizuar në kuadër të Projekteve të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor për vitin 2024 nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKKSHI).
4	Laboratori Embedded Systems	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Jo		Laboratori është konceptuar për të mbështetur punën kërkimore-shkencore dhe mësimdhënien në fushën e elektronikës, me fokus në projektimin e sistemeve komplekse elektronike, si projektimi i filtrave numerikë, sensorët në rrjetat wireless, matje në radiofrekuencë, qarqet e integruara për frekuenca të larta. Laboratori ka infrastrukturën e duhur karakteristike të përbërë nga një numër modulesh të sistemeve elektronike, oshiloskop digjital, analizatorë spektri, gjeneratorë sinjali, software dhe kompjutera të lidhur në rrjet lokal. Pajisjet e këtij laboratori, si dhe e gjithë infrastruktura e tije shërben për projektimin, eksperimentimin dhe testimin e sistemeve të integruara elektronike komplekse si analoge ashtu edhe digjitale. Fokus kryesor i këtij laboratori është projektim/testimi i sistemeve me sensorë/shndërrues/komandues të bazuara në mikrokontroller por edhe në sisteme më komplekse si FPGA, DSP, PLC e në tërësi të sistemeve të programueshme për zbatime në sistemet IoT (Internet of Things). Infrastrukturë që lejon projektimin, eksperimentimin dhe testimin e sistemeve elektronike digjitale edhe në frekuenca të larta. Laboratori përdoret për qëllime didaktike për zhvillimin e laboratorëve, detyrave praktike dhe tezave dhe për qëllime kërkimore-shkencore në fushën e elektronikës dhe sistemeve komplekse elektronike.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
5	Laboratori i Sistemeve Inteligjente	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Jo		Infrastruktura e laboratorit përbëhet nga: Serverë me performancë të lartë dhe GPU, i përshtatshëm për përpunimin e të dhënave dhe trajnimin e modeleve të avancuara të IA-së Kit zhvillimi FPGA Skaner 3D profesionalë, që mundësojnë digjitalizimin e objekteve fizike Printer 3D i teknologjisë së fundit, për prodhimin fizik të modeleve të rindërtuara dixhitalisht Sensorë dhe aksesorë shtesë, për marrjen precize të të dhënave dhe integrimin me sistemet ekzistuese, Pupil Core për gjurmimin e shikimit e domosdoshme për studime në eye-tracking Laptopë me parametra të lartë për analizë të të dhënave, përdorim të softuerëve të specializuar dhe mobilitet gjatë eksperimenteve. Ky laborator është financuar në kuadër të Projekteve të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor për vitin 2024 nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKKSHI).
6	Laborator kërkimor shkencor për projektimin, prototipizimin dhe testimin e bordeve të qarqeve elektronike dhe sistemeve të antenave të printuara.	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Jo		Laboratori për projektimin, prototipizimin dhe testimin e bordeve të qarqeve elektronike është një hapësirë moderne kërkimore dhe didaktike që mbështet zhvillimin e qarqeve elektronike të printuara, nga faza e projektimit deri te testimi përfundimtar. Ai ofron pajisje të avancuara për ndërtimin e prototipeve, matjen e parametrave elektronikë dhe analizimin e sinjaleve në kohë dhe frekuencë, duke mundësuar optimizimin e performancës së sistemeve. Laboratori shërben si qendër inovacioni dhe bashkëpunimi, ku ndërthuren kërkimi shkencor dhe aplikimet praktike, dhe zhvillon aktivitetin e tij në bashkëveprim të ngushtë me Laboratorin e Radiofrekuencës dhe Komunikimeve Optike (LRFO), duke kontribuar në formimin e specialistëve dhe në zhvillimin e teknologjive moderne. Ky laborator është financuar në kuadër të Projekteve të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor për vitin 2024 nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKKSHI).

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
7	Laboratori Arkitektura, Sistemet dhe Rrjetat Kompjuterike	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Jo		Laboratori shërben si një qendër mësimore dhe kërkimore për arkitekturën e kompjuterave, sistemet operative dhe rrjetat kompjuterike, duke ofruar infrastrukturë me servera, routera, switche dhe mjedise të avancuara rrjeti. Ai mbështet zhvillimin dhe testimin e aplikacioneve në sisteme të shpërndara përmes infrastrukturës GRID, si dhe projekte në teknologjitë FPGA për dizajn dhe siguri harduerike. I bazuar kryesisht në platforma open-source, laboratori krijon një mjedis fleksibël për mësim dhe kërkim shkencor, duke u shërbyer studentëve të të gjitha cikleve të studimit dhe duke mbështetur aktivitete akademike e kërkimore në fusha bashkëkohore të informatikës.
8	Laboratori Inxhinieri Softi, Gjuhë Programimi dhe Bazave të Dhënash	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Jo		Laboratori është i pajisur me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin dhe testimin e aplikacioneve në mjedise të ndryshme informatike. Ai përmban kompjuterat të lidhur në rrjet, servera dhe gjithë infrastrukturën e nevojshme mbështetëse. Në pajiset e laboratorit janë instaluar të gjitha programet e nevojshme duke u bazuar kryesisht në platforma "open source". Laboratori përdoret kryesisht për qëllime didaktike por dhe për zhvillimin e tezave të diplomave apo punë kërkimore-shkencore që mund të zhvillohen me infrastrukturën e disponueshme. Në këtë laborator zhvillohen seminaret, laboratorët dhe detyrat e kursit për lëndë e programimit, inxhinierisë së softit dhe bazave të të dhënave. Gjithashtu laboratori mund të përdoret për projekte kërkimore-shkencore të aplikimeve në mjedise heterogjene duke përdorur teknikat e avancuara të inxhinierisë së softit, bazave të të dhënave dhe programim në gjuhë të ndryshme.
9	Laboratori i Bazave të Informatikës	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	Jo		Laboratori është i pajisur me kompjutera të lidhur në rrjet dhe përdoret për qëllime didaktike për realizimin e laboratorëve apo detyrave praktike të lëndëve të programimit si "Teknikat dhe Gjuhët e Programit", "Informatika", "Bazat e Informatikës". Në kompjuterët e laboratorit janë të instaluar të gjithë programet e nevojshme për zhvillimin e punëve të laboratorit apo detyrave praktike. Studentët mund të aksesojnë laboratorin gjatë zhvillimit të laboratorëve, detyrave praktike apo të kursit për lëndët e programimit.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Tabela 6.8: Infrastruktura kërkimore e FAU.

Nr.	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratore)	Mbështet Mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (Iloji i shërbimit	Viti	Përshkrim i infrastrukturës
1	Laborator CAAD	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	NA		
2	Laborator i lëndëve të projektimit ambiental (DA)	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	NA		
3	Laborator i Virtual Reality (DA)	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	NA	2024-25	
4	Laborator i Modelimit Fizik – BAIND (DA)	Mësimdhënie	NA		
5	Laboratori i restaurimit (DRTA)	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	NA	2017	
6	Laboratori i Komfortit Urban (DU)	Mësimdhënie / Kërkim Shkencor	NA		

4.2.8 Instituti i Gjeoshkencave

Investimi i veçantë në infrastrukturë dhe programe, bashkëpunimi i ngushtë me institucione të huaja homologe, përfshirja e një standarti bashkëkohor për instalimin e sensorëve, kalibrimin dhe mirëmbajtjen e tyre, përpunimin e sinjalit dhe prodhimin e buletinit mujor, kanë siguruar rritjen e cilësisë së produkteve të punës në DS, që nga niveli teknik dhe operacional, deri te kërkimi shkencor.

Instrumentimi sizmik në Shqipëri ka nisur në 1968, me themelimin e rrjetit të parë sizmologjik në Tiranë. Formalisht, Rrjeti Sizmologjik Shqiptar (RrSSh) nisi në 1974, duke pasur një rol kryesor e një rrjeti sizmologjik lokal për monitorimin e aktivitetit sizmik në vend dhe për të dhënë alarmet sizmike drejt autoriteteve dhe publikut. RrSSh u përmirësua pas viteve 90 në një rrjet Bandgjerë BGJ, duke kontribuar gjithashtu për një kërkim më të thelluar shkencor në sizmologjinë lokale dhe rajonale, përtej asaj që ishte arritur deri atëherë. Konfigurimi aktual i RrSSh përfshin tre nën rrjete, përkatësisht:

- ✓ Rrjeti Sizmik i Lëkundjeve të Dobëta (RrSLD), për monitorimin normal të tërmeteve;
- ✓ Rrjeti Sizmik i Lëkundjeve të Forta (RrjSLF) për të regjistruar lëkundjet e tokës së prodhuar nga tërmetet e fortë;

Rrjeti Sizmik Kombëtar i Shqipërisë (RrSKSh) përfshin 12 stacione sizmik bandëgjerë (BB) të pajisur me sensor sizmik 30s, 40s (0.033-100Hz) dhe 120 s (0.0083-100Hz), të cilët përbëjnë "shtyllën kurrizore" të Rrjetit Sizmik Kombëtar; Instrumentat janë kryesisht Trillium-40 dhe Trillium-120CP, por përdoren gjithashtu edhe sensorët CMG-40T por dhe sensorë bangjerë Streicksen STS-2. Në kushtet e sistemit aktual të regjistrimit dhe transmetimit, të pajisur me dixhitalizues me 6 kanale të tipit Trident dhe njësi marrëse/transmetuese Cygnus. Kohët e fundit, pjesë e RrSSh, janë edhe një bashkësi

prej 10 stacione te rinj sizmik të pajisur me gjeofonë periudhë shkurtër 1 s (SS10) and 10 akselerometra triaksialë më gain të ndryshueshëm, 0.5 – 4 g (SA10). Një aspekt kyç në instrumentim është edhe grupi i lëvizshëm sizmik i pajisur me 3 sizmograf portativ të rinj SENTINEL – Geo4G, me akselerometra të brendshëm të tipit MEMS 1 – 8 g dhe gjeofonë.

Të dhënat sizmike transerohen në Qendrën Kombëtare të Monitorimit Sizmik (QKMS), në IGJEO, në kohë reale nëpërmjet radio-link, fibër optike dhe transmetime mobile 3G/4G. Të dhënat procesohen dhe arkivohen në kohë reale nëpërmjet sistemit SeisComP4 me konfigurim të brendshëm të një serveri Seedlink. I njëjti sistem përdoret për të shkëmbyer në mënyrë të drejtpërdrejtë të dhëna me institucionet partnere, sipas marrëveshjeve përkatëse. Gjithashtu kryhet një procesim offline i të dhënave që realizohet duke përdorur sistemin e përpunimit të të dhënave sizmike SEISAN v.12 në lidhje me strukturën e arkivës së të dhënave SDS të SeisComP4, duke përdorur gjithashtu detektimin automatik dhe mundësi lokalizuese.

Gjithashtu, në kuadër të modernizimit të infrastrukturës së rrjeteve kombëtare hidrologjike dhe meteorologjike, janë instaluar 5 stacione të reja hidrologjike automatike, pjesë e rrjetit hidrologjik kombëtar (në Paper, Memaliaj, etj.) si dhe 2 stacione të reja meteorologjike automatike, pjesë e rrjetit meteorologjik kombëtar (në Linzë dhe Kuçovë).

Gjatë vitit 2024-2025, në mbështetje të punës kërkimore shkencore të 4 departamenteve të IGJEO, ka patur investime në infrastrukturën IT të IGJEO, në dhomën e serverave, konkretisht: Data Center, investim Cyber security. 2 Firewall, 2 microtick dhe 2 swich.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

5 Programet e studimit

Universiteti Politeknik i Tiranës ofron programe studimi, të licensuara, në fushat inxhinierike, në të tre ciklet e studimit, referuar nivelit të 6_të, 7_të, 8_të të kualifikimit në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimit. Programet e studimit në UPT ofrohen në përputhje të plotë me misionin e UPT, në fushat inxhinierike të gjeologjisë, burimeve minerare, naftës&gazit, mekanike, materiale, tekstil dhe konfeksione, energjitikë, automatizim industrie, mekatronike, elektronike, telekomunikacion, inxhinieri informatike, inxhinieri matematike, inxhinieri fizike, ndërtim, mjedis, hidroteknikë, gjeodezi dhe në ato të arkitekturës, urbanistikës, interier dizajn dhe restaurim monumentesh kulture. Programet e studimit që ofrohen nga departamentet në fakultetet e UPT jepen në Shtojcë (Tabela 7. Mbi programet e studimit). Ato janë në përputhje me profilin e departamenteve dhe të fakulteteve që i ofrojnë. Programet e studimit të çdo fakulteti kanë lidhje organike me njëra-tjetrën dhe një bërthamë të përbashkët të disiplinave bazë formuese. Organizimi i programeve të studimit bëhet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Të gjitha programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë ofrohen me kohë të plotë. Programet e studimit të formimit të vazhduar dhe ato të doktoraturës janë ofruar me kohë të zgjatur. Në total, në UPT ofrohen programe studimit (duke llogaritur edhe profilet) si me poshtë:

Tabela 7: Numri i programeve të studimit të ofruara në tre cikle studimi në UPT.

UPT	Nr.pr.stud. Bachelor	Pr.st.Master i Shkencave	Pr.st.integruar Master i Shkencave	Pr.st. Master Profesional	Programi formimit të vazhd.	Pr.stud. Doktoratë
Të licensuar	23	38	2	29	5	13
Aktive 24-25	23	29	2	14	4	13
Inaktive	-	4	-	5	1	-
Pezulluara, në proces mbyllje	-	4	-	9	-	-
Pezulluara, që nuk kanë filluar proces mbyllje	-	1	-	-	-	-
Mbyllur me Urdhër të MA	-	-	-	1	-	-

Gjatë vitit akademik 2024-2025, është punuar intensivisht për hapjen e programeve të reja të studimit, si dhe për riorganizimin dhe përmirësimin e programeve ekzistuese, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe përshtatjes së tyre me nevojat e studentëve dhe tregut të punës.

1. Në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, gjatë vitit akademik 2024–2025, u hapën dy programe të përbashkëta studimi të ciklit të parë në bashkëpunim me Universitetin e Teknologjisë së Compiègne (UTC), Francë. Konkretisht, në Departamentin e Inxhinierisë Informatike u hap programi i përbashkët i studimit "Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike" (Urdhër MA Nr.334, datë 16.07.2025), ndërsa në Departamentin e Elektronikës dhe Telekomunikacionit u hap programi i përbashkët i studimit "Bachelor në Inxhinieri të

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Sistemeve Elektronike" (Urdhër MA Nr.335, datë 16.07.2025). Këto dy programe studimi u aktivizuan në vitin akademik 2025–2026.

2. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Prodhim Menaxhimit, në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Barit (Italy) është drejt përfundimit për realizimin e një tjetër diplome të dyfishtë me këtë universitet, "Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, profili Prodhim Menaxhim Industrial".

3. Në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, pranë Departamentit të Inxhinierisë Matematike, gjatë vitit akademik 2024–2025 u hapën dy programe studimi: programi i ciklit të parë "Bachelor në Inxhinieri Matematike dhe Data Science" (Urdhër MA Nr.312, datë 08.07.2025) dhe programi i ciklit të dytë "Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike, profili Aktuaristikë" (Urdhër MA Nr.4476/2, datë 15.07.2025). Këto dy programe studimi u aktivizuan në vitin akademik 2025–2026. Gjatë vitit akademik 2024-2025, Departamenti i Kimisë ka punuar dhe aplikoi për hapjen e programit të studimit "Master i Shkencave në Inxhinieri Kimike". Gjatë vitit akademik 2025-2026 pritet të vijojë dhe të përfundojë procesi i miratimit të hapjes së këtij programi studimi.

4. Në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, pranë Departamentit të Inxhinierisë së Burimeve Minerare, gjatë vitit akademik 2024–2025 u hap program i studimit të ciklit të dytë "Master Profesional në Inxhinieri e Burimeve Minerare, profili Inxhinieri Minerare dhe Përpunim Mineralesh" (Urdhër MA Nr.327, datë 14.07.2025). Ky program studimi u aktivizua në vitin akademik 2025–2026.

5. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, përmes Departamentit të Arkitekturës, ka punuar për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn", si vazhdimësi e programit "Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn", duke realizuar në nëntor 2025 aplikimin për hapjen e këtij programi në platformën e-Albania. Gjithashtu Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës po vlerëson kërkesat dhe nevojat e tregut për hapjen e ciklit të dytë të studimit master i shkencave apo drejtim profili profesionin e Arkitektit Restaurator. Departamenti i Urbanistikës ka pasur objektiv për të hapur një program të ri studimi, i cili lidhet me peizazhin apo dhe qytetet inteligjente, por ky proces ndodhet ende në fazat fillestare të zhvillimit.

Në portofolin e programeve të studimit të UPT ka programe studimi, të cilat nuk janë aktivizuar asnjëherë apo për një periudhë kohore mbi dy vjet dhe në bazë të kuadrit ligjor në fuqi janë faktikisht të pezulluar. Këto programe janë të gjitha programe studimi të ciklit të dytë. UPT ka filluar procesin për mbylljen e tyre, por ky proces nuk ka përfunduar për disa arsye:

- Për disa programe studimi (7 pr.st.) është marrë Vendimi i Senatit Akademik dhe i Bordit të Administrimit, por aplikimi për mbylljen e tyre në E-Albania është bllokuar, pasi dokumentacioni që duhet ngarkuar nuk është i plotë. Jemi në pritje që fakultetet përgjegjëse për këto programe studimi të përcjellin dokumentacionin e munguar, përndryshe procedura duhet të filloj nga e para. Për momentin këto programe studimi konsiderohen të pezulluara.
- Për 6 programe të tjera studimi të ciklit të dytë, është marrë vendimi i Senatit Akademik, por Bordi i Administrimit nuk është shprehur ende. Për momentin këto programe studimi konsiderohen të pezulluara.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Një program studimi nuk është aktivizuar për një periudhë të gjatë kohore që i kapërcen afatet e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi dhe për të cilën fakulteti nuk ka filluar procesin e mbylljes së tij. Ky program studimi konsiderohet gjithashtu i pezulluar. Për aktivizimin e tij, fakulteti duhet të aplikojë për riorganizimin e këtij programi.

Krahas programeve të pezulluara, egzistojnë edhe 9 programe studimi/ose profile që nuk kanë qene aktive për vitin akademik 2024-2025.

Organizimi i Programeve të Studimit, sipas cikleve të studimit dhe profilizimeve të tyre jepen si më poshtë:

5.1 CIKLI I PARË I STUDIMEVE

Në ciklin e parë të studimeve ofrohen gjithsej 23 Programe Studimi, me profile, të liçensuara, të gjitha aktive në Vitin Akademik 2024 – 2025. Programet e ciklit të parë të studimit ofrohen me 180 kredite ECTS, me kohëzgjatje normale të studimeve tre vite akademike. Programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (3 pr.st.), Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave (5 pr.st.), Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (4 pr.st.), Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (2 pr.st.), dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (3 pr.st.), kanë kaluar procesin e akreditimit dhe kanë marrë vendimin e Bordit të Akreditimit. Ndërkohë, programet e studimit që ofrohen nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (4 pr.st) dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (1 pr.st) dhe Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (1 pr.st.) janë në proces për të filluar akreditimin.

5.2 CIKLI I DYTË I STUDIMEVE

Në ciklin e dytë të studimeve ofrohen disa lloje programesh studimi, si:

- ✓ Programe studimi "Master i Shkencave", të cilat janë të organizuara me 120 ECTS, në sistemin e studimeve me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e tyre është dy vite akademike. Oferta akademike e UPT për programet "Master i Shkencave" është në total 33 programe studimi përfshirë dhe profilet e tyre. Në vitin akademik 2024 – 2025, u aktivizuan 29 profile të programeve të studimit "Master i Shkencave".
- ✓ Programe studimi të integruar "Master i shkencave", të organizuara me 300 ECTS në sistemin e studimeve me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e tyre është 5 vite akademike. UPT ofron gjithsej një program studimi të integruar me 2 profile në fushën e arkitekturës dhe urbanistikës, të dyja aktive për vitin akademik 2024-2025.
- ✓ Programe studimi "Master Profesional", të cilat ofrohen me 60 ECTS dhe 120 ECTS në sistemin e studimeve me kohë të plotë. Kohëzgjatja normale e tyre është përkatësisht një vit akademik dhe dy vite akademike. Oferta akademike e UPT për programet "Master Profesional" është në total 18 programe studimi përfshirë dhe profilet e tyre. Në vitin akademik 2024-2025, u aktivizuan 7 programe studimi me 60 ECTS dhe 7 programe studimi me 120 ECTS.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

5.3 CIKLI I TRETË I STUDIMEVE

Në ciklin e tretë ofrohen programe studimi të doktoraturës, të cilat janë të riorganizuar ose të reja, të gjitha në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kanë qenë aktive në vitin akademik 2024-2025. Në UPT janë aktive 13 programe studimi të doktoraturës. Fushat dhe nën fushat e programeve të studimit të doktoratës janë në përputhje të plotë me fushat e ekspertizës së departamenteve që i mbështetin ato.

5.4 PROGRAMET E STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR

Universiteti Politeknik i Tiranës ofron 5 programe studimi të formimit të vazhduar, të liçensuar, në përputhje me nevojat e tregut të punës, si më poshtë vijon:

1. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në bashkëpunim me Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, ofron programin e studimit të formimit të vazhduar në "Vlerësimi i Pasurive të Paluajtshme".
2. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Energjitikës, ofron programet e studimit të formimit të vazhduar për "Auditim Energjie", i cili mbështetur në kërkesat dhe nevojat e tregut është riorganizuar në dy profile: "Procese" dhe "Ndërtesa" dhe "Siguria dhe Shëndeti në Punë"
3. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Departamenti i Prodhim-Menaxhimit në bashkëpunim me departamentin e Mekanikës, në zbatim të kornizës ligjore për vlerësimin e linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve, ofron kursin e formimit të vazhduar në "Vlerësimi i linjave teknologjike, makinerive dhe pajisjeve".
4. Në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, Departamenti i Shkencave të Tokës, me kërkesë të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe palëve të tjerë të interesuar, është hapur me Urdhërin e MAS Nr. 405, datë 20.07.2023, Programi i Formimit të Vazhduar në Gjeologji, në fushat: Mineralogji, Petrologji-Petrografi, Paleontologji (Mikro dhe Makro) dhe Gjeokimi. Për vitin akademik 2024-2025 nuk është bërë e mundur aktivizimi i tij.

Organizimi i kurseve, programet e lëndëve, materialet didaktike, orari i mësimdhënies, pranimet, etj., menaxhohen nga departamentet përgjegjëse për to, ndërsa të dhënat e kandidatëve dhe rekordet akademike të arritura mbahen dhe ruhen në sekretaritë mësimore të fakultetit përkatës. Të gjitha kurset organizohen në mënyrë të tillë që t'i përshtaten nevojave të kategorive të studentëve pjesëmarrës.

5.5 PËRSHTATSHMËRIA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME MISIONIN E UPT.

Të gjitha programet e studimit që ofrohen nga UPT janë në fushat inxhinierike dhe atë të arkitekturës, në përputhje të plotë me misionin e UPT. Çdo fakultet mbulon programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në përputhje të plotë me fushat inxhinierike që mbulon sipas ekspertizës që ofron dhe misionit të fakultetit. Njësitë bazë të UPT kanë përgjegjësinë për administrimin e programeve të

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

studimit që ofrohen në fushën inxhinierike të lidhur ngushtë me profilin akademik dhe kërkimor të departamentit. Departamentet kanë ekspertizën e duhur për të menaxhuar programet e studimit që ato ofrojnë në të tre ciklet e studimit. Në mënyrë më të detajuar lista e programeve të studimit, statusi i tyre, njësitë përgjegjëse, etj., jepen në tabelën 7 të Shtojcës.

Profili kulturor dhe profesional i programeve të studimit është i lidhur me nivelin e kualifikimit që ato sigurojnë si dhe me fushën dhe nën fushën inxhinierike që mbulon. Një punë e mirë është bërë në lidhje me vendosjen e sistemit të kodifikimit për të gjitha programet e studimit, në të cilat qartësohet fusha kryesore e studimit si dhe nën fusha përkatëse, niveli i kualifikimit i programit të studimit, gjuha, forma e organizimit, etj.

- ✓ Programet e studimit të ciklit të parë synojnë të japin njohuri të avancuara në fushën bazë inxhinierike duke përfshirë njohuri të thelluara në fushat e matematikës, fizikës, kimisë, bazat e informatikës, gjuhë e huaj, etj., të cilat ngrihen mbi njohuritë e marra në shkollat e mesme. Mbi këto njohuri, ngrihen disiplinat që japin formimin bazë shkencor në fushën përkatëse inxhinierike, si dhe njohuri të tjera më profesionale që e aftësojnë studentin të marrë pjesë në zgjidhjen e problemeve inxhinierike, menaxhimin e veprimtarive ose projekteve komplekse teknike e profesionale dhe të marrë vendime në një situatë të paparashikuar punë. Në disiplinat të ndryshme aplikohen forma të kontrollit periodik gjatë zhvillimit të lëndës, për të bërë të mundur që studenti të përgatitet sistematikisht. Në mjaft disiplina aplikohen punë laboratorike, nëpërmjet të cilave studentët fitojnë aftësim praktik në fushat përkatëse. Disiplinat inxhinierike parashikojnë detyra dhe projekte të pavarura, të cilat studenti i kryen nën drejtimin e pedagogut. Gjithashtu në disiplina të ndryshme organizohen ekskursione mësimore ose praktika lëndore, për të bërë të mundur njohjen e studentit me anën praktike të programit të studimit.
- ✓ Programet e studimit "Master i Shkencave" japin njohuri të thelluara shkencore në fushat inxhinierike me synimin e formimit të inxhinierëve projektues dhe drejtues të proceseve të zbatimit. Studenti aftësohet të përdorë metoda bashkëkohore llogaritëse dhe të realizojë projekte të ndryshme në fushat përkatëse inxhinierike. Programet e studimit "Master Profesional" synojnë të thellojnë shprehitë praktike inxhinierike, duke krijuar profilizime më të ngushta. Disa fakultete si: Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Fakulteti Inxhinierisë Mekanike, Fakulteti Inxhinierisë së Ndërtimit, kanë krijuar një diversitet programesh studimi të ciklit të dytë duke krijuar shumë profilizime. Fakultete të tjera kanë ruajtur linjën vertikale të thellimit të njohurive pa krijuar degëzime dhe profilizime të shumta. Kjo ka ardhur si rezultat i natyrës i fushës së studimit dhe kërkesave që ka tregu i punës për profilizime nga njëra anë si dhe i kapaciteteve të fakulteteve për realizimin e këtyre programeve të studimit si në drejtim të kualifikimit të stafit, ashtu edhe në drejtim të infrastrukturës laboratorike dhe përvojave të fituara. Të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë të implementuara në Universitetin Politeknik janë në harmoni të plotë me fushat e kërkimit të njësive bazë dhe të ekspertizës që ofron personeli akademik. Oferta akademike e UPT me programet e studimit Master i Shkencave është zgjeruar me programe të përbashkëta studimi me partnerë ndërkombëtarë. Të gjithë studentët që mbarojnë një program studimi të ciklit të parë u krijohet mundësia për të ndjekur një program studimi të ciklit të dytë në linjën vertikale ose në programe studimi të përafërta. Studentët që përfundojnë studimet në një program studimi "Master i Shkencave" në fushën përkatëse inxhinierike ka mundësi të ndjekin studimet në programet e ciklit të tretë të studimeve. Në politikat e universitetit, si dhe në zbatim të kornizës ligjore në fuqi, stafi

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

akademik i përfshirë në mësimdhënie në ciklin e dytë të studimeve është, kryesisht, të paktën me gradë shkencore Doktor. Në disa raste specifike, në mungesë të stafit me gradë shkencore dhe tituj akademik, janë aktivizuar staf akademik me titull Msc, të cilët janë me eksperiencë në projektim dhe në zbatim.

- ✓ Programet e studimit të doktoraturës mbështeten tërësisht në projekte kërkimore. Studentët përfshihen në punë kërkimore nën drejtimin e udhëheqësit. Ata thellojnë njohuritë e tyre teorike.
- ✓ Programet e studimit që ofrohen nga Universiteti Politeknik i Tiranës përgatisin specialistë, që synojnë të punësohen në sipërmarrje organizata biznese prodhuese të produkteve industriale apo shërbime në fushat inxhinierike, siç janë fusha e ndërtimit, hidroteknike, projektimet arkitektonike, gjeodezike, ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit, energjitike dhe automatizim, elektronike, telekomunikacion, inxhinieria informatike, mekanike, materiale, tekstile, gjeologji, miniera, nafte dhe gaz, dhe nën fusha të tjera që dalin nga këto fusha kryesore. Disa programe studimi janë shpallur programe me prioritet kombëtar, pasi u përkasin fushave me rëndësi për ekonominë. Në Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT) janë shpallur dy programe studimi prioritare të ciklit të parë në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave: "Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike" dhe "Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare". Këto programe synojnë forcimin e rolit të fakultetit si njësi akademike me ekspertizë të konsoliduar në gjeoshkenca, miniera dhe industri nxjerrëse, si dhe në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.
- ✓ Referuar tendencave të zhvillimit të ekonomisë, si dhe aftësisë për përthithje që i bën tregu i punës në Shqipëri, por edhe në rajon, mund të themi që programet e studimit të ofruar plotësojnë në një masë të caktuar kërkesat dhe nevojat e tregut. Propozimet për hapjen e programeve të reja të studimit janë shoqëruar gjithmonë me argumentime dhe kërkime të tregut. Gjatë rishikimeve të programeve të studimit, janë përcaktuar rezultatet e të nxënit dhe kompetencat në dalje që fiton studenti, duke ju referuar kërkesave të tregut të punës ku synohet të punësohet studenti në përfundim të studimeve. Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, te organizuar nga UPT, si pjesëmarrje në panairet e punës, organizime workshope, takime, tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues të bizneseve apo vizita në terren në biznese të ndryshme në kuadrin e praktikave profesionale, etj., shkëmbehen mendime dhe opinione në lidhje me kërkesat që kanë bizneset për njohuri dhe aftësi të të diplomuarve tanë. Të gjithë këto indikatorë merren në konsideratë për të përmirësuar programet lëndore apo planet mësimore. Universiteti Politeknik i Tiranës, me një përvojë 74 vjeçare në përgatitjen e specialistëve në fushat inxhinierike, ofron programe studimi të konsoliduara dhe tashmë të afirmuara nga tregu i punës. Në UPT janë ngritur strukturat dhe po vendosen mekanizmat për realizimin e studimeve të tregut të punës për fushat tona të studimit si dhe për gjurmimin e punësimit të studentëve në përputhje me profesionin. Një analizë të mirëfilltë dhe të plotë të tregut për çdo fushë/nën fushë studimi, në të cilat janë organizuar programet tona të studimit, ende nuk ka përfunduar. Zyrat e Karrierës të njësive kryesore duhet të përfundojnë analizat e tregut të punës për të gjitha programet e studimit që ofron Fakulteti.

Organizimi i planeve mësimore i programeve studimi është bërë duke marrë në konsideratë përvojën e vet universitetit, kërkesat e tregut të brendshëm të punës, si dhe përvojat dhe zhvillimet në

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

universitete të ngjashme Europiane. Përmbajtja e planit mësimor, syllabuseve, zhvillimi i laboratorëve, detyrave të kursit, projekteve të kursit, organizimi i praktikave profesionale dhe i punimit të diplomës sigurojnë arritjen e objektivave formuese për çdo disiplinë si dhe rezultatet e të nxënit të programit të studimit.

Realizimi i procesit mësimor mbështetet në planin mësimor të çdo programi studimi. Organizimi i grupeve mësimore me jo më shumë se 25 studentë, bën të mundur që gjatë zhvillimit të orëve praktike nëpërmjet ushtrimeve apo laboratorëve, studenti të aktivizohet më shumë në mësim. Planifikimi në syllabus i orëve dhe tematikave të leksioneve që do zhvillohen sipas javëve të semestrit, monitorimi i zbatimit të orarit mësimor nga i gjithë personeli akademik, organizimi i grupeve të leksioneve në përputhje me kapacitetin e sallave të mësimit, përdorimi i teknikave audiovizive të gërshetuar me interpretimin dhe sqarime ne tabelë, pajisja e studentëve me materiale didaktike, etj., krijon kushte që studenti të ndjek normalisht shpjegimet, interpretimet dhe të studiojë individualisht në mënyrë sistematike përmbajtjen teorike të lëndës. Organizimi i punëve laboratorike, zhvillimi i detyrave të kursit apo i projekteve të kursit nën drejtimin e pedagogut, bëjnë të mundur që studenti të fitojë shprehi praktike laboratorike dhe të kryejë zgjidhje projektesh sipas natyrës së disiplinës/modulit. Kryerja e praktikave profesionale pranë bizneseve të vogla apo të mëdha bën të mundur që studenti të konkretizojë në praktikë njohuritë teorike që ka përftuar. Vlerësimi përfundimtar i studentit mbështetet në performancën e tij në të gjitha aktivitetet formuese të lëndës, si: detyra, projekte, punët laboratorike, kontrolle të ndërmjetme, etj. Kjo nxit studentin të punojë gjatë gjithë semestrit, duke rritur shkallën e përfitimit të dijeve.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

6 ORGANIZIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT DHE PËRMIRËSIMI I TYRE.

Të gjitha programet e studimit janë të organizuara në module, të shprehura me kredite; modulet janë të grupuara sipas kategorive formuese në raporte të mirëpërcaktuara, konform me kornizën ligjore në fuqi dhe me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies. Në UPT është bërë një punë e madhe për të riorganizuar të gjitha programet e studimit në përshtatje me aktet përkatëse nën-ligjore. Të gjitha programet e studimit respektojnë standardet shtetërore dhe ato institucionale në lidhje me organizimin e tyre në kredite, ndarjen e krediteve sipas aktiviteteve formuese të lëndës, përcaktimi i ngarkesës në orë në auditor për lëndën, ngarkesën javore, semestrale dhe vjetore të studentit, etj. Shpërndarja e disiplinave sipas semestrave/viteve akademike bëhet duke respektuar numrin e krediteve që duhet të fitojë studenti në një vit akademik, 60 ECTS, shpërndarja e balancuar e krediteve sipas semestrave të një viti akademik (rreth 30 ECTS), dhe formimin paraprak në njohuri dhe dije që duhet të ketë fituar studenti gjatë procesit të mësim nxënies.

Planet mësimore dhe syllabuset miratohen paraprakisht për çdo vit akademik. Plani mësimor miratohet në Senatin Akademik, ndërsa syllabuset në departamentet përkatëse. UPT i ka standardizuar këto dokumente bazë, të cilat përmbajnë të gjitha elementët e nevojshëm konform me kërkesat e kornizës ligjore në fuqi. Në zbatim të Rregullores së Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies si dhe të Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë, në UPT është ngritur, në nivel njësie bazë, Këshilli i Programit të Studimit (KPS) dhe është përcaktuar koordinatori i programit të studimit, për çdo program studimi të ofruar nga departamenti, të cilët kanë për detyrë të merren me organizimin dhe menaxhimin e programeve të studimit, të ri ose ekzistues.

6.1 ORGANIZIMI I MËSIMDHËNIES

6.1.1 Struktura mësimore

Mësimdhënia organizohet në përputhje me strukturën mësimore të UPT. Të gjithë fakultetet i kryejnë aktivitetet e procesit mësimor në përputhje me strukturën mësimore vjetore dhe Udhëzimet përkatëse të MA. Struktura mësimore planifikon periudhën e mësimdhënies sipas semestrave (2 semestra), sezonet e provimeve (3 sezone), sezonet e mbrojtjes se diplomave (3 sezone menjëherë pas sezoneve të provimeve).

Mbështetur në strukturën mësimore, fakultetet hartojnë oraret e mësimit dhe merren masat për zhvillimin e rregullt të procesit mësimor.

6.1.2 Kriteret e pranimit

Pranimet në UPT zhvillohen mbështetur në kriteret që janë të përgjithshme dhe të zbatueshme për çdo kandidat, që aplikon në një program studimi, në të dy ciklet e studimit. Kriteret vendosen mbështetur në një analizë të kushteve konkrete në të cilën veprohet, duke synuar të tërhiqen kandidatët me rezultate

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

më të larta. Për ciklin e parë të studimeve dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë, kriteret propozohen nga departamenti përkatës dhe marrin miratimin përfundimtar në Senatin Akademik. Për programet e studimit të ciklit të parë, të ofruara nga fakultetet FIM, FGJM, FIN dhe FIMIF u përdor formula e përgjithshme e UPT për vlerësimin me pikë të kandidatit, në të cilën merren në konsideratë rezultati i përgjithshëm të shkollës së mesme të lartë të kandidatit si dhe rezultatet në lëndët e matematikës, fizikës dhe kimisë, sipas një peshe të përcaktuar:

$$[\,0.7\times Mes_{(VKM)} + 0.3\times(\,0.5\times Mes_{(Matematikë)} + 0.4\times Mes_{(Fizikë)} + 0.1\times Mes_{(Kimi)})]\times K_{(Koef.\ Shkollës)}\times 1000$$

Për programet e ciklit të parë të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Fakultetin e Inxhinierisë u përdor një formulë e modifikuar, në të cilën nuk u mor në konsideratë rezultatet e kandidatit në lëndën e Kimisë:

$$[\,0.7\times Mes_{(VKM)} + 0.3\times(\,0.6\times Mes_{(Matematikë)} + 0.4\times Mes_{(Fizikë)}\,)\,]\times K_{(Koef.\ Shkollës)}\times 1000$$

Në programet e integruara të studimit në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, pranimi bëhet duke marrë në konsideratë rezultatin e përgjithshëm të shkollës së mesme të lartë dhe atij të testimit të organizuar nga FAU, sipas formulës:

$$0.4\times Mes_{(VKM)} \times K_{(Koef.\ Shkollës)} \times 1000 + 0.6 \times T_{(Testi)} \times 100$$

$T_{(Testi)}$, rezultati i testimit, i cili përbëhet nga katër (4) komponentë:

- **Test i arsyetimit logjik** **25% $T_{(Testi)}$, (25 pikë)**
- **Test i kulturës së përgjithshme** **25% $T_{(Testi)}$, (25 pikë)**
- **Test i historisë dhe historisë së arkitekturës** **25% $T_{(Testi)}$, (25 pikë)**
- **Test i vizatimit dhe prezantimit** **25% $T_{(Testi)}$, (25 pikë)**

Kriteret e pranimit, për ciklin e parë dhe programet e integruara te studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, miratohen 2 vite para, për t'i dhënë mundësi nxënësve të shkollës së mesme të bëjnë përzgjedhjen e disiplinave, që do të ndjekin në vitin e fundit të shkollës së mesme të lartë.

Për ciklin e dytë të studimeve, kriteret propozohen nga departamenti dhe miratohen në dekanat dhe bëhen publike në faqen zyrtare të fakulteteve dhe të UPT, si dhe shpallen në mjediset e fakultetit. Për të gjitha ciklet e studimit, vendosen kriteret minimale përjashtuese, si: nota mesatare minimale, kriteri i gjuhës së huaj, etj., dhe kriteri i vlerësimit me pikë, mbi bazë të së cilës bëhet renditja e aplikantëve. Kjo bën të mundur të përzgjidhen kandidatët më të mirë midis aplikantëve.

6.1.3 Kuotat e pranimit

Numri i pranimeve kufizohet nga kuotat e vendosura për çdo program studimi. Kuotat propozohen nga departamentet, miratohen në Dekanatin e Fakultetit dhe në Senatin Akademik të UPT. Në propozimin e kuotave, respektohet një politikë e UPT, ku parashikohen kuota për kategoritë e veçanta të studentëve, si kandidatë nga trojet shqipfolëse jashtë kufijve, shtetas të huaj, nga shtresat në nevojë, kandidatë me aftësi të veçantë, për transferim studimesh apo program të dytë studimi. Në planifikimin e numrit të studentëve në hyrje, departamentet dhe fakultetet marrin në konsideratë kapacitetet

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

infrastrukturore, si: ambjentet e mesimdhenies në fakultet, postet e punës në laboratore, numrin e stafit akademik efektiv dhe ngarkesen e tyre. Kuotat certifikohen nga MA pas verifikimit të kapaciteteve pritëse që ka UPT për çdo program studimi.

Për vitin akademik 2024-2025 kuotat e pranimit për cdo cikël studimi në nivel universiteti ishin si në tabelë:

Tabela: Kuotat e pranimit për çdo cikël studimi për vitin 2024-2025.

Viti akademik	Kuotat e ciklit të parë Bch		Kuotat e ciklit të dytë Msc		Kuotat e ciklit të dytë MP	
	Gjithsej	kryesore	Gjithsej	kryesore	Gjithsej	kryesore
2023-2024	2076	1679	1416	931	642	439
2024-2025	2071	1704	1449	978	605	426

Në nivel institucional (UPT) në vitin akademik 2024-2025 janë miratuar në total 4125 kuota (nga 4134 kuota gjithsej të miratuara në v.a.2023-2024), nga të cilat 3108 (nga 3049 kuota kryesore të miratuara në v.a.2023-2024) ishin të dedikuara si kuota kryesore dhe 1017 ishin kuota dytësore. Planifikimi i kuotave bëhet përgjithsisht brenda kapaciteteve maksimale pritëse të UPT, të certifikuara nga MA.

6.1.4 Hyrjet për vitin akademik 2024-2025

Regjistrimet për vitin e parë, në të dy ciklet e studimit bëhen sipas afateve kohore, të përcaktuar nga udhëzimet e MAS dhe kalendari i regjistrimeve të përcaktuar nga QSHA dhe RASH. Planifikimi dhe realizimi i kuotave sipas fakulteteve jepen në tabelat e mëposhtme:

Tabela: Planifikimi dhe realizimi i kuotave sipas fakulteteve për vitin 2024-2025.

	UPT	FTI	FGJM	FIMIF	FIE	FAU	FIN	FIM
Planifikimi	4125	872	568	230	431	225	958	841
Realizimi	2605	636	371	67	362	190	576	403
% e realizimit	63.15%	72.93%	65.31%	29.13%	83.99%	84.44%	60.12%	47.91%

Shkalla më e ulët e realizimit të kuotave është për kategorinë kuota dytësore, ku për shumë programe studimi nuk ka patur fare regjistrime, si dhe në disa programe studimi të ciklit të dytë. Krahasuar me vitin akademik 2023-2024, në të cilën realizimi i kuotave totale ishte 53.02%, kemi një rritje në përqindje të realizimit të kuotave. Numri i të regjistruarve për vitin akademik 2024-2025 është 10.13% më i lartë se ai i një viti më parë. Procesi i regjistrimit të kandidatëve, në ciklin e parë të studimeve, nga kategoritë dytësore nuk shkon në linjën e regjistrimit të kandidatëve në kategorinë kryesore, dhe periudha kohore për të bërë ndryshime në shpërndarjen e kuotave dytësore në ato kryesore është shumë e limituar. Kjo bën që pavarësisht se mund të kemi vende të lira në një program studimi dhe kërkesa nga kategoria e kandidatëve kryesorë, nuk mund të bëjmë regjistrime për shkak të pamundësisë së realizimit të rialokimit të kuotave në kohë. Për këtë, do të ishte mirë që fakultetet të analizojnë trendin e regjistrimeve në programet e tyre të studimit të ciklit të parë dhe te mundohen të bëjnë një planifikim sa më real në shpërndarjen e kuotave sipas kategorive.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

6.2 VEPRIMTARIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Rrjeti i cilësisë përbëhet nga Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC), e ngritur në Rektoratin e UPT dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NjSC) në çdo njësi kryesore.

Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë koordinon proceset e sigurimit të cilësisë në nivel institucional si dhe administron dhe analizon statistikat institucionale. DSBC mban kontakte të vazhdueshme me strukturat e NjSC në njësitë kryesore.

Gjatë vitit akademik 2024-2025, DSBC ka zhvilluar aktivitete dhe procese të cilat synojnë zhvillimin e sistemit të cilësisë duke mbështetur vlerësimin, trajnimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në UPT si më poshtë:

- ✓ Zhvillimi i anketimeve studentore semestrale;
- ✓ Hartimi i rekomandimeve bazuar në analizën e vlerësimeve të studentëve;
- ✓ Ndjekje dhe adresim të rekomandimeve;
- ✓ Analizë të dhënash në nivel universiteti, fakulteti, program studimi;
- ✓ Realizim i raporteve mbi anketimin studentor;
- ✓ Koordinim i proceseve të akreditimit me fakultetet dhe ASCAL;
- ✓ Ndjekje dhe zbatim të rekomandimeve të lëna nga BA dhe Planeve të Veprimit përkatës;
- ✓ Mbledhje dhe analizim të dhënash statistikore për UPT dhe raportim periodik në institucionet përkatëse;
- ✓ Analiza të proceseve administrative dhe akademike që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë, hartimin e propozimeve dhe adresimin e gjetjeve;
- ✓ Trajnime dhe aktivitete të tjera me fokus në rritjen e kulturës së cilësisë në Institucion.

Veprimtaria e DSBC e përmendur më lart, është përkthyer edhe në dokumentacion (template) të cilat ndihmojnë fakultetet por edhe vetë DSBC në vënien në zbatim të proceseve dhe monitorimin e tyre.

Gjatë vitit akademik 2024-2025, DSBC ka hartuar disa dokumente si më poshtë:

Raport mbi Anketimin Studentor për vitin akademik 2024-2025, Sem. I (link):

https://upt.edu.al/wp-content/uploads/2025/06/RAPORTI-I-ANKETIMIT-2024-2025-SEM-I-1.pdf;

Raport mbi Anketimin Studentor për vitin akademik 2024-2025, Sem. II (link):

https://upt.edu.al/wp-content/uploads/2025/11/RAPORT-MBI-ANKETIMIN-STUDENTOR-PER-VITIN-AKADEMIK-2024-2025-SEM-II.pdf;

Analizë krahasimore midis trendeve të cilësisë së UPT-së dhe IAL-ve (2016-2023);

Templati "Plani i Veprimit për përmbushjen e rekomandimeve" (për programet e studimit të akredituara);

Templati "Follow-Up" (raport i masave të marra mbi rezultatet e anketimit studentor).

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Në mënyrë të përmbledhur, më poshtë paraqiten disa tregues statistikorë të UPT-së për vitin akademik 2024-2025, të krahasuara me dy vitet e mëparshme (2022-2023; 2023-2024):

Të dhëna statistikore	Cikli	2022-2023	2023-2024	2024-2025
Numri i studenteve	Cikli I (Bachelor)	10,606 (71.8%)	10,243 (72.3%)	9,212 (70.9%)
	Cikli II (PIND, MSH, MP)	4,124 (27.9%)	3,854 (27.2%)	3,667 (28.2%)
	Cikli III (Doktoraturë)	42 (0.3%)	76 (0.5%)	120 (0.9%)
	Total	**14,772 (100%)**	**14,173 (100%)**	**12,999 (100%)**
Regjistrimi i studenteve në vit të parë	Cikli I (Bachelor)	1,306 (55.0%)	1,300 (58.3%)	1,244 (53.3%)
	Cikli II (PIND, MSH, MP)	1,027 (43.3%)	903 (40.5%)	1,045 (44.8%)
	Cikli III (Doktoraturë)	41 (1.7%)	27 (1.2%)	45 (1.9%)
	Total	**2,374 (100%)**	**2,230 (100%)**	**2,334 (100%)**
Diplomime	Cikli I (Bachelor)	1,037 (55.7%)	1,120 (55.8%)	1,085 (58.6%)
	Cikli II (PIND, MSH, MP)	823 (44.2%)	888 (44.2%)	765 (41.3%)
	Cikli III (Doktoraturë)	3 (0.2%)	- (0.0%)	3 (0.2%)
	Total	**1,863 (100%)**	**2,008 (100%)**	**1,853 (100%)**
Diplomime brenda kohës normale të studimit	Cikli I (Bachelor)	585 (56.0%)	638 (55.9%)	565 (55.3%)
	Cikli II (PIND, MSH, MP)	458 (43.8%)	504 (44.1%)	454 (44.4%)
	Cikli III (Doktoraturë)	2 (0.2%)	- (0.0%)	3 (0.3%)
	Total	**1,045 (100%)**	**1,142 (100%)**	**1,022 (100%)**
(*)Numri i programeve të studimit	Cikli I (Bachelor)	22	23	23
	Cikli II (PIND, MSH, MP)	49	51	45
	Cikli III (Doktoraturë)	10	10	13
	Total	**81**	**84**	**81**
Numri i programeve të akredituara (Në vitin aktual)	Cikli I (Bachelor)	-	10	7
	Cikli II (PIND, MSH, MP)	-	1	2
	Cikli III (Doktoraturë)	-	-	-
	Total	-	**11**	**9**
Numri i stafit efektiv (Titulli / Grada)	Profesor (Prof; Prof.Asoc; Akademik)	110 (28.9%)	130 (34.9%)	161 (42.4%)
	Lektor (Doktor)	189 (49.7%)	154 (41.3%)	126 (33.2%)
	Asistent Lektor (Master i Shkencave)	81 (21.3%)	89 (23.9%)	93 (24.5%)
	Total	**380 (100%)**	**373 (100%)**	**380 (100%)**
Numri i stafit me kontratë (Titulli/Grada)	Profesor (Prof; Prof.Asoc; Akademik)	37 (9.6%)	41 (10.8%)	44 (13.7%)
	Lektor (Doktor)	78 (20.3%)	61 (16.1%)	55 (17.1%)
	Asistent Lektor (Master i Shkencave)	269 (70.1%)	278 (73.2%)	222 (69.2%)
	Total	**384 (100%)**	**380 (100%)**	**321 (100%)**

(*)Programet me më shumë se një profil, janë konsideruar si një program i vetëm (bazuar në ligjin e arsimit të lartë 80/2015)

Figura 28: Tregues statistikorë për vitin akademik 2024-2025, 2022-2023 dhe 2023-2024.

Në kuadër të raportimit vjetor, në vijim paraqiten të dhënat mbi veprimtarinë për sigurimin e cilësisë në fakultete për vitin akademik 2024-2025 [Tetor 2024 - Shtator 2025], sipas tabelave të mëposhtme:

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

6.2.1 Ndryshimet në aktet e brendshme rregullatore

Tabela 8.1: Ndryshimet në aktet e brendshme rregullatore.

Fakulteti	Emërtimi i dokumentit	Data e miratimit	Shënime: Përshkrim i shkurtër i ndryshimeve /Dokument i ri
FAU	Rregullore mbi Pranimet në Programet e Integruara të Ciklit të Dytë të Studimeve dhe në Programin e Ciklit të Parë të Studimeve për vitin akademik 25-26	02/07/2025	Rregullore mbi të cilën zhvillohen testet e pranimit të studentëve për programet e studimit që ofron FAU.
FGJM	Rregullore e programit të studimit Bachelor ne "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit"	2024	
	Rregullore e programit të studimit Doktoratë në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit	2025	
FIE	Rregullorja e këshillit të profesorëve	2024	Përshtatur me legjislacionin në fuqi.
FIM	Plani Strategjik i Departamentit të Energjitikës	17/02/2025	
	Plani Strategjik i Departamentit të Tekstilit dhe Modës	17/02/2025	
	Plani Strategjik i Departamentit të Mekanikës	17/02/2025	
	Plani Strategjik i Departamentit të Prodhimit dhe Menaxhimit	17/02/2025	
	Rregullorja e Brendshme e Departamentit të Prodhimit dhe Menaxhimit	03/12/2024	
	Rregullorja e Programit të Ciklit të Dytë të Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, profili Konstruksion Makinash dhe Mjete Lëvizëse	03/12/2024	
	Rregullorja e Programit të Ciklit të Dytë të Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, profili Prodhim dhe Menaxhim Industrial	03/12/2024	
	Rregullorja e Programit të Ciklit të Dytë të Studimit "Master i Shkencave në Inxhinieri Ekonomike"	03/12/2024	
	Rregullorja e Programit të Ciklit të Dytë të Studimit Master i Shkencave në Inxhinieri Materiale, profili Materiale	03/12/2024	
	Rregullorja e Studimeve të Doktoraturës të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike	01/11/2024	
FIN	GJURMA E AUDITIMIT "Për ngarkesën mësimore vjetore dhe orët suplementare të personelit akademik të punësuar me kohë të plotë dhe të pjesshme në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin Politeknik të Tiranës"	11/03/2025	Miratohet me Vendim Dekanati Nr. 18
IGJEO	Plani strategjik i Departamentit të Sizmiologjise	Nr. 432/3 Prot., datë 08/01/2025	Strategjia bazohet në realitetin aktual sizmik të Shqipërisë dhe nevojën për informacion të besueshëm, të standardizuar dhe në kohë reale.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Bazuar në Statutin e Univeristetit Politeknik të Tiranës, Kreu IX, Neni 78 *"Organizimi strukturor i sigurimit të cilësisë në UPT"*, më poshtë paraqitet përbërja e Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT dhe rrjeti i cilësisë në fakultete.

6.2.2 Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë në UPT dhe fakultete

Tabela 8.2: Përbërja e Njësisë së Sigurimit të Cilësisë në UPT dhe fakultete.

UPT/ Fakulteti	Pozicioni në fakultet	Anëtari i NjSC	Kontakt
DSBC	Drejtor i DSBC	Prof. Asoc. Gjergji Islami	gjergjislami@upt.al
	Përgjegjëse Sektori i DSBC	Besmira Poçi	besmira.poci@gmail.com
	Specialist i DSBC	Elona Shanku	elonashanku@gmail.com
	Specialist i DSBC	Valbona Dervishllari	v.dervishllari@upt.al
FAU	Zv. Dekan	Dr. Ani Tola	ani.tola@fau.edu.al
	Specialist i sigurimit të cilësisë	Marsilda Zeqiraj	Marsilda.zeqiraj@fau.edu.al
FGJM	Zv. Dekan	Dr. Altin Karriqi	altin.karriqi@fgjm.edu.al
	Specialist i sigurimit të cilësisë	Melisa Bozhanaj	melisa.bozhanaj@fgjm.edu.al
FIE	Zv. Dekan	Prof. Asoc. Alfred Pjetri	alfredpjetri@gmail.com
	Specialist i sigurimit të cilësisë	Irida Balla	Irida.balla1@gmail.com
	Pedagog	Prof. Asoc. Gentian Dume	Gentian.dume@gmail.com
	Sekretaria mesimore	Teuta Alla	teuta.alla1@yahoo.com
	Student	Klementina Doko	klementinadoko@gmail.com
FIM	Zv. Dekan	Prof. Dr. Altin Dorri	adorri@fim.edu.al
	Specialist i sigurimit të cilësisë	Msc. Jona Amiti	jamiti@fim.edu.al
	Student	David Ndokaj	david.ndokaj@fim.edu.al
FIMIF	Zv. Dekan	Prof. Asoc. Dhurata Kuqi	dh.kuqi@fimif.edu.al
	Specialist i sigurimit të cilësisë	Rozina Ramaj	r.ramaj@fimif.edu.al
	Student	Glen Alibali	g.alibali@fimif.edu.al
FIN	Zv. Dekan	Dr. Alketa Ndoj	alketa.ndoj@fin.edu.al
	Specialist i sigurimit të cilësisë	Msc. Irena Katiaj	irena.katiaj@fin.edu.al
FTI	Zv. Dekan	Dr. Nelda Kote	nkote@fti.edu.al
	Specialist i sigurimit të cilësisë	M. Sc. Suada Bylyku	sbylyku@fti.edu.al
IGJEO	Drejtor	Prof. Dr. Ylber Muceku	y.muceku@geo.edu.al
	Zv.Drejtor	Dr. Liljana Lata	l.lata@geo.edu.al
	Përgjegjës i Dep. Gjeologjisë	Prof. Dr. Ibrahim Milushi	ibrahimmilushi@yahoo.com
	Përgjegjës i Dep.Meteorologjisë	Dr. Azem Bardhi	bardhiazem@yahoo.com
	Përgjegjës i Dep.Sizmiologjisë	Dr. Edmond Dushi	e.dushi@geo.edu.al
	Përgjegjës i Dep.Hidrologjisë	Dr. Klodian Zaimi	klodianzaimi@yahoo.com
	Ekspertët kyç	Sipas rastit	Të ndryshëm në varësi të fushës së kërkimit.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

6.2.3 Veprimtaria për sigurimin e brendshëm të cilësisë në fakultet

Gjatë vitit akademik 2024-2025, njësitë e sigurimit të cilësisë në fakultete (NjSC) së bashku me drejtorinë e sigurimit të cilësisë në rektorat (DSBC) kanë marrë pjesë në aktivitete dhe procese të cilat lidhen ngushtë me garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Këto aktivitete janë pasqyruar më poshtë të ndara në disa tabela sipas natyrës së aktivitetit apo proceseve që kanë ndodhur gjatë vitit 2024-2025.

6.2.3.1 Proceset e Akreditimit

Gjatë vitit akademik 2024-2025 nuk u zhvilluan procese akreditimi të programeve të sudimit, por Bordi i Akreditimit shpalli vendimet për 10 programet e studimit të cilat kishin përfunduar këtë proces.

Ndërkohë, gjatë këtij viti UPT vijoi punën për aplikimin për akreditim të 11 programeve të tjera të cilat aktualisht janë në fazën e shqyrtimit të aplikimit nga ASCAL.

Tabela më poshtë paraqet vendimet e BA si dhe vitet e akreditimit për çdo program studimi.

Tabela 8.3 Akreditime të programeve të studimit.

Fakulteti	Akreditim për herë të parë	Data e vendimit të B.A.	Anëtarët e GVB	Vlerësimi në vite sipas vendimit të B.A.
FGJM	Bachelor ne "Inxhinieri Gjeologjike"	Vendimi Nr. 68, datë 09/05/2025	Prof. Asoc. Ana Fociro Prof. Dr. Shaqir Nazaj Flutura Hafizi MSc. Aurela Jahja Flutura Karkini	4 (katër) vite
	Bachelor ne "Inxhinieri Gjeoinformatike"	Vendimi Nr. 69, datë 09/05/2025	Dr. Elva Leka Prof. Asoc. Luis Lamani Dr. Dhurata Ndreko Dr. Monika Hoxhaj Migena Tahiri	4 (katër) vite
	Bachelor ne "Inxhinieri Gjeomjedisi"	Vendimi Nr. 70, datë 09/05/2025	MSc. Aurela Jahja Prof. Dr. Arjan Beqiraj Flutura Hafizi Prof. Asoc. Ana Fociro Gloria Andoni	3 (tre) vite
	Bachelor ne "Inxhinieri e Burimeve Minerare"	Vendimi Nr. 71, datë 09/05/2025	Dr. Adelajda Halili Dr. Jorgaq Thanas Dr. Marpol Koço MSc. Pietro Bela Albion Karriqi	3 (tre) vite
	Bachelor ne "Inxhinieri e Naftës dhe Gazit"	Vendimi Nr. 72, datë 09/05/2025	Dr. Bardhosh Seitaj MSc. Erison Karamani MSc. Kejsid Vlashi MSc. Ortenca Gropa Ira Toska	3 (tre) vite
FIE	Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektrike – Mekatronike"	Vendimi Nr. 73 datë 09/05/2025	Prof. Asoc. Miranda Harizaj Prof. Asoc. Donald Selmanaj Dr. Arnisa Myrtellari Dr. Margarita Gjonaj Prof. Asoc. Gentian Dume Serxho Çepa	5 (pesë) vite

Fakulteti	Akreditim për herë të parë	Data e vendimit të B.A.	Anëtarët e GVB	Vlerësimi në vite sipas vendimit të B.A.
FIM	Master i Shkencave Inxhinieri Mekanike profil "Energjitikë"	Vendimi Nr. 74, datë 09/05/2025	Prof. Asoc.Majlinda Alcani Prof. Dr. Altin Dorri Prof. Asoc. Elena Bebi Dr. Artan Hoxha Dr. Ardit Gjeta Msc Ingrida Sinaj Msc. Juvelta Dalipaj Msc. Eriselda Profka Msc. Jona Amiti	5 (pesë) vite
FIMIF	Bachelor në Inxhinierinë Fizike	Vendimi Nr.66, datë 09/05/2025	Prof.Asoc. Dafina Xhako Prof.Asoc. Margarita Kuqali Prof.Asoc. Adhurim Hoxha; Prof.Asoc. Driada Mitrushi; Prof. Dr Partizan Malkaj; Xhoana Mardedaj (studente)	6 (gjashtë) vite
	Bachelor në Inxhinierinë Matematike	Vendimi Nr.67, datë 09/05/2025	Prof. Dr. Lulëzim Hanelli; Prof. Asoc. Teuta Myftiu; Prof. Asoc. Denisa Salillari; Dr. Albina Bisholla; Prof. Asoc. Rajmonda Dervishi Helena Paragoni (studente)	5 (pesë) vite

6.2.3.2 Trajnime nga ASCAL dhe/ose DSBC

Gjatë vitin akademik 2024-2025, ASCAL zhvilloi sondazhin Kombëtar Studentor dhe DSBC zhvilloi dy sondazhet semestralë.

Për të siguruar mbarëvajtjen e këtyre proceseve si dhe garantimin e pjesëmarrjes dhe informimit të studentëve, ASCAL dhe DSBC zhvilluan trajnime të specialistëve të NjSC në fakultete.

Tabela 8.4 Trajnime në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë të realizuara nga ASCAL dhe/ose DSBC

Emërtimi i trajnimit	Data	Pjesëmarrësit	Rezultatet / Temat specifike
Takim informues dhe koordinues për realizimin e Anketimit Studentor, semestri i parë nga DSBC	09/01/2025	Specialistët e Njësive së Sigurimit të Cilësisë (FAU, FIN, FIMIF, FIM, FIE, FTI, FGJM)	Fokusi kryesor i takimit ishte organizimi i punës në terren për informimin e studentëve mbi pyetësorin. Asistencë teknike dhe koordinim i procesit.
Takim për Sondazhin Kombëtar të Studentëve, organizuar nga ASCAL	19/03/2025 dhe 02/04/2025	Specialistët e Njësive së Sigurimit të Cilësisë (FAU, FIN, FIMIF, FIM, FIE, FTI, FGJM) DSBC	Takime informuese në kuadër të zhvillimit të Sondazhit Kombëtar të Studentëve dhe në vijim të fushatës informuese nga ASCAL.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Emërtimi i trajnimit	Data	Pjesëmarrësit	Rezultatet / Temat specifike
Takim informues dhe koordinues për realizimin e Anketimit Studentor, semestri i dytë nga DSBC	19/05/2025	Specialistët e Njësive së Sigurimit të Cilësisë (FAU, FIN, FIMIF, FIM, FIE, FTI, FGJM)	Fokusi kryesor i takimit ishte organizimi i punës në terren për informimin e studentëve mbi pyetësorin. Asistencë teknike dhe koordinim i procesit.

Tabela 8.5 Trajnime të tjera në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë ku ka marrë pjesë Personelit Akademik / Ndihmës-akademik / Administrativ

Emërtimi i trajnimit	Organizator	Data	Pjesëmarrësit	Rezultatet / Temat specifike
Takim rrjetëzimi mbi Këshillimin e Karrierës në Universitete	Risi Albania	19/11/2024	Këshilluesit e Karrierës së UPT-së (FIN, FAU, FIE) dhe Universitetet e tjera.	1. Shkëmbim eksperiencash mes këshilltarëve të karrierës mbi sfidat dhe praktikat më të mira të ofrimit të shërbimeve të karrierës në Universitete. 2. Promovimi i qendrave të karrierës në Universitete përmes fushatës kombëtare mbi Këshillimin e Karrierës dhe të nxënit gjatë gjithë jetës. 3. Konsolidimi i rrjetit të këshilltarëve të karrierës për të vazhduar shkëmbimin e përvojave mbi ofrimin e shërbimit të karrierës.
Trajnimi i testeve të karrierës	Risi Albania	02/12/2024 04/12/2024 10/12/2024 12/12/2024	Këshilluesit e Karrierës së UPT-së (FIN, FAU, FIE) dhe Universitete të tjera.	ADOR - Analiza e kërkesës për orientim VISA - Vlerësimi i Statusit të Identitetit Profesional PGI - Inventari i matjes së interesave CDDQ - Vështirësitë në Procesin e Vendimmarrjes për Karrierën.
Projekti: HINTS – High Innovative VET for Green and Digital Transformations	Erasmus+ Project	20/05/2025	DSBC dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë në fakultete	Fokusi kryesor i këtij aktiviteti ishte i dedikuar zhvillimit profesional të stafit UPT-së dhe shkëmbimit të përvojave me institucione partnerë ndërkombëtarë.

Tabela 8.6 Aktivitete dhe procese për sigurimin e brendshëm në fakultete

Emërtimi i aktivitetit / procesit	Organizator	Data	Pjesëmarrësit	Rezultatet / Temat specifike
Pyetësori Studentor Semestri i parë	DSBC	15/01/2025 - 25/01/2025	Studentët e UPT	Pyetësori ndihmon në krijimin e një panorame të problematikave në UPT, duke u fokusuar tek perceptimi i studentëve në lidhje me universitetin, fakultetin, programin e studimit ku ata studiojnë dhe pedagogët e tyre.
Pyetësori Studentor Semestri i dytë		19/05/2025 - 01/06/2025		

Emërtimi i aktivitetit / procesit	Organizator	Data	Pjesëmarrësit	Rezultatet / Temat specifike
Takime informuese dhe orientuese për studentët e vitit të parë	Rrjeti i Sigurimit të Cilësisë në fakultete (FIN,FAU)	07/10/2024-11/10/2024	Studentët e vitit të parë	Informim i studentëve në lidhje me procesin mësimor, detyrat dhe të drejtat e tyre.
Përditësim të dhënash për vitin akademik 2024-2025 për ASCAL	DSBC/ ASCAL	07/10/2024-21/11/2024	DSBC dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë në fakultete (FIN, FAU, FIMIF)	Përditësimi i të dhënave në sistemin AMS të ASCAL për vitin akademik 24-25 mbi: a) Programet e studimit; b) Stafi Akademik; c) Numri i studentëve; d) Drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë.
Orientim akademik për studentë nga universitete të ndryshme	IGJEO	2024–2025	Staf akademik & studentë	Përmirësim i aksesit në shërbimet dhe të dhënat ne fushat e gjeoshkencave.
Kalibrimi dhe verifikimi periodik i pajisjeve meteorologjike dhe klimatike	Departamenti i Meteorologjisë	2024–2025	Staf teknik dhe akademik i IGJEO	Garantimi i saktësisë së të dhënave meteorologjike dhe klimatike; përputhje me standardet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë.

6.3 ANGAZHIMI I PERSONELIT AKADEMIK

Ndarja e ngarkesës mësimore bëhet në departament në respektim të kërkesave të *Udhëzimit 29, datë 10.09.2018* të MAS dhe përfshin:

- ✓ veprimtari në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, projekte kursi, detyrë kursi);
- ✓ veprimtari jashtë auditorit (ndjekje dhe/ose drejtim i praktikës mësimore profesionale; konsultim studentësh, udhëheqje diplome të ciklit I, II, kontroll i dijeve (provime, kolokiume).

Kjo ngarkesë realizohet nga personel akademik i departamentit, efektiv dhe jo efektiv (me kohë të pjesshme), në përputhje me planet mësimore të programeve të studimit ku është përfshirë njësia bazë përkatëse. Në disa programe studimi përfshihen në mësimdhënie edhe punonjës të Institutit IGJEUM, i cili është pjesë e UPT, duke respektuar raportet 30 % e kohës mësimdhënie dhe 70% e kohës punë kërkimore. Në ndarjen e ngarkesës mbahen në konsideratë disa kritere:

- ✓ Norma e orëve në auditor që duhet të ketë personeli akademik në funksion të statusit të tij;
- ✓ Mbingarkesa e lejuar deri në 200 orë në auditor, sipas Udhëzimit 29, datë 10.09.2018 të MAS;
- ✓ Në raste specifike, tejkalimi deri në 100 orë në auditor të kufirit të mbingarkesës, 200 orë, për të cilën duhet të merret miratimi i Drejtuesit të njësisë kryesore;
- ✓ Ngarkesa e personelit akademik me kontratë, (pedagogë me kohë të pjesshme) shkon deri në 120 orë mësimore vjetore në auditor;
- ✓ Disiplinat ku aktivizohet pedagogu të jenë brenda fushës së tij të kualifikimit dhe të kompetencës;

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

- ✓ Numri i disiplinave që mbulon një pedagog, brenda mundësive të jetë brenda kërkesave të përcaktuar në Udhëzimit 29, datë 10.09.2018 të MAS;
- ✓ Të repektohet në maksimum kriteri i Ligjit 80/2015 për angazhimin në mësimdhënie të personelit akademik në një cikël studimi më të ulët se niveli i tij i kualifikimit.

Realizimi total i ngarkesës mësimore, në auditor, në njësitë kryesore si dhe mbingarkesa maksimale për secilin fakultet jepet në tabelën dhe grafikët e mëposhtëm:

Tabela 9 : Ngarkesa mësimore vjetore në auditor.

Fakultetet	Ngarkesa vjetore në auditor (PAE+PAK)	Ngarkesa vjetore në auditor (PAE)	% e ngarkesës e realizuar nga PAE	Ngarkesa maksimale e realizuar në auditor nga PAE
FIN	19103	15396	80.6	475.5
FGJM	13193	11620	88.1	459
FIE	12262	11244	91.7	535.5
FIMIF	25552	21340	83.5	446
FAU	23031	11280	49.0	478
FTI	18922	14116	74.6	498
FIM	16997	15132	89.0	439.5
UPT	129060	100128	77.6	




Figura 29: Përqindje e ngarkesës akademike e realizuar nga PAE.

Në nivel institucioni, UPT plotëson standardin për realizimin mbi 70% të ngarkesës mësimore nga personel akademik efektiv (PAE). Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike rezulton që PAE mban peshën më të madhe të ngarkesës së realizuar në të dy ciklet e studimit (91.7 %), ndjekur më pas nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike me 89 % dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave me 88.1 %. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës rezulton më përqindjen më të ulët prej 49 %. Kjo vjen për shkak të specifikave në organizimin e disa lëndëve (atelie/studio), ku numri i studentëve në grupet mësimore varion nga 10-15, gjë e cila kërkon angazhimin e një numri më të madh personeli akademik për një

grup mësimor në këto disiplina. Ngarkesa maksimale e realizuar në auditor nga një pedagog efektiv është konstatuar në FIE me 535.5 orë, e pasuar nga FTI me 498 orë. Në të gjithë fakultetet, ngarkesa maksimale e realizuar tregon se kapërcehet kufiri i lejuar i mbingarkimit (200 orë). Mbështetur në raportimet e analizës vjetore të fakulteteve, lidhur me mbingarkesën 200-300 orë të personelit akademik efektiv, Dekanatet janë shprehur me vendime, si më poshtë:

- *Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike*: Miratimi i mbingarkesës mbi 200 orë deri në 300 orë në auditor të pagueshme për stafin akademik efektiv është bërë me Urdhrin e Dekanit të FIM nr. 214, datë 16.11.2024.
- *Fakulteti i Teknologjisë së Informacinit*: Miratimi i mbingarkesës mbi 200 orë deri në 300 orë në auditor të pagueshme për personelin akademik efektiv është bërë me Vendim Nr. 92, datë 16.12.2024, nr. 422/3 Prot. "Miratimin e zhvillimit të realizimit të mbingarkesës mbi 200 orë, për disa pedagogë në FTI, për vitin akademik 2024-2025".
- *Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave*: Miratimi i mbingarkesës mbi 200 orë deri në 300 orë në auditor, të pagueshme për personelin akademik efektiv është bërë mbi bazën e Vendimit të Dekanatit të FGJM nr. 2/1, datë 09.01.2024.
- *Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike*: Miratimi i mbingarkesës mbi 200 orë deri në 300 orë në auditor të pagueshme për stafin akademik efektiv, dekani i FIE është shprehur me Urdhër nr. 25, datë 12.06.2025 për DSEF; nr. 24, datë 12.06.2025 për DA dhe nr. 26, datë 12.06.2025 për DE.
- *Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike*: Miratimi i mbingarkesës mbi 200 orë deri në 300 orë në auditor, të pagueshme për personelin akademik efektiv është bërë me Vendim të Dekanatit nr. 36, datë 25.10.2024 "Për miratimin e orëve suplementare në auditor, deri në 100 orë mbi limitin 200 orë, për vitin akademik 2024-2025".
- *Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës:* Miratimi i mbingarkesës mbi 200 orë deri në 300 orë në auditor, të pagueshme për personelin akademik efektiv është bërë me Vendim nr. 4, datë 10.01.2024.

Në tabelën dhe grafikët e mëposhtëm jepen vlerat mesatare në nivel fakulteti të ngarkesës totale të realizuar nga një PAE, mesatarja e orëve suplementare të realizuar referuar nje mesatare të normës së pedagogut, orët suplementare maksimale të realizuar në fakultet, numri i pedagogëve nën normë.

Tabela 9.1 : Ngarkesa mësimore mesatare vjetore në auditor për PAE

Fakulteti	Nr. PAE	Mes. e ngarkesës totale të realizuar në auditor (PAE)	Mes. e orëve suplementare të realizuar në auditor (PAE)	Mes. e normës së fakultetit (ref. normës PAE)	Orët suplementare maksimale në auditor	Numri i pedagogëve nën-normë
FIN	61	252.4	95.3	157.1	280.5	0
FGJM	47	247.2	98.6	151.6	294	6
FIE	33	340.7	185.1	155.6	370.5	0
FIMIF	70	304.9	159.9	146.9	306	1
FAU	38	296.8	136.7	160.1	313	1
FTI	43	328.3	176.8	151.5	347	5
FIM	53	285.5	138.2	146.0	302	0




Figura 30:Ngarkesa mësimore e realizuar nga PAE.




Figura 31: Orët suplementare në auditor.

Nga analiza e shifrave rezulton se vlera mesatare e ngarkesës totale në auditor, që mban një pedagog efektiv në fakultet luhatet në nivelin 247.2 orë (në FGJM) – 340.7 orë (në FIE). Mesatarja e ngarkesës së normuar në fakultet luhatet në kufijtë 146 (FIM) – 160 (FAU). Në secilin fakultet kemi një mbingarkesë mesatare, të realizuar nga stafi efektiv, që luhatet në kufijtë 95.3 (FIN) – 185.1 (FIE). Udhëzimi 29 përcakton një vlerë maksimale të mbingarkesës së stafit akademik efektiv prej 300 orësh në auditor. Në fakultetet FIE dhe FTI kemi raste ku ngarkesa maksimale në auditor e realizuar nga personeli akademik efektiv është mbi 300 orë në auditor (përkatësisht 370.5 dhe 347 orë në auditor). Në fakultetet FIM, FIMIF dhe FAU kufiri maksimal i ngarkesës në auditor është tejkaluar vetëm me pak orë (nga 2 deri në 13 orë). Vlen të theksohet që nuk është bërë asnjë pagesë për orët që tejkalojnë kufirin maksimal.

Numri i pedagogëve që kanë patur një realizim ngarkesë nën normë është shumë i vogël. Këto raste janë raportuar nga disa fakultete, ku numri më i madh konstatohet në FGJM (6 pedagogë). Në raportet e fakulteteve jepen arsyet e mosrealizimit të normës mësimore nga këta pedagogë, si më poshtë:

- *Në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave,* konstatohen 6 PAE me realizim ngarkese të orëve në auditor nën normën e parashikuar, nga të cilët 3 PAE kanë qenë të angazhuar me procesin e përgatitjes së doktoratës, 1 PAE ka patur arsye shëndetësore dhe 2 PAE kanë realizuar një ngarkesë afër normës së parashikuar. Për të këta janë marrë masa për ngarkimin e tyre me aktivitete të tjera mësimore, si drejtim të praktikave mësimore, udhëheqje tema diplome, etj.
- *Në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit*, konstatohen 2 PAE me realizim ngarkese të orëve në auditor nën normën e parashikuar në Udhëzimin e MA Nr.29, si rrjedhojë e punësimit të tyre përgjatë vitin akademik 2024 – 2025. Për këto rast nuk është bërë reduktimi i normës referuar kohës faktike të angazhimit të tij si personel akademik efektiv.
- *Në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës,* konstatohet 1 PAE me realizim të ngarkesës mësimore nën normën e parashikuar në Udhëzimin e MA Nr.29, datë 10.09.2018, si pasojë e daljes në pension përgjatë vitit akademik 2024-2025. Për këtë rast nuk është bërë reduktimi i normës referuar kohës faktike të angazhimit të tij si personel akademik efektiv.
- *Në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike*, konstatohet 1 PAE pa raportim të ngarkesës mësimore, pasi ka qenë me raport shëndetësor gjatë gjithë vitit akademik.
- Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike nuk ka asnjë PAE me ngarkese të realizuar nën normën mësimore vjetore.

Disa fakultete kanë kryer reduktim të normës për ndonjë pedagog, duke ju referuar dinamikave të ndryshimeve, që kanë ndodhur përgjatë vitit akademik. Këto raste janë raportuar nga fakultetet FIM (7 pedagogë), FIMIF (3 pedagogë) dhe FTI (1 pedagog). Arsyet e reduktimit të normës janë raportuar si më poshtë:

- *Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike*, janë 7 PAE me normë të reduktuar, 5 PAE si rrjedhojë e ndryshimit të statusit të tyre (kanë marrë titullin Prof. Asoc.) gjatë vitin akademik 2024 – 2025 dhe 2 PAE si rrjedhojë e punësimit të tyre përgjatë vitit akademik 2024 – 2025.
- *Në Fakultetin e Inxhinierisë Metematike dhe Inxhinierisë Fizike*, janë 3 PAE me normë të reduktuar, si rrjedhojë e ndryshimit të statusit të tyre (kanë marrë titullin Prof. Asoc.) gjatë vitit akademik 2024-2025.
- *Në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit*, konstatohet 1 PAE me normë të reduktuar, pasi ka qenë me raport shëndetësor gjatë një semestri.

Referuar Udhëzimit Nr. 29, datë 10.9.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", Kreu II, pikës 9, në të cilën citohet se: "Ngarkesa e plotë mësimore vjetore e një anëtari të personelit akademik mund të reduktohet me propozim të njesisë bazë, aprovim nga njësia kryesore dhe me miratim nga bordi i administrimit në rastin e përfitimit të një burse studimi jo më pak se 1-mujore, si dhe në raste të vecanta të angazhimeve në kuadër të kontributit institucional",
fakultetet nuk kanë cituar në material, vendimin e Bordit të Administrimit për reduktimin e normës të kryer nga ana e tyre.

Për personelin akademik me kohë të pjesshme (PAK) ngarkesa e realizuar përgjithësisht është brenda normës maksimale të përcaktuar në Udhëzimin 29, datë 10.9.2018, pavarësisht se ka raste që është tejkaluar norma me 20-110 orë suplementare. Rastet më të shumta vërehen në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës. Pavarësisht këtij tejkalimi, pagesat janë bërë konform me normën e përcaktuar në këtë Udhëzim.

Në tabelën e mëposhtme jepet totali i ngarkesës mësimore vjetore duke konsideruar orët në auditor ashtu dhe veprimtaritë jashtë auditorit sipas Udhëzimit Nr. 29, datë 10.9.2018. Realizimi i ngarkesës mësimore sipas fakulteteve për vitin akademik 2024-2025 jepen në shtojcën nr. 9: Për angazhimin e personelit akademik.

Tabela 9.2: Ngarkesa Mësimore Vjetore Totale në Auditor dhe Jashtë Auditorit (e pagueshme).

Fakultetet	Ngarkesa Mësimore Vjetore Totale në Auditor dhe Jashtë Auditorit (e pagueshme)	
	Ngarkesa Totale Vjetore (PAE+PAK)	Ngarkesa Totale Vjetore (PAE)
FAU	25628	13867
FGJM	15387	13794
FIE	17505	16464
FIM	25264	23399
FIMIF	28817	24605
FIN	24983	21251
FTI	23942	19136
UPT	161526	132516

Veprimtaritë e tjera ku përfshihet stafi akademik lidhur me studime e kërkime shkencore, pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, botime, kontribut profesional dhe ekspertizë, transferim të njohurive dhe teknologjive në prodhim, trajnime, kontribut në zhvillimin institucional të institucionit/ njësisë kryesore/njësisë bazë etj, janë vlerësuar nga pikëpamja cilësore, referuar deklarimeve të bëra në analizën e departamenteve dhe fakulteteve, pasi vlerësimi i tyre nga pikëpamja sasiore të konvertuara në orë pune nuk shprehet në asnjë prej akteve nënligjore, VKM apo Udhëzim, që përbëjnë bazën ligjore të funksionimit të një institucioni publik të arsimit të lartë. Nga ndonjë fakultet ka patur nisma për llogaritje me orë pune të veprimtarive të ndryshme të pedagogut përpos veprimtarisë mësimore, por koeficientët e konvertimit dhe metodologjia e përdorur nuk ka kaluar për miratim në nivel institucioni. Për këtë arsye në tabelën Nr. 9 "Shpërndarja e orëve vjetore të punës për vitin akademik 2024-2025" në shtojcën e këtij raportimi, kolonat 18, 19, 20, 21 janë plotësuar me simbolin N/A (nuk aplikohet) dhe në kolonën 22 është vendosur sasia e orëve vjetore të punës së një pedagogu, sipas Udhëzimit nr.29, datë 10.9.2018.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

6.4 GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE NË UPT

Zyra e Këshillimit të Karrierës (ZK) është një pjesë integrale e strukturës së Universitetit Politeknik të Tiranës dhe funksionon në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të UPT-së. Zyrat e Karrierës janë funksionale në të 7 njësitë qendrore, duke luajtur një rol kyç në lidhjen e universitetit me kërkesat e tregut të punës.

Qëllimi kryesor i ZK-së është të ofrojë informacion dhe mbështetje për studentët dhe të diplomuarit, duke përfshirë orientimin profesional, këshillimin, praktikat profesionale, internship-et dhe mundësitë e punësimit. Veprimtaria e Zyrës mbështetet në një rregullore që përcakton misionin, vizionin, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e saj.

Zyra e Karrierës interesohet për studentët dhe të diplomuarit, duke siguruar që të jenë të kërkuar në tregun e punës. ZK, në bashkëpunim me Alumni, organizojnë anketa online, intervista individuale, për të përditësuar statusin e punësimit dhe përfshirjen e studentëve në aktivitete të universitetit.

Vështirësitë e procesit të gjurmimit

Procesi i gjurmimit të të diplomuarve është kompleks dhe sfidues për shumë arsye, duke përfshirë: mungesën e përgjigjeve nga të diplomuarit, ndryshimet e shpeshta të vendit të punës, kontaktet e vjetruara dhe angazhimet e alumnit. Këto sfida bëjnë që të dhënat nuk janë gjithmonë të plota dhe që gjurmimi i studentëve në të gjitha ciklet e studimeve të jetë i pamundur të realizohet në mënyrë të plotë dhe uniforme.

Tendenca e punësimit për ciklet e studimeve

- Bachelor: Shkalla e punësimit në profil është relativisht e ulët, pasi shumica e të diplomuarve zgjedhin të vazhdojnë studimet në ciklin e dytë (Master). Kjo shpjegon përqindjen më të ulët të integrimit në tregun e punës për këtë cikël.
- Master (Shkencor dhe Profesional): Shkalla e punësimit është më e lartë, pasi studentët e këtij cikli janë më të specializuar dhe tregu i punës kërkon profile të gatshme për punë.

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave

Të dhënat mblidhen duke përdorur:

- Telefonata dhe pyetësorë elektronikë
- Takime gjatë tërheqjes së diplomës

Pyetjet kryesore përfshijnë:

- Statusin aktual të punës
- Përshtatjen me profesionin për të cilin studiuan
- Institucionin publik apo privat ku punojnë
- Punësimin para përfundimit të studimeve
- Kohëzgjatjen e punës (me kohë të plotë apo të pjesshme)

Bashkëpunimi me tregun e punës

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

UPT bashkëpunon ngushtë me kompani dhe institucione që ofrojnë mundësi punësimi, përfshirë: Deloitte Albania shpk, Alba Konstruksion sh.p.k, Lufthansa Solutions, Everest, Albtek Energy, Delmon Group Albania, Albtelecom, Vodafone Albania, Star Albania, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime, OSHE GROUP, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Korporata e Elektroenergjetike Shqiptare etj.

Për vitin akademik 2024–2025

Procesi i gjurmimit është dinamik dhe në përditësim të vazhdueshëm, duke reflektuar statusin aktual të punësimit dhe përparimin e të diplomuarve në tregun e punës. Rezultatet janë ende në përpunim, pasi diplomimet përfunduan në tetor 2025.

Informacioni zyrtar mbi veprimtarinë e Zyrës së Karrierës mund të konfirmohet në adresën: **zyraekarrieres@upt.al**

Universiteti Politeknik i Tiranës, gjatë vitit akademik 2024-2025, ka diplomuar një total prej:

- ✓ **1084 studentësh në Ciklin Bachelor**
- ✓ **122 studentësh në Ciklin Master Profesional**
- ✓ **502 studentësh në Ciklin Master i Shkencave**
- ✓ **126 studentësh në programet PIND**

Analizimi i të dhënave të punësimit, sipas fakulteteve:

1. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN)
   - Punësimi varion nga 48% deri në 100%, në varësi të programit.
   - Programet Master Profesional dhe Master i Shkencave shfaqin nivel të lartë punësimi.
2. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIMIF)
   - Programet Master paraqesin rritje të ndjeshme të punësimit (64–83%)
   - Punësimi në Bachelor është i ulët (14–18%)
   - Punësimi kryesisht në sektorin privat, me prani të moderuar në public.
3. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM)
   - Punësimi në ciklin Master varion nga 40% deri në 75%
   - Programet Bachelor kanë mungesë të dhënash të plota
   - Sektor privat dominues
   - Vetëpunësimi shfaqet në disa programe
4. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU)
   - Punësimi varion nga 37.5% në Bachelor deri në 85.7% në Master Profesional
   - Dominim i sektorit privat
   - Vetëpunësimi i pranishëm
Reformimi në bazë të rezultateve të të mësuarit dhe me qendër studentin	Fakuleti i Inxhinierisë Mekanike/ Departamentet	kursit, projektet semestrale dhe punimet e diplomës. Këto mjete u japin studentëve aftësi për të analizuar dhe optimizuar procese të ndërlikuara teknike, duke i përgatitur ata të përballen me sfidat reale të industrisë. Integrimi i tyre në orët teorike dhe praktike mbështet realizimin e programeve të studimit sipas standardeve europiane dhe i orienton studentët drejt kompetencave profesionale që kërkohen në tregun e punës. Gjithashtu, proceset e reformimit janë fokusuar në përmirësimin e metodave të vlerësimit formativ dhe refleksiv, duke rritur rolin e feedback-ut të vazhdueshëm dhe të konsultimeve akademike. Përdorimi i platformave digjitale të komunikimit dhe menaxhimit të mësimdhënies ka lehtësuar ndërveprimin me studentët, ndjekjen e progresit të tyre dhe harmonizimin e rezultateve të të nxënit me objektivat specifike të kurseve. Këto procese kontribuojnë në një mjedis mësimor më të integruar dhe më efikas, ku studentët përfshihen drejtpërdrejt në fazat kryesore të projektimit, simulimit dhe testimit, duke forcuar lidhjen teori–praktikë dhe duke garantuar rritjen e cilësisë së procesit mësimor dhe kërkimor në fakultet.	të orientuara drejt rezultateve të të nxënit. Përpjekjet e fakultetit kanë përfshirë gjithashtu përditësimin e manualeve të përdorimit të pajisjeve, standardizimin e procedurave laboratorike dhe integrimin e moduleve praktike të reja në lëndët kryesore të programeve bachelor dhe master. Instalimi i softuerëve të rinj inxhinierikë — veçanërisht atyre që mbështesin simulimet numerike, modelimin CAD/CAE dhe analizat termike e mekanike — ka rritur ndjeshëm saktësinë dhe efikasitetin e punëve të kursit dhe të projekteve të studentëve. Këto investime kanë mbështetur jo vetëm rritjen e kapacitetit të mësimdhënies së bazuar në laborator dhe simulim, por edhe integrimin më të plotë të teorisë me praktikën, duke u ofruar studentëve mundësinë të punojnë me teknologji bashkëkohore të ngjashme me ato të industrisë. Përmirësimet e realizuara synojnë të rrisin cilësinë dhe efikasitetin e proceseve edukativo-shkencore, duke përforcuar orientimin e fakultetit drejt mësimdhënies moderne me qendër studentin.	simulimeve numerike, modelimit CAD/CAE, analizave termike dhe laboratorëve virtualë – janë instaluar në të gjitha laboratorët përkatës, duke u bërë tashmë pjesë e pandashme e lëndëve praktike dhe projekteve të studentëve. Ky integrim është realizuar në bashkëpunim me ekspertët e IT-së të fakultetit dhe me grupet e departamenteve, duke siguruar funksionim efikas dhe përdorim të qëndrueshëm në të gjitha ciklet e studimit. Zbatimi i këtyre zhvillimeve është në përputhje të plotë me objektivat e planit strategjik të UPT-së që lidhen me modernizimin e infrastrukturës së kërkimit dhe mësimdhënies dhe me orientimin e arsimit drejt kompetencave praktike. Përmirësimet kanë krijuar një bazë më të fortë për zhvillimin e punëve laboratorike, rritjen e autonomisë praktike të studentëve dhe avancimin e kapaciteteve teknologjike të fakultetit. Në tërësi, këto investime kanë kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit, cilësisë dhe standardeve të proceseve edukativo-shkencore në FIM.	2024-2025 e në vazhdim	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	Nga aplikimi i metodave të reja inovative në lëndë të ndryshme është bërë e mundur rritja e cilësisë së mësidhënies gjë e cila ndikon direkt në ritjen profesionale të studentëve.	Janë zhvilluar takime me kompani te ndryshme, disa workshope dhe konferenca në të cilat janë përfshirë studentët të cilët kanë mundur të aplikojnë njohuritë e fituara gjatë aplikimit të metodave innovative.	Realizimi sipas planit startegjik është në nivel të kënaqshëm.	Tetor 2024 – Shtator 2025	N/A
	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit / Departamentet	Përmirësimi i infrastrukturës laboratorike. Analiza e performancës së studentëve bazuar në rezultatet e provimeve. Përditësimi i sylabuseve të lëndëve.	Analiza mësimore vjetore	Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës laboratorike, pasurimi i bibliotekës me libra të rinj.	Vjetor	
	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës / DA Këshilli i programit të studimit MSHA_Profili Arkitekt BAIND Zyra e cilësisë dhe karrierës	Marrja e feedback nga studentët lidhur me ngarkesën dhe format e mësimdhënies.	Përmirësimi i bashkëpunimit mes lektorëve të lëndëve të ndryshme, për të gjetur pika konvergimi në detyrat e projektet e studentëve, me qëllim lehtësim ngarkese.	Rishikimi I sylabuseve të lëndëve. Nxitja e metodave moderne në zhvillimin e lëndëve dhe praktikave.	Periodikisht çdo dy vite	Feedbacku-u nga studentët mbetet i rëndësishëm, sidomospër lëndët me karakter formues e projektues.
	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike / Departamentet / Qendra e Gjuhëve të huaja/ Alumni	FIMIF synon zhvillimin e aftësive praktike të studentëve, me fokus në zhvillimin efikas të praktikave profesionale për ta. FIMIF nxit dhe mbështet krijimtarinë e studentëve në partneritet të plotë me biznesin dhe institucionet publike dhe jopublike	- Hartimi i një plani të zhvillimit të aftësive praktike. - Zgjerimi i internship për studentët e UPT	- Është realizuar sipas planit strategjik; - Praktikat mësimore zhvillohen konform planit mësimor.	Vjetor	Marrëveshje me kompanitë publike dhe private
	FGJM / Departamentet / Zyra e Karrieres	Eshte planifikuar zgjerimi dhe formalizimi i bashkëpunimit me institucione publike, private dhe industri per zhvillimin e praktikave profesionale per te gjitha programet e studimit master qe ofron FGJM.	Nënshkrim marrëveshjesh për praktika profesionale; praktika profesionale në terren, laboratorë dhe industri; mbikëqyrje akademike dhe monitorimi i praktikave profesionale.	Në proces realizimi sipas planifikimit	2024-2025	Rrit përputhjen me tregun e punës dhe ndikon drejtpërdrejt në punësimin e të diplomuarve.
	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike / Departamentet / Alumni	FIE synon zhvillimin e aftësive praktike të studentëve.	1. Hartimi I një plani të zhvillimit të aftësive praktike. 2. Zgjerimi I intership për studentët e UPT.	Është realizuar sipas planit strategjik.	2021-2024	Marrëveshje me kompanitë publike dhe private

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Sh. DK.

Rritja e cilësisë në praktika profesionale dhe diversifikimi i tyre	Fakuleti i Inxhinierisë Mekanike/ Departamentet	Gjatë vitit akademik 2024–2025, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka vijuar të zgjerojë dhe të konsolidojë bashkëpunimet me kompani dhe institucione të reja që operojnë në sektorët e energjetikës, inxhinierisë mekanike, materialeve, tekstilit dhe menaxhimit industrial. Marrëveshjet e reja të nënshkruara këtë vit kanë krijuar mundësi më të gjera dhe më të strukturuara për zhvillimin e praktikave profesionale, duke i orientuar studentët drejt eksperiencave praktike që pasqyrojnë kërkesat aktuale të tregut të punës. Këto bashkëpunime janë konceptuar për të forcuar ndërveprimin midis fakultetit dhe industrisë, duke mundësuar shkëmbimin e njohurive teknike dhe përfshirjen e studentëve në ambiente reale pune, ku ata mund të zhvillojnë kompetenca të avancuara profesionale. Kompanitë partnere kanë treguar interes të shtuar për të angazhuar studentë dhe të diplomuar të FIM, falë formimit të tyre të specializuar dhe aftësive praktike të fituara gjatë studimeve. Kjo ka çuar në rritjen e mundësive për praktika të personalizuara, të cilat lidhen ngushtë me profilin akademik të studentëve dhe kërkesat specifike të industrisë. Përmes këtyre praktikave, studentët kanë pasur mundësinë të përfshihen në projekte teknike, procese prodhimi, analiza inxhinierike dhe detyra të specializuara që kontribuojnë në zhvillimin e tyre profesional. Bashkëpunimi i vazhdueshëm dhe i strukturuar midis fakultetit dhe industrisë gjatë këtij viti ka luajtur një rol të rëndësishëm në përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës, duke i pajisur ata me aftësi teknike, praktike dhe menaxheriale të nevojshme për realizimin e detyrave komplekse në mjedise profesionale. Këto zhvillime kanë ndihmuar në rritjen e cilësisë së praktikave profesionale dhe kanë kontribuar në diversifikimin e tyre, duke u dhënë studentëve mundësinë të eksplorojnë fusha të reja të specializimit dhe të avancojnë më tej në karrierën e tyre inxhinierike.	Gjatë vitit akademik 2024–2025, bashkëpunimi me kompanitë partnere është intensifikuar përmes organizimit të takimeve të rregullta me aktorët kryesorë të industrisë, ku kanë qenë të pranishëm drejtuesit e departamenteve, koordinatorët e grupeve mësimore dhe pedagogë të profileve përkatëse. Këto takime kanë shërbyer si platformë për shkëmbimin e informacionit dhe për analizimin e nevojave aktuale të tregut, duke identifikuar aftësitë teknike dhe praktike që kërkohen nga industria dhe që duhen integruar në programet mësimore dhe praktikat profesionale të studentëve. Në këtë kuadër, departamentet e fakultetit kanë vijuar me përgatitjen, negocimin dhe hartimin e marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit, të cilat janë formalizuar sipas procedurave ligjore dhe akademike të UPT-së. Ky proces ka siguruar që raportet e krijuara mes FIM dhe kompanive të jenë të qëndrueshme, funksionale dhe të orientuara drejt objektivave afatgjata të zhvillimit akademik dhe profesional. Marrëveshjet e reja kanë zgjeruar gamën e praktikave profesionale, duke përfshirë eksperienca në industri të avancuara dhe subjekte të specializuara në fusha të ndryshme të inxhinierisë mekanike, energjetikës dhe tekstilit. Këto iniciativa kanë kontribuar në krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e praktikave cilësore, duke ofruar mundësi reale punësimi dhe duke lehtësuar integrimin e studentëve në tregun e punës. Përmes këtij procesi, studentët kanë fituar aftësi të avancuara teknike, eksperiencë praktike në detyra të ndërlikuara inxhinierike dhe kompetenca profesionale të domosdoshme për progres në karrierën e tyre. Bashkëpunimi i ngushtë midis fakultetit dhe industrisë ka qenë një element kyç për rritjen e cilësisë së trajnimit praktik dhe për harmonizimin e programeve të studimit me kërkesat bashkëkohore të sektorit industrial.	Gjatë vitit akademik 2024–2025 janë nënshkruar marrëveshje dhe kontrata të reja bashkëpunimi me kompani dhe institucione që operojnë në sektorë të ndryshëm të inxhinierisë, përfshirë energjetikën, mekanikën, prodhimin industrial, materialet, tekstilin dhe fushat e menaxhimit teknik. Këto marrëveshje kanë zgjeruar gamën e mundësive profesionale për studentët dhe të diplomuarit, duke krijuar ura të qëndrueshme bashkëpunimi midis FIM dhe industrisë. Si rezultat i këtyre bashkëpunimeve, një numër studentësh të ciklit Master ka përfituar mundësi punësimi në kompani partnere menjëherë pas përfundimit të studimeve, duke dëshmuar efektivitetin e integrimit të praktikave profesionale me programet akademike. Gjatë periudhës së zbatimit të këtyre marrëveshjeve, disa studentë kanë qenë të përfshirë në projekte teknike, analiza të proceseve inxhinierike dhe detyra praktike të ofruara nga partnerët industrialë, çka ka kontribuar ndjeshëm në zhvillimin e tyre profesional dhe në krijimin e eksperiencave reale të punës. Këto bashkëpunime janë dëshmi e lidhjes së fortë midis programeve të studimit dhe kërkesave të tregut të punës, duke ndihmuar në përgatitjen e kuadrove që zotërojnë njohuri të avancuara dhe aftësi të transferueshme në industrinë moderne. Përmes këtyre marrëveshjeve, studentët kanë përfituar mundësi konkrete për të aplikuar njohuritë e fituara gjatë studimeve në situata reale pune, duke zhvilluar kompetenca profesionale të rëndësishme. Ky proces ka forcuar ndërlidhjen midis formimit universitar dhe punësimit, duke e bërë fakultetin një aktor të rëndësishëm në përgatitjen e specialistëve për tregun e punës dhe në mbështetjen e zhvillimit të karrierave të tyre.	2024-2025	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS REKTORATI SEKRETARIA-DK.

	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	Është parashikuar shtimi dhe diversifikimi i Institucioneve publike dhe private në fushën e Inxhinierisë së Ndërtmit, Mjedisit, Hidroteknikës, Gjeodezisë.	Janë zhvilluara takime me personat përgjegjës të institucioneve dhe kompanive për ofrimin e mundësive për kryerjen e praktikave sa më cilësore.	Realizimi sipas planit startegjik është në nivel të kënaqshëm.	Tetor 2024 – Shtator 2025	N/A
	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit / Departamentet / Zyra e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë, Karrierës dhe Alumni	Sigurimi i zhvillimit të praktikave profesionale pranë kompanive.	Zhvillimi i praktikave profesionale pranë kompanive, hartimi i relacionit të praktikës, mbrojtja dhe vlerësimi i praktikës nga komisioni.	Praktikat mësimore zhvillohen konform planit mësimor.	Vjetor	
	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës / Titullari i lendes Praktike Profesionale / Titullarët e lendeve me module praktike	Sigurimi i intershipeve në sektorin publik dhe privat.	Zgjerimi i partnerëve institucionale për përfshirjen e studentëve në praktika mësimore pranë sektorit privat dhe institucioneve publike.	Marrëveshje të reja bashkëpunimi me studio projektimi, për zhvillimin e praktikave të studentëve brënda dhe jashtë vëndi.	Periodikisht çdo vit.	Në rastet e praktikave profesionale jashtë vëndi të shikohet njohja e prezencës në lëndët e tjera që zhvillohen në semestrin e fundit.
	Administratori/ Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike / Departamentet / Qendra e Gjuhëve të huaja/ IT	FIMIF synon zhvillimin e qendrueshëm të metodave dhe metodikave në mësimdhënie duke u mbështetur në teknologjitë e reja të komunikimit dhe zhvillimit	Përdorimi i viodioprojektorëve në mjediset mësimdhënëse; - Instalimi i video – projektorëve në salla lekisoni. - Perdorimi i software në mësimdhënie	- Është realizuar sipas planit strategjik; - Çdo vit përmirësohet infrastruktura dixhitale duke rritur numrin e pajisjeve në funksion të mësimdhënies	Vjetor	
	FGJM / Departamentet / Drejtoria IT UPT	Digjitalizimi i procesit mësimor dhe përmirësimi i aksesit në burime dixhitale. Modernizim i laboratorëve dhe mjeteve digjitale	Përmirësim i laboratorëve GIS/ Remote Sensing, trajnime IT. Përdorimi i platformave LMS; materiale mësimore online; akses në databaza shkencore	Realizim i planifikuar në masë të kënaqshme	2024-2025	Mbështet mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Nevojiten investime të vazhdueshme.
	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike/ Administratori / Departamentet / IT	FIE synon zhvillimin e qëndrueshëm të metodave dhe metodikave në mësimdhënie duke u mbështetur në teknologjitë e reja të komunikimit dhe zhvillimit.	1. Përdorimi I tabelave interaktive. 2. Instalimi i video-projektorëve në çdo sallë. 3. Perdorimi i software në mësimdhënie.	Është realizuar sipas planit strategjik.	2023-2024	Perdorimi i softeve në mësimdhënie.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Zhvillimi i infrastrukturës dixhitale për përmirësimin e edukimit dhe krijimin e oportuniteteve për personelin akademik	Fakuleti i Inxhinierisë Mekanike/ IT	Gjatë vitit akademik 2024–2025, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka vazhduar të forcojë infrastrukturën dixhitale si pjesë të strategjisë për modernizimin e proceseve akademike dhe administrative. Platforma Microsoft Teams, e cila është shndërruar në një mjet standard të komunikimit dhe mësimdhënies, ka vijuar të përdoret gjerësisht jo vetëm për shpërndarjen e materialeve dhe zhvillimin e konsultimeve, por edhe për koordinimin e aktiviteteve të projekteve dhe punimeve të studentëve. Përdorimi i saj ka ofruar fleksibilitet dhe akses të vazhdueshëm në burimet mësimore, duke mbështetur modelet bashkëkohore të mësimdhënies hibride. Një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe platforma PITAGORA, e cila mbetet një komponent thelbësor në dixhitalizimin e shërbimeve administrative të fakultetit. Përmes saj, sekretaria mësimore ndjek në mënyrë të strukturuar ecurinë akademike të studentëve, realizon proceset e regjistrimeve, reflekton vlerësimet dhe mundëson menaxhimin transparent të të dhënave. Integrimi i funksionaliteteve të reja, përfshirë përditësimet e sistemit dhe optimizimet në raportim, ka kontribuar në rritjen e saktësisë së monitorimit dhe përmirësimin e menaxhimit të provimeve. Përveç këtyre, gjatë vitit 2024–2025 janë zbatuar edhe forma të reja të mbështetjes dixhitale, duke përfshirë instalimin e softuerëve të licencuar të nevojshëm për kërkimin shkencor dhe mësimdhënie, si dhe përdorimin e ambienteve virtuale për simulime inxhinierike. Këto zhvillime kanë lehtësuar procesin e mësimdhënies për pedagogët, duke u ofruar atyre mundësi të reja për bashkëpunim, zhvillim profesional dhe integrim të metodave moderne në kurrikula. Në tërësi, infrastruktura dixhitale e përmirësuar e FIM ka krijuar një mjedis më efikas dhe më të strukturuar për të gjithë procesin edukativ, ka rritur transparencën dhe ka forcuar lidhjet ndërmjet studentëve, pedagogëve dhe administratës akademike.	Përpjekjet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies janë intensifikuar përmes hapjes së grupeve të reja mësimore për lëndët teorike dhe seminaret, duke krijuar një mjedis akademik më të strukturuar dhe më të përshtatshëm për ndërveprim aktiv. Ndarja e studentëve në grupe më të vogla ka lejuar trajtimin më të detajuar të tematikave akademike, rritjen e cilësisë së diskutimeve dhe thellimin e analizave tematike, duke përmirësuar drejtpërdrejt përthithjen e njohurive dhe progresin e studentëve. Ky proces është vlerësuar si një masë efektive për rritjen e efikasitetit të mësimdhënies dhe për rritjen e pjesëmarrjes aktive të studentëve. Paralelisht me këtë, është ofruar mbështetje e vazhdueshme për pedagogët në përdorimin e platformës PITAGORA, e cila mbetet një nga mjetet dixhitale kryesore për menaxhimin e të dhënave akademike dhe administrative në FIM. Përmirësimet e realizuara gjatë këtij viti në funksionalitetet e platformës kanë synuar thjeshtimin dhe optimizimin e proceseve që lidhen me menaxhimin e orareve mësimore, regjistrimin e rezultateve, ndjekjen e progresit akademik dhe shpërndarjen e materialeve didaktike. Kjo qasje e përmirësuar ka rritur transparencën, ka lehtësuar aksesin e studentëve dhe pedagogëve në informacionin akademik dhe ka krijuar një sistem më efikas për menaxhimin e ngarkesave mësimore dhe administrative. Rritja e ndërveprimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ gjatë zbatimit të këtyre proceseve dixhitale ka ndikuar pozitivisht në rritjen e efikasitetit operativ dhe në përmirësimin e përvojës së përgjithshme akademike për studentët. Këto iniciativa, të mbështetura nga një qasje e vazhdueshme drejt dixhitalizimit, kanë vendosur një standard të ri në organizimin dhe funksionimin e mësimdhënies, duke përgatitur institucionin për të përballuar sfidat e epokës dixhitale dhe për të garantuar një mjedis modern, efektiv dhe inovativ në arsimin e lartë.	Gjatë vitit akademik 2024–2025, pedagogët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike kanë vijuar me krijimin dhe menaxhimin e klasave virtuale në platformën Microsoft Teams, duke siguruar një mjedis të organizuar për shpërndarjen e materialeve mësimore, komunikimin akademik dhe koordinimin e detyrave të studentëve. Paralelisht, sekretaria mësimore e FIM ka realizuar krijimin dhe përditësimin e grupeve mësimore në platformën PITAGORA, duke mundësuar menaxhimin e saktë të listave të studentëve, orareve dhe të dhënave akademike. Këto procese të dixhitalizuara kanë përmirësuar koherencën dhe efikasitetin e organizimit mësimor, duke garantuar një funksionim më të rregullt dhe më transparent të aktiviteteve akademike.	2024-2025	
	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	Gjatë kësaj periudhe kohore është punuar në drejtim të përdorimit të infrastrukturës dixhitale në procesin e mësimdhënies si dhe janë krijuar disa mundësi për stafin akdemik në drejtim të përvetësimit të tyre.	Kjo gjë është realizuar nëpërmjet pjesëmarjes në projekte të ndryshme ndërkombëtare (projektet ERASMUS+, të financuara nga CE, si dhe nga UPT në të cilat është përfshirë DGJ), të cilat kanë synuar në rritjen e kapaciteteve të mësidhënies por edhe në përdorimin e mjeteve të ndryshme dixhitale në përmirësimin e cilësisë në mësdhënie dhe kërkim shkencor.	Realizimi sipas planit startegjik është në nivel të kënaqshëm.	Tetor 2024 –Shtator 2025	N/A

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +3554 2227914, web: www.upt.edu.al

	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit / Departamentet	Pajisja e sallave me pajisjet e duhura (laptop, projektor, audio, etj.)	Planifikimi në buxhet për të rritur çdo vit infrastrukturën digjitale	Çdo vit përmirësohet infrastruktura dixhitale duke rritur numrin e pajisjeve të duhen në funksion të mësimdhënies.	Gjatë vitit akademik	
	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	Dixhitalizimi i sekretarisë mësimore dhe të gjitha proceseve akademike dhe administrative. Zgjerimi I bazës laboratorike dhe dixhitake.	Aplikime në projekte infrastrukturore.	Krijimi I një platforme për të gjitha proceset.	2025-2026	Platforma e-learning, ptatforma Bit-albania dhe regjistrat, 3 mënyra të cilat bëjnë procese që nuk lidhen midis tyre. Ndaj kërkohet një platformëe e unifikuar me karakter formues e projektues.
	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike / Administratori / Departamentet / Zyra e Karrierës	FIMIF synon promovimin e imazhit të tij në rekrutimin e studentëve	Pjesëmarrje në organizimin e Ditës së Hapur për UPT	- Është realizuar sipas planit strategjik; - Pjesëmarrje në organizimin e Ditës së Hapur për UPT. Takime këshillimore në bashkëpunim me zyrën e karrierës dhe të cilësisë me nxënësit e gjimnazeve dhe shkollave profesionale të vitit të fundit.	Gjatë vitit akademik	
	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave/ Departamentet/ IT/ Zyra e Karrierës	Analiza e të dhënave të pranimeve dhe përshtatja e kritereve me kërkesat akademike dhe tregun e punës. Rritje e cilësisë dhe atraktivitetit të programeve.	Studim statistikor mbi pranimet; analiza e performancës së studentëve; promovim i programeve të studimit; aktivitete informuese me maturantët.	Realizim i plotë sipas planit vjetor	2024-2025	Përmirëson cilësinë e inputit akademik. Stabilizim i numrit dhe cilësisë së studentëve
	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike/ Administratori / Departamentet / Zyra e Karrierës	FIE synon promovimin e imazhit të tij në rekrutimin e studentëve.	1. Organizimin e Ditës së Hapur për UPT. 2. Ndërtimi I broshurës për programet e studimit FIE.	Është realizuar sipas planit strategjik.	2021-2024	Takime të planifikuar në gjimnazet dhe organizimi tek Pallati i Kongreseve.
		Gjatë vitit akademik 2024–2025, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike ka vijuar të zbatojë dhe të përditësojë në mënyrë të vazhdueshme kriteret për pranimin e studentëve të rinj, duke u mbështetur në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular të Universitetit Politeknik të Tiranës. Këto kritere sigurojnë një proces pranimi të harmonizuar me standardet akademike dhe me kuadrin ligjor në fuqi, duke reflektuar orientimin strategjik të UPT-së drejt cilësisë dhe përputhshmërisë me zhvillimet bashkëkohore në arsimin e lartë. Për programet Bachelor të FIM, kërkesat e pranimit janë rishikuar për të garantuar që kandidatët të zotërojnë njohuritë dhe aftësitë bazë të nevojshme për të ndjekur me sukses një kurrikulë të specializuar teknike	Hartimi dhe përcaktimi i kritereve të përzgjedhjes për programet e studimit përbën një nga aktivitetet kyçe për garantimin e standardeve të larta akademike dhe përputhshmërisë me rregulloret institucionale. Ky proces përfshin analizimin e nevojave specifike të çdo programi në Fakultetin e	Përzgjedhja e kandidatëve për programet e studimit të ofruara nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM) vijon të realizohet në përputhje të plotë me kriteret e miratuara për		

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Sh. DK.

Zhvillimi i qëndrueshëm i cilësisë së pranimeve në të gjithë programet e studimit të UPT	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike/ Drejtuesit e departamenteve, drejtuesit e grupeve mësimore dhe pedagoget e Fakultetit	specializuar teknike. Për programet e ciklit të dytë, kriteret e përzgjedhjes në programet Master janë përafruar me standardet më të avancuara të cilësisë akademike, duke u orientuar drejt kompetencave profesionale që kërkohen nga tregu i punës dhe nga zhvillimet teknologjike që ndikojnë sektorin e inxhinierisë mekanike. Këto kritere synojnë të garantojnë që studentët e përzgjedhur të kenë potencialin akademik dhe motivimin e nevojshëm për të përfituar nga programet e specializuara të nivelit të avancuar. Përditësimi i rregullt i kritereve të pranimit, i kryer në bashkëpunim të ngushtë me departamentet akademike dhe njësitë përkatëse të UPT-së, ka për qëllim jo vetëm rritjen e transparencës dhe efektivitetit të procesit të pranimit, por edhe përafrimin me zhvillimet më të fundit shkencore dhe teknologjike. Në këtë mënyrë, FIM kontribuon në përgatitjen e kuadrove të kualifikuar, të cilët janë të aftë të përballojnë nevojat e industrisë dhe kërkesat akademike në rritje, duke siguruar një proces pranimi të orientuar drejt cilësisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.	përshtatshmërinë analizimit e nevojave specifike të çdo programi në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike (FIM), duke marrë parasysh kërkesat e tregut të punës, zhvillimet bashkëkohore shkencore dhe teknologjike, si dhe prioritetet strategjike të Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT). Në këtë kuadër, grupet përgjegjëse në FIM bashkëpunojnë ngushtësisht për të siguruar që kriteret e pranimit për programet Bachelor dhe Master të jenë transparente, të mirëargumentuara dhe të bazuara në standarde akademike të avancuara. Ky proces garanton përfshirjen e udhëzimeve të qarta për përzgjedhjen e kandidatëve më të përshtatshëm, duke nxitur ekselencën akademike dhe koherencën në formimin e specialistëve të ardhshëm.	pranimin e studentëve të rinj, duke respektuar në mënyrë të rreptë kërkesat e Rregullores së Zhvillimit Kurrikular të Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT). Ky proces synon garantimin e një standardi të lartë akademik, duke identifikuar dhe pranuar aplikantët që demonstrojnë përputhjen më të mirë me kërkesat dhe objektivat e programeve të studimit. Përzgjedhja mbështetet në parimet e transparencës, meritokracisë dhe integritetit në çdo hap të procedurës, duke siguruar që pranimi të reflektojë cilësinë dhe koherencën e kërkuar nga fakulteti.	2024-2025	
	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	Është planifikuar të ketë një qëndrueshmëri në cilësinë dhe sasinë e numrit të pranimeve në të gjitha programet e studimit që ofrohen nga departamentet.	Kjo gjë është realizuar nëpërmjet informimit me forma të ndryshme për të gjithë të interesuarit për të filluar studimet në programet që ofrohen nga departamentet.	Realizimi sipas planit startegjik është në nivel të kënaqshëm.	Tetor 2024 – Shtator 2025	N/A
	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit / Zyra e SBC, Karrieres dhe Alumnit	Informacionet e duhura (plane mësimore, literatura, etj.) lehtësisht të aksesueshme nga studentet. Organizimi i sesioneve të komunikimit dhe prezantimit për të ndarë informacionin dhe për të dëgjuar feedback-un e palëve të interesuara.	Organizimi i takimeve këshillimore në bashkëpunim në zyrën e karrierës dhe të cilësisë me nxënësit e gjimnazeve dhe shkollave profesionale të vitit të fundit.	Takime këshillimore në bashkëpunim me zyrën e karrierës dhe të cilësisë me nxënësit e gjimnazeve dhe shkollave profesionale të vitit të fundit.	Gjatë vitit akademik	
	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës / Departamentet	Përpunimi dhe përmirësimi I kritereve specifike në hyrje me pikësynim seleksionimin e kandidatëve me karakteristikat më të mira.	Aplikimi I testimit specifik për seleksionimin e studentëve.	Rritja e peshës në përqindje që mbart testimi specifik, në llogaritjen e pikëve për klasifikim të fituesve.	Çdo vit	Testi i pranimit nuk duhet të zhvillohet në muajin Gusht, Fakulteti mund ta zhvilloj në mënyrë të pavarur në muajin Korrik.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI POLITEKNIK TIRANËS REKTORATI SEKRETARIA

	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike / Zyra e Karrierës	- FIM synon rritjen e profesionale nëpërmjet monitorimit e vazhdueshëm të tregut të punës me qëllimin e futjes së të diplomuarve në tregun e punës. - Përshirja e moduleve ekstrakurrikulare, sidomos për studentët e Ba në Inxhinieri Kimike, si pjesë e Programeve/Projekteve të kërkimit shkencor të iniciuara apo në bashkëpunim me Institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, për t'ju mundësuar studentëve: - njohjen me teknollogjitë dhe zhvillimet më të fundit në nënfushat përkatëse, trajtimin e çështjeve rregullatore dhe ekonomike nga perspektiva të tjera. - angazhimin ektiv dhe njohjen me metodat gjithëpërfshirëse të edukimit; - të mësuarit sesi të shkruajnë një punim shkencor apo të aplikojnë për fonde projektesh e më gjerë.	- Organizimi i panaireve të punës. - Organizimi i leksioneve të hapura. - Marrëveshje me kompanitë publike dhe private. - U zhvillua moduli i përbashkët Co-teaching me titull "Ndotja e ajrit: shëndeti, politikat dhe zhvillimi ekonomik" në kuadër të Projektit të READ-AADF, me pjesëmarrje të studentëve të Inxhinierisë Kimike në FIMIFdhe të Inxhinierisë së Mjedisit (të dy ciklet) në FIN	- Është realizuar sipas planit strategjik;	Gjatë vitit akademik	
	FGJM / Departamentet /Zyra e Karrierës	Mbështetje e strukturuar për orientim profesional dhe lidhjes me tregun e punës	Mbështetje e strukturuar për orientim profesional dhe lidhjes me tregun e punës	Ofrim i këshillimit të karrierës dhe mentorimit për studentët, bashkëpunim i vazhdueshëm me punëdhënës në fushën e Gjeoshkencave, Burimeve Minerare dhe Burimeve te Energjise, ndjekje e alumnit, si dhe organizim i trajnimeve profesionale për të forcuar lidhjen midis programeve të studimit dhe tregut të punës.	2024-2025	Lehtëson tranzicionin studime–punësim. Kërkon bashkëpunim të qëndrueshëm me partnerët
	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike / Zyra e Karrierës	FIE synon në rritjen profesionale dhe futjen e të diplomuarve në tregun e punës.	1 Pjesëmarrja në panairet e punës. 2. Kontratat e bashkëpunimit me kompanitë e fushave të mbuluara. 3. Ofrimin e praktikave mësimore pranë kompanive dhe afrimin e studentit me tregun e punës.	Është realizuar sipas planit strategjik.	2019-2024	Aktivitete të përvitshme.
Fuqizimi i nismave mbështetëse për të ndihmuar suksesin profesional dhe futjen e të diplomuarve në tregun e punës	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike/ Departamenet / Specialistja e Karrieres dhe Alumnit	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (FIM) vijon të synojë përgatitjen e të diplomuarve për një sukses profesional të qëndrueshëm dhe për një integrim sa më efikas në tregun e punës. Për këtë qëllim, fakulteti përqendrohet në përmirësimin e cilësisë së formimit akademik, forcimin e bashkëpunimit me industrinë dhe ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme për studentët dhe të diplomuarit. Sigurimi i një përgatitjeje profesionale që i përgjigjet kërkesave të tregut mbetet një prioritet, duke u mundësuar studentëve dhe të diplomuarve eksperienca praktike dhe të personalizuara në fusha të ndryshme të inxhinierisë. Një aspekt i rëndësishëm i këtyre përpjekjeve është lehtësimi i tranzicionit të studentëve nga arsimi drejt karrierës profesionale, përmes ofrimit të udhëzimeve, mjeteve të zhvillimit të karrierës dhe këshillimit të vazhdueshëm. Fakulteti punon për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm dhe efektiv të nismave mbështetëse, duke krijuar mekanizma që përforcojnë aftësitë profesionale, shtojnë mundësitë e punësimit dhe rrisin shkallën e konkurrueshmërisë së të diplomuarve në tregun e punës.	Hartimi dhe integrimi i moduleve të reja që adresojnë teknologjitë bashkëkohore, si automatizimi, dixhitalizimi dhe materialet inovative, ka vijuar të jetë një prioritet në përditësimin e programeve të studimit. Gjithashtu, janë përfshirë lëndë që zhvillojnë aftësi ndërdisiplinore, përfshirë menaxhimin e projekteve, inovacionin dhe qëndrueshmërinë mjedisore, me synimin për të përgatitur studentët për sfidat e tregut modern të punës. Në bashkëpunim me industrinë, janë organizuar tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues të kompanive për të diskutuar kërkesat aktuale dhe tendencat në zhvillim të sektorëve përkatës. Feedback-u i marrë nga këto takime është përdorur për azhurnimin e programeve të studimit dhe për përshtatjen e tyre me nevojat e tregut. Paralelisht, janë negociuar marrëveshje të reja bashkëpunimi me kompani nga fushat e mekanikës, materialeve dhe tekstilit, të cilat mundësojnë kryerjen e praktikave mësimore dhe realizimin e punëve të diplomës në mjedise profesionale, duke rritur kështu cilësinë e formimit praktik të studentëve.	Reflektimi dhe zbatimi i ndryshimeve të propozuara nga departamentet përkatëse janë integruar në mënyrë të rregullt në planet mësimore të programeve të studimit, duke siguruar përputhshmëri të plotë me standardet akademike dhe kërkesat dinamike të tregut të punës. Këto ndërhyrje janë orientuar drejt përmirësimit të kurrikulës, azhurnimit të përmbajtjeve mësimore dhe rritjes së komponentëve praktikë në lëndët përkatëse. Një nga arritjet kryesore të këtij viti ka qenë forcimi i kontakteve të vazhdueshme me kompani që operojnë në fusha të ndryshme teknike, të cilat kanë ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë në realizimin e punimeve të diplomës. Ky bashkëpunim ka mundësuar përfshirjen e projekteve praktike dhe situatave reale të punës në procesin arsimor, duke krijuar një lidhje më të fortë dhe më funksionale midis teorisë dhe praktikës, dhe duke rritur vlerën profesionale të formimit të studentëve.	2024-2025	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al Sh. DK.

	Zyra e Alumni dhe Karriera e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit	Strategjia për zhvillimin e aftësive të punësueshmërisë: 1. monitorimin e vazhdueshëm të tregut të punës; 2. organizimin i moduleve të veçanta për forcimin e aftësive dhe të njohurive të studentëve për të lehtësuar futjen e tyre në tregun e punës; 3. mbështetjen për studentët jo vetëm për gjuhë të huaja, por edhe për lëndët ekstrakurrikulare, si dhe për çdo nismë që çon në lehtësimin e punësimit të tyre; 4. organizimin e panaireve të punës, në të cilët të inkurajohen kontaktet punëdhënës-punëmarrësi.	1. Trajnime dhe workshope: Organizimi i trajnimeve për përgatitje për tregun e punës dhe orientim në karrierë. 2. Panaire karriere (punë): Flesa për kompani partnere për të ofruar vende pune dhe praktika për studentët. 3. Takime ndërmjetëse mes studentëve dhe mentorëve: Krijimi i grupeve mentorimi për sektorë të ndryshëm. 4. Programe Internship: Identifikimi i mundësive për praktika profesionale.	Objektivat strategjike për vitin akademik: Integrimi i këtyre aktiviteteve në planet akademike dhe në bashkëpunim me sektorët industrialë.	Tetor 2024 – Shtator 2025	Bashkëpunimi me alumni dhe partnerë strategjikë është i domosdoshëm për suksesin e nismave të propozuara. Investimi në burimet teknologjike për platformat online është një prioritet për zbatimin efektiv të këtyre planeve.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Fakulteti	Departamenti	Programi i Studimit	Programe ndërsiplinore /të përbashkëta/ që ofrojnë formim për të tretë (nëse ka)	Cikli i Programit të Studimit	Aktiv / Pasiv / Mbyllur	Akredituar (PO/JO, nëse po, nr.datë vendimi bordi për akreditimin)	Nr.Akti / Data e miratimit hapjes (ose në proçes nëse ka)	Studim tregu
Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	Departamenti i Arkitekturës	Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn		Cikli i Parë Bachelor	Aktiv	Në proces	Urdhri Nr.190, datë 22.04.2016 i MAS	Po
		Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Arkitekt		Program i Integruar studimi i ciklit të dytë "Master i Shkencave" (5-vjeçar)	Aktiv	Në proces	Urdhri Nr. 559, datë 10/12/2010 i MAS	Po
	Departamenti i Urbanistikës	Master i Shkencave në Arkitekturë, profili Urbanist		Program i Integruar studimi i ciklit të dytë "Master i Shkencave" (5-vjeçar)	Aktiv	Në proces	Urdhri Nr. 559, datë 10/12/2010 i MAS	Po
	Departamenti i Restaurimit dhe Teknologjisë së Arkitekturës	Master Profesional në Restaurim Monumentesh Kulture		Cikli i Dytë Master Profesional	Aktiv	Jo	Urdhri Nr. 191, datë 22/04/2016 i MAS	Po
	Të tre Departamentet	Doktoraturë në Arkitekturë dhe Urbanistikë		Cikli i Tretë Doktoraturë	I mbyllur	Jo	VKM Nr. 1116 datë 13.11.2009	Po
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	Departamenti i Sistemeve Elektrike të Fuqisë	Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili Energjitikë		Cikli i Parë Bachelor	Aktiv	Vendim BA Nr. 190, datë 25.11.2023	Sh. MAS Nr.3482/1, datë 07.06.2006; riorganizuar me Ur Nr 235, datë 24/07/2009 i MAS	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, Profili Energjetikë		Cikli i Dytë Master i Shkencave	Aktiv	Në proces	VKM Nr. 1220, Datë 03.09.2008	Po
		Master Profesional në Elektroenergjitikë		Cikli i Dytë Master Profesional	Aktiv	Vendim BA Nr. 65, datë 15.03.2024	Urdhri Nr. 597, datë 09/12/2011 i MAS riorganizuar me Urdhrin Nr. 597/1, datë 9/9/2022 i MAS	Po
		Doktoraturë në Inxhinieri Elektrike - Energjetikë		Cikli i Tretë Doktoraturë	Aktiv	Në proces	Urdhri Nr. 180, datë 4.4.2022 i MAS	Po
	Departamenti i Automatikës	Bachelor në Inxhinieri Elektrike, Profili Automatizim i Industrisë		Cikli i Parë Bachelor	Aktiv	Vendim BA Nr. 189, datë 25.11.2023	Sh. MAS Nr.3482/1, datë 07.06.2006; riorganizuar me Ur MAS Nr 235, datë 24/07/2009	Po
		Bachelor në Inxhinieri Mekatronike			Aktiv	Vendim BA Nr. 187, datë 25.11.2023	Sh MAS Nr.1583/1, datë 12/05/2006	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike, Profili Automatizimi i Industrisë		Cikli i Dytë Master i Shkencave	Aktiv	Në proces	VKM Nr. 1220, datë 03.09.2008	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Mekatronike			Aktiv	Vendim BA Nr. 73, datë 09.05.2025	Urdhri Nr.354, datë 17/09/2021 i MAS	Po
		Master Profesional në Inxhinieri Elektrike, Profili Automatizim Industrie		Cikli i Dytë	Aktiv	Në proces	Urdhri Nr.597, datë 09/12/2011 i MAS	Po

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Sh. DK.

Fakulteti	Departamenti	Programi i Studimit	Programe ndërsiplinore /të përbashkëta/ që ofrojnë formim për të tretë (nëse ka)	Cikli i Programit të Studimit	Aktiv / Pasiv / Mbyllur	Akredituar (PO/JO, nëse po, nr.datë vendimi bordi për akreditimin)	Nr.Akti / Data e miratimit hapjes (osc në proçes nëse ka)	Studim tregu
		Master Profesional në Inxhinieri Mekatronike		Master Profesional	Aktiv	Jo	Urdhri Nr.378, datë 06/09/2013 i MAS	Po
		Doktoraturë në Inxhinieri Elektrike - Automatizimi i Industrisë		Cikli i Tretë Doktoraturë	Aktiv	Jo	Urdhri Nr. 177, datë 4.4.2022 i MAS	Po
	Departamenti i Shkencave të Tokës	Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike		Cikli i Parë Bachelor	Aktiv	Vendim BA, Nr.68, datë 09.05.2025	Sh MAS Nr 1583/1, date 12/05/2006, riorganizuar me Shkr MASR Nr. 6883/2, dt. 21/09/2018 efektive prej 2019 - 2020	Po
		Bachelor në Inxhinieri Gjeomjedisi			Aktiv	Vendim BA, Nr. 70, datë 09.05.2025	Urdhri Nr. 243, datë 14/06/2012 i MAS	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri e Gjeomjedisit		Cikli i Dytë Master i Shkencave	Aktiv	Jo	VKM Nr. 1245, datë 10/09/2008	Po
		Master Profesional në Inxhinieri Gjeomjedisi		Cikli i Dytë Master Profesional	Pasiv	Jo	Sh MASR nr. 2965/1 Prot., datë 24.04.2018 Miratuar për herë të parë me ur MAS nr. 597, datë 09.12.2011.	Po
		Doktoraturë "Gjeologjia dhe Mjedisi"		Cikli i Tretë Doktoraturë	Aktiv	Jo	Urdhri Nr. 179, datë 04.04.2022 i MAS	Po

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Sh. DK.

Fakulteti	Departamenti	Programi i Studimit	Programe ndërsiplinore /të përbashkëta/ që ofrojnë formim për të tretë (nëse ka)	Cikli i Programit të Studimit	Aktiv / Pasiv / Mbyllur	Akreditуar (PO/JO, nëse po, nr.datë vendimi bordi për akreditimin)	Nr.Akti / Data e miratimit hapjes (ose në proçes nëse ka)	Studim tregu
Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave	Departamenti i Gjeologjisë së zbatuar dhe Gjeoinformatikës	Bachelor në Inxhinieri Gjeoinformatike		Cikli i Parë Bachelor	Aktiv	Vendim BA, Nr. 69, datë 09.05.2025	Sh MAS Nr 1583/1, datë 12/05/2006	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, Profili Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji		Cikli i Dytë Master i Shkencave	Pasiv	Jo	VKM Nr. 1245, datë 10/09/2008	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, Profili Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji			Pasiv	Jo	VKM Nr. 1245, datë 10/09/2008	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, Profili Gjeologjia e Vendburimeve Hidrokarbure			Pasiv	Jo	VKM Nr. 1245, datë 10/09/2008	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeologjike, Profili Gjeoinformatikë			Aktiv	Jo	VKM Nr. 1245, datë 10/09/2008	Po
		Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, Profili Vendburimet e Mineraleve te Dobishme-Petrologji		Cikli i Dytë Master Profesional	Pasiv	Jo	Sh MASR nr. 2965/1 Prot., datë 24.04.2018 Miratuar për herë të parë me ur MAS nr. 597, datë 09.12.2011	Po
		Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, Profili Gjeologjia e Vendburimeve të Hidrokarbureve			Aktiv	Jo	Sh MASR nr. 2965/1 Prot., datë 24.04.2018 Miratuar për herë të parë me ur MAS nr. 597, datë 09.12.2011	Po
		Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, Profili Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji			Aktiv	Jo	Sh MASR nr. 2965/1 Prot., datë 24.04.2018 Miratuar për herë të parë me ur MAS nr. 597, datë 09.12.2011	Po
		Master Profesional në Inxhinieri Gjeologjike, Profili Gjeoinformatikë			Aktiv	Jo	Urdhri Nr 597, datë 09/12/2011 i MAS	Po
	Departamenti i Inxhinierisë së Burimeve Minerare	Bachelor në Inxhinieri e Burimeve Minerare		Cikli i Parë Bachelor	Aktiv	Vendim BA, Nr.71, datë 09.05.2025	Sh MAS Nr 1583/1, datë 12/05/2006, riorganizuar me Shkr MASR Nr. 6883/2, dt. 21/09/2018	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri e Burimeve Minerare, Profili Inxhinieri Minerare dhe Markshajderi		Cikli i Dytë Master i Shkencave	Aktiv	Jo	VKM Nr. 1245, datë 10/09/2008, riorganizuar me Shkr MASR Nr. 6883/2, datë 21/09/2018	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri e Burimeve Minerare, Profili Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve			Pasiv	Jo	VKM Nr. 1245, datë 10/09/2008, riorganizuar me Shkr MASR Nr. 6883/2, datë 21/09/2018	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri e Burimeve Minerare, Profili Gjeomatikë			Pasiv	Jo	VKM NR. 1245, datë 10/09/2008	Po

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Sh. DK.

Fakulteti	Departamenti	Programi i Studimit	Programe ndërsiplinore /të përbashkëta/ që ofrojnë formim për të tretë (nëse ka)	Cikli i Programit të Studimit	Aktiv / Pasiv / Mbyllur	Akredituar (PO/JO, nëse po, nr.datë vendimi bordi për akreditimin)	Nr.Akti / Data e miratimit hapjes (ose në proçes nëse ka)	Studim tregu
		Master Profesional në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, Profili Gjeomatikë		Cikli i Dytë Master Profesional	Aktiv	Jo	Urdhri Nr. 597 i MAS, datë 09/12/2011, riorganizuar me Shkr MASR Nr. 6883/2, datë 21/09/2018	Po
		Master Profesional në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, Profili Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve			Pasiv	Jo	Urdhri Nr. 597, datë 09/12/2011 i MAS, riorganizuar me Shkr MASR Nr. 6883/2, datë 21/09/2018	Po
		Master Profesional në Inxhinierinë e Burimeve Minerare, Profili Inxhinieri Minerare			Pasiv	Jo	Urdhri Nr. 597, datë 09/12/2011 i MAS, riorganizuar me Shkr MASR Nr. 6883/2, datë 21/09/2018	Po
		Doktoraturë në Inxhinieri e Burimeve Minerare, Profili Inxhinieri Minerare dhe Markshajder		Cikli i Tretë Doktoraturë	Aktiv	JO	Urdhër Nr. 407, datë 08.01.2024 i MASR	Po
	Departamenti i Burimeve të Energjisë	Bachelor në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit		Cikli i Parë Bachelor	Aktiv	Vendim BA, Nr.72, datë 09.05.2025	Sh MAS Nr. 1583/1, datë 12/05/2006, riorganizuar me Shkr MASR Nr. 6883/2, datë 21/09/2018	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri e Naftës dhe Gazit		Cikli i Dytë Master i Shkencave	Aktiv	Jo	VKM Nr. 1245, datë 10/09/2008, riorganizuar me Shkr MASR Nr. 6883/2, datë 21/09/2018	Po
		Master Profesional në Inxhinierinë e Naftës dhe Gazit		Cikli i Dytë Master Profesional	Aktiv	Jo	Urdhri Nr. 597, datë 09/12/2011 i MAS, riorganizuar me Shkr MASR Nr. 6883/2, datë 21/09/2018	Po
		Doktoraturë në Inxhinieri Nafte dhe Gazi		Cikli i Tretë Doktoraturë	Aktiv	Jo	Sh. MAS Nr. 182, datë 04.04.2022	Po
	Departamenti i Mekanikës	Bachelor në Inxhinieri Mekanike		Cikli i Parë Bachelor	Aktiv	Vendim BA Nr. 184, datë 25.11.2023	Sh. MAS Nr.1583/1, datë 12.05.2006;	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, Profili Konstruksion Makinash dhe Mjete Lëvizëse		Cikli i Dytë Master i Shkencave	Aktiv	Jo	VKM Nr. 1220, datë 03.09.2008	Po
		Master Profesional në Inxhinieri Transporti		Cikli i Dytë Master Profesional	Aktiv	Jo	Urdhër Nr. 597, datë 09/12/2011 i MAS, Riorganizuar me shkrese MAS 2965/1 datë 24.04.2018	Po
		Doktoraturë në "Integriteti strukturor"		Cikli i Tretë Doktoraturë	Aktiv	Jo	2021	Po
	Departamenti i Tekstilit dhe Modës	Bachelor në Inxhinieri Tekstile e Mode		Cikli i Parë Bachelor	Aktiv	Vendim BA Nr. 188, datë 25.11.2023	Sh. MAS Nr.1583/1, datë 12.05.2006;	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Tekstili dhe Modë		Cikli i Dytë Master i Shkencave	Aktiv	Jo	VKM Nr. 1273, date 17/09/2008	Po
	Departamentit i Prodhim Menaxhimit	Bachelor në Inxhinieri Materiale		Cikli i Parë Bachelor	Aktiv	Vendim BA Nr. 186, datë 25.11.2023	Sh. MAS Nr.1583/1, datë 12.05.2006;	Po
		Bachelor në Inxhinieri Ekonomike			Aktiv	Vendim BA Nr. 192, datë 25.11.2023	VKM Nr. 355, datë 12/05/2010	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, Profili Prodhim dhe Menaxhim Industrial			Aktiv	Jo	VKM Nr. 1220, datë 03.09.2008	Po

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Fakulteti	Departamenti	Programi i Studimit	Programe ndërsiplinore /të përbashkëta/ që ofrojnë formim për të tretë (nëse ka)	Cikli i Programit të Studimit	Aktiv / Pasiv / Mbyllur	Akreditуar (PO/JO, nëse po, nr.datë vendimi bordi për akreditimin)	Nr.Akti / Data e miratimit hapjes (ose në proçes nëse ka)	Studim tregu
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike		Master i Shkencave në Inxhinieri Ekonomike		Cikli i Dytë Master i Shkencave	Aktiv	Jo	Urdhër Nr. 368, datë 18/09/2014 i MAS	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Materiale, Profili Materiale			Aktiv	Jo	VKM Nr. 1220, datë 03.09.2008	Po
	Departamenti i Energjitikës	Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, Profili Energjetikë		Cikli i Dytë Master i Shkencave	Aktiv	Jo	VKM Nr. 1220, datë 03.09.2008	Po
		Master i Shkencave në Menaxhim Energjie			Aktiv	Jo	Urdhri Nr. 186, datë 22/04/2016 i MAS	Po
		DOUBLE DEEGRE: Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, Profili Energjitikë	DOUBLE DEEGRE: Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, Profili Energjitikë		Aktiv	Vendim BA, Nr. 74, datë 09.05.2025	Urdhri Nr. 624 datë 17.10.2022 i MAS	Po
		Master Profesional në Inxhinieri Mekanike, profili Energjitikë		Cikli i Dytë Master Profesional	I mbyllur me Urdhër të MA me nr. 531, datë 15.10.2025	Jo	Urdhri Nr. 597, datë 09/12/2011 i MAS, riorganizuar Shkrese MAS. 2965/1 datë 24.04.2018	Po
	DE+DM+DPM+DTM	Doktoratë në Inxhinieri Mekanike, Fusha Inxhinieri Materiale/nënfushë Materiale tekstile	-	Cikli i Tretë Doktoraturë	Aktiv	Jo	Miratuar, Korrik 25, 2024	Po
	Departamenti i Inxhinierisë Matematike	Bachelor në Inxhinierinë Matematike		Cikli i Parë Bachelor	Aktiv	Vendim BA, Nr.67, datë 09/05/2025	Sh. MAS Nr 9275, datë 27/12/2006	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike		Cikli i Dytë Master i Shkencave	Aktiv	Jo	VKM Nr 910, datë 26/08/2009	Po
		Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh		Cikli i Dytë Master Profesional	Aktiv	Jo	Urdhri Nr. 597, datë 09/12/2011 i MAS, Riorganizuar me shkrese MAS 2965/1 datë 24.04.2018	Po
		Master Profesional në Inxhinieri Matematike, Profili Aktuaristikë			I mbyllur, vendim Senati Nr. 29, datë 26.06.2025	Jo	Urdhër Nr. 274, datë 20.07.2015 i MAS	Po

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web:www.upt.al

Sh. DK.

Fakulteti	Departamenti	Programi i Studimit	Programe ndërsiplinore /të përbashkëta/ që ofrojnë formim për të tretë (nëse ka)	Cikli i Programit të Studimit	Aktiv / Pasiv / Mbyllur	Akredituar (PO/JO, nëse po, nr.datë vendimi bordi për akreditimin)	Nr.Akti / Data e miratimit hapjes (ose në proces nëse ka)	Studim tregu
Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike		Doktoraturë në Inxhinieri Matematike		Cikli i Tretë Doktoraturë	Aktiv	Jo	Urdhri Nr. 605, datë 29.12.2010 i MAS, Urdhri Nr. 176, datë 04.04.2022 i MAS	Po
	Departamenti i Inxhinierisë Fizike	Bachelor në Inxhinierinë Fizike		Cikli i Parë Bachelor	Aktiv	Vendim BA, Nr.66, datë 09.05.2025	Sh. MAS Nr 9275, datë 27/12/2006	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike Profili Fizikan Mjekësor		Cikli i Dytë Master i Shkencave	Aktiv	Jo	VKM Nr. 910, datë 26.08.2009 riorganizuar me Ur e MAS nr. 602, datë 26.09.2018	Po
		Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike Profili Inxhinier Fizike			Aktiv	Jo	VKM Nr. 910, datë 26.08.2009 riorganizuar me Ur e MAS nr. 602, datë 26.09.2018	Po
		Doktoraturë në Inxhinieri Fizike		Cikli i Tretë Doktoraturë	Aktiv	Jo	Urdhri Nr. 605, datë 29.12.2010 i MAS, Urdhri Nr. 176, datë 04.04.2022 i MAS	Po
	Departamenti i Inxhinierisë Kimike	Bachelor në Inxhinieri Kimike		Cikli i Parë Bachelor	Aktiv	Jo	Urdhri Nr. 334, datë 04.07.2023 i MAS	Po

	Departamenti i Mekanikës	**Bachelor në Inxhinieri Mekanike**	**Cikli i Parë Bachelor**	Të jenë në gjendje të identifikojnë, formulojnë dhe interpretojnë saktë problemet e inxhinierisë mekanike, duke analizuar elementët kryesorë të sistemit, duke vlerësuar kufizimet teknike dhe operative, dhe duke përcaktuar me qartësi kërkesat funksionale dhe kriteret e projektimit. Të aplikojnë metoda analitike, matematikore dhe mjete të teknologjisë së informacionit (CAD, CAE, simulime numerike, analiza eksperimentale) për të modeluar, analizuar dhe vlerësuar sjelljen e sistemeve mekanike dhe termike. Të vlerësojnë në mënyrë kritike alternativat e zgjidhjes, të krahasojnë teknologjitë dhe metodat e disponueshme, dhe të përzgjedhin alternativën më efikase, të qëndrueshme dhe të përshtatshme për problemin inxhinierik specifik. Të përdorin në mënyrë të sigurt dhe profesionale pajisjet laboratorike dhe instrumentet mekanike dhe energjetike, duke zbatuar praktikat e matjes, testimit dhe analizës eksperimentale sipas standardeve teknike. Të demonstrojnë aftësi për të integruar njohuritë teorike me praktikën profesionale, përmes projekteve, punëve laboratorike, detyrave të kursit dhe praktikave mësimore në industri. Të komunikojnë qartë dhe në mënyrë profesionale rezultatet teknike, me shkrim dhe me gojë, duke përdorur terminologji të saktë inxhinierike dhe mjete bashkëkohore të paraqitjes teknike. Të punojnë në mënyrë efektive në grup dhe të kontribuojnë në mjedise ndërdisiplinore, duke respektuar detyrat, afatet dhe përgjegjësitë profesionale. Të njohin parimet bazë të etikës profesionale, sigurisë teknike dhe qëndrueshmërisë, dhe t'i zbatojnë ato në situata reale të projektimit dhe menaxhimit të sistemeve inxhinierike.	Në përfundim të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekanike, studentët formohen si inxhinierë të aftë të kombinojnë bazën e fortë teorike me aftësi praktike dhe profesionale, duke fituar ekspertizë në analizimin, modelimin dhe zgjidhjen e problemeve mekanike. Përmbajtja e programit është strukturuar në mënyrë që të garantojë zhvillimin e kompetencave të specializuara në fushat e projektimit mekanik, termoteknikës, dinamikës së sistemeve dhe proceseve industriale. Programi realizon synimet e tij përmes integrimit të lëndëve bazë dhe të avancuara, punëve laboratorike, përdorimit të software-ve bashkëkohore të inxhinierisë, si dhe aktiviteteve praktike që ndihmojnë studentët të aplikojnë metodat teknike në situata reale industriale. Nëpërmjet kësaj strukture akademike, studentët aftësohen të analizojnë dhe optimizojnë sisteme mekanike, të përdorin mjete moderne inxhinierike dhe të kontribuojnë në zhvillimin teknologjik të sektorëve të ndryshëm të industrisë.	Të diplomuarit në Inxhinieri Mekanike gjejnë mundësi të gjera punësimi si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, duke operuar në fusha ku kërkohen aftësi të thelluara teknike dhe inxhinierike. Ata mund të punojnë në: • Sektorin e ndërtimit, duke u angazhuar në projektimin, instalimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve mekanike dhe instalimeve teknike në ndërtesa. • Sektorin e energjisë, ku përfshihen projektimi, administrimi dhe optimizimi i veprave dhe instalimeve energjetike, si dhe menaxhimi i sistemeve të eficiencës së energjisë dhe burimeve të rinovueshme. • Sektorin e transportit, duke kontribuar në projektimin, analizën, planifikimin dhe menaxhimin teknik të sistemeve të transportit rrugor, hekurudhor apo industrial. • Industrinë përpunuese dhe të prodhimit, duke marrë role në projektimin, prodhimin, testimin dhe menaxhimin e makinerive, pajisjeve dhe proceseve industriale. • Industri të tjera të specializuara, si industria ushqimore, mekanizimi bujqësor dhe blektoral, industria përpunuese e materialeve, si dhe kompani të sigurimeve që kërkojnë ekspertizë teknike për vlerësimin e riskut dhe auditimet teknike. Kjo larmi sektorësh reflekton fleksibilitetin dhe kërkesën e lartë të tregut të punës për profilin e inxhinierëve mekanikë, duke i ofruar të diplomuarve perspektiva të gjera zhvillimi profesional dhe karriere.
		Master I Shkencave në Inxhinieri Mekanike, Profili Konstruksion Makinash dhe Mjete Lëvizëse	**Cikli i Dytë Master i Shkencave**	I diplomuari i programit Master Shkencor në Inxhinieri Mekanike, me profilin "Konstruksione Makinash dhe Mjete Lëvizëse," është i aftë të projektojë, realizojë, menaxhojë dhe mirëmbajë sisteme komplekse në sektorët e industrisë së prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, si dhe në aktivitete prodhuese të tjera. Ai ka një njohuri të thellë mbi mjetet dhe metodologjitë e realizimit të projekteve, të cilat i mundësojnë realizimin e sistemeve të udërlikuara dhe inovative në një gamë të gjerë aplikimesh. Kombinimi i aftësive teknike dhe shkencore, së bashku me aftësitë e komunikimit të efektshëm, i mundëson atij të funksionojë në nivele të larta të drejtimit dhe menaxhimit të projekteve komplekse. Po ashtu, mbajtësi i diplomës ka njohuri të thella të kontekstit kulturor dhe global, që i jep mundësinë të kontribuojë në mjedise ndërkombëtare dhe të punojë në funksione udhëheqëse dhe profesionale në nivel global.	Mbajtësi i diplomës Master ka aftësi të zhvilluara dhe mjete intelektuale për të planifikuar dhe udhëhequr procese kërkimore inovative, si dhe për të implementuar zgjidhje të reja në fusha të ndryshme. Njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve i mundësojnë atij përdorimin e njeteve dhe metodologjive të avancuara për të analizuar dhe trajtuar informacionin në fushën e projektimit mekanik, dinamika e mjeteve lëvizëse dhe sistemeve të transportit. Ky program e përgatit individin për të kontribuar në zhvillimin e teknologjive të reja dhe për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme dhe efikase për sfidat e industrisë.	Fushat tipike për punësim janë rinovimi dhe zhvillimi i prodhimit, planifikimi i tjellë, menaxhimi i sistemeve komplekse si specialist i pavarur i punësuar në ndërmarrje / organizata publike apo private. Mbajtësi i diplomës Master i Shkencave mund të punësohet në industritë e prodhimit dhe përpunuese; në impiantet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë; në ndërmarrje/organizata publike apo private për projektimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të shërbimit; në ndërmarrje apo organizata që veprojnë në sferën e shërbimeve dhe të administrimit publik, si dhe në kompani që ofrojnë shërbime energjitike.
		Master Profesional në Inxhinieri Transporti	**Cikli i Dytë Master Profesional**	Ka si qëllim tu ofrojë të diplomuarve, që zotërojnë një diplomë të nivelit të parë ne Inxhinieri Mekanike Bachelor kompetenca të mëtejshme profesionale për problemet e planifikimit të sistemeve të transportit, menaxhimit të trafikut dhe sigurisë rrugore në përgjithësi.	Mbajtësi i diplomës kombinon aftësitë teknike, profesionale dhe komunikuese me kontekstin kulturor, gjë që i jep atij mundësinë të punojë në funksione me profil të lartë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.	Specialistet e këtyre fushave mund të punësohen në institucione, kompani dhe organizata të ndryshme shtetërore dhe private në sektorin e trafikut të tilla si: 1. Sekretariatet (qendrat) e trafikut; 2. Qendrat për shërbimet publike; 3. Ministrinë e Transportit - drejtoritë e trafikut dhe sigurisë rrugore; 4. Institucionet e urbanizimit; 5. Agjencitë e organizuara në trafik dhe/ose agjencitë e zhvillimit në një seri më të gjerë; 6. Institutet, agjencitë e angazhuara në planifikim. 7. Agjencitë publike të zhvillimit urban; 8. Kompani konsulente; 9. Kompani projektuese.
		Bachelor në Inxhinieri Tekstile e Modë	**Cikli i Parë Bachelor**	Të diplomuarit e programit "Bachelor" në Inxhinieri Tekstile dhe Modë kanë aftësi të plota për t'u angazhuar në zbatimin e projekteve inxhinierike, duke u përfshirë në fazat e ndryshme të krijimit dhe administratës së sistemeve inxhinierike tekstile. Ata janë të aftë të menaxhojnë dhe monitorojnë procese të ndryshme për mirënbajtjen dhe kontrollin e sistemeve tekstile, si dhe për të kontribuar në projektimin dhe zhvillimin e produkteve të reja. Gjithashtu, këta profesionistë mund të angazhohen në dizenjimin, projektimin dhe stilimin e veshjeve, duke aplikuar njohuri të thelluara mbi teknikat dhe teknologjitë moderne të industrisë së modës. Kompetencat e tyre mund të shtrihen edhe në fushën e menaxhimit të proceseve të prodhimit, zhvillimit të materialeve dhe analizave teknike, duke ofruar mundësi të ndryshme punësimi në industri të shumta, përfshirë tekstilin, modën dhe prodhimin e pajisjeve.	Inxhinieri i tekstilit dhe modës është i aftë të marrë vendime strategjike dhe të zgjidhë çështje operacionale në teknologjinë e prodhimit. Ai është në gjendje të projektuar zgjidhje duke përdorur metoda shkencore dhe inxhinierike, të cilat përfshijnë kuptueshmërinë, arsyetimin dhe modelimin, bazuar në një përgatitje të thelluar ndërdisiplinore. Kjo i mundëson atij të adresojë në mënyrë të përgjegjshme sfida dhe mundësi që lindin në mjedisin e ndërmarrjeve dhe industrisë, duke ofruar zgjidhje efektive dhe të qëndrueshme për problemet që mund të hasen.	Kompanitë e prodhimit të veshjeve ne vend, atelie te punësuar ose vetëpunësuar, ne çdo institucion shtetëror sipas fushës se ekspertizës.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Fakulteti	Departamenti	Programi i studimit	Cikli i studimit	Kompetencat në dalje	Realizimi i synimeve nga ana e përmbajtjes	Mundësitë e punësimit
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Departamenti i Tekstilit dhe Modës	Master i Shkencave në Inxhinieri Tekstili dhe Modë	Cikli i Dytë Master i Shkencave	Diploma Master i Shkencave ofron mundësinë për mbajtësin e saj të vazhdojë studimet në ciklin e tretë, përkatësisht në programet e doktoratës. Për të kaluar në këtë nivel studimi në fushën e inxhinierisë materiale ose në fusha të tjera të ngjashme, kandidati duhet të plotësojë të gjitha kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga Këshilli i Profesorëve, i cili është përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e studimeve doktorale. Ky proces i mundëson kandidatit të thellojë njohuritë e tij dhe të zhvillojë aftësi kërkimore, duke kontribuar në avancimin e fushës së inxhinierisë materiale dhe disiplinave të ngjashme.	Mbajtësi i diplomës Master i Shkencave mund të projektojë dhe veré në zbatim probleme dhe zgjidhje teknike komplkse të industrisë tekstile, të prodhimit të veshjeve, lëkurës dhe këpucëve; ai ka njohuri të thelluara mbi materialet tekstile, përdorimin , projektimin, prodhimin, kontrollin e cilësisë së produktit, makinerinë dhe pajisjet, testimet laboratorike, teknologjinë e informacionit dhe dixhitalizimin në këtë sektor të industrisë, kontrollin dhe optimizimin e proceseve për menaxhimin e burimeve, prodhimin e pastër dhe pa mbetje, trajtimin e mbetjeve teknologjike. Njohuritë mbi aspektet teknologjike i mundësojnë mbajtësit të diplomës Master i Shkencave ne Inxhinieri Tekstile e Mode, të këtë formim te plote mbi lëndën e paré, procesel, produktet përfundimtare, teknologjinë dhe inovacionin dhe aplikimet e materialeve tekstil në çdo fushë ku ato gjejnë zbatim.	Fusha tipike, nën këtë këndvështrim, janë rinovimi dhe zhvillimi i prodhimit, planifikimi i thellë, menaxhimi i sistemeve komplekse si specialist i pavarur i punësuar në ndërmarrje/organizata publike apo private. Mbajtësi i diplomë master i shkencave mund të punësohet në industritë e prodhimit dhe përpunimeve; në ndërmarrje që zhvillojnë veprimtaritë e tyre në sistemet e prodhimit të tekstili dhe industrinë e modës si edhe ndërmarrjet apo organizatat që veprojnë në sferën e shërbimeve dhe të administrimit publik.
		Bachelor në Inxhinieri Materiale	Cikli i Parë Bachelor	Kompetencat në dalje të BSc në Inxhinieri Materiale përfshijnë njohuri të thella për sektorët e ndërmarrjeve prodhuese dhe përpunuese, veçanërisht në zyrat teknike. Ky program i mundëson studentëve të bashkëpunojnë në mënyrë efektive për; - Përzgjedhjen e materialeve të duhura për procese të ndryshme prodhimi; - Hartimin e cikli teknologjik të prodhimit, duke siguruar që procesel të jenë të optimizuara dhe efikase; - Krijimin e protokolleve të kontrollit, për të siguruar cilësinë dhe standardet e nevojshme gjatë prodhimit.	BSc në Inxhinieri Materiale fokusohet në zhvillimin e aftësive që mundësojnë punësimin dhe performancën efikase në fusha tipike të industrisë. Në këtë kontekst, një fushë kyçe është industria e prodhimit dhe përpunimit të materialeve, ku diplomuarit mund të kontribuojnë si specialistë të pavarur në menaxhimin dhe optimizimin e proceseve të prodhimit. Po ashtu, ata janë të aftë të drejtojnë sisteme komplekse dhe të punojnë në mënyrë të pavarur në ndërmarrje dhe organizata të sektorëve publikë apo privatë, duke aplikuar njohuritë dhe aftësitë e tyre teknike dhe menaxheriale për të siguruar efikasitet dhe inovacion në procesel e prodhimit.	Mbajtësi i diplomës Bachelor mund ta ushtrojë profesionin e tij: •Në ndërmarrjet për prodhimin ose për përpunimin e materialeve metalike; •Në ndërmarrjet për prodhimin ose për përpunimin e materialeve qeramike dhe qelqore; •Në ndërmarrjet për prodhimin ose për përpunimin e materialeve; polimerike dhe kompozite; •Në laboratorë industriale ose kërkimi, publike ose private, që merren me testimin dhe kontrollin e materialeve; •Ne arsim, për mbulimin e lëndëve të fushës.
		Bachelor në Inxhinieri Ekonomike		BSc në Inxhinieri Ekonomike ofron aftësitë për të kuptuar dhe menaxhuar proceset teknologjike të prodhimit, duke përfshirë njohuritë për makinerinë, pajisjet dhe vizatimet e detajuara të punës. Ky program zhvillon aftësitë për të analizuar dhe përmirsuar zhvillimin e prodhimit dhe sistemeve të prodhimit, si dhe për të realizuar llogaritjen e kostos dhe normimin teknik të punës. Diplomantët janë të aftë të punojnë si specialistë të pavarur, duke u angazhuar në ndërmarrje dhe organizata publike ose private, ku mund të kontribuojnë në optimizimin e proceseve dhe rritjen e efikasitetit në menaxhimin e burimeve dhe kostove.	Ky program i mundëson diplomuarit zhvillimin e të menduarit kritik, duke u mundësuar atyre të kombinojnë aftësitë teknike të zgjidhjes së problemeve inxhinierike me aftësitë menaxheriale. Ai gjithashtu përgatit studentët për të vlerësuar kostot dhe investimet e ndërmarrjeve, duke përfshirë një analizë të thelluar të aspektit ekonomiko-menaxherial në kontekstin e riorganizimit të proceseve të biznesit. Studentët gjithashtu do të mësojnë si të planifikojnë projekte dhe si të monitorojnë dhe kontrollojnë avancimin e aktiviteteve të këtyre projekteve, duke siguruar përmbushjen e objektivave të planifikuara.	Mbajtësi i diplomës Bachelor në Inxhinieri Ekonomike ka mundësi punësimi në një gamë të gjerë sektorësh, duke përfshirë industritë e prodhimit dhe përpunimit, si dhe në fushën e menaxhimit të cilësisë dhe kontrollit të cilësisë ISO. Ai mund të angazhohet në ndërmarrje që operojnë në sistemet e prodhimit të produkteve industriale, si dhe në organizata që punojnë me procese të avancuara prodhimi dhe optimizimi të tyre. Përveç kësaj, mund të punojë edhe në sektorin publik, duke kontribuar në zhvillimin dhe mbikëqyrjen e projekteve dhe proceseve të tëndësisëme për menaxhimin e burimeve, kostove dhe zhvillimin e qëndrueshëm të organizatave.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Sh. DK.

Fakulteti	Departamenti	Programi i studimit	Cikli i studimit	Kompetencat në dalje	Realizimi i synimeve nga ana e përmbajtjes	Mundësitë e punësimit
	Departamentit i Prodhim Menaxhimit	Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, Profili Prodhim dhe Menaxhim Industrial	Cikli i Dytë Master i Shkencave	Projektimi i produkteve dhe procesi teknologjik i prodhimit të tyre, zhvillimi i prodhimit dhe sistemeve të prodhimit, planifikimi i prodhimit, menaxhimi i sistemeve komplekse dhe të automatizuara të prodhimit si specialist i pavarur i punësuar në ndërmarrje/organizata publike apo private.	Mbajtësi i diplomës Master i Shkencave ka aftësi dhe mjete intelektuale për të planifikuar dhe udhëhequr procese kërkimi inovative të mirëfillta apo të zbatuara. Njohuritë dhe aftësitë e fituara i japin mundësi titullarit të vejë në përdorim mjete, metoda, dhe metodologji në mënyrë që të bëjnë të mundur planifikimin e zgjidhjeve në ndërmarrje, industri dhe në menaxhim.	Mbajtësi i diplomës master i shkencave mund të punësohet në industritë e prodhimit dhe përpunuese; të kontrollit të cilësisë dhe sistemeve të cilësisë ISO në ndërmarrje që zhvillojnë veprimtaritë e tyre në sistemet e prodhimit të produkteve industriale dhe në sektorin publik ose privat.
		Master i Shkencave në Inxhinieri Ekonomike		Ky formim ndërdisiplinor, me aplikime të ndryshme, përbën një avantazh të madh për integrimin profesional të studentëve: 1. Ai thellohet në planifikimin e strategjive të prodhimit, organizimin dhe kontrollin e tij, strategjitë e kapacitetit, menaxhimin e zinxhirit të furnizimit dhe logjistikës; 2. Ai thellohet në teknologjitë e reja të prodhimit dhe automatizimit industrial; 3. Ai thellohet në analiza të rentabilitetit, politikave financiare të investimeve, analizës së tregut dhe rrezikun financiar; 4. Ai thellohet në menaxhimit të cilësisë, menaxhimit të riskut në ndërmarrje; 5. Ai thellohet në metodat e kërkimit të tregut dhe teknikat e mbledhjes së informacionit. planifikimin e marketingut, analizën e produktit dhe vendosjen e emrimit.	Mbajtësi i diplomës Master Shkencor ka aftësi dhe mjete intelektuale për të planifikuar dhe udhëhequr procese kërkimi inovative të mirëfillta apo të zbatuara. Njohuritë dhe aftësitë e fituara i japin mundësi titullarit të vejë në përdorim mjete, metoda, dhe metodologji në mënyrë që të bëjnë të mundur planifikimin e zgjidhjeve në ndërmarrje, industri dhe në menaxhim.	Studentët në këtë cikël studimesh pajisen me njohuri që duhen për studim, projektim e zbatim në fusha të tilla të rëndësishme të ekonomisë si financa, menaxhimi, menaxhimi i riskut, menaxhimi i cilësisë, teknologjitë mekanike dhe sistemet e prodhimit, logjistika etj. •Banka të nivelit të dytë, •Kompani prodhimi, •Kompani shërbimesh, si menaxherë të nivelit të mesëm. •Në strukturat shtetërore qendrore dhe lokale si: -Menaxherë projektesh; -Në zyra urbanistike; -Në planifikim dhe menaxhim transporti etj.
		Master i Shkencave në Inxhinieri Materiale, Profili Materiale		I diplomuari në Inxhinierinë e Materialeve është i aftë që: 1. Në sektorët e ndërmarrjeve prodhuese dhe përpunuese (në zyrat teknike), të bashkëpunojë: - në përzgjedhjen e materialeve, -në hartimin e cikli teknologjik të prodhimit, -në hartimin e protokollit të kontrollit; 2. Në repartet e prodhimit: të koordinojë aktivitetin e drejtimit të implanteve për prodhimin e materialit ose transformimin e tij në produkt; 3. Në Laboratore kërkimi ose prodhimi; -të mbikqyrë kryerjen e provave, -të interpretojë dhe analizojë rezultatet. -të dialogojë me përgjegjësit mbi optimizimin e vetive të materialit.	Mbajtësi i diplomës M.Sc. kombinon aftësitë teknike, shkencore dhe komunikuese me kontekstin kulturor, gjë që i jep atij mundësinë të punojë në funksione me profil të lartë në nivel ndërkombëtar.	Inxhinieri i Materialeve mund ta ushtrojë profesionin e tij: 1. Në ndërmarrjet për prodhim ose për përpunimin e materialeve metalike; 2. Në ndërmarrjet për prodhimin ose për përpunimin e materialeve qeramike dhe qelqore; 3. Në ndërmarrjet për prodhimin ose për përpunimin e materialeve polimerike dhe kompozite; 4. Në laboratore industriale ose kërkimi, publike ose private, që merren me testimin dhe kontrollin e materialeve; 5. Në arsim, për mbulimin e lëndës të fushës.
		Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, Profili Energjetikë		Mbajtësi i diplomës mund të projektojë, realizojë, menaxhojë dhe mirëmbajë sisteme komplekse të industrisë së prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, si dhe të aktiviteteve prodhuese të tjera; ai ka njohuri mbi mjetet dhe metodologjitë e realizimit të projekteve, që i japin atij mundësi të realizojë sisteme komplekse në fushë të ndryshme zbatimi. Mbajtësi i diplomës kombinon aftësitë teknike, shkencore dhe komunikuese me kontekstin kulturor, gjë që i jep atij mundësinë të punojë në funksione me profil të lartë në nivel ndërkombëtar.	Mbajtësi i diplomës master ka aftësi dhe mjete intelektuale për të planifikuar dhe udhëhequr procese kërkimi inovative të mirëfillta apo të zbatuara. Njohuritë dhe aftësitë e fituara i japin mundësi titullarit të vërë në përdorim mjete dhe metodologji në mënyrë që të menaxhojnë situata dhe te planifikojnë zgjidhje ne sferën e sistemeve reale.	Fushat tipike për punësim janë rinovimi dhe zhvillimi i prodhimit, planifikimi i thellë, menaxhimi i sistemeve komplekse si specialist i pavarur i punësuar në ndërmarrje / organizata publike apo private. Mbajtësi i diplomës Master i Shkencave mund të punësohet në industritë e prodhimit dhe përpunuese, në impiantet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë; në ndërmarrje/organizata publike apo private për projektimin dhe mirëmbajtjen e impianteve të shërbimit; në ndërmarrje apo organizata që veprojnë në sferën e shërbimeve dhe të administrimit publik, si dhe në kompani që ofrojnë shërbime energjitike.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Fakulteti	Departamenti	Programi i studimit	Cikli i studimit	Kompetencat në dalje	Realizimi i synimeve nga ana e përmbajtjes	Mundësitë e punësimit
	Departamenti i Energjitikës	Master i Shkencave në Menaxhim Energjie	Cikli i Dytë Master i Shkencave	Mbajtësi i diplomës fiton aftësitë për krijimin e një figure të re të "Menaxherit të Energjisë", si një ekspert i kualifikuar, i aftë të operojë nga ana teknike, ekonomike dhe legjislative për problemet që lidhen me menaxhimin e energjisë dhe përmirësimin e performancës energjetike në sektorin industrial dhe të ndërtesave; të zotërojë një panoramë globale të gjithë proceseve transformuese energjetike, nga prodhimi deri tek përdoruesit fundorë, që të mund të kryejë zgjedhje efiçente të sistemeve të avancuara të prodhimit dhe përdorimit të energjisë; të ketë njohuritë bazë të problematikave mjedisore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm, të njohë parimet bazë të auditimit të energjisë dhe metodologjinë e realizimit të tij. Mbajtësi i diplomës kombinon aftësitë teknike, shkencore dhe komunikuese me kontekstin kulturor, gjë që i jep atij mundësinë të punojë në funksione me profil të lartë në nivel ndërkombëtar.	Mbajtësi i diplomës master ka aftësi dhe njohuri intelektuale për të planifikuar dhe udhëhequr aktivitete kërkimi inovative bazë apo të zbatuara. Njohuritë dhe aftësitë e fituara i japin mundësi te diplomuarit të vërë në përdorim njohuri dhe metodologji në mënyrë që të menaxhojë situata te ndryshme dhe te planifikojë zgjidhje në sferën e sistemeve reale.	Mbajtësi i diplomës "Master i Shkencave" mund të punësohet në industritë e prodhimit dhe përpunuese; •Në implantet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë; në ndërmarrje/organizata publike apo private për monitorimin e përdorimit dhe konsumit të burimeve energjetikë, për hartimin e strategjive dhe planeve për përmirësimin e eficencës energjetike në sektorin industrial, te shërbimeve, transporti dhe të ndërtesave; •Në ndërmarrje apo organizata që veprojnë në sferën e shërbimeve dhe të administrimit publik. •Në kompani që ofrojnë shërbime energjetike.
		DOUBLE DEEGRE NË: Master i Shkencave në Inxhinieri Mekanike, Profili Energjitikë		Mbajtësi i diplomës së dyfishtë mund të projektojë, realizojë, menaxhojë dhe mirëmbajë sisteme komplekse të industrisë së prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, si dhe të aktiviteteve prodhuese të tjera; ai ka njohuri mbi mjetet dhe metodologjitë e realizimit të projekteve, që i japin atij mundësi të realizojë sisteme komplekse në fusha të ndryshme zbatimi. Mbajtësi i diplomës kombinon aftësitë teknike, shkencore dhe komunikuese me kontekstin kulturor të fituar ne saje te faktit qe ky program studimi zhvillohet në bashkëpunim me një universitet të një vendi të BE që është Universiteti UNITUS (Itali), gjë që i jep mundësinë te diplomuarit të punojë në funksione me profil të lartë në nivel ndërkombëtar.	Mbajtësi i diplomës së dyfishtë master zoteron aftësi dhe njohuri intelektuale për të planifikuar dhe udhëhequr aktivitete kërkimi inovative bazë ose të zbatuara. Njohuritë dhe aftësitë e fituara i japin mundësi titullarit të vërë në përdorim njohuri dhe metodologji për të menaxhuar situata te ndryshme dhe per t'i dhenë zgjidhje problemeve në sferën e sistemeve reale.	Mbajtësi i diplomës "Master i Shkencave" mund të punësohet në industritë e prodhimit dhe përpunuese; •Në implantet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë; në ndërmarrje/organizata publike apo private për monitorimin e përdorimit dhe konsumit të burimeve energjetikë, për hartimin e strategjive dhe planeve për përmirësimin e eficencës energjetike në sektorin industrial, te shërbimeve, transporti dhe të ndërtesave; •Në ndërmarrje apo organizata që veprojnë në sferën e shërbimeve dhe të administrimit publik. •Në kompani që ofrojnë shërbime energjetike.
		Kurs i formimit të vazhduar "Auditim Energjie në Ndertesa"		Në përfundim te këtij kursi, personi i certifikuar është në gjendje të realizojë auditimin energjetik, dhe vlerësimin e performancës energjetike të tipeve të ndryshme të ndërtesave të përeaktuara nga kuadri ligjor përkatës.	Realizimi i një raporti auditimi energjitik dhe VPE në ndërtesa	Në sektorin publik dhe privat
		Kurs i formimit të vazhduar "Auditim Energjie në Procese"		Në përfundim të këtij kursi, personi i certifikuar është në gjendje të realizojë auditimin energjetik, në procese (të një impianti të plotë apo të komponenteteve të vecantë që janë konsumatore të energjisë sipas kuadrit ligjor përkatës.	Realizimi i një raporti auditimi energjitik në procese	Në sektorin publik dhe privat

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS SEKRETARIA

Fakulteti	Departamenti	Programi i studimit	Cikli i studimit	Kompetencat në dalje	Realizimi i synimeve nga ana e përmbajtjes	Mundësitë e punësimit
Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Departamenti i Inxhinierisë Matematike	Bachelor në Inxhinierinë Matematike	Cikli i Parë Bachelor	I aftë të ndjekë studime të një niveli më të lartë në studimin e sistemeve komplekse, në të cilët është prezente një ndërthurje e fortë midis njohurive teknike-shkencore të ndryshme, duke shfrytëzuar në mënyrë inxhinierike metodologjitë që ofrojnë sektorët e ndryshëm të Matematikës së Zbatuar.	Janë realizuar të gjithë synimet nga ana e përmbajtjes	Kompanitë e menaxhimit të të dhënave; në përdorimin e teknologjisë kompjuterike dhe softeve matematike;në teknologjitë Web, të aplikimeve grafike dhe multimediale;në organizimin e sigurisë dhe mbrojtjes së sistemeve të trafikut në rrjeta, etj.
		Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike	Cikli i Dytë Master i Shkencave	Mbajtësi i diplomës "Master i Shkencave" ka kompetencë për modelimin matematik të një sërë fenomenesh inxhinierike në gjeologji, hidrogjeologji, inxhinieri mekanike dhe elektrike.	Janë realizuar të gjithë synimet nga ana e përmbajtjes	Kompani në fushën e trajtimit të të dhënave me metoda matematikore dhe statistikore; mund të bartojë programe specifike për sistemet e shërbimit, në auditime, në optimizim, planifikim dhe shpërndarjen e produkteve. Në laboratore shkencore, ku zbatohet teoria e eksperimenteve, teoria e sinjaleve dhe e sigurisë së funksionimit, programimit dinamik, teoria e rrezikut, studimet e ambjentit, metodat GIS, matjet antropometrike, studimi i tendecave te zhvillimit, parashikimet e zhvillimit te investimeve, llogaritjen e rezervave të burimeve të energjisë, etj.
		Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh	Cikli i Dytë Master Profesional	I aftë për t'u punësuar në zbatimin e projekteve inxhinierike, në modelimet dhe simulimet matematike në projektin e teknologjive të reja, në analizën e sistemeve komplekse, në përpunimin e strategjive dhe teknikave të reja të administrimit, në institucionet monitoruese të problemeve sociale-ekonomike, të territorit, të sigurimeve, në sistemin bankar, etj.	Janë realizuar të gjithë synimet nga ana e përmbajtjes	I diplomuari në profilin 'Analiza Sistemesh', në përputhje me njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve, është i aftë të ushtrojë veprimtari profesionale në një gamë të gjerë institucionesh dhe organizatash, si: ndërmarrje industriale, agjenci private dhe shtetërore, sektorin bankar, organizata të shoqërisë civile, institucione financiare, si edhe në studio këshillimore dhe kërkimore.
		Master Profesional në Inxhinieri Matematike, profili Aktuaristikë		Mbajtësi i diplomës kombinon aftësitë teknike, profesionale dhe komunikuese me kontekstin kulturor, gjë që i jep atij mundësinë të punojë si aktuar i autorizuar.	Janë realizuar të gjithë synimet nga ana e përmbajtjes	Mbajtësi i diplomës mund të punësohet në kompani/institucione/industri aktiviteti i të cilave lidhet me sigurimet e jetës dhe të jo-jetës, me skemat e pensioneve private dhe kolektive; në ndërmarrje që zhvillojnë veprimtaritë në sigurime dhe pensione private e kolektive, si dhe në institucione që veprojnë në sferën e mbikëqyrjes së sigurimeve dhe pensioneve.
		Doktoraturë në Inxhinieri Matematike	Cikli i Tretë Doktoraturë	I aftë të kryejë kërkime shkencore të pavarura në universitete dhe institucione të tjera të kualifikuara, publike ose private, duke vepruar si pjesë e një grupi udhëheqës specialistësh me nivel të lartë profesional dhe akademik	Janë realizuar të gjithë synimet nga ana e përmbajtjes	Mbajtësi i gradës shkencore 'Doktor' në Inxhinieri Matematike mund të punësohet si personel akademik në universitete dhe institucione të arsimit të lartë, si dhe si profesionist në fusha të ndryshme të shkencave inxhinierike. Ai është i aftë të punojë në një mjedis multidisiplinar dhe ndërkombëtar, në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm të fushës përkatëse. I pajisur me aftësi të avancuara kërkimore dhe analitike, ai mund të udhëheqë përpunimin teknologjik në vend, të realizojë sinteza dhe vlerësime kritike, si dhe të kontribuojë në zgjidhjen e problemeve komplekse në kërkim, inovacion dhe në fusha të tjera të shoqërisë
	Departamenti i Inxhinierisë Fizike	Bachelor në Inxhinierinë Fizike	Cikli i Parë Bachelor	I aftë të ndjekë studime të një niveli më të lartë në fushën e optikës së zbatuar, shkencave materiale, fizikës mjedisore.	Janë realizuar të gjithë synimet nga ana e përmbajtjes	•Kompanitë e menaxhimit të të dhënave; • Mirëmbajtës rrjeti; •Ekspert mjedisor; •Kompanitë e energjive të ripërtëritshme, etj.
		Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike Profili Fizikan Mjekësor	Cikli i Dytë Master i Shkencave	Specialist në radioterapi, diagnostike, radiombrojtje dhe fizikë e mjekësisë bërthamore.	Janë realizuar të gjithë synimet nga ana e përmbajtjes	Në qendrat diagnostikuese, rehabilituese, radiombrojtje, mjekësisë bërthamore, etj.
		Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike Profili Inxhinier Fizike		Specialist për mirëmbajtje rrjeti të dhënash, pajisjesh bionjekësore, sizmologji, metrologji, karakterizues materialesh, optoelektronike, etj.	Janë realizuar të gjithë synimet nga ana e përmbajtjes	Në kompanitë e menaxhamit të të dhënave, banka, industrinë e pajisjeve bionjekësore (fabrikim, instalim dhe mirëmbajtje), institutet kërkimore (shkenca materiale, sizmologji, metrologji, energjitë e ripërtëritshme, optoelektronikës).
		Doktoraturë në Inxhinieri Fizike	Cikli i Tretë Doktoraturë	I aftë që të kryejë punë kërkimore shkencore të pavarur në Universitetet dhe institucione te tjera të kualifikuara, publike apo private, si pjesë e një klase udhëheqëse specialistësh me nivel të lartë profesional.	Janë realizuar të gjithë synimet nga ana e përmbajtjes	Mbajtësi i gradës shkencore "Doktor" në Inxhinierinë Fizike mund të punësohet si personel akademik në Universitet, profesionist në fusha të shkencave inxhinierike, fizikës së zbatuar në industri, komunikim, energjitë e rinovueshme dhe shkencat mjekësore.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Fakulteti	Departamenti	Programi i studimit	Cikli i studimit	Kompetencat në dalje	Realizimi i synimeve nga ana e përmbajtjes	Mundësitë e punësimit
	Departamenti i Inxhinierisë Kimike	Bachelor në Inxhinieri Kimike	Cikli i Parë Bachelor	Në përfundim të programit të studimit kompetencat e studentëve janë: a) metodologjitë bashkohore të projektimit dhe funksionimit të teknologjive industriale të prodhimeve kimike inorganike, organike, ushqimore, etj; b) zgjidhjen e problemeve konkrete të projektimit dhe menaxhimit; c) metodat e prodhimit kimik, materialeve dhe standardeve të cilësisë dhe specifikimeve teknike; d) projektimin e pajisjeve të impianteve kimike dhe hartimin e proceseve të prodhimit; e) prova dhe kontrolle për nivelin e kontrollit të procesit të prodhimit kimik; f) llogaritsin kostot e prodhimit dhe progres riporte të prodhimit dhe menaxhimit; g) zhvillojnë procedurat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në prodhimin kimik. etj;	Studentët janë në vitin e dytë ndërsa është hapur viti i parë. Studimet përparojnë sipas programit të miratuar.	Disa nga mundësitë e punësimit për inxhinierët kimikë janë në: 1. Industri Kimike: Inxhinierët kimikë janë të kërkuar në industrinë kimike për të zhvilluar dhe menaxhuar proceset e prodhimit të produkteve kimike, duke përfshirë plastikën, industrinë farmaceutike, detergjentet dhe materiale të kujdesit personal, etj. 2. Industri të Naftës dhe e Gazit: Inxhinierët kimikë punësohen në industrinë e naftës dhe e gazit, për të zhvilluar dhe menaxhuar proceset e rafinimit të naftës dhe të gazit, dhe për të shpërndarë produkte të rafinuar në treg. 3. Energji dhe Mjedis; Inxhinierët kimikë krijojnë teknologji të avancuara për prodhimin e energjisë së pastër dhe të qëndrueshme, duke përfshirë energjinë e rinovueshme dhe baterinë. Ata gjithashtu mund të punojnë në zhvillimin e teknologjive për trajtimin e ujërave të zeza dhe për menaxhimin e mbeturinave industriale. 4. Teknologji të Përpunimit të Materialeve: Inxhinierët kimistë përdoren për të zhvilluar teknologji për përpunimin e materialeve të ndryshme, si dhe për të menaxhuar proceset e prodhimit në industritë e përpunimit të metaleve, plastikës, ineteve, etj). 5. Shërbime Këshimore dhe Konsulencë: Inxhinierët kimikë punësohen në shërbimet këshimore dhe konsulencë, për organizata shkencore, laboratorë, institucione akademike dhe kompani konsulencë për të ofruar ekspertizën e tyre në fushën e inxhinierisë kimike. 6. Industri Ushqimore: Inxhinierët kimistë punësohen në industritë e ushqimit dhe pijeve, për të zhvilluar procese të prodhimit dhe për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e produkteve ushqimore dhe të pijeve.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
SEKRETARIA

Fakulteti	Departamenti	Programi i studimit	Cikli i studimit	Kompetencat në dalje	Realizimi i synimeve nga ana e përmbajtjes	Mundësitë e punësimit
	Departamenti i Konstruksioneve të Ndërtimit dhe Infrastrukturës së Transportit	Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi	Cikli i Parë Bachelor	Nëpërmjet këtij programi, synohet pajisja e inxhinierit me një formim të plotë në shkencat ekzakte matematikë fizikë, kimi, teori strukturash si edhe njohuritë bazë në lëndët aplikative.	Inxhinieri i Ndërtimit me diplomë Bachelor, është i aftë të realizojë të gjitha studimet lidhur me fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit sipas kompetencave dhe objektiva që ka ky program në përmbajtje të tij.	Diploma "Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi" i krijon mundësi punësimi, në zbatimin e projekteve inxhinierike, në fushën e ndërtimit të ndërtesave dhe veprave të infrastrukturës së Hekurudhave.
		Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, Profili Strukturist	Cikli i Dytë Master i Shkencave	I diplomuari në këtë profil zotëron njohuri njohuri të thella në lëndët e formunit të përgjithshëm të inxhinierit si probabilitetit, statistikë si edhe të shkencave bazë. Ai do të jetë në gjendje të përdori këto njohuri për të interpretuar problemet e Inxhinierisë së Ndërtimit në drejtimin e Strukturist, projektues veprash ndërtimi. I diplomuari në këtë profil zotëron njohuritë e plota teorike mbi llogaritjet e thelluara në konstruksioneve prej betoni të armuar dhe të paranderur. I diplomuari do të jetë në gjendje të projektojë dhe përcaktojë specifikimet teknike të punimeve të ndërtimit, të njohë dhe zbatojë rregullat dhe normat e projektimit me prioritet euronormat,etj furnizimit me ujë, kanalizimeve.	Inxhinieri i Ndërtimit me diplomë Master i Shkencave, në Profilin Strukturist është i aftë të realizojë të gjitha studimet lidhur me fushën e e tij të ekspertizës sipas kompetencave dhe objektivave që ka ky program në përmbajtje të tij.	Pas përfundimit të këtij cikli studimesh ky inxhinier është plotësisht në gjendje të ushtrojë këtë profesion në në fushat e lartpërmendura si në institucione publike ashtu dhe ato private. Inxhinieri i këtij profili është në gjendje të mbulojë edhe detyrat e inxhinierit të zbatimit apo projektimit për këtë fushë, për rrjedhojë ai mund të jetë drejtues teknik në shoqëritë e ndërtimit apo të projektimit të këtij konteksti. I diplomuari mund të punojë në profesion të lirë, pasi ka fituar të drejtën e marrjes së licenses nga institucionet kompetente.
		Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, Profili Infrastrukturë e transportit		I diplomuari është në gjendje të projektoje rrugë, hekurudha, aeroporte, ura, tunele etj., si dhe të realizojë ndërtimin e tyre. Ai do të jetë në gjendje të realizojë zbatimin e këtyre punimeve edhe në koordinim me specialistë të tjerë si në fushat e arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit dhe gjeodezisë.	Master i Shkencave, në Inxhinieri Ndërtimit Profili Infrastrukturë Transporti është i aftë të realizojë të gjitha studimet lidhur me fushën e e tij të ekspertizës sipas kompetencave dhe objektiva që ka ky program në përmbajtje të tij.	Pas përfundimit të këtij cikli studimesh ky inxhinier është plotësisht në gjendje të ushtrojë këtë profesion në në fushat e projektimit dhe zbatimit të veprave të infrastrukturës së transporteve si në institucione publike ashtu dhe ato private.
		Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, Profili Gjeoteknikë		I diplomuari është në gjendje të projektojë rrugë, hekurudha, aeroporte, ura, tunele etj si dhe të realizojë ndërtimin e tyre. Ai do të jetë në gjendje të realizojë zbatimin e këtyre punimeve edhe në koordinim me specialistë të tjerë si në fushat e arkitekturës, urbanistikës, gjeodezisë, e mjedisit etj.	Inxhinieri i Ndërtimi me diplomë Profili Gjeoteknikë është i aftë të realizojë të gjitha studimet lidhur me fushën e e tij të ekspertizës sipas kompetencave dhe objektivave që ka ky program në përmbajtje të tij.	Pas përfundimit të këtij cikli studimesh ky inxhinier është plotësisht në gjendje të ushtrojë këtë profesion në në fushat e projektimit dhe zbatimit të veprave të infrastrukturës së transporteve si në institucione publike ashtu dhe ato private. Ai mund të jetë drejtues teknik në shoqëritë e ndërtimit apo të projektimit të këtij konteksti.
	Departamenti i Hidraulikës dhe Hidroteknikës	Bachelor në Inxhinierinë Hidroteknike	Cikli i Parë Bachelor	Inxhinier në fushën e zbatimit të projekteve Hidroteknike si: Diga Damba Ujësjellës Kanalizime Kullime Ujitje Porte Decare Hidrologji	Realizim i plotë	Punësim në sektorin e projekteve hidroteknike dhe civile
		Master i Shkencave në Inxhinieri Hidroteknikë	Cikli i Dytë Master i Shkencave	Inxhinier ne fushen e zbatimit & projektimit ne Hidroteknike si : Diga Damba Ujesjelles Kanalizime Kullime Ujitje Porte Decare Hidrologji	Realizim i plotë	Punësim në sektorin e projekteve hidroteknike dhe civile

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI POLITEKNIK TIRANË SEKRETARIA

Fakulteti	Departamenti	Programi i studimit	Cikli i studimit	Kompetencat në dalje	Realizimi i synimeve nga ana e përmbajtjes	Mundësitë e punësimit
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit		Master Profesional në Inxhinieri Hidroteknikë	Cikli i Dytë Master Profesional	Inxhinier ne fushen e zbatimit & projektimit ne Hidroteknike si : Diga Damba Ujesjelles Kanalizime Kullime Ujitje Porte Detare Hidrologji	Realizim i plotë	Punësim në sektorin e projekteve hidroteknike dhe civile
	Departamenti i Inxhinierisë së Mjedisit	Bachelor në Inxhinieri Mjedisi	Cikli i Parë Bachelor	Pjesëmarrje në projekte në fusha të ndryshme të mjedisit, si psh. Projektimi i sistemeve të ndryshme të ngrohjes e ftohjes së godinave; Trajtimi i ujrave dhe menaxhimi i burimeve ujore; Menaxhim i mbetjeve. Vlerësimi ndikimit në mjedis. Iejet e mjedisit, vlerësimi strategjik mjedisor; Cilësia e mjedisit, vlerësimi i rriskut ; Mbrojtje nga erozioni; Energjitë alternative, etj.	Inxhinieri i Mjedisit me diplomë Bachelor, është i aftë të realizojë të gjitha studimet lidhur me fushën e Inxhinierisë së Mjedist sipas kompetencave dhe objektiva që ka ky program në përmbajtje të tij.	Diploma "Bachelor në Inxhinieri Mjedisi" krijon mundësi punësimi, për studentët e diplomuar për tu punësuar në zbatimin e projekteve inxhinierike, në fushën e ujit dhe të energjisë. Të diplomuarit mund të punojnë në sektorin publik dhe atë privat si ekspertë të VNM-së dhe auditimit mjedisor si dhe në fushat e ndryshme të menaxhimit të mjedisit.
		Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, Profili Trajtim Uji	Cikli i Dytë Master i Shkencave	"Master i shkencave" në Inxhinieri Mjedisi, "Profili Trajtim Uji" ofron formim për të punuar në projektim, vënie në jetë dhe mirëmbajtje të sistemeve të furnizimit me ujë, kanalizimeve, impianteve të trajtimit të ujit të përdorur urban, impiantetet e prodhimit të ujit të pijshëm, menaxhim dhe trajtimin e mbetjeve urbane, kryerjen e studimeve mbi impaktet në mjedis dhe hartimin e projekteve për sistemimin e pellgjeve ujëmbledhës.	Inxhinieri i Mjedisit me diplomë Master i Shkencave, në Profilin "Trajtim Uji", është i aftë të realizojë të gjitha studimet lidhur me fushën e e tij të ekspertizës sipas kompetencave dhe objektiva që ka ky program në përmbajtje të tij.	I diplomuari "Master i Shkencave" mund të punësohet në kompanitë publike dhe private, në çdo sektor, të cilat ofrojnë apo përdorin burimet mjedisore, si edhe ndërmarrjet apo organizatat që veprojnë në sferën e shërbimeve dhe të administrimit publik.
		Master i Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, Profili Energjetikë		Aftësi dhe mjete intelektuale për të planifikuar dhe udhëhequr proçese kërkimi inovative të mirëfillta apo zbatim projektesh. Njohuritë dhe aftësitë e fituara i japin mundësi inxhinierit të vejë në përdorim mjete dhe metodologji në mënyrë që të bëjnë të mundur mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimin e zgjidhjeve në sferën e sistemeve realë.	Inxhinieri i Mjedisit me diplomë Master i Shkencave, në Profilin "Energjetikë", është i aftë të realizojë të gjitha studimet lidhur me fushën e e tij të ekspertizës sipas kompetencave dhe objektiva që ka ky program në përmbajtje të tij.	I diplomuari "Master i Shkencave" mund të punësohet në kompanitë publike dhe private, në çdo sektor, të cilat ofrojnë apo përdorin burimet mjedisore, si edhe ndërmarrjet apo organizatat që veprojnë në sferën e shërbimeve dhe të administrimit publik.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2227914, web: www.upt.edu.al

Fakulteti	Departamenti	Programi i studimit	Cikli i studimit	Kompetencat në dalje	Realizimi i synimeve nga ana e përmbajtjes	Mundësitë e punësimit
	Departamenti i Gjeodezisë	Bachelor në Inxhinieri Gjeodet	Cikli i Parë Bachelor	Kurrikula Bachelor u mundëson të diplomuarve të zgjerojnë kualifikimin e tyre me një program master të afërt ose të angazhohen drejtpërdrejt në fushat e listuara: • Detyrat e shërbimit gjeodezik. • Marrjen e të dhënave fushore. • Përpunimi dhe analiza shkencore e të dhënave hapësinore. • Vizualizimi i të dhënave hapësinore. • Administrimi dhe alokimi i shërbimeve gjeodezike dhe hartografike. Kurrikula Bachelor përcjell aftësitë e mëposhtme: **1. Aftësi profesionale dhe metodike:** • Aftësitë bazë në matematikë, gjeometri, fizikë dhe informatikë. • Njohuri në shkencat natyrore dhe gjeoshkencat. • Teoria, teknika dhe terminologjia bazë shkencore në Gjeodezi, Gjeodezi dhe Gjeoinformacion. • Njohuri për vlerësimin e parametrave dhe kontrollin e cilësisë në modelet statistikore. • Njohuri të sistemit juridik kombëtar me theks të veçantë të kadastrës kombëtare. **2. Aftësitë njohëse dhe praktike:** • Aftësi për një përvetësim të njohurive të pavarura me anë të literaturës teknike. • Aftësia për të integruar zhvillimet aktuale teknike në bazën e njohurive individuale. • Analizë shkencore e parnqitjes së problemit bazë brenda fushës së lëndës Gjeodezi. **3. Aftësitë sociale, aftësitë inovative dhe kreativiteti** • Prezantimi dhe diskutimi i ideve dhe punës. • Përpilimi i raporteve teknike. • Organizimi i operacioneve të ekipit teknik.	Programi i Studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeodezi ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e Departamentit të Gjeodezisë, si dhe në përputhje me strategjinë e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Gjeodezi ka për qëllim dhënien e njohurive të reja, për t'i pajisur studentët me njohuritë e nevojshme specifike për plotësimin e nevojave të tregut të punës, lidhur me fushat e Inxhinierisë së Gjeodezisë dhe të fushave të shkencave ne gjeodezi. Realizimi i synimeve: PO	Inxhinierët gjeodetë të diplomuar në Bachelor punojnë në shërbimet e planifikimit urban dhe të projekteve inxhinierike si Inxhinier Gjeodet, të vetëpunësuar ose si pjesë e kompanive gjeodezike apo të ndërtimit.
		Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeodezi	Cikli i Dytë Master i Shkencave	Programi "Master i Shkencave në GJEODEZI" i aftëson të diplomuarit për: Zgjidhjen e problemeve të ndryshme që lidhen me gjeodezinë dhe gjeo-informatikën, për intensifikimin e mëtejshëm të njohurive në mbështetje të vazhdimit të studimeve të doktoraturës (programi PhD), si dhe për një punësim të menjëhershëm në një sërë fushash si: • Inxhinier i Ndërtimit për Gjeodet (punë topografiko-inxhinierike për kryerjen e ndërtimit të objekteve civile, veprave të artit në rrugë, tunele) • Menaxhimi i operacioneve në administrimin e tokës (regjistrimi i pasurive dhe hipotekat) • Menaxhimi i Gjeo-të dhënave • Pozicionimi GNSS (aplikacione të bazuara në pozicionimin përmes satelitëve në inxhinierin e projektit të posaçëm që zbaton infrastrukturën-rrugë, hekurudhë, det, etj.) • Kompanitë dhe Organizatat Publike/Private Lokale/Ndërkombëtare • Konsulencë (lëndë, studime dhe projekte në fushën e infrastrukturës, turizmit, minierave, urbanizimit dhe sistemit të menaxhimit të tokës, etj.)	Programi i Studimit Master Shkencor në Inxhinieri Gjeodezi, ofrohet në përputhje me vizionin dhe misionin e Departamentit të Gjeodezisë, si dhe në përputhje me strategjinë e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Qëllimi i këtij programi studimi është të formojë specialistë të larte dhe të përgatisë shkencëtarë të riuj të fushave të Gjeodezisë, në Inxhinieri Gjeodezi dhe të përshtatshëm për tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera perëndimore. Realizimi i synimeve: PO	Inxhinierët gjeodetë të diplomuar në Master Shkencor punojnë në shërbimet e planifikimit urban dhe të projekteve inxhinierike si Inxhinier Gjeodet, të vetëpunësuar ose si pjesë e kompanive gjeodezike apo të ndërtimit. Inxhinierët Gjeodetë punojnë janë institucionet qeveritare apo të pushtetit lokal, si: Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Ndërtimit, Agjencia e Kadastrës (në Qendër apo në zyrat rajonale në rrethe), Zyrat e urbanistikës pranë Bashkive, etj.
